



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË SHOQËRTIVE PUBLIKE DHE INVESTIMEVE TË HUAJA

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË SPITALIN UNIVERSITAR TË
TRAUMËS TIRANË

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
TË PËRPUTHSHMËRISË
NË
SPITALIN UNIVERSITAR TË TRAUMËS, TIRANË**

Tiranë, Korrik 2023

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 3

II. HYRJA	9
1. Objektivat dhe qëllimi :	9
2. Qëllimi i auditimit :	10
3. Identifikimi i çështjes:	10
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të auditur lidhur me çështjen nën auditim: ...	10
5. Përgjegjësitë e audituesve:.....	10
6. Kriteret e vlerësimit:	10
7. Standardet e auditimit:.....	11
8. Metoda e auditimit.....	11
9. Dokumentimi i auditimit.....	11
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	11
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	11
2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.	12
2.2. Mbi hartimin, shqyrtimin, zbatimin dhe raportimin e programit ekonomik-financiar	16
2.3. Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënie e pagave dhe shpërblimeve.....	23
2.4. Mbi auditimin me zgjedhje të pagesave të kryera me anë të arkës dhe bankës, shpenzimeve administrative.....	30
2.4.1. Zbatimi i dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve me vlerë të vogël	34
2.5. Mbi mbajtjen e evidences kontabel, hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare, evidentimin, ndjekjen dhe pasqyrimin e debitoreve dhe kreditoreve, si dhe perlllogaritjen, njohjen, rregjistrimin dhe pagesën e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore.....	50
2.6. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike, lidhjen e zbatimin e kontratave.	56
2.7. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qera të aktiveve afatgjata materiale.....	120
2.8. Të ndryshme, që do të dalin gjatë auditimit	125
2.8.1. Evidenca dokumentare e qarkullimit të materialeve ortopedike.	125
1. Të ndryshme.	149
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	152
A. MASA ORGANIZATIVE.....	152
B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.	168
C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.	170
D. MASA DISIPLINORE	174
V. ANEKSE	186

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Auditimi i Spitalit Universitar i Traumës, Tiranë me synimin dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj, si dhe aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik), promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

2. Në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet më të rëndësishme të auditimit, paraqiten si më poshtë vijon.

Gjetje nr.	Përmbledhja e Gjetjes	Ref. me RPA	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Nga auditimi sipas pikës 2.8.1. te programit te auditimit “Evidenca dokumentare e qarkullimit të materialeve ortopedike”, rezulton se:</p> <p>Materialet ortopedike të tërhequra nga kryeinfermierja e bllokut operator qendror dhe që janë gjendje dhe inventar i shërbimit të ortopedisë për të 3 (tre) pavijonet e saj, qëndrojnë në ambientet e zyrës së kryeinfermieres të ndara e të vendosura në raft/dollap sipas furnitorëve (T., L. dhe O.).</p> <p>Në marrëveshjeve kuadër është përcaktuar që duhet të jetë prezent një specialist i këtyre firmave gjatë operacionit me setin e veglave që shërbejnë për montimin e implanteve.</p> <p><i>Në asnjë nen apo klauzolë në kontratën e furnizimit apo të marrëveshjes kuadër nuk është parashikuar që përfaqësuesi i firmës kontraktuese të ketë përveç setit të veglave që shërbejnë për montimin e protezave me komponentët e saj, të ketë me vete edhe materialet ortopedike të sjella jashtë SUT-së.</i></p> <p>Shkëmbimi i pretenduar i materialeve ortopedike, sipas strukturave përgjegjëse në SUT bëhet sepse këto materiale nuk janë gjendje sipas llojit dhe përmasave që kërkojnë mjekët kirurg operues gjatë realizimit të operacionit. Nga auditimi i sistemit të menaxhimit spitalor, rezulton se, te gjitha protezat dhe komponentët e tyre për 14 raste, ishin gjendje në bllokun operator qendror dhe në farmaci.</p>	Pika 2.8.1 Fq. 129-144	E lartë	<p>Drejtoria e financës, pranë SUT të krijoj dhe të llogarisë si zë më vete shpenzimet për materiale tek llogaria e shpenzimeve të materialeve të shërbimit të ortopedisë, për ti mundësuar sektorit të koston që të llogarisë dhe të raportoj këto shpenzime të ndara nga njëra tjetra.</p> <p>Drejtoria e financës të filloj të përgatisë një model bilanci mujor/vjetor dhe progresiv në lidhje me hyrjet daljet dhe gjendjen e materialeve ortopedike të identifikuar sipas kodit ATC dhe nr.serial (lote) dhe të raportoj për çdo muaj pranë Drejtorisë së Spitalit Universitar të Traumës, për të mundësuar ndjekjen dhe monitorimin e qarkullimit të materialeve ortopedike.</p> <p>Drejtoria e SUT, në bashkëpunim me kryeinfermierin dhe shefin e shërbimit të bllokut operator qendror dhe sektorin juridik të fillojnë hartimin e modelit të Proces Verbalit mbi administrimin e materialeve ortopedike të grupit sinteza, dhe regjistrin e veçantë për këto materiale, për të mundësuar gjurmën e auditit.</p> <p>Titullari i institucionit të përcaktoj nëpërmjet akteve administrative procedurat që duhen të ndiqen në lidhje</p>

<p>Për më shumë që shkëmbimet, nëse do të ishin të nevojshme duhet të ishin bërë vetëm nëpërmjet farmacisë, siç përcaktohet në nenin 5 të kontratës së furnizimit (Afatet e Lëvrimit dhe kushtet e lëvrimit) , e citoj:</p> <p><i>Të gjitha materialet do të sillen me anë të kontratës së furnizimit në SUT mund të ndërrohen (mallrat/materialet do të qëndrojnë te magazinuar në farmacinë e SUT) sipas përmasave dhe llojeve të kërkuara rast pas rasti. Çdo material që do të ndërrohet, duhet të pasqyrohet me anë të një procesverbali të cilin e firmosin përfaqësuesit e OE dhe përfaqësuesit e SUT që do të marrin pjesë gjatë operacioneve kirurgjikale rast pas rasti. Vlera e materialeve nuk do të ndryshojë nga ajo e kontratës së furnizimit.</i></p> <p>Referuar të dhënave të tabelave të mësipërme të cilat janë nxjerr nga regjistrat e protezave të sipërcituar, rezulton se ka mospërputhje të numrave serial për 14 rastet (pacient) në lidhje me materialet që janë vendosur pacientit, numrat serial (Loti) të materialeve që janë kërkuar për pacientin dhe nr. serial në kartelën e elektronike të këtyre 14 pacientëve.</p> <p>Kampioni i përzgjedhur prej 14 pacientë është përfaqësues për të gjitha të dhënat e materialeve ortopedike të implantuara tek këta pacientët, pasi të gjithë pacientët që janë të regjistruar në 3 (tre) regjistrat që përfshijnë periudhën 2021 dhe 2022, rezulton se nr.serial (Loti) i materialeve ortopedike nuk kanë përputhje midis materialeve të vendosura, atyre të kërkuara dhe atyre të shkarkuara në kartelën elektronike.</p>		<p>me materialet e sintezës që nga momenti i fillimit të sterilizimit të tyre duke i identifikuar sipas hyrje daljeve dhe numrave identifikues për nevojat e bllokut qendror operator.</p> <p>Nga ana e titullarit të institucionit të përcaktohet qarte gjithë procedura dhe të nxirren udhëzues se si do të dokumentohet nderimi <u>vetëm për rastet</u> që në magazine e farmacisë apo te pavianit nuk gjendet materiali ortopedik që nevojitet gjate ndërhyrjes kirurgjikale.</p> <p>Nga ana e Titullarit të Institucionit të emetohen akte administrative në lidhje me sasitë e nevojshme dhe të domosdoshme qe duhet të mbahen në ambientet e bllokut operator qendror në lidhje me materialet ortopedike, ku të përshkruhen procedura dhe udhëzues sesi ato do të lëvizin nga farmacia tek blloku operator qendror.</p> <p>Nga ana e Titullarit të Institucionit nëpërmjet akteve (urdhër, udhëzim) të përcaktohen procedura të qarta që duhen të ndiqen mbi administrimin e materialeve ortopedike te sintezës pas heqjes nga pacienti, seleksionimin e tyre mbi mundësinë e ripërdorimit për ato materiale që janë në gjendje të mirë.</p> <p>Drejtorja e financës të realizoj inventar te gjendjes se materialeve ortopedike ne ambientin e kryeinfermierit, te ballafaqoj me daljet e farmacisë dhe gjendjes fillestare te tyre gjate marrjes ne dorëzim nga farmacia.</p> <p>Drejtorja e Spitalit Universitar të Traumës të marrë masa që materialet oropedike që implantohen/vendosen tek pacienti të përputhen me materialet ortopedike sipas nr.serial (lotëve) që pasqyrohen në kartelën elektronike të pacientit tek moduli i koston në sistemin e menaxhimit spitalor SIIS.</p> <p>Nga drejtorja e SUT, të analizohet dhe të nxirren përgjegjësi për mos dokumentimin në regjistrat e mbajtur në bllokun operator qendror të materialeve ortopedike të përdorura gjatë ndërhyrjeve kirurgjikale, pasi për vitin 2021 nga ana e bllokut operator qendror, nuk janë dokumentuar 667 operacione dhe 811 për vitin 2022.</p>
---	--	---

2	<p>Nga auditimi i pikës 2.8.3. mbi ruajtjen e barnave dhe materialeve të mjekimit, rezulton se: Nga verifikimi i realizuar në datën 13.01.2023 i pasqyruar në akt verifikimin nr. 1 u verifikua një sasi e madhe e medikamenteve ishin pa vulën e kuqe me mbishkrimin “për përdorim spitalor ndalohet shitja”.</p> <p>Në Urdhrin nr.287 date 12.07.2022 i MSHMS, ku në piken 1 parashikohet se: <i>Barnat që qarkullojnë në sistemin shëndetësor publik përveç pullës së sigurisë duhet detyrimisht të jene të vulosura edhe me vulën me mbishkrimin ” Përdorim Spitalor-Ndalohet Shitja”.</i> dhe ne dhe në piken 4 te këtij urdhri përcaktohet se: <i>Boja që përdoret për stampimin e vulës të jetë me ngjyrë të kuqe që nuk fshihet</i></p> <p>Gjithashtu barnat dhe materialet e mjekimit të verifikuar në akt verifikimin e datës 13.01.2023, ruheshin në magazinën e mallrave të SUT, ku krahas mallrave gjendeshin dhe pajisje mjekësore jashtë përdorimit e me rrezikshmëri për shëndetin e njërit.</p> <p>Magazina e mallrave të SUT nuk plotëson në asnjë drejtim kushtet e ruajtjes së barnave duke shtuar këtu se në këtë ambient gjenden dhe pajisje mjekësore jashtë përdorimit si radiografi etj., kjo në mospërputhje me urdhrin nr.660 datë 20.09.2018 të MSHMS, për miratimin e rregullores mbi praktikën e ruajtjes dhe shpërndarjes së mirë të barnave, neni 5 pika 2 dhe nenet në vijim të këtij urdhri ku parashikohet se: <i>Zonat e magazinimit duhet të jenë të përshtatshme për të siguruar kushte të mira të ruajtjes. Në veçanti, ato duhet të jenë të pastra, brenda kufijve të temperaturës dhe lagështirës. Kushtet e ruajtjes duhet të sigurohen, kontrollohen, monitorohen sipas specifikimeve në etiketën e barit.</i> <i>Barnat nuk duhet të jenë në kontakt të drejtpërdrejtë me dyshemenë dhe muret e të kenë hapësirë të përshtatshme për të lejuar pastrimin dhe inspektimin.</i></p>	Pika 2.8.3 Fq. 151-154	E lartë	Drejtori i Spitalit të SUT, në raste të pa mundësisë për të magazinuar barna apo materiale mjekimi në Farmacinë qendrore duhet ti vendos ato në ambiente të sigurta dhe me kushte të mira të ruajtjes dhe në asnjë rast në magazinën e mallrave e cila është e pa përshtatshme për ruajtjen e këtyre barnave apo materiale mjekimi.
	<p>Nga auditimi i procedurës së Prokurimit me objekt “Furnizim me barna për nevojat e SUT, e ndarë në 19 lote”, rezulton se, në listën e barnave për përdorim spitalor të miratura nga MSHMS për vitin 2022, bari me princip aktiv Nadroparine Calcium me formë dozë 5700 IU Axa/0.6ml është bar i regjistruar dhe pjesë e kësaj liste.</p> <p>OE F.F. ka paraqitur ofertë për barin me principin aktiv Nadroparine Calcium me formë dozë 5700 IU Axa/0.6ml për njësi (një shiringe parapërgatitur) në shumën 455 lekë pa TVSH.</p> <p>Anëtarët e Njësisë së prokurimit të AK, SUT., kanë përcaktuar fondin limit për barin tregtar Fraxiparine, nga studimi i tregut, duke mos marrë parasysh çmimin e përcaktuar nga KCB në MSHMS si i vetmi komision ligjor për</p>	Pika. 2.6.4 Fq. 83-93	E lartë	Drejtuesi i institucionit të Spitalit Universitar të Traumës, të analizoj veprimtarinë e njësisë së prokurimit për këtë procedurë dhe kryesisht të komisionit të përcaktimit të specifikimeve teknike dhe të përlllogaritjes së fondit limit për barin me princip aktiv Nadroparine Calciumi dhe të nxjerr përgjegjësitë për secilin prej anëtarëve të këtij komisioni, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e shumës prej 1,011,255 lekë nga OE F.F.

<p>përcaktimin e çmimeve të barnave të listës së barnave për përdorim spitalor.</p> <p>OE F.f.ka ofertuar për barin Faksiparine i cili ka për princip aktiv Nadroparine Calciumi çmimin për njësi 455 lekë (një shiringë e parapërgatitur), ndërkohë që ky çmim duhej të ishte 434,7 leke dhe vlera totale e kontratës për 50000 copë duhej të ishte 21,738,745 leke.</p> <p>Pasi ne referim te shkresës nr.1775/3 prot datë 29.06.2023 të MSHMS çmimi CIF për për barin Faksiparine me princip aktiv Nadroparine Calciumi është 3.5 euro per shiring.</p> <p>Ne datën 31.08.2023 që është zhvilluar procedura, kursi i këmbimit zyrtar për 1 euro ka qënë 117.19 leke.</p> <p>Ne zbatim te VKM nr.143 date 18.02.2015 “Për përcaktimin e marzheve te tregtimit dhe fabrikimit të barnave” për grupin “ Gjaku dhe organet formuese te gjakut” në të cilën bënë pjesë dhe bari me princip aktiv Nadroparine Calciumi do te zbatohet nje marzh fitimi 6 %.</p> <p>Si rezultat do të kishim: $(3.5 * 117.19) * 1.06 = 434.7$ leke (nje shiring) $434.7 * 50,000$ shiringa = 21,738,745 leke duhej te ishte vlera e kontratës se lidhur me kontraktuesin. AK., SUT pas shpalljes fitues nga KVO, ka lidhur kontratë me OE FloriFarma për sasin 50,000 copë (shiringa të parapërgatitura) në shumën 22,750,000 lekë.</p> <p>Për sa më lart, shuma prej 1,011,255 lekë, e cila përfaqëson diferencën e çmimit të ofertuar dhe të shpallur fitues me atë të përcaktuar nga KCB të MSHMS duhej të ishte 434,7 lekë për njësi, përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të SUT.</p>			
<p>Nga auditimi i procedurës se prokurimit me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT” viti 2022, rezulton se:</p> <p>KVO ka kualifikuar OE L. në kushtet kur ky OE, nuk i plotësonte kërkesat e AK në lidhje me listën e paraqitjes së mostrave, duke vepruar në mospërputhje me kriterin 2.3 pika h në DST.</p> <p>OE L.si pjese e BOE nuk përmbush kriteret per kualifikim, ne këto kushte AK duhej te skualifikonte BOE.</p> <p>KVO ka skualifikuar OE C. P. për mosparaqitjen e plotë të mostrave.</p> <p>1.KVO OE L., pjese e BOE nuk përmbush kriteret për kualifikim dhe ne këto kushte duhej ta kishte s’kualifikuar BOE, dhe duke qene se oferta e OE tjetër të kualifikuar rezulton e rregullt por ekonomikisht më pak e leverdishme, KVO ka vepruar duke favorizuar BOE edhe pse ne kushtet e skualifikimit, Vlera 353.521.600 Lekë përbën prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efencë dhe efektivitet (3-E^{-të}), në kundërshtim me ligjin nr. 162 /2020 “Për prokurimin publik.</p>	<p>Pika 2.6.8 Fq. 119-124</p>	<p>E Lartë</p>	<p>Titullari i AK t`i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit dhe procesit të shqyrtimit e vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve nga komisionet e vlerësimit të ofertave.</p>

<p>***KVO, ka kualifikuar dy OE pjesëmarrës, respektivisht BOE “T.” & “L.” SHPK dhe “O.N.” SHPK.</p> <p>Pas kualifikimit të OE pjesëmarrës, KVO ka pranuar Ofertat ekonomike sipas klasifikimit të mëposhtëm.</p> <p>2.BOE “T.”Shpk dhe “L.” Shpk me ofertën ekonomike 353.521.600 Lekë pa TVSH.</p> <p>3.“O.N.” Shpk me ofertën ekonomike 354.398.600 Lekë pa TVSH.</p> <p>Formulari i njoftimit të Operatoreve Ekonomik të suksesshëm në marrëveshjen kuadër është bërë me shkresën nr. 50/13 Prot., datë 11.10.2022.</p> <p>Pas verifikimit të dokumentacionit të shkruar nga OE të cilat sipas KVO përputheshin me ato të ngarkuara në SEP, është nënshkruar Marrëveshja Kuadër nr. 50/16 Prot., datë 25.10.2022, me objekt: “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT” midis SUT dhe B.OE “T.” & “L.” SHPK dhe “O.N.” SHPK me vlerën e fondit limit për një afat kohor dy vjeçar. Marrëveshje kuadër nuk është një kontratë më vete, por përcakton kushtet për kontratat që do të lidhen mbi bazën e saj.</p> <p><i>Oferta ekonomike, sipas parimit të çmimit më të ulët e ofertuar nga BOE “T. dhe L.”, në vlerën 353.521.600 leke pa TVSh, shërben si fond limit për minikonkurset që do të zhvillohen.</i></p>			
--	--	--	--

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit

Është audituar veprimtaria ekonomiko financiare e Spitalit Universitar të Traumës, Tiranë për periudhën nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2022, e cila ka përfshirë; organizimin dhe funksionimin e Spitalit, funksionimin e strukturave drejtuese dhe ligjshmërinë për emërimet dhe vendimet e marra prej tyre, strukturën organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve, programet ekonomiko-financiar (buxhetet vjetor), rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë dhe bankë, mbajtjen e evidencës kontabile, zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale.

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinionin e modifikuar/kualifikuar të auditimit:

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Spitalit Universitar të Traumës, Tiranë për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2022, sa i takon shkallën së zbatueshmërisë nga subjekti të ligjeve, vendimeve rregullave dhe rregulloreve, udhëzimeve politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, nëpërmjet auditimit të hartimit dhe zbatimit të programit ekonomiko financiar, mbi pagat dhe shpërblimet, në fushën e prokurimeve publike, hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare, dhe çështjeve të tjera që dalin gjatë auditimit. Auditimi është bazuar në ligjin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit, Manualin e Përputhshmërisë, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik ISSAI 4000 .

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Spitalit Universitar të Traumës, Tiranë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që nën

gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kualifikuar.

Baza për Opinionin

Për gjetjet nga auditimi dhe rekomandimet, jemi dakortësuar me Drejtuesit e Institucionit, si dhe jemi siguruar prej Tij, që vendimmarrjet në ardhmen të jenë eficente, që të japin shërbime më të mira dhe vlerë më të mirë për paranë. Për të arritur këtë, Drejtuesi i këtij Institucioni të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve financiare, por edhe për të siguruar që këto vendime të janë dobiprurëse dhe në interesin më të mirë të publikut. Kjo do të thotë, të sigurohet se paratë publike shfrytëzohen mirë dhe shfrytëzimi i tyre shtrihet sa më shumë që është e mundur, nëpërmjet përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, si personeli, pasuritë dhe buxheti sipas programit ekonomik.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e këtij opinionit. Nga auditimi i veprimtarinë së SUT u konstatuan:

-Shpenzimet për materiale ortopedike (proteza, pllaka, vida, shtiza, etj.) për vitin 2022, janë në shumën 365,269,600 lekë.

-Materialet ortopedike të prokuruar nga SUT për vitin 2022, kanë një mbulim për pacientin në shumën $(365,269,600/2,542) = 143,694$ lekë.

-Vlera e materialeve ortopedike (proteza, Pllaka, vida, shtiza, etj.) të prokuruar në vitin 2022, mbulon 210% $(143,694/68,233)$ koston mesatare të një pacienti për materiale ortopedike.

-Referuar proces verbaleve të regjistrave të materialeve të përdorura gjatë ndërhyrjeve kirurgjikale për vitin 2021-2022, shkëmbimi i materialeve nuk është bërë në përputhje me kushtet e marrëveshjes kuadër apo të kontratave të furnizimit, pasi në asnjë rast nuk rezulton që materiale të ndryshme ortopedike të jene kthyer mbrapsht në farmaci dhe të jenë ndëruar me materiale të tjera, siç parashikohet ne kushtet e Marrëveshjes Kuadër apo në atë të kontratës së furnizimit.

- Nga verifikimi fizik i kryer në ambientin e kryeinfermierit të bllokut qendror operator nga grupi i auditimit të KLSH, më datë 23.03.2023 rezultojë se në këtë ambient gjendeshin materialeve ortopedike Proteza dhe të grupit të Sintezës në shumën 35,228,087 lekë ose 317,370 euro.

- Për periudhën 2 vjeçare 2021 e 2022 mjekët e shërbimit të ortopedisë kanë gjeneruar 2,680 receta për pacientët e shtruar në pavijonin e ortopedisë, receta të njëjta me ato që lëshohen në sistemin parësor (për pacientët jo të shtruar në spital) për materiale ortopedike që nevojiten për këta pacientë sipas diagnozës që gjendet në kartelat mjekësore të tyre.

- Për periudhe objekt auditimi, nga ana e mjekëve ortoped janë lëshuar 2,680 receta për pacientët.

- Nga personeli përgjegjës i bllokut operator qendror për vitin 2021, janë dokumentuar vetëm 1567 $(1,294+273)$ operacione të kryera, duke mos pasqyruar të gjithë operacionet e kryera në regjistrat e mbajtura për vendosjen e materialeve ortopedike (proteza) me një diference prej 667 operacione.

- Nga personeli përgjegjës i bllokut operator qendror për vitin 2022 nuk janë pasqyruar të gjitha operacionet e kryera, pasi ka një diferencë me 811 operacione të pa dokumentuar në regjistrat e këtij shërbimi.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin “Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Spitali Universitar i Traumës, theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e përputhshmërisë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë. Drejtuesit e Institucionit janë përgjegjës për marrjen e masave të nevojshme në drejtim të garantimit të përputhshmërisë së aktivitetit me kushtet e dispozitave ligjor në fuqi dhe për ngritjen e sistemeve të kontrollit dhe marrjes së masave të sinjalizimit për veprime korruptive në realizimin e të ardhurave dhe

kryerjen e shpenzimeve, duke nisur nga hartimi i rregullave të brendshme, strukturës në dispozicion, duke përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e çdo punonjësi të këtij Institucioni, mbi të gjitha duke shmangur dhe mbikëqyrur konfliktin e interesit.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë.

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse aktiviteti i Institucionit, nuk paraqet anomali materiale, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi përputhshmërinë e aktivitetit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mastrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar.

Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të aktivitetit. Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë në lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të programit të auditimit nr. 1199/1 prot., datë 13.01.2023 i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 16.01.2023 deri 14.04.2023, u krye auditimi “Mbi Përputhshmërinë” në Spitalin Universitar të Traumës Tiranë për periudhën nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2022, nga Grupi i auditimit me përbërje:

1. A. L., përgjegjës grupi
2. E. K.,
3. A. T.,
4. K. G.,
5. K. P.,
6. K. Sh.

1. Objektivat dhe qëllimi :

Objektivi kryesor i grupit të auditimit të KLSH-së, është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit, që SUT, u ka bërë fondeve në dispozicion, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, udhëzuesve të donatorëve, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve, si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë së Projektit.

Auditimi ka për qëllim të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe

parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

2. Qëllimi i auditimit :

Auditimi ka për qëllim të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomicitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

3. Identifikimi i çështjes:

Spitali Universitar të Traumës Tiranë duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi për arritjen në cilësi të shërbimeve shëndetësore të ofruara, duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të auditur lidhur me çështjen nën auditim:

Menaxhmenti është përgjegjës për kryerjen e transaksioneve financiare në pajtim me kornizën e aplikueshme ligjore dhe që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me Ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për Sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin nr. 147/2014 “Për shërbimin e urgjencës mjekësore”; Ligjin nr. 9323, datë 25.11.2004 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, i ndryshuar; Ligjin nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”; Ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, me ndryshimet vijuese të tij, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së përgjithshme”.

5. Përgjegjësitë e audituesve:

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit për auditimin. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Janë respektuar kërkesat etike, është planifikuar dhe kryer auditimi, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

6. Kriteret e vlerësimit:

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) IFAC; Kushtetuta dhe Baza Ligjore:

Ligji nr. 154/2014 “Mbi Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Manualët e Auditimit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH;

Ligji nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për Sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 8615, datë 01.06.2000 “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 147/2014 “Për shërbimin e urgjencës mjekësore”; Ligji nr. 105/2014, datë 31.7.2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”; Ligji nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”; Ligji nr. 9718, datë 19.4.2007 “Për urdhrin e infermierit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr.

9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij; Ligji nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Ligji nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtë kontraktore të organeve të administratës shtetërore”, i ndryshuar; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndryshimet vijuese të tij”; Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 ”Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 527, datë 01.11.1993 ”Për përcaktimin e çmimeve në sistemin shëndetësor shtetëror”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 508 datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1661 datë 29.12.2008 “Për financimin e shërbimeve spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, i ndryshuar; VKM nr. 143, datë 18.2.2015 “Për përcaktimin e marzheve të tregtimit dhe fabrikimit të barnave”; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, me ndryshimet vijuese të tij, Udhëzimi nr. 2/2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, me ndryshimet vijuese të tij.

7. Standardet e auditimit:

- ISSAI 100- (*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*).
- ISSAI 400- (*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*).
- Kodi etik i KLSH.

8. Metoda e auditimit.

Auditimi është zbatuar sipas drejtimeve në programin përkatës, për zbatimin e rekomandimeve lënë në auditimin e mëparshëm, ligjshmërinë e vendimmarrjes së organeve drejtuese, hartimin dhe zbatimin e programit ekonomiko-financiar, strukturën organizative dhe pagat, pasqyrat financiare, procedurat e prokurimit, menaxhimin financiar dhe kontrollin etj. Janë konstatuar mangësi në largimin e punonjësve nga puna, strukturën organizative, procedurat e prokurimit etj. Auditimi është realizuar i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje.

9. Dokumentimi i auditimit.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH^{së} nr. 196, datë 29.12.2015, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Spitali Universitar i Traumës, Tiranë është institucion i shërbimit të kujdesit shëndetësor publik, në varësi të Ministrisë përgjegjëse të Shëndetësisë. SUT, funksionon si strukturë shëndetësore universitare e përgjithshme, në nivelin terciar. Gjithashtu SUT kryen veprimtari mësimore dhe kërkimore-shkencore, si pjesë e Universitetit të Mjekësisë Tiranë.

Veprimtaria e SUT është në përputhje me VKM nr. 357, datë 18.7.2002 “Për dhënien e statusit "Spital Universitar", Spitalit Ushtarak Qendror”, Ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 1001, datë 02.12.2015 “Për integrimin e spitalit universitar të traumës dhe spitalit ushtarak të forcave të armatosura në një strukturë të bashkuar”, VKM nr. 657, datë 10.11.2017 “Për miratimin, si strukturë shëndetësore universitare, të spitalit universitar të traumës”, VKM nr. 892, datë 24.12.2012 “Për ndryshimin e emërimit të spitalit ushtarak qendror universitar në "Spitali universitar i traumës" dhe kalimin e përgjegjësisë së administrimit të tij nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Shëndetësisë, si dhe për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 515, datë 18.7.2003 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", VKM nr. 66, datë 3.2.2017 “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare”.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.

2.1. Mbi realizimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

Në zbatim të pikës nr. 1., të Programit të Auditimit nr. 1199/1 Prot., datë 13.01.2023, i ndryshuar, “Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së” nga grupi i auditimit të KLSH-së, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Planet e masave të ndërmarra nga SUT për zbatimin e rekomandimeve.
2. Dokumentacion plotësues dhe justifikues për zbatimin e rekomandimeve.
3. Kthim përgjigje mbi pyetësonin për zbatimin e rekomandimeve.

Nga auditimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

I. Respektimi i afatit prej 20 ditësh, për informimin e KLSH-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:

Raporti Përfundimtar i mëparshëm mbi Auditimin e Përputhshmërisë në Spitalin Universitar të Traumës, është dërguar me shkresën nr.130/10 Prot. datë 14.10.2021 me objekt “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin e ushtruar në Spitalin Universitar të Traumës”, protokolluar në SUT me Nr. 2207 Prot. Datë 15.10.2021.

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Spitali Universitar i Traumës, ka kthyer përgjigje në KLSH, me shkresën nr.2207/3 prot, datë 01.11.2021, duke respektuar afatin 20 ditor.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:

Nga ana e subjektit të audituar është raportuar me shkresën nr.843 prot, datë 19.04.2022 në Kontrollin e Lartë të Shtetit “Për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna”, sipas Ligjit nr.154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30. Raportimi është kryer brenda afatit prej 6 Muaj.

III. Rekomandimet e KLSH-së:

Në Raportin Përfundimtar, të dërguar me shkresën nr.130/10 Prot. datë 14.10.2021 për auditimin në Spitalin Universitar të Traumës, janë rekomanduar gjithsej:

- 29 masa organizative;
- 2 masa për shpërblim dëmi;
- 21 masa disiplinore;

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar mbi Zbatimin e Rekomandimeve me nr. 520/56 Prot. datë 04.12.2020, rezultoi se janë trajtuar rekomandimet e lëna si më poshtë:

- Nga **29** masa organizative të rekomanduara gjithsej, **20** masa janë zbatuar plotësisht dhe **9** masa janë në proces zbatimi.
- Nga **2** masa shpërblim dëmi të rekomanduara, 1 masë është zbatuar plotësisht dhe 1 masë tjetër është në proces zbatimi.
- Nga **21** masa disiplinore të rekomanduara gjithsej, **21** masa janë zbatuar plotësisht.

Për sa më lart, Rekomandimet e mbetura në proces zbatimi, paraqiten si më poshtë:

Masa Organizative – **Rekomandimet nr. 3.1, 6.1, 19.1, 20.1, 21.1, 21.2, 22.1, 28.1, 29.1**

Masa Shpërblim Dëmi – **Rekomandimet nr. 2.1**

Masa Organizative

Rekomandimi 3.1: Nga sektori i shërbimeve të brendshme të merren masa që shpenzimet e shërbim gjelbërimit të kryhen me dokumentacion specifik që i përkasin këtij shërbimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Përgjegjës për zbatim është caktuar Grupi i punës së ndjekjes së kontratës së gjelbërimit. Shërbimi i gjelbërimit në SUT është kryer në bazë të minikontratës nr.54/17 Prot., datë 05.01.2022 me afat deri 30.06.2022, dhe mbështetet nga Marrëveshja Kuadër nr.68/8 Prot., datë 05.11.2021.

Për arsye se Marrëveshja Kuadër e ka afatin 36 muaj, deri në 04.11.2024, SUT është duke përgatitur ndryshimet në DST sipas rekomandimeve të KLSH.

Rekomandimi 6.1: Nga Bordi i Spitalit Universitar i Traumës të merren masa për miratimin e përvitshëm të pasqyrave financiare vjetore.

Në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

-Urdhri Nr.319, datë 18.05.2022 i Ministrit SHMS “Për ngritjen e Bordit Drejtues të SUT;

-Vendimi Nr.1 datë 15.06.2022 i Bordit të SUT sipas të cilit është miratuar struktura e spitalit, statusi, rregullorja e funksionimit të SUT etj.

Rekomandimi 19.1: SUT të marrë masa që të verifikojë preventivat e paraqitura nga shoqëritë konsulente të përzgjedhura për realizimin e projekt preventivave, si në fazën e marrjes në dorëzim të shërbimeve konsulente, ashtu edhe në kuadër të përllogaritjes së fondit limit, me synim shmangien e gabimeve që shkaktojnë blerjen e shërbimeve, mallrave apo punimeve me çmime më të larta se ato të tregut, apo të përcaktuara në aktet ligjore.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Përsa më sipër, janë ngarkuar të marrin masat sektori i prokurimeve dhe inxhinierja e SUT, që për procedurat e prokurimit në kontratat e punës, në vazhdimësi (nga muaji Tetor 2021 e në vazhdim) të kenë parasysh që çdo çmim në preventivat e paraqitura nga OE e kontraktuar të jenë të argumentuara sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve/normativave ligjore në vazhdimësi.

Rekomandimi 20.1: SUT të marrë masa për rritjen e kontrollit të procedurave të auditimit të cilat rezultojnë me mangësi të dukshme dhe të identifikuar, si nëpërmjet strukturave të auditimit të brendshëm, ashtu dhe në shqyrtimin me përgjegjshmëri të raportit të vlerësimit të ofertave dhe ankesave që paraqiten.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga Sektori i Auditimit janë marrë masa që në planifikimin vjetor të vitit 2022 të kryhen auditime më të shpeshta për kontrollin e procedurave të prokurimit të cilat pasqyrohen në programin vjetor të miratuar nr. 2282/3, date 26.10.2021.

Është hartuar programi i angazhimit nr. 1319/2 datë 20.06.2022 “Auditimi i sektorit të prokurimit dhe sektorit të shërbimeve të brendshme në SUT” për periudhën Prill 2021 deri në Maj 2022, ku përfshihen edhe rekomandimet e lëna nga KLSH-ja, jemi në proces auditimi.

Rekomandimi 21.1: SUT të marrë masa për analizimin e aplikimit të çmimeve të preventivave si në kuadrin e marrjes në dorëzim të shërbimeve konsulente, ashtu dhe në kuadër të hartimit të fondit limit, ku për referencë merret vlera e preventivit e hartuar nga konsulentë të përzgjedhur.

Në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Ngarkohet për zbatim Inxhinieri i Ndërtimit dhe Sektori i Prokurimeve.

Për sa më lartë, sektori i prokurimeve (përgjegjësit për prokurim) dhe inxhinierja e SUT kanë marrë masat që në procedurat e prokurimit që do të zhvillohen në vazhdimësi të kenë parasysh që çdo çmim në preventivat e paraqitura nga OE e kontraktuar të jenë të argumentuara sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve/normativave ligjore në vazhdimësi.

Rekomandimi 21.2: Gjatë zbatimit të kontratës së punimeve civile, të kërkohet reflektimi i saktësisë faktike të polisterolit që vendoset në vepër, duke reflektuar çmimin e polisterolit, në mënyrë që të shmanget gabimi në analizën e çmimit në manualët e çmimeve të ndërtimit të miratuara në vitin 2015.

Gjatë zbatimit të kontratës

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Për sa më lartë, nuk kemi një procedure të re prokurimi pune, sektori i prokurimeve (përgjegjësit për prokurim) dhe inxhinierja e SUT kanë marrë masat që në procedurat e prokurimit që do të zhvillohen në vazhdimësi të kenë parasysh që çdo çmim në preventivat e paraqitura nga OE e kontraktuar të jenë të argumentuara sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve/normativave ligjore në vazhdimësi.

Rekomandimi 22.1: SUT të marrë masa për ndjekjen e procedurave për shlyerjen e detyrimeve shoqëruar me kamatë vonesat përkatëse ndaj qiramarrësve të aseteve në administrim. Kontraktorëve t’u kërkohet që të zhvillojë aktivitete sipas përcaktimeve në marrëveshje, duke mos lejuar ushtrimin e aktiviteteve tregtare që nuk ka lidhje me fushën e operimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Përgjegjës për zbatimin e rekomandimit është caktuar për zbatim Grupi i monitorimit të kontratave të qirasë. Deri në momentin e verifikimit rezultoi se SUT-ja është në proces gjyqësor ndaj qiramarrësve të aseteve në administrim (Spitali Amerikan).

Rekomandimi 28.1: Nga Drejtoria e SUT të merren masa për hartimin dhe menaxhimin e riskut për çdo drejtori, monitorimin dhe vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve, krijimin e listave të proceseve kryesore dhe gjurmët e auditimit, me qëllim arritjen e mjaftueshme të aktiviteteve të kontrollit për identifikim, kontrollin dhe reduktimin e risqeve të ndryshëm në procese, dokumentacionin përkatës, përgjegjësitë personale, mbështetjen e sistemeve të IT.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Nga verifikimi i grupit të auditimit rezultoi se regjistri i riskut për SUT-në është hartuar ndërsa për sektorët dhe pavijonet e SUT-se është në proces.

Rekomandimi 29.1: Nga Drejtoria e SUT të merren masa përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve të prapambetura dhe ruajtja e dokumenteve të bëhet në ambiente në përputhje me normativat e përcaktuara.

Brenda datës 30.11.2021

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Përgjegjës për zbatim të këtij rekomandimi është sekretaria e SUT-se. Për zbatimin e rekomandimit është ngritur Grupi i ekspertizës.

Masa Shpërblim Dëmi

Rekomandimi 2.1: SUT të marrë masa dhe të ndjekë të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës së 3,536,421 lekë nga shoqëria “S.C.Shpk. Kjo vlerë ka të bëjë me mos zbatimin e specifikime teknike, pjesë e kontratave në marrëveshjen kuadër të lidhur me nr, 7/26 prot., datë 17.07.2020 “Për kryerjen e shërbimit të lavanterisë dhe hotelerisë për një periudhë 48 mujore”.

Brenda datës 31.12.2021

Përshkrimi i zbatimit të rekomandimit

Çështja në proces gjyqësor, sipas Kërkesë Padisë nr.430 datë 23.02.2022 në Gjykatën Administrative Shkalla e Parë Tiranë;

Autorizimi nr.428 prot., datë 23.02.2022;

Prapësime në Gjykatën Administrative të shkallës së parë Tiranë, datë 23.03.2022;

Titulli i gjetjes:	Rekomandime të cilat akoma nuk janë zbatuar
Situata:	Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar mbi Zbatimin e Rekomandimeve me nr. 520/56 Prot. datë 04.12.2020, rezultoi se janë trajtuar rekomandimet e lëna si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> · Nga 29 masa organizative të rekomanduara gjithsej, 20 masa janë zbatuar plotësisht dhe 9 masa janë në proces auditimi. · Nga 2 masa shpërblim dëmi të rekomanduara, 1 masë është zbatuar plotësisht dhe 1 masë tjetër është në proces zbatimi. · Nga 21 masa disiplinore të rekomanduara gjithsej, 21 masa janë zbatuar plotësisht.
Kriteri:	Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa “j”.
Efekt/Ndikimi:	Realizimi i rekomandimeve ndihmon Spitalin Universitar të Traumës të arrijë objektivat dhe të përmbush misionin.
Shkaku	Nga ana e shoqërisë ka pasur përpjekje për realizimin e rekomandimeve, por nuk ka arritur t’i realizojë plotësisht.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	SUT, të marrë masa për përshpejtimin e realizimit të rekomandimeve në proces zbatimi të lëna në auditimin e mëparshëm, me synim realizimin e objektivave dhe në përmbushjen e misionit të shoqërisë.

Për sa më sipër, për ndjekjen dhe realizimin e rekomandimeve që rezultojnë në proces zbatimit ngarkohet me përgjegjësi znj. E. B. në cilësinë e titullarit të institucionit.

2.2. Mbi hartimin, shqyrtimin, zbatimin dhe raportimin e programit ekonomiko-financiar

Spitali Universitar i Traumës financohet përmes FSDKSH, përmes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe përmes Ministrisë së Mbrojtjes. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale financon SUT-në për zërat 600, 601, 602, ndërsa Ministria e Mbrojtjes e financon për zërat 600, 601, 602, 606 dhe 231.

Detajimi i buxhetit për periudhën e auditimit

Me shkresë nr. 51 prot., datë 27.01.2021 “Detajim Buxheti për vitin 2021”, miratuar nga A. Z., Drejtor i SUT ku detajohet në formë tabelare zëri 602 në nën/artikujt buxhetor përkatës dhe në fund miratohet nga Grupi i Menaxhimit Strategjik.

Ndërsa me shkresën e SUT nr. 732 prot., datë 28.12.2021 “Detajim Buxheti i rindryshuar për zërin 602 për vitin 2021”, miratuar nga E. B., Drejtore e SUT ku detajohet në formë tabelare zëri 602 në nën/artikujt buxhetor përkatës respektivisht për MM dhe MSHMS për vitin 2021 dhe në fund miratohet nga Grupi i Menaxhimit Strategjik.

Bordi Drejtues i SUT

Me shkresën e SUT me nr. 1195 prot., datë 03.06.2022 “Kërkesë për mbledhjen e Bordit Drejtues të SUT” të miratuar nga znj. E. B., Drejtore e SUT, ku është mbledhur Bordi në ambjentet e SUT. Gjithashtu është mbajtur dhe Procesverbali i mbledhjes së Bordit është protokolluar në SUT me nr. 1303 prot., datë 16.06.2022, firmosur nga Bordi. Me tej, SUT ka nxjerrë Vendimin nr.1, datë 15.06.2022 “Për ngritjen e Ekipit të Menaxhimit të Programit Buxhetor”, e cila është firmosur nga E. B. Drejtore e SUT dhe protokolluar me nr. 1218 prot., datë 06.06.2022, ku citohet se Bordi i SUT miratoi strukturën, organikën, statutin, rregulloren e funksionimit të SUT.

Projekt-Buxheti për vitin 2021

Projekt buxheti i vitit 2021 është hartuar në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 28, datë 10.07.2020, “Për përgatitjen e PBA 2021-2023”, me shkresën nr. 13077/1 prot, datë 10.07.2020.

Në mënyrë të përmbledhur zërat buxhetorë paraqiten si më poshtë:

Tabelë nr. 1: Kërkesa Buxhetore për vitin 2021 për zërat që financohen nga MSHMS. (në mijë lekë)

Kërkesa Buxhetore 2021	600	601	602	603	604	605	606	230	231	Totali
Programi	115,000	19,200	230,000							364,200
Çelja nga buxheti i përgjithshëm	151,000	19,500	180,000							350,500
Shpenzime për të ardhurat	-	-	-							-

Burimi: SUT, përpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Tabelë nr. 2: Kërkesa Buxhetore për vitin 2021 për zërat që financohen nga Ministria e Mbrojtjes. (në mijë lekë)

Kërkesa Buxhetore 2022	600	601	602	603	604	605	606	230	231	Totali
Programi	400,000	66,000	548,000	-	-	-	2,000		200,000	1,216,000
Çelja nga buxheti i përgjithshëm	400,000	66,000	548,000	-	-	-	2,000	5,000	195,000	1,216,000
Shpenzime për të ardhurat	4,295		2,185	-	-	-			12,098	18,578

Burimi: SUT, përpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Përsa i përket kërkesave buxhetore të vitit 2021 për zërat që financohen nga MSHMS janë: zëri 600 e planifikuar në vlerën 115 milion lekë, zëri 601 planifikuar në vlerën 19.2 milion lekë dhe zëri 602 planifikuar në vlerën 230 milion lekë. Ndërsa kërkesave buxhetore të vitit 2021 për zërat që financohen

nga MM janë: zëri 600 e planifikuar në vlerën 400 milion lekë, zëri 601 planifikuar në vlerën 66 milion lekë, zëri 602 planifikuar në vlerën 548 milion lekë, zëri 606 planifikuar në vlerën 2 milion lekë dhe zëri 231 planifikuar në vlerën 200 milion lekë.

Projekt-Buxheti për vitin 2022

Projekt buxheti i vitit 2022 është hartuar në përputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 26.02.2021, “Për përgatitjen e PBA 2022-2024”, me shkresën nr. 4010/1 prot, datë 26.02.2021 “Dërgohet Udhëzimi i PBA 2022-2024”.

Në mënyrë të përmbledhur zërat buxhetorë paraqiten si më poshtë:

Tabelë nr. 3: Kërkesa Buxhetore për vitin 2022 për zerat që financohen nga MSHMS. (në mijë lekë)

Kërkesa Buxhetore 2022	600	601	602	Totali
Programi	157,440	26,293	329,711	513,444
Çelja nga buxheti i përgjithshëm	165,000	22,500	243,000	430,500
Shpenzime për të ardhurat	0	0	0	-

Burimi: SUT, përpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Tabelë nr. 4: Kërkesa Buxhetore për vitin 2022 për zerat që financohen nga MM. (në mijë lekë)

Kërkesa Buxhetore 2022	600	601	602	606	231	Totali
Programi	480,000	81,000	327,240	2,000	200,000	1,090,240
Çelja nga buxheti i përgjithshëm	517,348	88,488	327,240	2,000	200,000	1,135,076
Shpenzime për të ardhurat	3,607	-	7,946	-	12,359	23,912

Burimi: SUT, përpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Miratimi i Buxhetit Vjetor:

Tabelë nr. 5: Buxheti i miratuar në vitin 2021, për pjesën që financohet nga Ministria e Shëndetësisë. (në mijë lekë)

Viti 2021/Ilogaria	600	601	602	Totali
VKM nr 20 datë 20/01/2021	151,000	19,500	180,000	350,500
Rialokimi I				-
Vendim i FSDKSH nr7 datë 24/01/2021	25,500	-	-	
Zërat pas ndryshimeve Rialokimi I	176,500	19,500	180,000	376,000
Rialokimi II				-
Vendim i FSDKSH nr 300 datë 19/05/2021			33,289	33,289
Vendim i FSDKSH nr 15 datë 27/07/2021 & Vendim i FSDKSH nr 16 date 27/07/2021	9,000		17,870	26,870
Zërat pas ndryshimeve Rialokimi II	185,500	19,500	231,159	436,159
Rialokimi III				-
Vendim i KM nr 563 datë 29/09/2021	(10,000)	(500)	30,000	19,500
Vendim i FSDKSH nr 20 datë 08/11/2021	(8,000)	(450)		(8,450)
PA SHKRESE	(3,600)	3,600	-12000	(12,000)
Zërat pas ndryshimeve Rialokimi III	163,900	22,150	249,159	435,209
Totali	163,900	22,150	249,159	435,209
Raste fatkeqësish Fondi i vecantë 606	0			
Buxheti paga pasi është shtuar 606	163,900			

Burimi: SUT, përpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Tabelë nr. 6: Buxheti i miratuar në vitin 2022, për pjesën që financohet nga Ministria e Shëndetësisë. (në mijë lekë)

Viti 2022/Ilogaria	600	601	602	606	Totali
VKM nr 43 datë 19/01/2022	165,000	22,500	243,000	-	430,500
Rialokimi I	-	-	-	-	-
Zërat pas ndryshimeve Rialokimi I	165,000	22,500	243,000	-	430,500
Rialokimi II	-	-	-	-	-
Zërat pas ndryshimeve Rialokimi II	165,000	22,500	243,000	-	430,500

Rialokimi III					
Vendim i FSDKSH nr 12 datë 30/08/2022			100,000		100,000
VKM Nr 615 date 22/09/2022			626		626
Vendim i FSDKSH nr 17 datë 04/10/2022			50,000		50,000
		400			400
Vendi i Keshillit administrativ Nr 29 date 30/12/2022				1740	1,740
PA SHKRESE	(22,000)		2331		(19,669)
Zërat pas ndryshimeve Rialokimi III	143,000	22,900	395,957	1,740	563,597
Totali	143,000	22,900	395,957	1,740	563,597
Raste fatkeqësish Fondi i vecantë 606	1740				
Buxheti paga pasi është shtuar 606	144,740				

Burimi: SUT, përpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Tabelë nr. 7: Buxheti i miratuar në vitin 2021, për pjesën që financohet nga Ministria e Mbrojtjes. (në mijë lekë)

Viti 2021	600	601	602	606	230	231	Totali
MM/Nr 436/2 Prot datë 28/01/2021	400,000	66,000	548,000	2,000			1,016,000
MM/Nr5573/5 Prot datë 19/02/2021					5000	195000	200,000
Celje 2021	400,000	66,000	548,000	2,000	5,000	195,000	1,216,000
Rialokimi I							
PA SHKRESE					(5,000)		(5,000)
Zërat pas ndryshimeve Rialokimi I	400,000	66,000	548,000	2,000	-	195,000	1,211,000
Rialokimi II							
MM/Nr 859/4 Prot datë 26/07/2021				500			500
PA SHKRESE					5,000		5,000
Zërat pas ndryshimeve Rialokimi II	400,000	66,000	548,000	2,500	5,000	195,000	1,216,500
Rialokimi III							-
MM/Nr 4576/1 Prot datë 01/10/2021			60,000				60,000
MM/Nr 4413/6 Prot datë 18/10/2021				734			734
MM/Nr 5336/2 Prot datë 22/11/2021	75,000	6,000	26,600				107,600
PA SHKRESE					59,320	(59,320)	-
Zërat pas ndryshimeve Rialokimi III	475,000	72,000	634,600	3,234	64,320	135,680	1,384,834
Totali	475,000	72,000	634,600	3,234	64,320	135,680	1,384,834
Raste fatkeqësish Fondi i vecantë 606	3,234						
Buxheti paga pasi është shtuar 606	478,234						

Burimi: SUT, përpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Tabelë nr. 8: Buxheti i miratuar viti 2022, për pjesën e financuar nga Ministria e Mbrojtjes. (në mijë lekë)

Viti 2022	600	601	602	606	230	231	Totali
MM/Nr 6246/3 Prot datë 08/02/2022	517,348	88,488		2,000			607,836
MM/Nr 737/1 Prot datë 15/02/2022			327,240				327,240
MFE/Nr 6246/4 datë 25/2/2022						200000	200,000
Celje 2022	517,348	88,488	327,240	2,000	-	200,000	1,135,076
Rialokimi I							

MM/Nr 2393/3 Prot datë 18/05/2022	(12,934)	(2,212)						(15,146)
Zërat pas ndryshimeve Rialokimi I	504,414	86,276	327,240	2,000	-	200,000		1,119,930
Rialokimi II								
MM/Nr 2393/4 Prot datë 18/05/2022						(50,000)		(50,000)
MM/Nr 1957/8 Prot datë 05/08/2022				686				686
MM/Nr 4453/2 Prot datë 16/09/2022			200,000					200,000
PA SHKRESE			91,000					91,000
Zërat pas ndryshimeve Rialokimi II	504,414	86,276	618,240	2,686	-	150,000		1,361,616
Rialokimi III								-
MM/AN Nr14405/134 Prot datë 06/09/2022						100,000		100,000
MM/Nr 5558/1 Prot datë 07/11/2022	-		(1,400)	1,400				-
MM/Nr6473/2 Prot datë 27/12/2022	(55,000)	(11,000)						(66,000)
MM/Nr 6587/2 Prot datë 10/01/2023	(55,000)	(11,000)	70,000					4,000
PA SHKRESE	46,675	7,798	1,400	9,962				65,835
Zërat pas ndryshimeve Rialokimi III	441,089	72,074	688,240	14,048	-	250,000		1,465,451
Totali	441,089	72,074	688,240	14,048	-	250,000		1,465,451
Raste fatkeqësish Fondi i vecantë 606	14,408							
Buxheti paga pasi është shtuar 606	455,497							

Burimi: SUT, përpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Zbatimi i Buxhetit

Realizimi i buxhetit, sipas situacioneve progresive të miratuara në thesar për vitet 2021 dhe 2022, paraqiten si më poshtë në tabelat nr. 9, 10, 11 dhe 12:

Tabelë nr. 9: Zbatimi i buxhetit viti 2021 për pjesën që financohet nga Ministrinë e Shëndetësisë. (në mijë lekë)

Nr	Artikulli Kodi	EMËRTI MI	Planifikimi 2021	Rialokimi mi I	Rialokimi II	Rialokimi mi III	Fakti 2021	Ndryshimi në vlerë (Rialokimi III -Fakti)	Ndryshimi në %
2	601	Sigurime Shoqerore	19,500	19,500	23,100	22,150	22,086	64	99.71
3	602	Mallra dhe Sherbime te tjera	180,000	180,000	231,159	249,159	228,455	20,704	91.69
			350,500	376,000	436,159	435,209	413,395	21,814	

Burimi: SUT, përpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Buxheti i planifikuar i vitit 2021 për pjesën që financohet nga MSHMS ka qenë 350,500 mijë lekë, ndërsa realizimi është 413,395 mijë lekë. Konkretisht, zëri 600 “Pagat” është planifikuar të jetë 151,000 mijë lekë, ndërkohë që realizimi është 162,854 mijë lekë. Zëri 601 “Sigurime shoqërore” është planifikuar të jetë 19,500 mijë lekë, ndërkohë që realizimi është 22,086 mijë lekë. Zëri 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” është planifikuar të jetë 180,000 mijë lekë, ndërkohë që realizimi është 228,455 mijë lekë.

Tabelë nr. 10: Zbatimi i buxhetit të vitit 2021 për pjesën që financohet nga Ministrinë e Mbrojtjes. (në mijë lekë)

Nr	Artikulli Kodi	EMËRTIMI	Planifikimi 2021	Rialokimi I	Rialokimi II	Rialokimi III	Fakti	Ndryshimi në vlerë (Rialokimi III -Fakti)	Ndryshimi në %
							2021		
1	600	Paga	400,000	400,000	400,000	475,000	450,441	24,559	94.83
2	601	Sigurime Shoqërore	66,000	66,000	66,000	72,000	70,407	1,593	97.79
3	602	Mallra dhe Shërbime te tjera	548,000	548,000	548,000	634,600	621,473	13,127	97.93
4	606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	2,000	2,000	2,500	3,234	2,210	1,024	68.35
5	230	Kapitale të Patrupëzuara	5,000	-	5,000	64,320	64,320	-	100.00
6	231	Kapitale të Trupëzuara	195,000	195,000	195,000	135,680	96,499	39,181	71.12
			1,216,000	1,211,000	1,216,500	1,384,834	1,305,350	79,484	

Burimi: SUT, përpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Buxheti i planifikuar i vitit 2021 për pjesën që financohet nga Ministria e Mbrojtjes ka qenë 1,216,000 mijë lekë, ndërsa realizimi është 1,305,350 mijë lekë.

Tabelë nr. 7: Zbatimi vjetor i buxhetit të vitit 2022 për pjesën që financohet nga Ministrinë e Shëndetësisë.

(në mijë lekë)

Nr	Artikulli Kodi	EMËRTIMI	Planifikimi 2022	Rialokimi I	Rialokimi II	Rialokimi III	Fakti	Ndryshimi në vlerë (Rialokimi III -Fakti)	Ndryshimi në %
							2022		
1	600	Paga	165,000	165,000	165,000	143,000	142,172	828	99.42
2	601	Sigurime Shoqërore	22,500	22,500	22,500	22,900	22,672	228	99.00
3	602	Mallra dhe Shërbime te tjera	243,000	243,000	243,000	395,957	386,818	9,139	97.69
4	606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	-	-	-	1,740	1,700	40	97.70
			430,500	430,500	430,500	563,597	553,361.50	10,236	

Burimi: SUT, përpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Buxheti i planifikuar i vitit 2022 për pjesën që financohet nga MSHMS ka qenë 430,500 mijë lekë, ndërsa realizimi është 553,361.50 mijë lekë.

Nga buxheti i vitit 2022 të Ministrisë së Shëndetësisë, zëri 600 “Pagat” është planifikuar të jetë 165,000 mijë lekë, ndërkohë që realizimi është 142,172 mijë lekë. Zëri 601 “Sigurime shoqërore” është planifikuar të jetë 22,500 mijë lekë, ndërkohë që realizimi është 22,672 mijë lekë. Zëri 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” është planifikuar të jetë 243,000 mijë lekë, ndërkohë që realizimi është 386,818 mijë lekë. Zëri 606 “Trans për Buxh. Fam. & Individ” nuk ka qenë e planifikuar, ndërkohë që realizimi është 1,700 mijë lekë.

Tabelë nr. 8: Zbatimi i buxhetit të vitit 2022 për pjesën që financohet nga Ministrinë e Mbrojtjes. (në mijë lekë)

Nr	Artikulli Kodi	EMËRTIMI	Plani fikim i 2022	Rialokimi I	Rialokimi II	Rialokimi III	Fakti 2022	Ndryshim i në vlerë (Rialokim i III - Fakti)	Ndryshimi në %
1	600	Paga	517,348	504,414	504,414	441,089.3	441,089.26	0	100.00
2	601	Sigurime Shoqerore	88,488	86,276	86,276	72,074.20	72,074.09	0	100.00
3	602	Mallra dhe Shërbime të tjera	327,240	327,240	618,240	688,239.60	668,975.11	19,264	97.20
4	606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	2,000	2,000	2,686	14,048.65	10,713.60	3,335	76.26
5	230	Kapitale të Trupëzuara	-	-	-	-	-	-	-
6	231	Kapitale të Trupëzuara	200,000	200,000	150,000	250,000	248,962.19	1,038	99.58
			1,135,076	1,119,930	1,361,616	1,465,451.75	1,441,814.25	23,637.50	

Burimi: SUT, përpunim nga grupi i auditimit të KLSH-së.

Nga auditimi rezulton se:

Buxheti i planifikuar i vitit 2022 për pjesën që financohet nga MM ka qenë 1,135,076 mijë lekë, ndërsa realizimi është 1,441,814.25 mijë lekë.

Nga buxheti i vitit 2022 të Ministrisë së Mbrojtjes, zëri 600 “Pagat” është planifikuar të jetë 517,348 mijë lekë, ndërkohë që realizimi është 441,089.26 mijë lekë. Zëri 601 “Sigurime shoqërore” është planifikuar të jetë 88,488 mijë lekë, ndërkohë që realizimi është 72,074.09 mijë lekë. Zëri 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” është planifikuar të jetë 327,240 mijë lekë, ndërkohë që realizimi është 668,975.11 mijë lekë. Zëri 606 “Trans për Buxh. Fam. & Individ” ka qenë e planifikuar në vlerën 2,000 mijë lekë, ndërkohë që realizimi është 10,713.60 mijë lekë. Zëri 231 “Kapitale të trupëzuara” ka qenë e planifikuar në vlerën 200,000 mijë lekë, ndërkohë që realizimi është 248,962.19 mijë lekë.

- Buxheti i vitit 2022 nuk është i miratuar nga Bordi, pasi hera e vetme që është mbledhur Bordi është data 06.06.2022, ku ka miratuar strukturën, organikën, statutin, rregulloren e funksionimit të SUT, veprimie në mospërputhje me VKM nr. 66, datë 03.02.2017 “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen e organizimit e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare”.
- Në hartimin e Projekt Buxheteve nuk janë marrë në konsideratë kërkesat e kryera nga departamentet sipas strukturës organizative, nuk ekziston asnjë shkresë e përgjegjësve të departamenteve dërguar Grupit për Menaxhimin Strategjik.
- Buxheti i planifikuar për vitin 2021 për pjesën që financohet nga MSHMS ka qenë 350,500,000 lekë, ndërsa realizimi është 413,395,000 lekë, duke tejkalar planifikimin e buxhetit me 62,895,000 lekë.
- Buxheti i planifikuar i vitit 2021 për pjesën që financohet nga MM ka qenë 1,216,000,000 lekë, ndërsa realizimi është 1,305,350,000 lekë, duke tejkalar planifikimin e buxhetit me 89,350,000 lekë.
- Buxheti i planifikuar i vitit 2022 për pjesën që financohet nga MSHMS ka qenë 430,500,000 lekë, ndërsa realizimi është 553,361,500 lekë, duke tejkalar planifikimin e buxhetit me 122,861,500 lekë.
- Buxheti i planifikuar i vitit 2022 për pjesën që financohet nga MM ka qenë 1,135,076,000 lekë, ndërsa realizimi është 1,441,814,250 mijë lekë, duke tejkalar planifikimin e buxhetit me 306,738,250 lekë.

Titulli i gjetjes:	Projekt-Buxheti për periudhën e auditimit nuk janë të miratuara nga Bordi Drejtues i Spitalit Universitar të Traumës.
---------------------------	---

Situata:	Mbështetur sa më lart, Bordi Drejtues i Spitalit Universitar të Traumës, është mbledhur vetëm një herë përgjatë gjithë periudhës së auditimit 01.01.2020-31.12.2022, në të cilën ka miratuar Strukturën, Organikën, Statutin dhe Rregulloren e Spitalit Universitar të Traumës me Vendim nr.1, datë 15.06.2022.
Kriteri:	VKM nr. 66, datë 3.2.2017 “Për Përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen e organizimin e Shërbimeve dhe Strukturave Shëndetësore Universitare”, pika 10/a.
Ndikimi/Efekti:	Mos efikasitet në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për SUT.
Shkaku:	Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga Organet Drejtuese të merren masa që projekt-buxhetet të miratohen nga Bordi Drejtues, pasi kjo mund të sjelli keqmenaxhim të burimeve dhe mosrealizim të objektivave në SUT.

Titulli i gjetjes:	Nga Spitali Universitar i Traumës nuk është kryer një planifikim i saktë, ku t’i referohej kërkesave reale buxhetore.
Situata:	Në hartimin e Projekt Buxheteve nuk janë marrë në konsideratë kërkesat e kryera nga departamentet sipas strukturës organizative, nuk ekziston asnjë shkresë e përgjegjësve të departamenteve dërguar Grupit për Menaxhimin Strategjik. Buxheti i planifikuar për vitin 2021 për pjesën që financohet nga MSHMS ka qenë 350,500,000 lekë, ndërsa realizimi është 413,395,000 lekë, duke tejkuluar planifikimin e buxhetit me 62,895,000 lekë. Buxheti i planifikuar i vitit 2021 për pjesën që financohet nga MM ka qenë 1,216,000,000 lekë, ndërsa realizimi është 1,305,350,000 lekë, duke tejkuluar planifikimin e buxhetit me 89,350,000 lekë. Buxheti i planifikuar i vitit 2022 për pjesën që financohet nga MSHMS ka qenë 430,500,000 lekë, ndërsa realizimi është 553,361,500 lekë, duke tejkuluar planifikimin e buxhetit me 122,861,500 lekë. Buxheti i planifikuar i vitit 2022 për pjesën që financohet nga MM ka qenë 1,135,076,000 lekë, ndërsa realizimi është 1,441,814,250 mijë lekë, duke tejkuluar planifikimin e buxhetit me 306,738,250 lekë.
Kriteri:	Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 3, pika 29, dhe Kontrata “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore” për vitin 2019 dhe 2020, miratuar me VKA të FSDKSH nr. 20, datë 19.12.2018, dhe nr. 37, date 19.12.2019, neni 11, pika 14, neni 12, pika 14, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “Objektiva të politikës së programit buxhetor” janë rezultatet specifike të matura saktësisht në kohë, sasi dhe kosto, të cilat realizohen në një periudhë afatshkurtër deri afatmesme dhe që përbëjnë hapa të ndërmjetëm drejt arritjes së qëllimit të politikës së programit buxhetor”; “Të zbatohet buxheti sipas fondeve të planifikuara, duke mos lejuar tejkalime jashtë fondeve të miratuara”.
Ndikimi/Efekti:	Mos efikasitet në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për SUT.

Shkaku:	Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga ana e SUT të merren masa që në raportet e monitorimit për zbatimin e buxhetit, të përmbajnë një informacion të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, e buxhetit, nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planifikuara të zërave në buxhet gjatë vitit ushtrimor, si në sasi dhe vlerë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse në fuqi për zbatimin e buxhetit.
Rekomandimi:	Nga ana e SUT të bëhet programimi i buxhetit duke pasur parasysh nevojat reale gjatë vitit të pritshëm buxhetor dhe të shmangen programimet duke rritur bazën në një përqindje të caktuar. Gjatë vitit të angazhohen vetëm ato shpenzime të cilat janë planifikuar sipas llojit dhe të mos ndryshohet destinacioni i përdorimit të këtyre fondeve Brenda artikujve buxhetorë.
Rekomandimi:	Nga ana e SUT të merren masa që strukturat/struktura që do të merren me programimin dhe planifikimin buxhetor, të kryejnë analiza të hollësishme të të gjithë treguesve të buxhetit referuar kuadrit rregullator ligjor përkatës, me qëllim eliminimin e ndryshimeve të konsiderueshme të buxhetit gjatë vitit ushtrimor.

Me veprimet apo mos veprimet ngarkohen me përgjegjësi Z. A. Z. në cilësinë e ish titullarit të institucionit, pasi ka vepruar në mospërputhje me: Nenin 8 të ligjit nr. Nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe Pika 5 e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Znj. E. B. në cilësinë e titullarit të institucionit, pasi ka vepruar në mospërputhje me Nenin 8 të ligjit nr. Nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe Pika 5 e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Znj. E. R. në cilësinë e Përgjegjëses së financës për periudhën nën auditim, dhe znj. E. B., në cilësinë e Përgjegjëses së Financës (07.2022 e në vazhdim), pasi kanë vepruar në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

2.3. Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënie e pagave dhe shpërblimeve.

Bordi Drejtues i Spitalit Universitar të Traumës, ka miratuar Strukturën, Organikën, Statutin dhe Rregulloren e re të Spitalit Universitar të Traumës me Vendim nr.1, datë 15.06.2022, por ato nuk janë miratuar ende nga ministritë.

1. Titulli i gjetjes:	Struktura, organika dhe statuti nuk janë të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Mbrojtjes.
Situata:	Struktura, organika dhe statuti nuk janë të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Mbrojtjes. Struktura organike e re e SUT, është e domosdoshme gjithashtu sepse rregullorja e re e protokolluar me nr. 1195/3 prot., datë 03.06.2022 përfshin pozicione të reja të cilat i janë shtuar rregullores së re. Në këtë mënyrë SUT nuk mund ta

	implementojë ende këtë rregullore. Ndërsa statuti i SUT vazhdon të jetë në fazë Projekt-Statuti. Në Vendimin Nr. 1001, datë 2.12.2015 “Për integrimin e Spitalit Universitar të Traumës dhe Spitalit Ushtarak të Forcave të Armatosura në një strukturë të bashkuar”, ndër të tjera është përcaktuar edhe mënyra e hartimit të strukturës organike të Spitalit Universitar të Traumës, konkretisht pika 5 dhe 6.
Kriteri:	-Kreu III, Neni 23/pika 2, i Ligjit nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; - Pika 8 dhe 10 të VKM nr. 66, datë 03.02.2017 “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare”; - Pika 5 dhe 6 në Vendimin Nr. 1001, datë 2.12.2015 “Për integrimin e Spitalit Universitar të Traumës dhe Spitalit Ushtarak të Forcave të Armatosura në një strukturë të bashkuar”; - Pika 10/ a, b, c në VKM Nr. 66, datë 3.2.2017 “Për Përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen e organizimin e Shërbimeve dhe Strukturave Shëndetësore Universitare”.
Ndikimi/Efekti:	Mos vlerësimi sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Shkaku:	Mos efikasitet në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për SUT.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga Organet Drejtuese të merren masa për sinjalizimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Mbrojtjes, për miratimin e strukturës së re, organikës dhe statutit të SUT, në mënyrë që të aplikohet/zbatohet rregullorja e re e miratuar e SUT.

Struktura dhe organika e SUT është e miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 30, datë 13.03.2017. Numri total i strukturës organizative të miratuar të SUT ka parashikuar të jetë 630 punonjës nga të cilët 141 punonjës financohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Marrëdhëniet e punës në SUT janë të rregulluara me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, me kontratë individuale për secilin punonjës dhe Kontratën kolektive të punës, e cila është lidhur ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë (KSSH) 2021-2024 dhe e protokolluar me nr. 1528/1 prot., datë 30.03.2021.

Nga auditimi rezulton se për periudhën objekt auditimi, nuk ka pasur ndryshime të strukturës, siç është paraqitur në tabelën nr. 1, Aneksi 2.3. Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënie e pagave dhe shpërblimeve.

Referuar të dhënave të tabelës, u konstatua se struktura faktike krahasuar me strukturën e miratuar është realizuar në masën 92.5% për vitin 2021, dhe në masën 91.26% për vitin 2022. Nga auditimi rezulton se, numri i punonjësve të SUT nuk është tejkaluar. SUT ka ende vende vakante të cilat duhen plotësuar për përmbushjen e strukturës së miratuar.

Menaxhimi i burimeve njerëzore (Auditimi i dosjeve të personelit)

Nga auditimi me përzgjedhje i dosjeve të personelit (u audituan 150 dosje personeli me përzgjedhje rastësore, nga 630 punonjës që ka Spitali Universitar i Traumës, pra 23.8 % e dosjeve) konstatohet se në përgjithësi kontrata individuale e punës nuk është ripërtëritur, diploma dhe lista e notave për Arsimin e lartë mungon në 15 raste, dëshmia e mbrojtjes së gjuhës së huaj mungon në 30 raste, raporti i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, si dhe konfirmimi për kryerjen e kontrollit mjekësor bazë nuk është i plotësuar në 5 raste, dhe në 5 raste nuk kanë të plotësuar librezën e punës.

Në shumicën e rasteve nuk është bërë pjesë e dosjes njoftimi për shpalljen e vendit vakant. Në shumicën e rasteve nuk është bërë pjesë e dosjes pikëzimi ose vlerësimi me pikë i kandidatëve mbi pikët e fituara përgjatë gjithë procesit të rekrutimit/konkurrimit përfshirë këtu: pikët e fituara nga përmbajtja e dokumentave të dosjes së kandidati, pikët e fituara gjatë fazës së intervistimit nga Komisioni i Vlerësimit etj. Në shumicën e rasteve nuk është bërë pjesë e dosjes vlerësimi periodik i performancës së punonjësve. *Këto veprime janë në mospërputhje me: VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.*

-Nga verifikimi i dosjeve të personelit me përzgjedhje, u konstatua se Sektori i Auditimit të Brendshëm në organikë nuk plotëson numrin minimal të punonjësve që duhet të ketë njësia e auditimit të brendshëm. *Këto veprime janë në mospërputhje me: VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, pika 3, ku përcaktohet se: “Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë. Në strukturën e njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pacertifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik”.*

Nga grupi u auditimit, u konstatua se aktualisht në SUT janë të punësuar vetëm dy specialistë auditimi, ndërkohë pozicioni i Përgjegjësit të Sektorit të Auditimit të Brendshëm vijon të jetë vend vakant.

Nga auditimi rezulton se:

Nga auditimi i dosjeve të personelit me detyrë elektriciçistë, u konstatua se në dosjet e punonjësve elektriciçistë të SUT nuk u gjetën dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik, konkretisht për: A.M. dhe N. Q. me detyrë elektriciçistë. Referuar strukturës organizative të “Spitalit Universitar të Traumës”, të miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 30, datë 13.03.2017, shkresë e cila është protokolluar me nr. 371 prot., datë 16.03.2017, ku është miratuar që numri i punonjësëve të SUT të jetë 630 punonjës, ndër të cilat ka 4 pozicione janë për elektriciçistë.

Titulli i gjetjes:	Nuk u gjetën dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik për dy punonjës elektriciçistë.
Situata:	Nga auditimi i dosjeve të personelit me detyrë elektriciçistë, u konstatua se në dosjet e punonjësve elektriciçistë të SUT nuk u gjetën dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik, konkretisht për: A.M. dhe N.Q. me detyrë elektriciçistë. Referuar strukturës organizative të “Spitalit Universitar të Traumës”, të miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 30, datë 13.03.2017, shkresë e cila është protokolluar me nr. 371 prot., datë 16.03.2017, ku është miratuar që numri i punonjësëve të SUT të jetë 630 punonjës, ndër të cilat ka 4 pozicione janë për elektriciçistë.
Kriteri:	Ligji nr. 8734, datë 01.02.2001, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike” i ndryshuar, neni 9, pika 1, gërma “a”.
Ndikimi/Efekti:	Risk i mundshëm për ngjarje në dëm të shëndetit dhe jetës së punonjësve.
Shkaku:	Mos njohje e dispozitave ligjore përkatëse.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Drejtori i Spitalit Universitar të Traumës në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse të marrin masa për pajisjen e punonjësve që punojnë në pozicionet e punës elektriciçist me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik, për të siguruar asetet e subjektit.

Me veprimet apo mos veprimet ngarkohen me përgjegjësi Znj. O. M. në cilësinë e Përgjegjëses së Burimeve Njerëzore për periudhën nën auditim, pasi ka vepruar në mospërputhje me: Ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike” i ndryshuar, neni 9, pika 1, gërma “a”.

Nga auditimi rezulton se:

Në disa raste nuk ka përputhshmëri në lidhje me funksionet organike të ushtarakëve, gradës në Top dhe gradës në Fakt për personelin Oficer dhe Nënoficer të Njësisë Mjekësore Ushtarake, e cila konkretisht është në masën 13.3%.

Grada Top përcaktohet si grada për pranimin në pozicionin vakant. Kurse grada Fakt, është grada që realisht punonjësi disponon. Mospërputhja gradë-funksion lidhur me Oficerët, është 5 Oficerë nga 40 në total (12.5%), dhe 5 nënoficerë nga 35 në total (14%), e cila e shprehur në përqindje është në masën 13.3% (totali), siç e kemi paraqitur dhe në tabelat nr. 2, 3, 4 dhe 5, Aneksi 2.3. Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënie e pagave dhe shpërblimeve.

Kjo ka ardhur si pasojë e ndryshimeve gradë-funksion të oficerëve, të cilët janë rritur në gradë gjatë ushtrimit të detyrës, pasi ushtarakët sipas Ligjit nr.59/2014 “Për karrierën ushtarake në forcat e armatosura të Republikës së Shqipërisë” paguhet sipas gradës dhe jo sipas pozicionit ku aktualisht janë vendosur nga Ministria e Mbrojtjes. Kjo është e lejueshme deri në masën 10%, pasi referuar ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, Kreu III, Neni 32, pika 2, përcaktohet se:

“1. Ushtaraku mund të emërohet në një funksion me gradë më të ulët, duke mbajtur gradën që ka, por jo më shumë se një vit. Emërimi në një funksion më të ulët sipas kësaj pike nuk mund të kryhet pa kaluar të paktën 3 (tre) vjet nga emërimi i mëparshëm në një funksion me gradë më të ulët”.

“1/1. Në rast pëlqimi me shkrim nga vetë ushtaraku, emërimi në një funksion me një gradë më të ulët mund të bëhet më shumë se afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.”

“2. Mospërputhja e gradave me funksionet organike në Forcat e Armatosura nuk duhet të kalojë masën 10% (për qind) të numrit të përgjithshëm të personelit ushtarak”.

Në të kundërt, emërimi i tyre në funksionet që aktualisht janë vende bosh/vakante në NJMU, nuk do të plotësonte disa nga kriteret e kërkuara në Kreun II, pika 2, “Kriteret e emërimit”, përcaktuar në Urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes nr. 1446, datë 06.10.2014, “Për miratimin e politikave dhe procedurave të standardeve të emërimit të personelit FARSH”, siç janë: plotësimi i kërkesave sipas funksionit organik, specialiteti, arsimimi/trajnimi/kualifikimi dhe eksperiencia e nevojshme. Në zbatim të pikës 4.2, të këtij urdhri për detyra të veçanta, që kërkojnë aftësi të veçanta dhe specialitete të veçanta të cilat janë të nevojshme për FA, aplikohet kohë qëndrimi më të mëdha, çka justifikon deri në një farë mase këtë mospërputhje.

Duke qënë se Njësia Mjekësore Ushtarake është e vetmja strukturë në Forcat e Armatosura, që ofron shërbime shëndetësore të specializuara, lihet si detyrë që të shihet mundësia e emërimeve me qëllim të mos kemi mospërputhje midis gradave me funksioneve organike.

Titulli i gjetjes:	Në disa raste nuk ka përputhshmëri në lidhje me funksionet organike të ushtarakëve, gradës në Top dhe gradës në Fakt për personelin Oficer dhe Nënoficer të Njësisë Mjekësore Ushtarake, e cila konkretisht është në masën 13.3%.
Situata:	Në disa raste nuk ka përputhshmëri në lidhje me funksionet organike të ushtarakëve, gradës në Top dhe gradës në Fakt për personelin Oficer dhe Nënoficer të Njësisë Mjekësore Ushtarake, e cila konkretisht është në masën 13.3%. Grada Top përcaktohet si grada për pranimin në pozicionin vakant. Kurse grada Fakt, është grada që realisht punonjësi disponon. Mospërputhja gradë-funksion lidhur me Oficerët, është 5 Oficerë nga 40 në total (12.5%), dhe 5 nënoficerë nga 35 në total (14%), e cila e shprehur në përqindje është në masën 13.3%

	<p>(totali), siç e kemi paraqitur dhe në tabelat nr. 2, 3, 4 dhe 5, Aneksi 2.3. Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënie e pagave dhe shpërblimeve.</p> <p>Kjo ka ardhur si pasojë e ndryshimeve gradë-funksion të oficerëve, të cilët janë rritur në gradë gjatë ushtrimit të detyrës, pasi ushtarakët sipas Ligjit nr.59/2014 “Për karrierën ushtarake në forcat e armatosura të Republikës së Shqipërisë” paguhen sipas gradës dhe jo sipas pozicionit ku aktualisht janë vendosur nga Ministria e Mbrojtjes. Kjo është e lejueshme deri në masën 10%, pasi referuar ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, Kreu III, Neni 32, pika 2, përcaktohet se:</p> <p>“1. Ushtaraku mund të emërohet në një funksion me gradë më të ulët, duke mbajtur gradën që ka, por jo më shumë se një vit. Emërimi në një funksion më të ulët sipas kësaj pike nuk mund të kryhet pa kaluar të paktën 3 (tre) vjet nga emërimi i mëparshëm në një funksion me gradë më të ulët”.</p> <p>“1/1. Në rast pëlqimi me shkrim nga vetë ushtaraku, emërimi në një funksion me një gradë më të ulët mund të bëhet më shumë se afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.”</p> <p>“2. Mospërputhja e gradave me funksionet organike në Forcat e Armatosura nuk duhet të kalojë masën 10% (për qind) të numrit të përgjithshëm të personelit ushtarak”.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në forcat e armatosura të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Neni 32, pika 2.</p> <p>VKM nr. 426, datë 22.06.2022, “Për disa ndryshime në vendimin me nr.224, datë 21.03.2017, të Këshillit të Ministrave “Per trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve aktiv të Forcave të Armatosura të RSH-së, i ndryshuar”.</p>
Ndikimi/Efekti:	Ka sjell mosrespektimin e masës së lejueshme për përputhjen gradë-funksion organik.
Shkaku:	Për shkak të mungesës së kandidatëve që i plotësojnë të gjitha kriteret e përcaktuara për pozicionet vakante dhe ofrimit të një shërbimi sa më të mirë për pacientët.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Nga Organet Drejtuese të NJMU, pavarësisht se ligji nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në forcat e armatosura të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, lejon deri në 10% lidhur me mospërputhjen e gradave me funksionet organike në Forcat e Armatosura, lihet detyrë që NJMU në bashkëpunim me Drejtorin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes të ndjekin vazhdimësinë e kësaj problematike.

Masat disiplinore të dhëna nga strukturat përgjegjëse të SUT

Nga auditimi rezulton se:

Për vitin 2021 janë dhënë 18 masa disiplinore në total, nga të cilat 5% e masave disiplinore i janë dhënë infermierëve/laborantëve dhe 2% mjekëve.

Për vitin 2022 janë dhënë 24 masa disiplinore në total, nga të cilat 7% e masave disiplinore i janë dhënë infermierëve/laborantëve dhe 4% mjekëve. Tabela përmbledhëse lidhur me masat disiplinore përgjatë periudhës së auditimit 2021-2022 është paraqitur në tabelën nr. 6, Aneksi 2.3. Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënie e pagave dhe shpërblimeve.

Ndërprerja e marrëdhënieve të punës

Nga grupi i auditimit konstatohet se në vitin 2021 janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për 10 punonjës dhe për vitin 2022 janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për 21 punonjës, siç e kemi paraqitur dhe në tabelën nr. 7, Aneksi 2.3. Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënie e pagave dhe shpërblimeve.

Për vitin 2021 janë 10 ndërprerje marrëdhëniesh pune, nga të cilat kanë dhënë dorëheqjen 3% infermierë/laborantë dhe 2% mjekë.

Për vitin 2022 janë 21 ndërprerje marrëdhëniesh pune, nga të cilat kanë dhënë dorëheqjen 4% infermierë/laborantë dhe 1% mjekë.

Pagat dhe shpërblimet

Përgjatë periudhës së auditimit, SUT ka marrë si referencë për dhënien e pagave këto VKM: - VKM nr. 224, datë 21.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve aktivë të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë”, VKM nr. 426, datë 26.06.2022 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve aktivë të forcave të armatosura të Republikës së Shqipërisë”, VKM nr. 466, datë 06.07.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve me arsim të lartë dhe të punonjësve të personelit Teknik të shkencave mjekësore, në systemin e ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, në njësinë mjekësore ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, në strukturat e tjera të forcave të armatosura dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe spitalin përkatës”, VKM nr. 555, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve të personelit mjekësor, të punonjësve me arsim të lartë dhe punonjësve të infermieristikës në systemin e ministrisë së Shëndetësisë dhe njësinë mjekësore ushtarake pranë Spitalit Universitar të Traumës, si dhe për trajtimin e personelit mjekësor në strukturat e forcave të armatosura”.

Nga auditimi në tërësi të listë pagesave për periudhën e përcaktuar në program, u konstatua se shuma e përgjithshme e listë pagesave është e njëjtë me urdhër xhirimin e përgatitur për këtë qëllim. Përmbledhëset e listë pagesës në çdo rast janë të nënshkruara nga eprori direkt dhe drejtori i departamenti etj. Listë pagesat janë të shoqëruara me listë prezencat përkatëse për çdo drejtori. Listë pagesat paraqesin nga paga bruto, shtesat, ndalesat deri në pagën neto. Pagesat neto të pagës, kryhen nëpërmjet sistemit banker.

Në procedurën e pagesës hartohet listë prezenca dhe nënshkruhet nga drejtorët e drejtorive më pas hartohet listë pagesa mbi bazën e klasifikimit të pagave, shtesa për pozicione të veçanta pune, duke kryer llogaritjet për tatimin mbi të ardhurat nga punësimi dhe kontributet e sigurimeve shoqërorë dhe shëndetësore plotësohet listë-pagesa përkatëse dhe dërgohet në thesar për pagesë.

Janë kryer ndalesat për tatimin e të ardhurave personale nga punësimi sipas përcaktimeve në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe janë paguar brenda datës 20 të muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa.

Është përlllogaritur, ndalur dhe derdhur në organet tatimore kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mbi bazën e pagës minimale dhe maksimale si dhe përqindjeve përkatëse punëdhënës e punëmarrës sipas VKM nr. 1114, datë 30.7.2008 i ndryshuar “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11. 5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligji nr. 9136, datë 11.9.2003 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe ligji nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 26, datë 16.4.2009 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” i ndryshuar, dhe pas hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 457, datë 09.07.2014, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 1114, datë 30.7.2008, të këshillit të ministrave, “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në republikën e Shqipërisë””, të ndryshuar, nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe

shëndetësore në republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr. 10383, datë 24.2.2011, “për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Afatet e deklarimit dhe pagesës së kontributeve janë në varësi të statusit të personit që detyrohet të paguajë kontributet dhe përcaktohen në nenet 10 dhe 11 të ligjit nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, i përcaktuar jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës. Paga e tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi, si dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, siç është paraqitur në tabelat nr. 8 dhe 9, Aneksi 2.3. Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënien e pagave dhe shpërblimeve paraqiten të dhëna përmbledhëse për përdorimin e fondit të veçantë për periudhën e auditimit.

Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin e fondit të veçantë, dhënien e shpërblimeve për raste për trajtim financiar, ndihmë financiare dhe ndihmë e menjëhershme për ushtarakët, për lirim nga detyra si shtarak, për dalje në pension etj.

Nga auditimi, konstatohet se fondi i shpërblimeve përdoret sipas nevojave të cilat dalin në pah në varësi të nevojave të ndryshme në periudhën objekt auditimi, siç është paraqitur në tabelën nr. 10, Aneksi 2.3. Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënie e pagave dhe shpërblimeve paraqiten të dhëna përmbledhëse për përdorimin e fondit të veçantë për periudhën e auditimit.

Ky fond është përdorur në vlerën 6,285,410 lekë, për shpërblime për raste për trajtim financiar, ndihmë financiare dhe ndihmë e menjëhershme për ushtarakët, shpërblime për lirim nga detyra të ushtarakëve, kompesim telefoni (Zv. Drejtori ushtarak) dhe shpërblime për medalje.

Konkretisht:

1. Fondi i veçantë për vitin 2022 është 4,870,000 lekë. Ky fond është dhënë mbi bazën e Vendimit nr. 898, datë 29.12.2022, “Për mbeshtetje Financiare të menjëhershme të punonjësve të Njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e krizës”.

2. Trajtimi financiar për vitin 2021 është në vlerën 377,674 lekë, ndërsa për vitin 2022 në vlerën 382,945 lekë. Kjo përfshin trajtimin financiar të ish-ushtarakut aktiv F. Sh. e cila është liruuar si e paafte si ushtarake aktive, e cila trajtohet me pagesë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 451, datë 09.07.2009.

3. Ndihma financiare dhe ndihma e menjëhershme për ushtarakët përfshin ndihmat në rast sëmundje, fatkeqësish për punonjësit civilë dhe ushtarakë, sipas urdhrave përkatës të gjithësecilit.

4. Shpërblim për lirim nga detyra e ushtarakëve. Këtu përfshihet trajtimi i punonjësve nga detyra ushtarakë sipas pikës 1, 2 dhe 3 të nenit 12 të Ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009 “Për Sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të policisë së shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe sigurisë së mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit të punonjësve të shërbimit të kontrollit të brendshëm në Republikën e Shqipërisë”.

Për punonjësit e larguar të cilët janë në proces gjykimi.

Përsa i përket punonjësve të larguar, është bërë paraqitja e tyre me anë të një tabelë përmbledhëse, siç është paraqitur në tabelën nr. 11, Aneksi 2.3. Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënie e pagave dhe shpërblimeve paraqiten të dhëna përmbledhëse për përdorimin e fondit të veçantë për periudhën e auditimit. Nga të dhënat konstatohet se procedura për 6 (gjashtë) punonjësit e larguar (R.C., D.K., F.B., Dh.M., E.T., A.D.) është në proces gjykimi në Gjykatën e Apelit. Ndësa për punonjësinnj. Alida Mandri është në proces gjykimi nga Gjykata e Shkallës së Parë.

2.4. Mbi auditimin me zgjedhje të pagesave të kryera me anë të arkës dhe bankës, shpenzimeve administrative.

Nga auditimi i veprimeve me arkën në Spitalin Universitar të Traumës, u konstatua se funksionon një arkë e cila ndodhet në ambjentet e spitalit, ku bëhen arkëtimet nëpërmjet mandateve të vizitave: Ekg, Scanner, MRI etj. Nga verifikimi i ditarit të arkës me përzgjedhje, për periudhën e auditimit 01.01.2021 deri më 31.12.2022, u konstatua se për të gjitha rastet e kontrolluara të ardhurat që vijnë nga arka shoqërohen me mandat-arkëtime për shërbimet e kryera për pacientët. Të gjitha mandat-arkëtimet janë në dokumentacionin e arkës sipas muajve përkatës. Nga kontrolli i regjistrimeve kontabël të bëra në ditar arke, u konstatua se veprimet mbahen kronologjikisht. Të gjitha veprimet e kryera nëpërmjet arkës, janë të rregullta e të pajisura me dokumenta justifikuese.

Respektimi i limitit të arkës.

Limiti i arkës së SUT nuk është i miratuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Shëndetësisë, por veprohet sipas pikës 3 të VKM nr. 290, datë 14.06.1993 “Për limitin ditor të arkës për ndërmarrjet shtetërore”. Daljet e arkës me derdhjet në bankë janë të rakorduara. Arkëtari i arkës qëndrore çdo ditë mbledh arkëtimet dhe bën derdhjet në bankë për shumat e mbledhura. Derdhjet në bankë janë bërë jo çdo ditë, por një herë në 3-4 ditë.

Titulli i gjetjes:	Tejkalim të limitit ditor të arkës së SUT.
Situata:	Nga auditimi i librit të arkës për periudhën e auditimit u konstatua se shumat e arkëtuara në arkën qëndrore e tejkalojnë limitin ditor të arkës. Arkëtari i arkës qëndrore çdo ditë ka mbledhur arkëtimet dhe ka bërë derdhjet për shumat e mbledhura. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, u konstatua se derdhjet në bankë nuk janë bërë çdo ditë, por një herë në 3-4 ditë.
Kriteri:	VKM nr. 290, date 14.06.1993 “Për limitin ditor të arkës për ndërmarrjet shtetërore”, pika nr. 3.
Ndikimi/Efekti:	Mos vlerësim, sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Shkaku:	Mungesa e efikasitetit në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për SUT.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga Arkëtari dhe Shefja e Financës të merren masa për respektimin e limitit ditor të arkës për të ulur riskun e mbajtjes së Cash-it në SUT.

Nga auditimi konstatohet se: mungon një mandat-arkëtim i datës 15.04.2022.

Nga auditimi i dokumentave me përzgjedhje të arkës, pasi u kontrolluan një për një të gjitha mandat-arkëtimet konkretisht për muajt shkurt, prill, dhjetor të vitit 2021 dhe shkurt, prill, tetor të vitit 2022, u konstatua se dokumentat bashkëlidhur janë në rregull, përveç një rasti ku mungon një mandat-arkëtim i datës 15.04.2022. konkretisht është mandat-arkëtim nr. 56859, datë 15.04.2022 “Tomografi aksiale e kompjuterizuar (CT) e regjioneve të tjera” në vlerë 1,000 lekë është shënuar në përmbledhësen ditore, por nuk ndodhet fizikisht tek dokumentat. Pra në këtë datë duhet të ishin gjëndje fizike 13 mandat arkëtime (referuar përmbledhësese ditore të realizuara nga arkëtari), ndërkohë që fizikisht gjenden 12 mandat arkëtimi.

Duke vepruar në mospërputhje me: Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, Kreu III, pika 62, ku përcaktohet se: “Veprim arke është shërbimi i arkëtimet dhe i pagesës me para në dorë që bëhet në të gjitha nivelet e njësisë publike, në bazë të mandatarkëtimet ose të mandatpagesës”.

-Nga auditimi me zgjedhje të pagesave të kryera me anë të bankës, u konstatua se të gjitha veprimet kryeshin nëpërmjet llogarisë në lekë pranë Degës së Thesarit Tiranë. Për secilin muaj është bërë

rakordimi me Degën e Thesarit lidhur me veprimet bankare që SUT ka realizuar përmes Degës së Thesarit.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se transaksionet janë kryer konformë Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me ndryshimet vijuese të tij, Ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, me ndryshimet vijuese të tij, Ligjit nr. 83/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me ndryshimet vijuese të tij.

Veprimet financiare janë regjistruar në regjistrat e kontabilitetit, bazuar në dokumente vërtetues. Dokumentacioni është i sistemuar në mënyrë kronologjike.

U audituan me përzgjedhje Urdhër-shpenzimet e 3 mujorit të parë 2021 dhe 2022, për likuidimin e faturave të energjisë elektrike dhe ujit dhe u konstatua se të gjitha detyrimet janë likuiduar në kohë dhe bashkëlidhur ndodhet gjithë dokumentacioni justifikues (nuk kanë gjoba).

Titulli i gjetjes:	Ka parregullsi mbi veprimet e kryera me bankë.
Situata:	<p>Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të bankës konstatohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në të gjitha rastet për vitet 2021 dhe 2022, procesverbalet për marrjen në dorëzim të mallrave apo shërbimeve janë pa numër protokolli. - Në disa raste u konstatua se referuar kontratave me operatorët ekonomikë, nga ana e Spitalit Universitar të Traumës ka vonesa në likuidimin e faturave me operatorët ekonomikë, (të cilat janë bërë jashtë afatit të përcaktuar në kontratë, me një vonesë deri në 1 ose 2 muaj) duke mos respektuar afatet e parashikuara në detyrimet kontraktuale të kontratave dypalëshe respektive. - Gjatë auditimit me zgjedhje të likuidimeve nëpërmjet bankës u konstatua se gjatë muajit shkurt dhe mars 2022 janë pranuar dhe likuiduar nga Komisioni i Pritjes së mallit “Blerje medikamente mjekësore”, të cilat e kanë pasur afatin e skadencës më të vogël se 1 vit. Kjo gjë është konstatuar në urdhër-shërbimin nr. 15, datë 15.02.2022 dhe në urdhër-shërbimin nr. 36, datë 10.03.2022. - Likuidimi i urdhër shpenzimit nr. 15, datë 15.02.2022 “Blerje medikamente mjekësore” i referohet kontratës nr. 79/15, datë 17.01.2022 lidhur mes SUT dhe OE “P. O.” në vlerën 14,235,000 lekë. Urdhri i brendshëm për ngritjen e Komisionit të marrjes në dorëzim është nr. 79/4, datë 24.11.2021, me komision: A. C. (Kryetar), T. C. dhe A. G. (Anëtarë). Procesverbali i marrjes në dorëzim është i datës 17.01.2022, i cili nuk është i protokolluar. Ndërsa fletë hyrja në Farmaci Qëndrore mban nr. 1242. Referuar këtij procesverbali janë marrë në dorëzim medikamentet: Eptacog Alfa (Advanced) (1 mg/m i after reconstitution; me nr. serial AG93) me skadencë 30.06.2022 në vlerën totale 4,818,000 lekë dhe Eptacog Alfa (Advanced) (1 mg/m i after reconstitution; me nr. serial AX85) në vlerën 9,417,000 lekë. - Likuidimi i urdhër shpenzimit nr. 36, datë 10.03.2022 “Furnizim medikamente mjekësore” i referohet kontratës nr. 79/29, datë 10.02.2022 lidhur mes SUT dhe OE “Medicamenta” në vlerën 2,002,602 lekë. Urdhri i brendshëm për ngritjen e Komisionit të marrjes në dorëzim është nr. 79/4, datë 24.11.2021, me komision: A. C. (Kryetar), T. C. dhe A. G. (Anëtarë). Procesverbali i marrjes në dorëzim është i datës 28.02.2022, i

	cili nuk është i protokolluar. Ndërsa fletë hyrja në Farmaci Qëndrore mban nr. 1271, Referuar këtij procesverballi janë marrë në dorëzim medikamentet: Serum Antitetanik (SAT) Human Antitetanus immunoglobuline; me nr. serial L02R0720 me skadencë 01.02.2023 në vlerën totale 601,983 lekë.
Kriteri:	DST të paraqitura në procedurën e prokurimit dhe në kontratën e nënshkruar mes palëve si dhe në dokumentet standarde të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe APP; dhe Kontrata dypalëshe e lidhur midis SUT dhe OE “P. O.” nr. 79/15, datë 17.01.2022; Kontrata dypalëshe e lidhur midis SUT dhe OE “Medicamenta” nr. 79/29, datë 10.02.2022 dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Mos pasqyrimi i rrjedhës së dokumentacionit mbi mbajtjen e dokumentave justifikues në veprimet e kryera me bankë si dhe risqe për krijimin e penalteteve të mundshme.
Shkaku:	Mos implementimi i dispozitave ligjore përkatëse.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga Organet Drejtuese të merren masa në të ardhmen, për plotësimin dhe sistemimin në mënyrë kronologjike të dokumentacionit justifikues, bashkëlidhur veprimeve të kryera me bankë në zbatim të përcaktimeve të dispozitave ligjore përkatëse.

Konsumi i karburantit

Për vitin 2021, Spitali Universitar i Traumës ka konsumuar 30,058 litra naftë dhe 704 litra benzinë, të cilën e ka përdorur vetëm autoambulanca, tip Ford me targë 619010 (e bardhë) e cila nuk përdoret më që nga korrik 2021, pasi të gjithë automjetet e tjera janë me naftë, siç e kemi paraqitur dhe në tabelën nr. 1, Aneksi 2.4. Mbi auditimin me zgjedhje të pagesave të kryera me anë të arkës dhe bankës, shpenzimeve administrative.

Ndërsa për vitin 2022, Spitali Universitar i Traumës ka konsumuar 28,068 litra naftë.

Shpenzimet për konsumin e karburantit mbahen në dosjen e mjetit nga drejtuesi i automjetit. Pjesë përbërëse e dosjes janë: Urdhri për përdorimin e mjetit, siguracioni vjetor, leje qarkullimi, kontrolli teknik, pasqyrat e konsumit të karburantit dhe kilometrave për secilin muaj, kartelat e secilit automjet dhe fletë udhëtimet, fletë-daljet nga magazine dhe kërkesat dhe autorizimet për lëvizjen e mjetit.

Nga kontrolli me zgjedhje i ushtruar në rakordimin e rrugëve të raportuara në fletë udhëtime dhe regjistrin të shërbimit 24-orësh, u konstatua se rrugët e shënuara në regjistër përputhen me volumin e punës në fletë udhëtimet përkatëse.

Për çdo lëvizje të autoambulancave plotësohen çdo ditë nga ana e shoferëve, fletë udhëtimet të cilat dorëzohen në fund të muajit tek Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve të Brendshme, për të bërë përpunimin e tyre.

Nga kontrolli i ushtruar ndaj fletë udhëtimeve u konstatua se:

Për çdo automjet janë mbajtur fletë udhëtime e lëvizjeve ditore, formati i të cilave është sipas standardit. Për urgjencat jashtë rrethit ka autorizime, të cilat janë të vulosura dhe të miratuara nga Titullari. Në çdo fletë udhëtimi janë shënuar kilometrat e përshkruara mbi bazën e distancës së këtyre lëvizjeve. Për urgjencat e brendshme, fletë udhëtimet janë të firmosura nga mjeku i urgjencës për çdo shërbim roje.

Titulli i gjetjes:	Nuk ka normativa të miratuara për konsumin e karburantit për automjetet e Spitalit Universitar të Traumës.
Situata:	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, me përzgjedhje, u konstatua se: -Në 5 raste Autorizimi për lëvizjen e mjetit nuk ndodhej në dosje. -Nuk kanë bërë një planifikim mujor apo vjetor ku të ketë një plan shpërndarje për çdo sektor/degë/drejtori. -Nga Organet Drejtuese nuk ka të përcaktuar një udhëzim, manual dhe rregulla ku të jenë pjesë e rregullores së brendshme në të cilën të përcaktohet mënyra e funksionimit, monitorimit dhe organizimit të gjithë procesit të konsumit të karburantit për automjetet e SUT, në të cilën të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësitë respektive sipas drejtorive apo sektorëve.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 19, neni 22, dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 5, 10, 19 dhe 36.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e një pasqyrimi të saktë dhe transparent i procesit të monitorimit për konsumin e karburantit për mjetet e institucionit.
Shkaku:	Mos implementimi dhe zbatimi i dispozitave.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga Titullari i SUT të merren masa për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshijë ata që kanë mjete në ngarkim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë gjendjen teknike të mjeteve dhe më pas të caktojë normativat mbi konsumin e karburantit, për mjetet që ushtrojnë aktivitetin në SUT pa normativa të miratuara.

Titulli i gjetjes:	Zëra të pajustificuar në urdhër-shpenzime për automjetin me targë 619 013.
Situata:	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se në Urdhër-shpenzimin nr. 122, datë 09.08.2021, janë likujduar shërbim mirëmbajtje automjesh sipas kontratës nr. 79/29, datë 23.04.2021 për automjetin me targë 619 013. Nga grupi i auditimit u konstatua se janë kryer zëra shërbimesh të pajustificuara, pasi automjeti me targë 619 013, sipas fletë udhëtimeve nuk ka lëvizur për të gjithë vitin 2021. Pra, vlera që është likujduar në urdhër shpenzimin nr. 122, datë 09.08.2021 në vlerën 116,400 lekë përbën dëm ekonomik. Gjithashtu u konstatua se në Urdhër-shpenzimin nr. 239/1, datë 31.12.2021 janë likujduar shërbim mirëmbajtje automjesh sipas kontratës nr. 3/15, datë 08.10.2021 për automjetin me targë 619 013. Nga grupi i auditimit u konstatua se janë kryer zëra shërbimesh të pajustificuara, pasi automjeti me targë 619 013, sipas fletë udhëtimeve nuk ka lëvizur për të gjithë vitin 2021. Pra, vlera që është likujduar në urdhër shpenzimin nr. 239/1, datë 31.12.2021 në vlerën 21,600 lekë përbën dëm ekonomik.

Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Kontratën S/2021 Neni 11 pika 2, Kontrata S/2022 Neni 13 pika 2; Kontrata S/2021 Neni 11 pika 2, Kontrata S/2022 Neni 13 pika 2; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar; si dhe Kontrata S/2021 Neni 11 pika 2, Kontrata S/2022 Neni 13 pika 2.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e një pasqyrimi të saktë dhe transparent i procesit të monitorimit për konsumin e karburantit për mjetet e institucionit.
Shkaku:	Nuk është kryer një analizë e detajuar në lidhje për automjetet të cilat disponon në pronësi SUT, konkretisht për automjetet që janë në gjendje pune dhe jo funksionale.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga Organet Drejtuese të analizohet kjo situatë duke nxjerrë përgjegjësitë respektive dhe të merret vendimi përkatës, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative.

Me veprimet apo mos veprimet ngarkohen me përgjegjësi Z. A. Z. në cilësinë e ish titullarit të institucionit dhe Znj. E. B. në cilësinë e titullarit të institucionit, pasi kanë vepruar në mospërputhje me Neni 19, neni 22 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 5, 10, 19 dhe 36.

Znj. E. R. në cilësinë e Përgjegjëses së financës për periudhën nën auditim, dhe znj. E. B., në cilësinë e Përgjegjëses së Financës (07.2022 e në vazhdim) në mospërputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” dhe VKM nr. 290, datë 14.06.1993 “Për limitin ditor të arkës për ndërmarrjet shtetërore”, pika 3.

Z. V. S., në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Shërbimeve të Brendshme dhe Z. A. Rr., në cilësinë e magazinierit të SUT (Janar 2022 e në vazhdim) dhe z. F. B. në cilësinë e magazinierit të SUT (deri dhjetor 2021), pasi kanë vepruar në mospërputhje me: Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar; si dhe Kontratën S/2021 Neni 11 pika 2, Kontratën

2.4.1. Zbatimi i dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve me vlerë të vogël

Në zbatim të pikës nr. 4, të programit të auditimit nr. 1199/1 prot., datë 13.01.2022, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Regjistrat e planifikimit dhe realizimit të prokurimeve për vitin 2021.
2. Urdhrat për ngritjen e komisioneve të prokurimeve me vlera të vogla për vitin 2021.
3. Procedurat e prokurimeve me vlera të vogla me zgjedhje për vitin 2021.
4. Dokumentacion plotësues/justifikues si fatura, transaksione bankare, fletë-hyrje në magazinë etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar në SEP rezulton se:

Për vitin 2021 janë realizuar 27 procedura prokurimi me vlera të vogla të publikuara në sistemin elektronik të APP-së me fond limit 19,298,700 lekë pa tvsh dhe realizuar me vlerë kontrate në shumën 15,907,112 lekë pa tvsh, sic paraqitet në tabelën nr.1 aneksi 2.4.1.

Komisioni i prokurimit me vlera të vogla për vitin 2021 i ngritur me Urdhrin Nr.1/1, Datë 07.01.2021, përbëhet nga znj. R.J. me detyre specialiste prokurimi (përgjegjëse për prokurim), znj.M.M.(Specialiste) dhe z. B. V.(Jurist).

Grupi i auditimit të KLSH nga 27 procedura prokurimi me blerje të vogël të realizuara në shumën 19,298,700 lekë pa tvsh, përzgjodi 5 procedura me fond limit në shumën 4,595,285.33 lekë pa tvsh ose në masën 23.85% të vlerës totale të fondit limit, sic paraqitet në tabelën nr.2 aneksi 2.4.1.

Procedura e Prokurimit me Vlerë të Vogël “Blerje sete mjekimi për aparaturat e Vak Terapisë në funksion të shërbimit të Këmbës Diabetike”.

Me Urdhrin nr. 48, datë 05.05.2021, të Drejtorit të SUT, z.A.Z.në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor është urdhëruar ngirtja e grupit të punës për hartimin e Specifikimeve Teknike të procedurës: **“Blerje sete mjekimi për aparaturat e Vak Terapisë në funksion të shërbimit të Këmbës Diabetike”**, i përbërë prej Dr.M. Xh. (Kryetar), Dr.B. P.) dhe z.G. P.

Me Urdhrin nr. 48/1, datë 14.12.2021, të Drejtoreshës së SUT, znj. E.B.e në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor është urdhëruar ngirtja e grupit të punës për hartimin e Specifikimeve Teknike i përbërë prej Dr.Medien Xhaferri (Kryetar), z.M.S. dhe z.G. P.

Me Urdhrin Nr.48/3, datë 20.12.2021, është krijuar Komisioni i Procedurës me vlerë të vogël i përbërë prej znj.R. J. (Specialiste prokurimi), znj.M.M. (Specialiste prokurimi), z.B.V.(Jurist). Anëtarët kanë firmosur Formularët e Deklarimit.

Me shresën Nr. 48/4, datë 20.12.2021 i është dërguar kërkesë 3 Operatorëve Ekonomike për dhënie oferte O.E. “G.-A.” Shpk, “L.” Shpk dhe “E.” Shpk.

Me shkresën Nr.48/5, datë 20.12.2021 është bërë argumentimi për llogaritjen e fondit limit në bazë të ofertave të Operatorëve Ekonomikë.

Me shkresën Nr. 48/6, datë 20.12.2021 është urdhëruar prokurimi për procedurën me Fond Limit 998,338.00 Lek pa TVSH.

Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi me vlerë të vogël janë 2:

“G.” Shpk – 900,500 lekë pa TVSH

“G.-A. F.” Shpk – 950,000 lekë pa TVSH

OE “G.” Shpk është skualifikuar me arsyen sepse nuk ka të përfshirë objektin e prokurimit në fushën e veprimtarisë.

Me shkresën Nr.48/8, datë 23.12.2021 është mbajtur Proçes-Verbal për procedurën Prokurim me Vlera të Vogla u njoftua OE **“G.-A. F.”** me ofertë ekonomike **950,000 lekë pa TVSH**, i renditur në vend të parë i cili u paraqit me dokumentacionin e kërkuar sipas ftesës për ofertë dhe u njoftua grupi i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit për të kontrolluar mallrat objekt i këtij prokurimi.

Për sa më sipër nga grupi i auditimit nuk u konstatua ndonjë problematikë.

Procedura e Prokurimit me Vlerë të Vogël “Krijimi i faqes Web zyrtare të Spitalit Universitar të Traumës”.

Me shkresën Nr.308 Prot., datë 07.06.2021 nga Përgjegjësi i Sektorit të Planifikimit znj.E.O.është bërë kërkesa për prokurimin **“Ndërtim WEB për SUT”**, drejtuar Sektorit të Prokurimeve z. G.H.

Me Urdhrin Nr.55, datë 07.06.2021 është ngritur grupi i punës për Specifikimet Teknike të procedurës me objekt: **“Krijimi i faqes ËEB zyrtar të Spitalit Universitar të Traumës”**. Grupi përbëhet prej z.L.H. z.S. K. dhe z.G. P.

Me shkresën Nr.55/1, datë 08.06.2021 janë hartuar Specifikimet Teknike dhe i janë dërguar Sektorit të Prokurimeve.

Me Urdhrin Nr.55/2, datë 08.06.2021 është krijuar Komisioni i Blerjes me Vlerë të Vogël i përbërë prej znj.R. J., znj.M.M. dhe z.B.V.Anëtarët kanë firmosur Formularët e Deklarimit sipas Shtojcës Nr.1.

Me Shkresat Nr.55/3, datë 08.06.2021, i është dërguar kërkesë për dhënie oferte 3 Operatorëve Ekonomik si më poshtë: “A.” Shpk, “T. CO” Shpk dhe “L.” Shpk.

Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi me vlerë të vogël janë 13, 8 oferta janë pranuar dhe 5 janë refuzuar:

- OE "K." Shpk – 360,000.00 Lek pa TVSH
- OE "A-T-D" Shpk – 450,000.00 Lek pa TVSH
- OE "S. P." Shpk – 480,000.00 Lek pa TVSH
- OE "S.T." Shpk – 540,000.00 Lek pa TVSH
- OE "O. T." Shpk – 550,000.00 Lek pa TVSH
- OE "L." Shpk – 550,000.00 Lek pa TVSH
- OE "F." Shpk – 590,000.00 Lek pa TVSH
- OE "J. G." Shpk – 600,000.00 Lek pa TVSH

Me Shkresën Nr.55/5 Prot., datë 09.06.2021 është bërë argumentimi i Fondit Limit për procedurën në fjalë.

Me Shkresën Nr.55/6, datë 24.06.2021, është bërë Urdhri i Prokurimit për Prokurimet me Vlera të Vogla ku janë të cituara Specifikimet Teknike dhe Kushtet e Kualifikimit për OE pjesëmarrës.

Në datë 24.06.2021 është mbajtur Procesverbal për Argumentimin dhe Miratimin e Secifikimeve Teknike dhe Kriteve për Kualifikim. .

Me Shkresën Nr.58, datë 01.07.2021 është bërë Urdhri Prokurimit me Vlera të Vogla.

Me Shkresën Nr.58/2, datë 08.07.2021 është urdhëruar krijimi i komisionit të marrjes në dorëzim të variantit përfundimtar të faqes WEB zyrtare të SUT. Komisioni përbëhet prej 5 anëtarësh të cilët janë z.G. H. (Përgjegjës i sektorit të prokurimeve), z.S.K.(Specialist IT), z.M. S. (Jurist), znj.D. Ll. (Inxhinieri Ndërtimi) dhe z.G. P. (Specialist paisjesh).

Me Shkresën Nr.58/3, datë 12.07.2021 është mbajtur Proces-Verbal ku listohen OE pjesëmarrës të cilët janë skualifikuar dhe pranuar. Pas verifikimit të dokumentacionit të kërkuar sipas Kërkesave në Ftesën për Ofertë, Komisioni i blerjes me vlerë të vogël vendosi shpalljen e fituesit për këtë procedurë OE "L." i renditur në vend të tretë me ofertë ekonomike **500,000 lekë pa TVSH** dhe do të arkivojë dosjen në sistemin elektronik.

Titulli i gjetjes:	Mos përmbushja e kushteve të kontratës
Situata:	Nga verifikimi i faqes Web për funksionimin dhe administrimin e saj, u konstatua që faqja Web nuk funksiononte dhe në nënmenut dhe faqja kryesore ishin të paplotësuara dhe pa të dhënë, duke ngarkuar me përgjegjësi grupin e marrjes në dorëzim dhe i monitorimit të kontratës z.G. H. (Përgjegjës i sektorit të prokurimeve), z.S. K. (Specialist IT), z.M.S. (Jurist), znj.D. Ll. (Inxhinieri Ndërtimi) dhe z.G. P.(Specialist paisjesh).
Kriteri:	Neni 77 "Mbikëqyrja e kontratës", të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020", Neni107 "Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës", të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".
Ndikimi/Efekti:	Cënon cilësinë dhe vazhdimësinë e kryerjes së shërbimit
Shkaku:	Mos zbatimi i kushteve të kontratës
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	SUT, të marrë masat për ngritjen e një komisioni të dytë për zbatimin dhe mbikëqyrjen e kontratës, në lidhje me faqen ëeb, për vënien e saj në përdorim sipas kushteve të kontratës.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur shpjegimi me shkresën nr.1375/11 prot, datë 04.07.2023 "Shpjegime për Projekt Raportin e Auditimit Nr.1190 Prot., datë 05.06.2023" nga z G. H., z. S. K., z. M. S., znj. D. Ll dhe z. G. J., ku janë shprehur si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Me shkresën Nr.1375/11 Prot., datë 04.07.2023, Komisioni i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës i përbërë prej z.G. H., z.S. K., z.M. S., znj.D. Ll. dhe z.G. P.kanë dërguar shpjegime për Projekt – Raportin e Auditimit Nr.1190/20 Prot., datë 05.06.2023. Grupi i punës “Për marrjen në dorëzim dhe monitorimin e kontratës” ka pritur dhe administruar Web faqen zyrtare të SUT bazuar në Specifikimet Teknike, Ftesën për ofertë si dhe në bazë të ofertës ekonomike të OE. Faqja zyrtare Web e SUT është funksionale, ndërsa për të dhënat dhe nënmenutë ato janë plotësuar me të dhëna për SUT, informacion i cili gjendet i publikuar në Web. Nga ana e grupit të punës janë marrë masat e nevojshme për plotësimin e Web si dhe janë hapur llogari elektronike (e-mail zyrtar @sut.gov.al) për të gjithë punonjësit e administratës.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Në bazë të shpjegimeve që komisioni i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës ka dërguar, merret parasysh nga ana e grupit të auditimit dhe shkarkon nga përgjegjësia grupin e punës për marrjen në dorëzim dhe monitorimit të kontratës.

Procedura e Prokurimit me Vlerë të Vogël “Furnizim vendosje automate për kabinat elektrike në SUT”.

Me shkresën Nr.639 Prot., datë 01.12.2021 nga Përgjegjësi i Sektorit të Planifikimit znj.E. O.është bërë kërkesa për prokurimin “**Blerje automati**”, drejtuar Sektorit të Prokurimeve z. G. H.

Me Urdhrin Nr.89, datë 02.12.2021 është ngritur grupi i punës për Specifikimet Teknike të procedurës me objekt: “**Blerje automati për transformatorin e linjës 20000 Volt në SUT**”. Grupi përbëhet prej z.V.S. (Përgjegjës i sektorit të shërbimeve të brendshme), z.A. I. (Elektriçist) dhe z.N. Q.(Elektriçist). Anëtarët kanë plotësuar Formularët e Deklarimit sipas Shtojcës Nr.1.

Me shkresën Nr.89/1, datë 17.12.2021 janë hartuar Specifikimet Teknike dhe i janë dërguar Sektorit të Prokurimeve.

Me Urdhrin Nr.89/2, datë 17.12.2021 është krijuar Komisioni i Blerjes me Vlerë të Vogël i përbërë prej znj.R. J. (Specialiste prokurimi, Përgjegjës për prokurim), znj.M.M. (Specialiste prokurimi) dhe z. B. V. (Jurist). Anëtarët kanë firmosur Formularët e Deklarimit sipas Shtojcës Nr.1.

Me Shkresat Nr.89/3, datë 17.12.2021, i është dërguar kërkesë për dhënie çmimi për procedurën e prokurimit 3 Operatorëve Ekonomik si më poshtë: “Gj. E.” Shpk, “P.A.T P.” Shpk dhe “I. Group” Shpk. Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi me vlerë të vogël janë 6, 4 oferta janë pranuar dhe 2 janë refuzuar:

- OE “I.” Shpk – 700,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “A.2018” Shpk – 898,500.00 Lekë pa TVSH
- OE “S.Rr.j” – 925,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “A. D.” – 975,000.00 Lekë pa TVSH

Me Shkresën Nr.89/5 Prot., datë 21.12.2021 është bërë argumentimi i Fondit Limit per procedurën. Fondi Limit është përcaktuar në vlerën 977,333.33 Lek pa TVSH.

Me Shkresën Nr.89/6, datë 22.12.2021, është bërë Urdhri i Prokurimit për Prokurimet me Vlera të Vogla për procedurën me objekt: “Furnizim vendosje automate për kabinat elektrike në SUT”.

Në datë 22.12.2021 është mbajtur Procesverbali për Argumentimin dhe Miratimin e Secifikimeve Teknike dhe Kriteve për Kualifikim.

Me Shkresën Nr.89/7, datë 22.11.2021 është plotësuar Formulari Nr.3 Ftesë për Ofertë për zhvillimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, në datë 23.12.2021, ora 11:30 në adresën zyrtare të APP-së.

Me Shkresën Nr.89/8, datë 24.12.2021 është mbajtur procesverbali për procedurën e prokurimit të zhvilluar dhe nga vlerësimi paraprak, OE i renditur në vend të parë “**I.” Shpk** me Ofertë Ekonomike **700,000.00 Lekë pa TVSH** u njoftua për paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar në ftesën për ofertë. OE “I.” Shpk u paraqit brenda afatit dhe dorëzoi dokumentacionin e kërkuar në ftesën për ofertë.

Me Urdhrin Nr.89/9, datë 24.12.2021, është bërë krijimi i Komisionit të pritjes së mallit i përbërë prej z.V.S., Z.M. S. dhe z.A. I.

Në datë 28.12.2021 është mbajtur Proces-Verbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit. Malli u kontrollua nga komisioni dhe konstaton se është sipas standarteve dhe Specifikimeve Teknike të kërkuara (Furnizim-Vendosje). Këta artikuj do të administrohen dhe të bëhet fletë hyrje Nr.21, datë 28.12.2021.

Për sa më sipër nga grupi i auditimit nuk u konstatua ndonjë problematikë.

Procedura e Prokurimit me Vlerë të Vogël “Çmontim dhe transport brenda territorit të SUT të CT skaner TOSHIBA Dual Slice”.

Me shkresën Nr.695 Prot., datë 13.12.2021 nga Përgjegjësi i Sektorit të Planifikimit znj.E.O.është bërë kërkesa për prokurimin “Shërbim i specializuar për çmontim dhe transport të CT Scan Toshiba”, drejtuar Sektorit të Prokurimeve z.G. H.

Me Urdhrin Nr.96, datë 15.12.2021 është ngritur grupi i punës për Specifikimet Teknike të procedurës me objekt: “Çmontim dhe transport i skanerit brenda territorit të SUT”. Grupi përbëhet prej z.V.D. (Shef i shërbimit të imazherisë), z.T. Xh. (Teknik imazherie) dhe z.G.P. (Specialist paisjesh). Anëtarët kanë plotësuar Formularët e Deklarimit sipas Shtojcës Nr.1.

Me shkresën Nr.96/1, datë 16.12.2021 janë hartuar Specifikimet Teknike dhe i janë dërguar Sektorit të Prokurimeve.

Me Urdhrin Nr.96/2, datë 16.12.2021 është krijuar Komisioni i Blerjes me Vlerë të Vogël i përbërë prej znj.R. J. (Specialiste prokurimi, Përgjegjës për prokurim), znj.M.M. (Specialiste prokurimi) dhe z.B. V. (Jurist). Anëtarët kanë firmosur Formularët e Deklarimit sipas Shtojcës Nr.1.

Me Shkresat Nr.96/3, datë 16.12.2021, i është dërguar kërkesë për dhënie çmimi për procedurën e prokurimit 3 Operatorëve Ekonomik si më poshtë: “B.E.” Shpk, “A. T.” PF dhe “DKMed” Shpk.

Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi me vlerë të vogël janë 4, 3 oferta janë pranuar dhe 1 ofertë është refuzuar:

- OE “B. E.” Shpk – 927,600.00 Lekë pa TVSH
- OE “D.” Shpk – 946,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “O&A” – 970,0 00.00 Lekë pa TVSH

Me Shkresën Nr.96/5 Prot., datë 20.12.2021 është bërë argumentimi i Fondit Limit i cili është përcaktuar në vlerën 980,000.00 Lekë pa TVSH.

Me Shkresën Nr.96/6, datë 20.12.2021, është bërë Urdhri i Prokurimit për Prokurimet me Vlera të Vogla për procedurën.

Në datë 19.12.2021 është mbajtur Procesverbali për Argumentimin dhe Miratimin e Specifikimeve Teknike dhe Kriteve për Kualifikim.

Me Shkresën Nr.96/7, datë 20.11.2021 është plotësuar Formulari Nr.3 Ftesë për Ofertë për zhvillimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, në datë 21.12.2021, ora 14:30 në adresën zyrtare të APP-së.

Me Shkresën Nr.96/8, datë 24.12.2021 është mbajtur procesverbali për procedurën e prokurimit të zhvilluar dhe nga vlerësimi paraprak, OE “A. T.” PF u skualifikua me arsye se oferta e tij është mbi Fondin Limit. Nga vlerësimi i ofertave u rendit në vend të parë OE “B. E.” Shpk me Ofertë Ekonomike **927,600.00 Lekë pa TVSH.**

Me Urdhrin Nr.96/9, datë 24.12.2021, është bërë krijimi i Komisionit të ndjekjes së shërbimit i përbërë prej Dr.V.D., z.T. Xh.dhe z.G.P.

Me Shkresën Nr.210 Prot., datë 11.03.2022 është mbajtur Akt-Rakordim për kryerjen e “Shërbimit të Mirëmbajtjes, Çmontim dhe Transportim brenda territorit të SUT për CT Scanner Toshiba” nga OE “B. E.” Shpk.

Për sa më sipër nga grupi i auditimit nuk u konstatua ndonjë problematikë.

Procedura e Prokurimit me Vlerë të Vogël “Furnizim vendosje raftje metalike në SUT”.

Me shkresën Nr.458 Prot., datë 05.10.2021 nga Përgjegjësi i Sektorit të Planifikimit znj.E.O.është bërë kërkesa për prokurimin “**Furnizim vendosje Raftje Metalike**”, drejtuar Sektorit të Prokurimeve z.G. H. Bashkangjitur kësaj kërkesë është planimetria për çdo sektor përkatës me emrat posedues të tyre që përmban numrin e rafteve me përmasa të përcaktuara për çdo raft.

Me Urdhrin Nr.74, datë 06.10.2021 është ngritur grupi i punës për Specifikimet Teknike të procedurës. Grupi përbëhet prej Dr.L.N. (Përgjegjës i sektorit të statistikës), znj.M. P. (Specialiste planifikimi) dhe z.M. S.(Jurist). Anëtarët kanë plotësuar Formularët e Deklarimit sipas Shtojcës Nr.1.

Me shkresën Nr.74/1, datë 11.10.2021 janë hartuar Specifikimet Teknike dhe i janë dërguar Sektorit të Prokurimeve.

Me Urdhrin Nr.74/2, datë 01.11.2021 është krijuar Komisioni i Blerjes me Vlerë të Vogël i përbërë prej znj.R. J. (Specialiste prokurimi, Përgjegjës për prokurim), znj.M.M. (Specialiste prokurimi) dhe z.B.V.(Jurist). Anëtarët kanë firmosur Formularët e Deklarimit sipas Shtojcës Nr.1.

Me Shkresat Nr.74/3, datë 01.11.2021, i është dërguar kërkesë për dhënie çmimi për procedurën e prokurimit 3 Operatorëve Ekonomik si më poshtë: “A&A S. S.” Ltd, “G.P.” dhe “F. 2000” Shpk.

Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi me vlerë të vogël janë 14:

- OE “F. 2000” – 716,760.00 Lek pa TVSH
- OE “K.” – 780,000.00 Lek pa TVSH
- OE “S.L RR.” – 900,000.00 Lek pa TVSH
- OE “B. K.” – 900,000.00 Lek pa TVSH
- OE “G.” – 900,000.00 Lek pa TVSH
- OE “B.B.” – 932,100.00 Lek pa TVSH
- OE “B.” – 944,400.00 Lek pa TVSH
- OE “M.-M.” – 948,000.00 Lek pa TVSH
- OE “A.K.M” – 948,000.00 Lek pa TVSH
- OE “P. A.” – 964,000.00 Lek pa TVSH
- OE “E.” – 975,000.00 Lek pa TVSH
- OE “T.-I.” – 976,000.00 Lek pa TVSH
- OE “E. Konstruksion & Teknologji” – 978,000.00 Lek pa TVSH
- OE “F. E.” – 985 ,000.00 Lek pa TVSH

Me Shkresën Nr.74/5 Prot., datë 20.12.2021 është bërë argumentimi i Fondit Limit, i cili është përcaktuar në vlerën 999,613.87 Lek pa TVSH.

Me Shkresën Nr.74/6, datë 20.12.2021, është bërë Urdhri i Prokurimit për Prokurimet me Vlera të Vogla. Në datë 20.12.2021 është mbajtur Procesverbali për Argumentimin dhe Miratimin e Secifikimeve Teknike dhe Kriteve për Kualifikim.

Me Shkresën Nr.74/7, datë 20.12.2021 është plotësuar Formulari Nr.3 Ftesë për Ofertë për zhvillimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, në datë 21.12.2021, ora 15:00 në adresën zyrtare të APP-së.

Me Shkresën Nr.74/8, datë 24.12.2021 është mbajtur procesverbali për procedurën e prokurimit të zhvilluar dhe nga vlerësimi paraprak, OE i renditur në vend të parë “**F. 2000**” Shpk me ofertë ekonomike **716,760.00 Lekë pa TVSH** u njoftua për paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar në ftesën për ofertë. Pasi Komisioni i blerjes me vlerë të vogël verifikoi dokumentacionin e kërkuar, i cili ishte sipas kërkesave në ftesën për ofertë, vendosi shpalljen e fituesit për këtë procedurë.

Me Urdhrin Nr.74/9, datë 29.12.2021, është krijuar Komisioni i i pritjes së mallit i përbërë prej Dr.L.N., znj.M. P. dhe z.M.S.

Në datë 29.12.2021 është mbajtur Proçec-Verbal i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit. Pasi malli u kontrollua nga komisioni, konstatohet se është sipas standarteve dhe specifikimeve teknike të kërkuara. Këta artikuj do të administrohen dhe të bëhet Fletë-Hyrje Nr.15, datë 29.12.2021.

Për sa më sipër nga grupi i auditimit nuk u konstatua ndonjë problematikë.

Për vitin 2022 janë realizuar 26 procedura prokurimi me vlera të vogla të publikuara në sistemin elektronik të APP-së me fond limit 23,113,900 lekë pa tvsh dhe realizuar me vlerë kontrate në shumën 16,900,984 lekë pa tvsh sic paraqitet në tabelën nr.3 aneksi 2.4.1.

Funksionin e komisionit të prokurimit me vlera të vogla për vitin 2022 e kanë ushtruar znj. R. J.Specialiste prokurimi (përgjegjëse për prokurim), znj.M. M. (Specialiste) dhe z. B. V. (Jurist). Komisioni i Blerjeve me vlerë të vogël për vitin 2022 është ngritur me Urdhrin Nr.1/1, Datë 14.01.2022. Me zgjedhje nga 26 procedura të realizuara me fond limit në shumën 23,113,900 lekë pa tvsh janë audituar 8 procedura me fond limit në shumën 6,916,702 lekë pa tvsh ose në masën 30% të vlerës totale të fondit limit, sic paraqitet në tabelën nr.4 aneksi 2.4.1.

Procedura e Prokurimit me Vlerë të Vogël “Mirëmbajtje Printera, fotokopje, kompjutera dhe paisje elektronike për SUT”.

Me shkresën Nr.562 Prot., datë 31.08.2022 nga Përgjegjësi i Sektorit të Planifikimit znj. M.M. është bërë kërkesa për prokurimin “Mirëmbajtje Printera, fotokopje, kompjutera dhe paisje elektronike për SUT”, drejtuar Sektorit të Prokurimeve z. G. H.

Me Urdhrin Nr.67, datë 06.09.2022 është ngritur grupi i punës për hartimin e Specifikimeve Teknike të procedurës. Grupi përbëhet prej z. S. K. (Inxhinier IT), z.A.A.(Inxhinier Fizikant) dhe z.E. P.(Specialist prokurimi).

Me shkresën Nr.67/1, datë 21.09.2022 janë hartuar Specifikimet Teknike dhe i janë dërguar Sektorit të Prokurimeve.

Me Urdhrin Nr.67/2, datë 21.09.2022 është krijuar Komisioni i Blerjes me Vlerë të Vogël i përbërë prej z. G.H. (Përgjegjës sektori prokurimi), znj M.M. (Përgjegjëse sektori planifikimi) dhe znj. R. J.(Specialiste prokurimi).

Me Shkresat Nr.67/3, datë 21.09.2022, i është dërguar kërkesë për dhënie çmimi për procedurën 4 Operatorëve Ekonomik si më poshtë: “N.” Shpk, “M. C.S” Shpk dhe “A.” Shpk dhe “BNT E.” Shpk. Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi me vlerë të vogël janë 17, 16 oferta janë pranuar dhe 1 është skualifikuar:

- OE “A.” Shpk – 500,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “L. S.” Shpk – 624,800.00 Lekë pa TVSH
- OE “R. 2000” Shpk – 785,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “O. T.” Shpk – 833,333.00 Lekë pa TVSH
- OE “N.” Shpk – 840,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “A. D.” – 875,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “C.” Shpk – 887,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “E.I.” Shpk – 899,900.00 Lekë pa TVSH
- OE “S. 2022” Shpk – 916,667.00 Lekë pa TVSH
- OE “M.N.” – 921,210.00 Lekë pa TVSH
- OE “X. S.” Shpk – 922,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “I. S.” Shpk – 926,241.00 Lekë pa TVSH
- OE “J.G.” Shpk – 958,333.00 Lekë pa TVSH
- OE “B. E.” Shpk – 980,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “A.” Shpk – 980,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “O. H.” – 988,000.00 Lekë pa TVSH

Me Shkresën Nr.67/5 Prot., datë 09.12.2022 është bërë argumentimi i Fondit Limit per procedurën, i cili është përcaktuar në vlerën 997,000.15 Lekë pa TVSH.

Me Shkresën Nr.67/6, datë 12.12.2022, është bërë Urdhri i Prokurimit për Prokurimet me Vlera të Vogla për procedurën.

mbajtur Procesverbali për Argumentimin dhe Miratimin e Secifikimeve Teknike dhe Krieteve për Kualifikim.

Me Shkresën Nr.67/7, datë 12.12.2022 është plotësuar Formulari Nr.3 Ftesë për Ofertë për zhvillimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, në datë 13.12.2022, ora 14:00 në adresën zyrtare të APP-së. Me Urdhrin Nr.67/8, datë 14.12.2022, është krijuar i Komisionit të pritjes së mallit i përbërë prej z.S.K., z.E.P. dhe z.M. S.

Me Urdhrin Nr.67/9, datë 30.12.2022, është mbajtur Proces-Verbali ku argumentohen arsyet e skualifikimit të OE pjesëmarrës në procedurën e Prokurimit me vlerë të vogël. Pas verifikimit të dokumentacionit të kërkuar sipas Kërkesave në Ftesën për Ofertë, Komisioni i blerjes me vlerë të vogël vendosi shpalljen e fituesit **OE “N.” Shpk** me ofertë ekonomike **840,000.00 Lekë pa TVSH** për këtë procedurë dhe do të arkivojë dosjen në sistemin elektronik.

Në datë 31.12.2022 është mbajtur Proces-Verbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit. Malli u kontrollua nga komisioni dhe konstaton se është sipas standarteve dhe Specifikimeve Teknike të kërkuara (Furnizim-Vendosje). Nga grupi i pritjes së mallit citohet se bashkangjitur këtij Proces-Verbali do të jenë gjithashtu Proces-Verbalet e punimeve.

Procedura e Prokurimit me Vlerë të Vogël “Transport, montim, koladim, mirëmbajtje dhe ç’montim skaneri GE Healthcare”.

Me shkresën Nr.44 Prot., datë 14.01.2022 nga Përgjegjësi i Sektorit të Planifikimit znj.E.O. është bërë kërkesa për prokurimin “**Instalim Skaneri CT 16 SL**”, drejtuar Sektorit të Prokurimeve z.G.H.

Me Urdhrin Nr.2, datë 17.01.2022 është ngritur grupi i punës për hartimin e Specifikimeve Teknike të procedurës me objekt: “Transport, montim, koladim, mirëmbajtje dhe ç’montim skaneri GE Healthcare”. Grupi përbëhet prej Dr.V.D. (Shef i shërbimit të imazherisë), z.M. S.(Jurist) dhe z.G.P. (Specialist paisjesh).

Me shkresën Nr.2/1, datë 20.01.2022 janë hartuar Specifikimet Teknike dhe i janë dërguar Sektorit të Prokurimeve.

Me Urdhrin Nr.2/2, datë 20.01.2022 është krijuar Komisioni i Blerjes me Vlerë të Vogël i përbërë prej znj.R. J.(Specialiste Prokurimi), znj M. M. (Specialiste Prokurimi) dhe z.B. V. (Jurist).

Me Shkresat Nr.2/3, datë 20.01.2022, i është dërguar kërkesë për dhënie çmimi për procedurën e prokurimit 3 Operatorëve Ekonomik si më poshtë: “P.” Shpk, “M.” Shpk dhe “B. A.” Shpk.

Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi me vlerë të vogël janë 2, 1 ofertë është pranuar dhe 1 është refuzuar:

- OE “M.” Shpk – 995,000.00 Lekë pa TVSH.

Me Shkresën Nr.2/5 Prot., datë 21.05.2022 është bërë argumentimi i Fondit Limit per procedurën, i cili është përcaktuar në vlerën 998,333.33 Lekë pa TVSH.

Me Shkresën Nr.2/6, datë 21.01.2022, është bërë Urdhri i Prokurimit për Prokurimet me Vlera të Vogla për procedurën.

Në datë 21.01.2022 është mbajtur Procesverbali për Argumentimin dhe Miratimin e Secifikimeve Teknike dhe Krieteve për Kualifikim.

Me Shkresën Nr.2/7, datë 21.01.2022 është plotësuar Formulari Nr.3 Ftesë për Ofertë për zhvillimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, në datë 24.01.2022, ora 10:00 në adresën zyrtare të APP-së.

Me Urdhrin Nr.2/8, datë 26.01.2022, është mbajtur Proces-Verbali ku argumentohen arsyet e skualifikimit të OE pjesëmarrës në procedurën e Prokurimit me vlerë të vogël. Pas verifikimit të dokumentacionit të kërkuar sipas Kërkesave në Ftesën për Ofertë, Komisioni i blerjes me vlerë të vogël vendosi shpalljen e fituesit **OE “M.” Shpk** me ofertë ekonomike **995,000.00 Lekë pa TVSH** për këtë procedurë dhe do të arkivojë dosjen në sistemin elektronik.

Me Shkresën Nr.2/9, datë 26.01.2022, është lidhur Kontratë Shërbimi midis palëve Spitali Universitar i Tiranës (Porositësi) dhe shoqërisë “M.” Shpk (Sipërmarrësi) me afat 5 mujor nga data e lidhjes së kësaj Kontrate Shërbimi.

Me Urdhrin Nr.2/10, datë 26.01.2022, është krijuar komisioni për ndjekjen, realizimin dhe zbatimin e kontratës. Komisioni përbëhet prej z.A. M. (Mjek Imazherist), z. G. P. (Specialist Paisjesh) dhe z.T. Xh. (Teknik Imazherie).

Me Shkresën Nr.138 Prot., datë 22.02.2022, është mbajtur Akt-Rakordimi pasi Komisioni kontrolloi të gjitha kërkesat për riparimin e paisjes.

Me Shkresën Nr.395 Prot., datë 20.06.2022, është mbajtur Akt-Rakordimi pasi Komisioni kontrolloi të gjitha kërkesat për riparimin e paisjes. Bashkangjitur këtij Akt-Rakordimi janë Raportet e Servisit si dhe faturat elektronike për likuidimin e OE të shpallur fitues për këtë procedurë prokurimi me vlerë të vogël. Për sa më sipër, nga grupi i auditimit nuk u konstatua ndonjë problematikë.

Procedura e Prokurimit me Vlerë të Vogël “Blerje printer dhe fotokopje”.

Me shkresën Nr.43 Prot., datë 14.01.2022 nga Përgjegjësi i Sektorit të Planifikimit znj.E. O. është bërë kërkesa për prokurimin “**Printera & Fotokopje për SUT**”, drejtuar Sektorit të Prokurimeve z.G.H.

Me Urdhrin Nr.5, datë 26.01.2022 është ngritur grupi i punës për hartimin e Specifikimeve Teknike të procedurës me objekt: “**Blerje printer dhe fotokopje**”. Grupi përbëhet prej z.S. K. (Inxhinier IT), znj.D.Ll.(Inxhinier Ndërtimit) dhe z.M.S. (Jurist).

Me shkresën Nr.5/1, datë 01.02.2022 janë hartuar Specifikimet Teknike dhe i janë dërguar Sektorit të Prokurimeve.

Me Urdhrin Nr.5/2, datë 08.02.2022 është krijuar Komisioni i Blerjes me Vlerë të Vogël i përbërë prej z.G. H.(Përgjegjës sektori prokurimi), znj.M. M. (Specialiste prokurimi) dhe znj. R. J. (Specialiste prokurimi).

Me Shkresat Nr.5/3, datë 08.02.2022, i është dërguar kërkesë për dhënie çmimi për procedurën e prokurimit 3 Operatorëve Ekonomik si më poshtë: “C. N. S.” Shpk, dhe “A.” Shpk dhe “N.” Shpk.

Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi me vlerë të vogël janë 19, 16 oferta janë pranuar dhe 3 janë skualifikuar:

- OE “A. A.” Shpk – 499,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “Q.D.” – 600,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “A.” Shpk – 685,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “I.” Shpk – 750,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “R.2000” Shpk – 776,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “A.” Shpk – 790,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “S. CO” Shpk – 834,900.00 Lekë pa TVSH
- OE “C.” Shpk – 845,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “O. T.” Shpk – 900,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “S. RR.” – 925,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “B. E.” Shpk – 929,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “T.E.” Shpk – 945,800.00 Lekë pa TVSH
- OE “T. K.” – 950,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “R.N.M” Shpk – 955,500.00 Lekë pa TVSH
- OE “CRF” Shpk – 960,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “J.” – 970,000.00 Lekë pa TVSH

Me Shkresën Nr.5/5 Prot., datë 08.02.2022 është bërë argumentimi i Fondit Limit për procedurën, i cili është përcaktuar në vlerën 974,956.00 Lekë pa TVSH.

Me Shkresën Nr.5/6, datë 08.02.2022, është bërë Urdhri i Prokurimit për Prokurimet me Vlera të Vogla për procedurën.

Në datë 08.02.2022 është mbajtur Procesverbali për Argumentimin dhe Miratimin e Secifikimeve Teknike dhe Krieteve për Kualifikim.

Me Shkresën Nr.5/7, datë 08.02.2022 është plotësuar Formulari Nr.3 Ftesë për Ofertë për zhvillimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, në datë 09.02.2022, ora 14:30 në adresën zyrtare të APP-së. Me Urdhrin Nr.5/8, datë 18.02.2022 , është krijuar i Komisionit të pritjes së mallit i përbërë prej z.S.K., znj.D. Ll. dhe z.M. S.

Me Urdhrin Nr.5/9, datë 21.02.2022, është mbajtur Proces-Verbali ku argumentohen arsyet e skualifikimit të OE pjesëmarrës në procedurën e Prokurimit me vlerë të vogël. Pas verifikimit të dokumentacionit të kërkuar sipas Kërkesave në Ftesën për Ofertë, Komisioni i blerjes me vlerë të vogël vendosi shpalljen e fituesit **OE “A.” Shpk** me ofertë ekonomike **790,000.00 Lekë pa TVSH** për këtë procedurë dhe do të arkivojë dosjen në sistemin elektronik.

Në datë 25.02.2022 është mbajtur Proces-Verbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit. Malli u kontrollua nga komisioni dhe konstaton se është sipas standarteve dhe Specifikimeve Teknike të kërkuara (Furnizim-Vendosje). Këta artikuj do të administrohen dhe do të bëhet hyrje me Fletë-Hyrje Nr.1, datë 21.02.2022

Titulli i gjetjes:	Anomali gjatë procesit të regjistrimit të aseteve
Situata:	Gjatë verifikimi fizik të artikujve u has vështirësi pasi në inventarizimin e tyre, nuk regjistrohen me numrat serial/identifikimit përkatës të mallrave, duke bërë të vështirë identifikimin e tyre. Nga veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi magazinieri z. A. Rr.
Kriteri:	Neni 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”, Neni107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.
Ndikimi/Efekti:	Cënon cilësinë dhe vazhdimësinë e kryerjes së shërbimit
Shkaku:	Mos zbatimi i kushteve të kontratës
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	SUT, të marrë masat që në komisionet e pritjes së mallit ose marrjen në dorëzim të tij, përgjegjësi material, që në momentin e pranimit të një malli/produti, të bëjnë regjistrimet përkatëse sipas natyrës, llojit dhe identifikimit të produktit/mallit.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi në cilësinë e magazinierit (z. A. Rr.) dhe grupi i i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit (z. S. K., z. E. P. dhe z. M. S.) në mospërputhje me Neni 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”, Neni107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Procedura e Prokurimit me Vlerë të Vogël “Blerje kancelari për vitin 2022”.

Me shkresën Nr.200 Prot., datë 07.03.2022 nga Përgjegjësi i Sektorit të Planifikimit znj. E.O. është bërë kërkesa për prokurimin **“Blerje kancelari për vitin 2022”**, drejtuar Sektorit të Prokurimeve z.G.H.

Me Urdhrin Nr.19, datë 09.03.2022 është ngritur grupi i punës për hartimin e Specifikimeve Teknike të procedurës me objekt: **“Blerje kancelari për SUT”**. Grupi përbëhet prej z.V.S. (Përgjegjës i sektorit të shërbimeve të brendshme), z.S.K. (Specialist IT) dhe z.M.S. (Jurist).

Me shkresën Nr.19/1, datë 18.03.2022 janë hartuar Specifikimet Teknike dhe i janë dërguar Sektorit të Prokurimeve.

Me Urdhrin Nr.19/2, datë 18.03.2022 është krijuar Komisioni i Blerjes me Vlerë të Vogël i përbërë prej z.G.H.(Përgjegjës sektori prokurimi), znj.M.M. (Specialiste prokurimi) dhe znj. R. J. (Specialiste prokurimi).

Me Shkresat Nr.19/3, datë 18.03.2022, i është dërguar kërkesë për dhënie çmimi për procedurën e prokurimit 6 Operatorëve Ekonomik si më poshtë: “A. 2005” Shpk, “Y.” Shpk, “R. G.” Shpk, “E.” Shpk., “A. P.” Shpk dhe “N. O. A.” Shpk

Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi me vlerë të vogël janë 24, 21 oferta janë pranuar dhe 3 janë refuzuar:

- OE “P. O.” Shpk – 754,800.00 Lekë pa TVSH
- OE “O.H.” Shpk – 798,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “C.” Shpk – 850,473.00 Lekë pa TVSH
- OE “F. A.” Shpk – 870,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “S. Rr.” Shpk – 925,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “O. T.” Shpk – 933,333.00 Lekë pa TVSH
- OE “R.G.” Shpk – 935,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “J.& Sh.” Shpk – 939,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “G.” Shpk – 945,600.00 Lekë pa TVSH
- OE “E. G.” Shpk – 950,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “E. A.” Shpk – 955,900.00 Lekë pa TVSH
- OE “M.-M.” Shpk – 974,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “I.O.” Shpk – 981,00.00 Lekë pa TVSH
- OE “P.A.” Shpk – 984,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “B.” Shpk – 985,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “O.M. M.” Shpk – 986,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “R.N.M” Shpk – 988,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “T. K.” Shpk – 989,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “L. D.” Shpk – 990,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “M. & D.” Shpk – 990,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “M. & D.” Shpk – 991,000.00 Lekë pa TVSH

Me Shkresën Nr.19/5 Prot., datë 31.03.2022 është bërë argumentimi i Fondit Limit për procedurën, i cili është përcaktuar në vlerën 993,590.80 Lekë pa TVSH.

Me Shkresën Nr.19/6, datë 31.03.20212, është bërë Urdhri i Prokurimit për Prokurimet me Vlera të Vogla për procedurën e prokurimit.

Në datë 31.03.2022 është mbajtur Procesverbali për Argumentimin dhe Miratimin e Secifikimeve Teknike dhe Kriteve për Kualifikim.

Me Shkresën Nr.19/7, datë 31.03.2022 është plotësuar Formulari Nr.3 Ftesë për Ofertë për zhvillimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, në datë 01.04.2022, ora 15:00 në adresën zyrtare të APP-së.

Me Urdhrin Nr.19/8, datë 05.04.2022, është krijuar i Komisionit të pritjes së mallit i përbërë prej znj.M. P., z.S. K. dhe z.M.S.

Me Urdhrin Nr.19/9, datë 14.04.2022, është mbajtur Proces-Verbali ku argumentohen arsyet e skualifikimit të OE pjesëmarrës në procedurën e Prokurimit me vlerë të vogël. Pas verifikimit të dokumentacionit të kërkuar sipas Kërkesave në Ftesën për Ofertë, Komisioni i blerjes me vlerë të vogël vendosi shpalljen e fituesit **OE “E.” Shpk** me ofertë ekonomike **950,000.00 Lekë pa TVSH** për këtë procedurë dhe do të arkivojë dosjen në sistemin elektronik.

Në datë 12.04.2022 është mbajtur Proces-Verbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit. Malli u kontrollua nga komisioni dhe konstaton se është sipas standarteve dhe Specifikimeve Teknike të

kërkuara (Furnizim-Vendosje). Këta artikuj do të administrohen dhe do të bëhet hyrje me Fletë-Hyrje Nr.2, datë 12.04.2022.

Për sa më sipër, nga grupi i auditimit nuk u konstatua ndonjë problematikë.

Procedura e Prokurimit me Vlerë të Vogël “Blerje bazë materiale për SUT”.

Me shkresën Nr.334 Prot., datë 13.05.2022 nga Përgjegjësi i Sektorit të Planifikimit në mungesë dhe me urdhrin znj. M. P. është bërë kërkesa për prokurimin “**Blerje bazë materiale për SUT**”, drejtuar Sektorit të Prokurimeve z.G. H.

Me Urdhrin Nr.32, datë 17.05.2022 është ngritur grupi i punës për hartimin e Specifikimeve Teknike të procedurës me objekt: “**Blerje rrole shtrati fizioterapeutik, letër higjenike dhe letër duarsh**”. Grupi përbëhet prej z. P.R. (Kryeinfermier shërbimi Fizioterapi), znj. V. D. (Kryeinfermiere Ortopedi 3) dhe z.M.S.(Jurist).

Me shkresën Nr.32/1, datë 26.05.2022 janë hartuar Specifikimet Teknike dhe i janë dërguar Sektorit të Prokurimeve.

Me Urdhrin Nr.32/2, datë 26.05.2022 është krijuar Komisioni i Blerjes me Vlerë të Vogël i përbërë prej z. B.V. (Jurist), znj. M. M. (Specialiste prokurimi) dhe znj.R.J.(Specialiste prokurimi).

Me Shkresat Nr.32/3, datë 26.05.2022, i është dërguar kërkesë për dhënie çmimi për procedurën e prokurimit 3 Operatorëve Ekonomik si më poshtë: “M. V.” PF, “A. D.” Shpk dhe “XH-N-Sh Group” Shpk.

Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi me vlerë të vogël janë 23, 15 oferta janë pranuar dhe 8 janë refuzuar:

- OE “B. K.” – 787,321.00 Lekë pa TVSH
- OE “A.M.” Shpk – 899,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “A.K.M” Shpk – 932,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “O. T.” PF – 933,333.00 Lekë pa TVSH
- OE “M.V.” – 945,551.00 Lekë pa TVSH
- OE “M.-M.” – 948,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “HB-G.” PF – 950,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “J. G.” Shpk – 950,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “C.” Shpk – 951,120.00 Lekë pa TVSH
- OE “E.A.” – 955,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “O.M. M.” Shpk – 958,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “T. I.” Shpk – 962,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “E.” – 965,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “O. H.” – 966,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “J.” – 970,000.00 Lekë pa TVSH

Me Shkresën Nr.32/5 Prot., datë 03.06.2022 është bërë argumentimi i Fondit Limit për procedurën e cili, është përcaktuar në vlerën 973,000.00 Lekë pa TVSH.

Me Shkresën Nr.32/6, datë 06.06.2022, është bërë Urdhri i Prokurimit për Prokurimet me Vlera të Vogla për procedurën e prokurimit.

Në datë 06.06.2022 është mbajtur Procesverbali për Argumentimin dhe Miratimin e Secifikimeve Teknike dhe Kriteve për Kualifikim.

Me Shkresën Nr.32/7, datë 06.06.2022 është plotësuar Formulari Nr.3 Ftesë për Ofertë për zhvillimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, në datë 07.06.2022, ora 14:30 në adresën zyrtare të APP-së.

Me Urdhrin Nr.32/8, datë 13.06.2022, është krijuar i Komisionit të pritjes së mallit i përbërë prej z. P.R., znj.V. D. dhe z.M.S.

Me Urdhrin Nr.32/9, datë 16.06.2022, është mbajtur Proces-Verbali ku argumentohen arsyet e skualifikimit të OE pjesëmarrës në procedurën e Prokurimit me vlerë të vogël. Pas verifikimit të

dokumentacionit të kërkuar sipas Kërkesave në Ftesën për Ofertë, Komisioni i blerjes me vlerë të vogël vendosi shpalljen e fituesit OE “M. V.” PF me ofertë ekonomike **945,551.00 Lekë pa TVSH** për këtë procedurë dhe do të arkivojë dosjen në sistemin elektronik.

Në datë 17.06.2022 është mbajtur Proces-Verbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit. Malli u kontrollua nga komisioni dhe konstaton se është sipas standarteve dhe Specifikimeve Teknike të kërkuara (Furnizim-Vendosje). Këta artikuj do të administrohen dhe do të bëhet hyrje me Fletë-Hyrje Nr.5, datë 17.06.2022.

Procedura e Prokurimit me Vlerë të Vogël “Blerje bazë materiale për SUT”.

Me shkresën Nr.332 Prot., datë 13.05.2022 nga Përgjegjësi i Sektorit të Planifikimit në mungesë dhe me urdhër znj.M.P. është bërë kërkesa për prokurimin “**Blerje bazë materiale për SUT**”, drejtuar Sektorit të Prokurimeve z.G. H.

Me Urdhrin Nr.31, datë 17.05.2022 është ngritur grupi i punës për hartimin e Specifikimeve Teknike të procedurës me objekt: “**Blerje sapun likuid dhe mekanizma kontenitori**”. Grupi përbëhet prej znj.V. B. (Kryeinfermiere Kirurgji 1), znj.A. L. (Kryeinfermiere Blloku Operativ-Urgjencë) dhe z.M.S. (Jurist). Me shkresën Nr.31/1, datë 26.05.2022 janë hartuar Specifikimet Teknike dhe i janë dërguar Sektorit të Prokurimeve.

Me Urdhrin Nr.31/2, datë 26.05.2022 është krijuar Komisioni i Blerjes me Vlerë të Vogël i përbërë prej znj.R.J. (Specialiste prokurimi), znj.M. M. (Specialiste prokurimi) dhe z.B. V. (Jurist).

Me Shkresat Nr.31/3, datë 26.05.2022, i është dërguar kërkesë për dhënie çmimi për procedurën e prokurimit 3 Operatorëve Ekonomik si më poshtë: “M.V.” PF, “A. D.” Shpk dhe “XH. Group” Shpk.

Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi me vlerë të vogël janë 32, 25 oferta janë pranuar dhe 7 janë refuzuar:

- OE “M.-M.” – 532,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “P. A.” Shpk – 548,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “B. K.” – 562,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “H.-2012” – 616,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “M. V.” – 645,551.00 Lekë pa TVSH
- OE “P.G.” Shpk – 689,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “E. D. & D.” Shpk – 699,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “H. 2010” Shpk – 777,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “I&V C.” – 788,880.00 Lekë pa TVSH
- OE “A.” Shpk – 790,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “A. M.” Shpk – 795,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “M.H.” – 779,900.00 Lekë pa TVSH
- OE “2 H C.” Shpk – 889,900.00 Lekë pa TVSH
- OE “G.K.” Shpk – 890,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “E. M. 2010” PF – 895,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “O.T.” Shpk – 916,667.00 Lekë pa TVSH
- OE “E. A.” – 922,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “D.-R.” – 934,900.00 Lekë pa TVSH
- OE “O.M. M.” Shpk – 944,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “HB-G.” Shpk – 950,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “B.” – 950,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “A.-K.” Shpk – 956,500.00 Lekë pa TVSH
- OE “J.” Shpk – 957,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “XH. G.” Shpk – 958,800.00 Lekë pa TVSH
- OE “A.-A.” Shpk – 959,879.00 Lekë pa TVSH

Me Shkresën Nr.31/5 Prot., datë 03.06.2022 është bërë argumentimi i Fondit Limit per procedurën, i cili është përcaktuar në vlerën 963,000.00 Lekë pa TVSH.

Me Shkresën Nr.31/6, datë 06.06.2022, është bërë Urdhri i Prokurimit për Prokurimet me Vlera të Vogla për procedurën e prokurimit.

Në datë 06.06.2022 është mbajtur Procesverbali për Argumentimin dhe Miratimin e Secifikimeve Teknike dhe Kriteve për Kualifikim.

Me Shkresën Nr.31/7, datë 06.06.2022 është plotësuar Formulari Nr.3 Ftesë për Ofertë për zhvillimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, në datë 07.06.2022, ora 13:00 në adresën zyrtare të APP-së.

Me Urdhri Nr.31/8, datë 13.06.2022, është krijuar i Komisionit të pritjes së mallit i përbërë prej znj.V.B., znj.A. L. dhe z.M. S.

Me Urdhri Nr.31/9, datë 16.06.2022, është mbajtur Proces-Verbali ku argumentohen arsyet e skualifikimit të OE pjesëmarrës në procedurën e Prokurimit me vlerë të vogël. Pas verifikimit të dokumentacionit të kërkuar sipas Kërkesave në Ftesën për Ofertë, Komisioni i blerjes me vlerë të vogël vendosi shpalljen e fituesit OE “M. V.” PF me ofertë ekonomike **645,551.00 Lekë pa TVSH** për këtë procedurë dhe do të arkivojë dosjen në sistemin elektronik.

Në datë 17.06.2022 është mbajtur Proces-Verbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit. Malli u kontrollua nga komisioni dhe konstaton se është sipas standarteve dhe Specifikimeve Teknike të kërkuara (Furnizim-Vendosje). Këta artikuj do të administrohen dhe do të bëhet hyrje me Fletë-Hyrje Nr.4, datë 17.06.2022.

Për sa i përket dy procedurave të mësipërm, konstatohet se objekti i tyre është njëjtë dhe O.E. fitues është gjithashtu i njëjtë, që të dyja sëbashku mund të formonin shërbimi i ngjashëm “**Blerje bazë materiale për SUT**”, me të njejtin operator ekonomik M.V. Të dy procedurat së bashku rezultojnë në vlerën **1,591,102 Lekë pa TVSH**, që tejkalojnë me **591,102 Lekë** prapë e procedurës së prokurimit në vlerë të vogël. Me tejkalimin e pragut të prokurimit në vlerë të vogël, SUT duhet të kalojë në procedurën kufinjëve të ulët monetar prokurimit.

Nga auditimi rezulton se:

Copëzimi i fondeve apo kontratave në 2 raste gjatë përzgjedhjes së procedurave. SUT në llogaritjen e fondeve për procedurën e prokurimit në vlerë të vogël, nuk ka marrë parasysh grupin e mallrave apo shërbimeve të ngashme, të cilat zakonisht duhet të prokurohen njëherësh dhe në asnjë rast, nuk duhet të ndahen gjatë përdorimit të kësaj procedure. Materialet e sipërcituara nuk janë pjesë e linjave teknologjike në proceset kryesore të veprimtarisë, por janë pjesë e shërbimeve mbështetëse. Për këtë arsye, ato nuk përbëjnë shkak për ndërprerje të proceseve kryesore të shoqërisë, pra nuk janë objekt i avarive të cilat kërkojnë kryerjen e detyruar të procedurave të veçanta të prokurimit për çdo objekt. Sa më sipër, prokurimet e sipërcituar janë kurdoherë të planifikueshme. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 3 të Udhëzimit Nr.05, datë 25.06.2021 si dhe nenin 56, pika 2, e Vendimit Nr.285 datë 19.05.2021.

Gjithashtu, bie në kundërshtim me pikën 11 të nenit 56 të këtij vendimi, ku përcaktohet se: “Në asnjë rast, autoriteti kontraktor në momentin e planifikimit të nevojave të tij, nuk duhet të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël, si mundësi për të pjestuar vlerën e kontratës për shmangien nga procedurat e prokurimit.

Për arsyen e mësipërme procedurat e sipërcituara të prokurimit konsiderohen tejkalim i pragut të prokurimit në vlerë të vogël dhe SUT duhej të kalonte në procedurën kufijëve të ulët monetar të prokurimit, me qëllim ruajtjen e konkurrencës në prokurim.

Titulli i gjetjes:	Copëzim i fondeve apo kontratave
Situata:	Copëzimi i fondeve apo kontratave në 2 raste gjatë përzgjedhjes së procedurave. SUT në llogaritjen e fondeve për procedurën e prokurimit në vlerë të vogël, nuk

	ka marrë parasysh grupin e mallrave apo shërbimeve të ngashme, të cilat zakonisht duhet të prokurohen njëherësh dhe në asnjë rast, nuk duhet të ndahen gjatë përdorimit të kësaj procedure. Materialet e sipërcituara nuk janë pjesë e linjave teknologjike në proceset kryesore të veprimtarisë, por janë pjesë e shërbimeve mbështetëse. Për këtë arsye, ato nuk përbëjnë shkak për ndërprerje të proceseve kryesore të shoqërisë, pra nuk janë objekt i avarive të cilat kërkojnë kryerjen e detyruar të procedurave të veçanta të prokurimit për çdo objekt.
Kriteri:	Pika 3 e Udhëzimit Nr.05, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” si dhe nenin 56, pika 2 dhe pika 11, e Vendimit Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave për Prokurimin publik”.
Ndikimi/Efekti:	Copëzim të fondeve
Shkaku:	Nuk kanë marrë parasysh grupin e mallrave/shërbimeve
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	SUT, të marrë të gjitha masat që në hartimin e regjistrit të prokurimeve të parashikohen të gjitha procedurat e blerjes së mallrave, punëve dhe shërbimeve, që do të prokurohen në vlerë të vogël, me qëllim që të shmangë përdorimin e paplanifikuar dhe të parregulluar të fondeve publike

Me veprimet apo mos veprimet ngarkohen me përgjegjësi z. B. V., znj. M. M. dhe znj.R. J., në cilësinë e komisionit të blerjes me vlerë të vogël në mospërputhje me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”, Neni107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Procedura e Prokurimit me Vlerë të Vogël “Blerje printera dhe kompjutera për SUT”.

Me shkresën Nr.561 Prot., datë 31.08.2022 nga Përgjegjësi i Sektorit të Planifikimit znj. M.M. është bërë kërkesa për prokurimin “**Blerje printera dhe kompjutera për SUT**”, drejtuar Sektorit të Prokurimeve z.G.H.

Me Urdhrin Nr.66, datë 06.09.2022 është ngritur grupi i punës për hartimin e Specifikimeve Teknike të procedurës me objekt: “**Blerje kompjutera, printera/fotokopje për SUT**”. Grupi përbëhet prej z. S.K. (Inxhinier IT), z. A.A. (Inxhinier fizikant) dhe z. E.P. (Specialist prokurimi).

Me shkresën Nr.66/1, datë 09.09.2022 janë hartuar Specifikimet Teknike dhe i janë dërguar Sektorit të Prokurimeve.

Me Urdhrin Nr.66/2, datë 09.09.2022 është krijuar Komisioni i Blerjes me Vlerë të Vogël i përbërë prej z. G.H. (Përgjegjës sektori prokurimi), znj.R. J. (Specialiste prokurimi) dhe z.E. P. (Specialist prokurimi).

Me Shkresat Nr.66/3, datë 09.09.2022, i është dërguar kërkesë për dhënie çmimi për procedurën e prokurimit 3 Operatorëve Ekonomik si më poshtë: “I. P.” Shpk, “PC S.” Shpk dhe “S. S.” Shpk.

Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi me vlerë të vogël janë 25, 21 oferta janë pranuar, 3 oferta janë refuzuar dhe 1 ofertë është e papërfunduar:

- OE “S. Z.” Shpk – 560,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “F.” Shpk – 799,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “I.AI” Shpk – 810,000.00 Lekë pa TVSH
- OE “E.I.” Shpk – 869,900.00 Lekë pa TVSH
- OE “I.S.T.” – 874,750.00 Lekë pa TVSH
- OE “A.” Shpk – 926,200.00 Lekë pa TVSH
- OE “IT Gj. K.” Shpk – 931,000.00 Lekë pa TVSH

- OE "A.D." Shpk – 933,333.00 Lekë pa TVSH
- OE "S. CO" Shpk – 945,500.00 Lekë pa TVSH
- OE "I.S." Shpk – 947,121.00 Lekë pa TVSH
- OE "PC S." Shpk – 948,500.00 Lekë pa TVSH
- OE "H.G." Shpk – 956,300.00 Lekë pa TVSH
- OE "O.T." – 958,333.00 Lekë pa TVSH
- OE "S.M. M." Shpk – 964,700.00 Lekë pa TVSH
- OE "T. K." Shpk – 970,900.00 Lekë pa TVSH
- OE "T." – 978,900.00 Lekë pa TVSH
- OE "J. G." Shpk – 983,333.00 Lekë pa TVSH
- OE "B. T." Shpk – 987,000.00 Lekë pa TVSH
- OE "E.K. & T." – 987,000.00 Lekë pa TVSH
- OE "X. S." Shpk – 988,700.00 Lekë pa TVSH
- OE "E.H." – 998,000.00 Lekë pa TVSH

Me Shkresën Nr.66/5 Prot., datë 07.10.2022 është bërë argumentimi i Fondit Limit per procedurën, i cili është përcaktuar në vlerën 992,200.00 Lekë pa TVSH.

Me Shkresën Nr.66/6, datë 10.10.2022, është bërë Urdhri i Prokurimit për Prokurimet me Vlera të Vogla për procedurën e prokurimit.

Në datë 10.10.2022 është mbajtur Procesverbali për Argumentimin dhe Miratimin e Secifikimeve Teknike dhe Kriteve për Kualifikim. Me Shkresën Nr.66/7, datë 10.10.2022 është plotësuar Formulari Nr.3 Ftesë për Ofertë për zhvillimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, në datë 11.10.2022, ora 15:00 në adresën zyrtare të APP-së. Me Urdhrin Nr.66/8, datë 13.10.2022, është krijuar i Komisionit të pritjes së mallit i përbërë prej z.S. K., z.A. A.dhe z.E. P.

Me Urdhrin Nr.66/9, datë 17.10.2022, është mbajtur Proces-Verbali ku argumentohen arsyet e skualifikimit të OE pjesëmarrës në procedurën e Prokurimit me vlerë të vogël. Pas verifikimit të dokumentacionit të kërkuar sipas Kërkesave në Ftesën për Ofertë, Komisioni i blerjes me vlerë të vogël vendosi shpalljen e fituesit **OE "F." Shpk** me ofertë ekonomike **799,000.00 Lekë pa TVSH** për këtë procedurë dhe do të arkivojë dosjen në sistemin elektronik.

Në datë 17.10.2022 është mbajtur Proces-Verbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit. Malli u kontrollua nga komisioni dhe konstaton se është sipas standarteve dhe Specifikimeve Teknike të kërkuara (Furnizim-Vendosje). Këta artikuj do të administrohen dhe do të bëhet hyrje me Fletë-Hyrje Nr.6, datë 17.10.2022.

Nga auditimi rezulton:

Gjatë verifikimi fizik të artikujve u has vështirësi pasi në inventarizimin e tyre, nuk regjistrohen me numrat serial/identifikimit përkatës të mallrave, duke bërë të vështirë identifikimin e tyre.

Nga veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi magazinieri z. A.Rr.

Procedura e Prokurimit me Vlerë të Vogël "TEST BED SIDE për SUT"

Me shkresën Nr.626 Prot., datë 06.10.2022 nga Përgjegjësi i Sektorit të Planifikimit në mungesë dhe me urdher znj.M.P. është bërë kërkesa për prokurimin "**TEST BED SIDE për SUT**", drejtuar Sektorit të Prokurimeve z.G. H.

Me Urdhrin Nr.79, datë 07.10.2022 është ngritur grupi i punës për hartimin e Specifikimeve Teknike të procedurës me objekt: "**Blerje kite (Bed Side Test) për shërbimin e Reanimacionit në SUT**". Grupi përbëhet prej Dr.R. S. (Shefe e shërbimit të Reanimacionit), z.P. S. (Kryeinfermiere Reanimacioni) dhe z.M.S. (Jurist).

Me shkresën Nr.79/1, datë 10.10.2022 janë hartuar Specifikimet Teknike dhe i janë dërguar Sektorit të Prokurimeve.

Me Urdhrin Nr.79/2, datë 10.10.2022 është krijuar Komisioni i Blerjes me Vlerë të Vogël i përbërë prej z.G.H. (Përgjegjës sektori prokurimi), znj.M.M. (Përgjegjëse sektori planifikimi) dhe znj.R. J. (Specialiste prokurimi).

Me Shkresat Nr.79/3, datë 10.10.2022, i është dërguar kërkesë për dhënie çmimi për procedurën e prokurimit 3 Operatorëve Ekonomik si më poshtë: “G.-A.F.” Shpk, “K.” Shpk dhe “E.” Shpk. Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi me vlerë të vogël është 1:

- OE “E.” Shpk – 951,600.00 Lekë pa TVSH

Me Shkresën Nr.79/5 Prot., datë 19.10.2022 është bërë argumentimi i Fondit Limit per procedurën, i cili është përcaktuar në vlerën 989,733.33 Lekë pa TVSH.

Me Shkresën Nr.79/6, datë 20.10.2022, është bërë Urdhri i Prokurimit për Prokurimet me Vlera të Vogla për procedurën e prokurimit.

Në datë 20.10.2022 është mbajtur Procesverbali për Argumentimin dhe Miratimin e Secifikimeve Teknike dhe Kriteve për Kualifikim.

Me Shkresën Nr.79/7, datë 20.10.2022 është plotësuar Formulari Nr.3 Ftesë për Ofertë për zhvillimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël, në datë 21.10.2022, ora 14:00 në adresën zyrtare të APP-së.

Me Urdhrin Nr.79/8, datë 24.10.2022, është mbajtur Proces-Verbali ku argumentohen arsyet e skualifikimit të OE pjesëmarrës në procedurën e Prokurimit me vlerë të vogël. Pas verifikimit të dokumentacionit të kërkuar sipas Kërkesave në Ftesën për Ofertë, Komisioni i blerjes me vlerë të vogël vendosi shpalljen e fituesit **OE “E.” Shpk** me ofertë ekonomike **951,600.00 Lekë pa TVSH** për këtë procedurë dhe do të arkivojë dosjen në sistemin elektronik.

Me Urdhrin Nr.79/9, datë 24.10.2022 , është krijuar i Komisionit të pritjes së mallit i përbërë prej Dr.R. S. (Shefe e shërbimit të Reanimacionit), z.P. S.(Kryeinfermier Reanimacioni) dhe z.M.S.(Jurist).

Në datë 24.10.2022 është mbajtur Proces-Verbali i pritjes, kontrollit dhe administrimit të mallit. Malli u kontrollua nga komisioni dhe konstaton se është sipas standarteve dhe Specifikimeve Teknike të kërkuara (Furnizim-Vendosje). Këta artikuj do të administrohen dhe është bërë hyrje me Fletë-Hyrje Nr.1637, datë 25.10.2022.

Për sa më sipër, nga grupi i auditimit nuk u konstatua ndonjë problematikë.

2.5.Mbi mbajtjen e evidences kontabel, hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare, evidentimin, ndjekjen dhe pasqyrimin e debitoreve dhe kreditorëve, si dhe perlllogaritjen, njohjen, rregjistrimin dhe pagesën e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore

Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit, plotësimi i pasqyrave financiare në afat, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë.

Në Spitalin Universitar të Traumës (SUT), për vitin 2021 janë hartuar dy Pasqyra Financiare sipas burimit të të ardhurave (fondeve), atë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Shëndetësisë, të cilat i janë vënë në dispozicion grupit të auditimit në formatin elektronik dhe fizik. Përsa i përket vitit 2022, sipas përfaqësuesve të subjektit, nuk janë hartuar dhe miratuar ende pasqyrat financiare, pasi afati përfundimtar i dorëzimit të tyre është data 31.03.2023.

Nga auditimi rezultoi se:

Pasqyrat Financiare për vitin 2021 janë dorëzuar brenda afateve ligjore në Degën e Thesarit Tiranë, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me Nr. 2214 prot., datë 30.03.2022 dhe për Ministrinë e Mbrojtjes me Nr. 2213 prot., datë 30.03.2022, por nuk janë të miratuara nga Bordi i Spitalit Universitar të Traumës.

Pasqyrat financiare vjetore nuk janë miratuar nga Bordi i Spitalit Universitar të Traumës (miratimi i raportit vjetor të veprimtarisë financiare). Ky veprim është në mospërputhje me *Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 66, datë 03.02.2017 “Për përcaktimin e kriteve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare”, pika 10 c).*

Bordi i SUT është mbledhur për herë të parë në qershor të vitit 2022, referuar shkresës nr. 1195 prot., datë 03.06.2022 “Kërkesë për mbledhjen e Bordit Drejtues të SUT”, të miratuar nga znj. E. B., Drejtore e SUT.

Pasqyrat financiare për vitin 2021, edhe pse janë të depozituara në Degën e Thesarit të Rrethit Tiranë, nuk provohet nga ana shkresore që të jetë bërë konfirmimi nga kjo e fundit. Pasqyrat kanë vetëm numër protokollimi në Degën e Thesarit. Ky veprim është në mospërputhje me *Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kapitulli V, pika 117, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022.*

Sektori i Financës në SUT, për regjistrimin dhe kontabilizimin e veprimeve financiare përdor programin financiar “Alpha Buxhetor” dhe duke analizuar lidhjen midis programit financiar dhe pasqyrave financiare vihen re mos rakordime mbi kontabilizimin e veprimeve si më poshtë:

Llogaria 85 “Rezultati i Veprimtarisë ushtrimore”, në bilancin e përgatitur për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është pasqyruar në vlerën 32,233,478 lekë, ndërkohë që në programin Alpha kjo llogari është pasqyruar në vlerën 32,486,306 lekë me një diferencë prej 252,828 lekë.

Llogaria 31 “Materiale”, në bilancin e përgatitur për Ministrinë e Mbrojtjes është paraqitur në vlerën 91,389,139 lekë, ndërkohë që në programin Alpha gjendja e po kësaj llogarie është në vlerën 91,404,179 lekë me një diferencë prej 15,040 lekë.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (Të Drejta),” në bilancin e përgatitur për Ministrinë e Mbrojtjes është paraqitur në vlerën 42,739,560 lekë, ndërkohë që në programin Alpha gjendja e po kësaj llogarie është në vlerën 42,721,560 lekë me një diferencë prej 18,000 lekë.

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri dhe pajisje”, në bilancin e përgatitur për Ministrinë e Mbrojtjes është paraqitur në vlerën 71,880,612 lekë, ndërkohë që në programin Alpha gjendja e po kësaj llogarie pas amortizimit me vlerë prej 34,365,740 lekë, realisht është në vlerën 72,124,705 lekë me një diferencë prej 244,093 lekë.

Llogaria 218 “Inventari ekonomik”, në bilancin e përgatitur për Ministrinë e Mbrojtjes është paraqitur në vlerën 8,528,133 lekë, ndërkohë që në programin Alpha gjendja e po kësaj llogarie pas amortizimit me vlerë prej 5,755,425 lekë, realisht është në vlerën 8,877,378 lekë.

Llogaritë 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në bilancin e përgatitur për Ministrinë e Mbrojtjes është paraqitur në vlerën 1,199,705 lekë, ndërkohë që në programin Alpha gjendja e po kësaj llogarie rezulton në vlerën 1,343,905 lekë me një diferencë në vlerën 144,200 lekë.

Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”, në bilancin e përgatitur për Ministrinë e Mbrojtjes është paraqitur në vlerën 28,306,401 lekë, ndërkohë që në programin Alpha gjendja e po kësaj llogarie rezulton në vlerën 28,288,401 lekë me një diferencë në vlerën 18,000 lekë.

Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar/Deficiti i akumuluar),” në bilancin e përgatitur për Ministrinë e Mbrojtjes është paraqitur në vlerën 338,289,524 lekë, ndërkohë që në programin Alpha gjendja e po kësaj llogarie rezulton në vlerën 268,949,436 lekë, me një diferencë në vlerën 69,340,088 lekë.

Llogaria 85 “Rezultati i Veprimtarisë ushtrimore”, në bilancin e përgatitur për Ministrinë e Mbrojtjes është paraqitur në vlerën (94,289,861) lekë, ndërkohë që në programin Alpha gjendja e po kësaj llogarie rezulton në vlerën 95,174,285 lekë, me një diferencë në vlerën 884,424 lekë.

Llogaria 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme”, në bilancin e përgatitur për Ministrinë e Mbrojtjes është paraqitur në vlerën 160,818,724 lekë, ndërkohë që në programin Alpha gjendja e po kësaj llogarie rezulton në vlerën 172,727,073 lekë, me një diferencë në vlerën 11,908,349 lekë.

Gjatë analizimit mbi regjistrimin dhe likuidimin e faturave nga furnitorët, regjistrimi i tyre në programin financiar “Alpha Buxhetor” nuk kryhet në momentin e pranimit të tyre si dhe likuidimi i tyre është bërë

jashtë afatit më një diferencë ditore, por në disa raste edhe mujore, një ose dy muaj pas afatit të vendosur në faturat përkatëse.

Për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale vihet re se llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, e paraqitur në bilanc me vlerë prej 2,444,384 lekë, ka një diferencë prej 43,800 lekë krahasuar me vlerën e debitorëve të paraqitur te ekstrakti i llogarive kontabël në programin e mbajtjes së llogarive Alpha, ku vlera për këtë llogari pasqyrohet 2,488,184 lekë.

Për Ministrinë e Mbrojtjes vihet re se llogaria **468 “Debitorë të ndryshëm”**, e paraqitur në bilanc me vlerë prej 206,015 lekë, rakordon me vlerën e paraqitur për këtë llogari te ekstrakti i llogarive kontabël në programin e mbajtjes së llogarive Alpha.

Gjatë analizimit të zërave të tjerë të pasqyrave financiare u vunë re anomalitë e mëposhtme në mospërputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK):

Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”, është pasqyruar në bilancin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në vlerën 366,545 lekë, pasi është amortizuar në vlerën 165,627 lekë, ndërsa në bilancin e përgatitur për Ministrinë e Mbrojtjes është paraqitur në vlerën 79,019,639 lekë, pasi është amortizuar në vlerën 2,564,258 lekë. Nuk mund të amortizohet studimi dhe kërkimi, por sipas SKK duhet të regjistrohet dhe deklarohet si shpenzim periudhe në PASH.

Llogaria 433 “Detyrime, shtetit për fatkeqësi natyrore”, është pasqyruar në bilancin e përgatitur për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në vlerën 2,652,949 lekë, por që realisht kjo vlerë i takon llogarisë 435 “Sigurime Shoqërore”, duke u bazuar edhe në ekstraktin e mbajtjes së llogarive në programin Alpha. Ndërsa vlera prej 376,265 lekë, që është pasqyruar në llogarinë 435 “Sigurime Shoqërore”, në të vërtetë i takon të jetë vlera e llogarisë 436 “Sigurime Shëndetësore”.

Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në bilancin e përgatitur për Ministrinë e Mbrojtjes është paraqitur në vlerën 646,731 lekë, ndërkohë që nuk kemi të dhëna se për çfarë do të përdoret kjo vlerë, as për pjesën nëse ky shpenzim është i sigurt që do të ndodhë. Nëse nuk është i sigurt si shpenzim kalon në llogarinë Provizion për të ardhmen.

Në SUT nuk ka të përgatitura pasqyra financiare të konsoliduara për vitin 2021, veprim i cili është në mospërputhje me *Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, Kapitulli IV, pika 98-111, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022.*

Nga auditimi rezultoi se pasqyrat financiare të përgatitura për vitin 2021 nuk kanë shkresë përcjellëse që vërteton dërgesën e tyre në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, bazuar në legjislacionin në fuqi.

Në pasqyrat financiare të përgatitura për Ministrinë e Mbrojtjes, në llogarinë 12 “Rezultatet e mbartura”, nuk është pasqyruar rezultat i mbartur nga viti i kaluar. Duke qenë se në bilanc nuk është pasqyruar rezultat i mbartur, kjo pengon për të bërë krahasimin ndërmjet gjendjes në çelje të tij, shtesën përgjatë vitit dhe përdorimin e tij në rezultat për të financuar shpenzimet korente apo kapitale.

Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021 rezultoi se, pjesa e shënimeve shpjeguese është plotësuar pjesërisht dhe nuk janë përfshirë të gjitha informacionet që duhen, si për rastin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ashtu dhe për Ministrinë e Mbrojtjes.

Ky veprim është në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 3.7 “Rregullat për dhënien e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare individuale”, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022.

Në lidhje me Inventarizimin e aseteve:

Procesi i inventarizimit në SUT për vitin 2021 është kryer sipas Urdhrit Nr. 39, datë 24.01.2022, nr. 151 prot., “Për inventarizimin e vlerave aktive dhe detyrimeve në SUT për vitin 2021”.

Nga auditimi i të dhënave në formë shkresore dhe elektronike, rezulton se është realizuar procesi i inventarizimit për këtë vit, ku gjendet bashkëlidhur edhe shkresa nr. 212 prot., datë 15.03.2022, “Raporti përmbledhës në lidhje me inventarizimin e Hotelierisë dhe Pajisjeve Mjekësore në SUT”.

Sipas të dhënave të marra nga SUT për inventarizimin e realizuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2021, gjendja totale e inventarit në fund të këtij viti ka rezultuar në vlerën **1,521,769,987 lekë**. Ndërsa për inventarizimin e realizuar për Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 2021, sipas të dhënave të marra nga SUT, gjendja totale e inventarit në fund të këtij viti ka rezultuar në vlerën **147,589,990 lekë**.

Gjatë analizimit të inventarëve të mësipërm rezultoi se, për vitet objekt auditimi nuk është nxjerrë jashtë përdorimit asnjë aset (produkt), edhe pse duke u nisur nga vitet dhe nga norma e amortizimit, ekzistojnë asete të cilat janë plotësisht të amortizuara. Gjithashtu te inventarët dërguar grupit auditues nuk janë përfshirë zërat (toka, ndërtesa, rikonstruksione), në mënyrë që të bëhet verifikimi i vlerës së aseteve, amortizimit të duhur të tyre duke përfshirë edhe shtesat, si dhe të ardhurat e gjeneruara nga përdorimi i tyre, nëse ka. Gjatë analizimit të inventarëve të përmendur më lart rezultoi se, në fletë hyrjen e magazinës dhe në dokumentacionin e marrjes në dorëzim të mallrave, nuk regjistrohen numrat serial/identifikimit përkatës të mallrave, duke e bërë të vështirë identifikimin e tyre.

Ky veprim është në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV Sistemi i kontrollit periodik te aktiveve, pika 73 – 120.

Pas diferencave të konstatuara gjatë auditimit lidhur me llogaritë e paraqitura si vijon:

- 468 “Debitorë të ndryshëm”,
- 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)”,
- 212 “Ndërtime”,
- 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje dhe vegla pune”,
- 215 “Mjete transporti”,
- 218 “Inventar ekonomik”,
- 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”,

dhe kërkesës për të marrë informacion lidhur me përmbajtjen e detajuar të këtyre llogarive, grupit të auditimit nuk iu vu në dispozicion asnjë informacion analitik për të bërë të mundur arritjen në konkluzion për këto llogari.”**Për sa më sipër**, në lidhje për sa u konstatua, ngarkohen me përgjegjësi:

z. A. Z., në cilësinë e ish titullarit të institucionit në mospërputhje me Nenin 8 të ligjit nr. Nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe Pika 5 e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Znj. E. B., në cilësinë e titullarit të institucionit në mospërputhje me Nenin 8 të ligjit nr. Nr. 10 296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe Pika 5 e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”. Znj. E. R., në cilësinë e Përgjegjëses së financës për periudhën nën auditim dhe znj. E. B., në cilësinë e Përgjegjëses së Financës (07.2022 e në vazhdim), në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”. Z. A. Rr., në cilësinë e magazinierit të SUT (Janar 2022 e në vazhdim) dhe z. F. B. në cilësinë e magazinierit të SUT (deri dhjetor 2021), dhe në mospërputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Titulli i gjetjes:	Pasqyrat financiare vjetore nuk janë miratuar nga Bordi i Spitalit Universitar të Traumës.
---------------------------	--

Situata:	Bordi i Spitalit Universitar të Traumës nuk ka funksionuar gjatë periudhës objekt auditimi dhe si rrjedhojë e kësaj nuk ka miratuar pasqyrat financiare vjetore (miratimi i raportit vjetor të veprimtarisë financiare), për vitin 2021. Përsa i takon periudhës objekt auditimi, Bordi i SUT është mbledhur për herë të parë në qershor të vitit 2022, referuar shkresës nr. 1195 prot., datë 03.06.2022 “Kërkesë për mbledhjen e Bordit Drejtues të SUT”.
Kriteri:	Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 66, datë 03.02.2017 “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare”, pika 10 c).
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e kontrollit nga organet drejtuese të raportit vjetor të veprimtarisë financiare.
Shkaku:	Bordi i Spitalit Universitar të Traumës nuk është mbledhur asnjëherë gjatë periudhës objekt auditimi.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Bordi i Spitalit Universitar të Traumës të merren masa në vijimësi për miratimin çdo vit të pasqyrave financiare vjetore.

Titulli i gjetjes:	Nuk janë përgatitur pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
Situata:	Në Spitalin Universitar të Traumës nuk janë përgatitur pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara për vitin 2021, sipas udhëzimeve të MFE. Pasqyrat financiare janë përgatitur më vete, ku njëra është hartuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe një pasqyrë për Ministrinë e Mbrojtjes.
Kriteri:	Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, kapitulli IV, pika 98-111, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022.
Ndikimi/Efekti:	Gjendja financiare e të dy Ministrive nuk është paraqitur në aneksin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit SUT.
Shkaku:	Neglizhencë e sektorit të financës dhe e Degës së Thesarit Tiranë.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga sektori i financës të merren masa për të përgatitur pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara dhe paraqitja e tyre të jetë në përputhje me standardet kontabël kombëtare, duke pasqyruar gjendjen e tyre financiare në aneksin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit SUT.

Titulli i gjetjes:	Pasqyrat financiare vjetore për vitin 2021, nuk janë konfirmuar nga Dega e Thesarit Tiranë.
Situata:	Pasqyrat financiare vjetore edhe pse janë depozituar në Degën e Thesarit Tiranë, nuk provohet nga ana shkresore të jetë bërë konfirmimi nga kjo e fundit. Pasqyrat kanë vetëm numër protokollimi në Degën e Thesarit.
Kriteri:	Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, kapitulli V, pika 117, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022.
Ndikimi/Efekti:	Risk i besueshmërisë për të dhënat e paraqitura në bilanc.
Shkaku:	Mos koordinimi me Degën e Thesarit të Rrethit Tiranë.

Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Nga sektori i financës në SUT të merren masa që pasqyrat financiare vjetore të dërgohen në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në Ministrinë e Mbrojtjes, pasi të jenë konfirmuar paraprakisht nga Dega e Thesarit të Rrethit Tiranë.

Titulli i gjetjes:	Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare janë plotësuar pjesërisht, si për rastin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ashtu dhe për Ministrinë e Mbrojtjes.
Situata:	Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se shënimet shpjeguese nuk janë të plotësuara me detaje dhe informacione që duhet të pasqyrohen në të dy bilancet, si për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ashtu dhe për Ministrinë e Mbrojtjes. Plotësimi i tyre është realizuar pjesërisht dhe nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, në të cilin jepen informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë dhe të qartë të pasqyrave financiare.
Kriteri:	Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 3.7 “Rregullat për dhënien e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare individuale”, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e informacionit analitik dhe të detajuar të llogarive përkatëse.
Shkaku:	Mos vlerësim nga sektori i financës.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, shënimet shpjeguese të plotësohen në mënyrë të saktë dhe të detajuar, në përputhje me SKK, duke dhënë informacionin e nevojshëm dhe të domosdoshëm për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.
Titulli i gjetjes:	Në pasqyrat financiare të përgatitura për Ministrinë e Mbrojtjes, nuk pasqyrohet në llogarinë 12 rezultat i mbartur nga viti i kaluar.
Situata:	Në pasivin e bilancit kontabël të Spitalit Universitar të Traumës për Ministrinë e Mbrojtjes, nuk pasqyrohet në llogarinë 12 rezultat i mbartur nga viti i kaluar. Në këtë zë të pasqyrës së pasivit nuk është pasqyruar rezultat i mbartur për të bërë krahasimin ndërmjet gjendjes në çelje të tij, shtesën përgjatë vitit dhe përdorimin e tij në rezultat për të financuar shpenzimet korente apo kapitale.
Kriteri:	Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022.
Ndikimi/Efekti:	Nuk bëhet i mundur krahasimi ndërmjet gjendjes në çelje të bilancit, shtesës përgjatë vitit dhe përdorimi i tij në rezultat për të financuar shpenzimet korente apo kapitale.
Shkaku:	Mos vlerësim nga sektori i financës.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, pasqyrat financiare të përgatiten dhe paraqiten në përputhje me SKK duke pasqyruar në pasivin e

	bilancit rezultatin e mbartur nga viti i kaluar te “Llogaria 12”, për të bërë të mundur krahasimin ndërmjet gjendjes në çelje të tij, shtesën përgjatë vitit dhe përdorimin e tij në rezultat për të financuar shpenzimet korente apo kapitale.
--	---

Titulli i gjetjes:	Për vitet objekt auditimi në SUT nuk është nxjerrë jashtë përdorimit asnjë aset i cili përmbushte kushtet për nxjerrjen jashtë përdorimi.
Situata:	Gjatë analizimit të inventarëve rezultoi se, për vitet objekt auditimi nuk është nxjerrë jashtë përdorimit asnjë aset (produkt), edhe pse duke u nisur nga vitet dhe nga norma e amortizimit, ekzistojnë asete të cilat janë plotësisht të amortizuara. Gjithashtu te inventarët nuk janë përfshirë zërat (toka, ndërtesa, rikonstruksione), në mënyrë që të bëhet verifikimi i vlerës së aseteve, amortizimit të duhur të tyre duke përfshirë edhe shtesat, si dhe të ardhurat e gjeneruara nga përdorimi i tyre, nëse ka. Në fletë hyrjen e magazinës dhe në dokumentacionin e marrjes në dorëzim të mallrave, nuk regjistrohen numrat serial/identifikimit përkatës të mallrave, duke e bërë të vështirë identifikimin e tyre.
Kriteri:	Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik te aktiveve”, pika 73 – 120.
Ndikimi/Efekti:	Nuk bëhet i mundur identifikimi i vlerës reale të aseteve dhe nga ana tjetër kemi rritje të vlerës së amortizimit, si pasojë e mos nxjerrjes jashtë përdorimit.
Shkaku:	Neglizhenca nga sektori i financës.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, asetet plotësisht të amortizuara të nxirren jashtë përdorimit. Gjithashtu duhet të përfshihen në inventar zërat si toka, ndërtesa, rikonstruksione dhe për secilin mall që merret në dorëzim nga institucioni, të përcaktohet dhe regjistrohet numri serial për të bërë të mundur identifikim e tyre.

2.6. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore ne fushën e prokurimeve te fondeve publike, lidhjen e zbatimin e kontratave.

2.6.1. Auditimi i Procedures "Mirëmbajtje Autoambulancave për SUT"

Përshkrimi i procedurës

Loti 1

Me kërkesën nr. 16 Prot., datë 11.01.2021 drejtuar z. G. H. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve, E. O.me detyrë përgjegjëse e sektorit të planifikimit, me arsyen e ezaurimit të Marrëveshjes Kuadër me nr. 79/14 Prot., date 11.06.2019 bën kërkesë për prokurim me objekt: “Mirëmbajtje Autoambulancave & Moto-Gjeneratoreve në SUT”, për një periudhë 24 mujore, fond i cili është planifikuar me financim nga fondet e buxhetit të shtetit (Ministria e Mbrojtjes).

Loti 2

Bazuar ne email-in e datës 19.03.2021 nga përgjegjësja për prokurim pranë ABP-së, SUT është njoftuar se loti nr.2 nuk mund të zhvillohej vetëm me ofertën e një OE pasi nuk është e parashikuar në legjislacionin e prokurimit publik.

AK ka marrë masat për zhvillimin e një testimi tregu me tre OE të ndryshëm dhe ka ridërguar kërkesat për prokurimin e lotit nr. 2 me objekt: “Riparim Mirëmbajtje të Autoambulancave tip Ford për SUT” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj.

Fondi Limit: Loti 1 5,012,050 lekë (pa TVSH) dhe Loti 2 2,300,000 lekë (pa TVSH)

Përmbledhja e procedurës në tabelë Loti 1

Procedura e Prokurimit "Riparim dhe mirëmbajtje automjeteve për Spitalin Universitar të Traumës"		
Urdhër Prokurimi		
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e përqëndruar në ABP	2. Njësia e prokurimit	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
4. Komisioni i Hartimit të Specifikimeve Teknike z. L. H. z. G.P. z. I.K.		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 5,012,050 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 2,797,400 lekë pa TVSH	7. Diferenca me Fondin Limit (pa tvsh) 2,214,650 lekë
8. Data e hapjes së ofertave	9. Burimi i Financimit Buxheti i Shtetit, Ministria e Mbrojtjes	10. Operatorët Ekonomikë
11. Ankimime -	12. Përgjigje e ankesës nga AK -	13. Grupi i ndjekjes së Kontratës z. L. H. z. G.P. z. I. K.
b. Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhje e kontratës Kontratë shërbimi Nr.1/2021 Nr.3/15 Prot., datë 08.10.2021 Kontratë shërbimi Nr.2/2022 Nr.3/19 Prot., datë 31.03.2022 Kontratë shërbimi Nr.3/2022 Nr.3/24 Prot., datë 17.01.2023	15. Vlera e kontratës (me tvsh)	16. Afati i kontratës në muaj Afati i realizimit 24 Muaj (Marrëveshje Kuadër)

Fondi është akorduar nga Buxheti i Shtetit – Ministria e Mbrojtjes (sipas PBA), për të dy lotet është me vlerë: Për lotin nr. 1 - 5,012,050 (pesë milion e dymbëdhjetë mijë e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH dhe për lotin nr. 2 -1,824,800 (Një milionë e tetëqind e njëzetë e katër mijë e tetëqind) lekë pa TVSH.

Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike të Spitalit Universitar të Traumës Tiranë.

Procedura fillestare e ndarë në dy lote ka qënë e ndarë sipas llojit të automjeteve ku në lotin 1 janë përfshirë automjetet e ndryshme të SUT me vit prodhimi para 2018 dhe autoambulancat e reja të tipit FORD me vit prodhimi mbas vitit 2018.

Nga komunikimi me ABP-në është zhvilluar procedura fillestare vetëm për lotin e parë me objekt si më poshtë:

Objekti i kontratës: “Riparim dhe mirëmbajtje automjeteve për Spitalin Universitar të Traumës”.

Numri i referencës së procedurës / Lotit REF-91858-03-30-2021

Fondi Limit 5,012,050 (pesë milion e dymbëdhjetë mijë e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH.

Me urdhër të Titullarit të Spitalit nr. 3 Prot., datë 11.01.2021, është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike i përberë nga, L. H.(Përgjegjës i sektorit të menaxhimit të teknologjisë); G.P. (Specialist paisjesh); I.K. (Shofer)

Me urdhër të Titullarit të Spitalit nr. 3/1 Prot., datë 15.02.2021, është ngritur grupi i punës për Argumentimin e Fondit Limit i përbërë nga, E. XH. (Specialiste planifikimi), M. M. (Specialiste prokurimi), R. J. (Specialiste prokurimi)

Me dokument të protokolluar nr.3/2 Prot., datë 15.02.2021 grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike ka hartuar specifikimet teknike për të gjitha automjetet përjashtuar Autoambulancat e tipit Ford te cilat janë te reja dhe brenda afateve të garancisë.

Me dokument të protokolluar nr. 3/3 Prot., datë 15.02.2021 grupi i punës për Argumentimin e Fondit Limit, ka bërë kërkesë për dhënie çmimi drejtuar tre operatorëve, konkretisht OE R. I.shpk, OE V. M. shpk dhe OE AEE S. shpk me qëllim testimin e tregut.

Me dokument të protokolluar nr. 3/4 Prot., datë 22.02.2021 janë administruar dhe protokolluar ofertat e tre operatorëve të lartpërmendur.

Me dokument të protokolluar nr. 3/4 Prot., datë 27.02.2021 grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike ka hartuar specifikimet teknike për Autoambulancat e tipit Ford të cilat janë të reja dhe brenda afateve të garancisë.

Me dokument të protokolluar nr. 3/6 Prot., datë 27.02.2021 grupi i punës për Argumentimin e Fondit Limit, ka bërë kërkesë për dhënie çmimi drejtuar OE ku janë blerë Autoambulancat, konkretisht “A. M. C. (F. Albania)” SHPK, pasi këto automjete janë të reja dhe për të respektuar kushtet e garancisë mund të riparohen vetëm pranë koncesionarit ku janë blerë.

Me dokument të protokolluar nr. 3/7 Prot., datë 27.02.2021 grupi punës ka përgatitur Argumentimin e Fondit Limit për Autoambulancat, përjashtuar Autoambulancat Ford të reja. Përlllogaritja u bë në bazë të mesatares së çmimit të tregut. Për llogaritjen e fondit limit u përzgjedh çmimi mesatar i testimit të tregut.

Fondi limit sipas sasive të pritshme për një periudhë 24 mujore ka rezultuar në total:

5,012,050 (Pese milion e dymbëdhjetë mijë e pesëdhjetë) leke pa TVSH.

Me dokument të protokolluar nr. 3/8 Prot., datë 09.03.2021 është administruar dhe protokolluar oferta nga “A. M.C. (Ford Albania)” SHPK.

Me dokument të protokolluar nr. 3/9 Prot., datë 10.03.2021 grupi punës ka përgatitur Argumentimin e Fondit Limit për Autoambulancat Ford të reja. Komisioni ka marrë për bazë ofertën e paraqitur nga “A.M.C. (F.Albania)” SHPK si operator i vetëm. Këto automjete janë të reja dhe për të respektuar kushtet e garancisë mund të riparohen vetëm pranë koncesionarit ku janë blerë për të evituar që të dalin jashtë garancisë.

Fondi limit për këtë procedurë prokurimi është: 1,824,800 (Një milionë e tetëqind e njëzetë e katër mijë e tetëqind) lekë pa TVSH.

Me dokument të protokolluar nr. 3/10 Prot., datë 10.03.2021 janë përgatitur Shërbimet dhe Grafiku i Ekzekutimit dhe Termat e Referencës për Lotin nr. 1- “Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Spitalin Universitar të Traumës” dhe me dokument të protokolluar nr. 3/11 Prot., datë 10.03.2021 janë përgatitur Shërbimet dhe Grafiku i Ekzekutimit dhe Termat e Referencës për Lotin nr. 2 - “Riparim Mirëmbajtje të Autoambulancave tip Ford për SUT”.

Me dokument të protokolluar nr. 528 Prot., datë 10.03.2021 i është drejtuar ABP-se Kërkesa për zhvillimin e procedurës me objekt: “Riparim Mirëmbajtje të Autoambulancave në SUT” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj e ndarë në dy lote.

Mbas komunikimeve nëpërmjet email me ABP-në, SUT është vënë në dijeni se vetëm loti NR. 1 është publikuar pasi për lotin nr. 2 (Mirëmbajtje ambulanca FORD) duhej të rishikohej fondi limit duke u mbështetur në një testim tregu me minimumi tre OE sipas LPP dhe rregullave të prokurimit publik.

Me dokument të protokolluar nga ABP me nr. 38/6 Prot., datë 04.05.2021 dhe protokolluar nga SUT me nr 981 Prot., date 06.05.2021 është administruar në dosje “Njoftimi për Lidhje Kontrate” nga ABP vetëm për Lotin nr. 1- “Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Spitalin Universitar të Traumës”.

Me dokument të protokolluar nr. 3/12 Prot., datë 17.05.2021 është lidhur Marrëveshja Kuadër për Lotin 1 dhe nga kjo datë e në vazhdim janë lidhur minikontratat përkatëse vetëm për Lotin 1.

Përmbledhja e procedurës në tabelë Loti 2

Procedura e Prokurimit "Riparim dhe mirëmbajtje automjetesh për Spitalin Universitar të Traumës"		
Urdhër Prokurimi		
1.Lloji i Procedurës së Prokurimit Procedurë e përqëndruar ne ABP	2. Njësia e prokurimit	3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
4. Komisioni i Hartimit të Specifikimeve Teknike z. L.H. z. G.P. z. I.K.		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 2,300,000 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 1,227,200 lekë pa TVSH	7. Diferenca me Fondin Limit (pa tvsh) 1,072,800 lekë
8. Data e hapjes së ofertave	9. Burimi i Financimit Buxheti i Shtetit, Ministria e Mbrojtjes	10. Operatorët Ekonomikë 1. A. Sha. – 1,247,700 lekë 2. K. Sha. – 1,391,120 lekë 3. S.A.Shpk – 1,597,380 lekë 4. V.M. Shpk – 1,227,200 lekë
11. Ankimime -	12. Përgjigje e ankesës nga AK -	13. Grupi i ndjekjes së Kontratës z. L.H. z. G.P. z. R. D. z. B. N. z.E. N.
b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave		
14. Lidhje e kontratës Kontratë shërbimi Nr.1/2021 Nr.49/10 Prot., datë 25.10.2021 Kontratë shërbimi Nr.2/2022 Nr.49/13 Prot., datë 28.02.2022 Kontratë shërbimi Nr.3/2022 Nr.49/18 Prot., datë 06.09.2022 Kontratë shërbimi Nr.4/2022 Nr.49/22 Prot., datë 25.11.202	15. Vlera e kontratës (me tvsh)	16.Afati i kontratës në muaj Afati i realizimit 24 Muaj (Marrëveshje Kuadër)

Bazuar në email-in e datës 19.03.2021 nga përgjegjësja për prokurim pranë ABP-së SUT është njoftuar se loti nr. 2 nuk mund të zhvillohej vetëm me ofertën e një OE pasi nuk është e parashikuar në legjislacionin e prokurimit publik.AK ka marrë masat për zhvillimin e një testimi tregu me tre OE të ndryshëm dhe ka ridërguar kërkesat për prokurimin e lotit nr. 2 me objekt: “Riparim Mirëmbajtje të Autoambulancave tip Ford për SUT” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj. Fondi limit i vënë në dispozicion për këtë procedurë është: 2.300.000,00 (Dy milion e treqind mijë) Lekë pa Tvsh. Mbase është zhvilluar procedura e prokurimit me objektin e sipërpërmëndur, në datë 11.10.2021 është protokolluar shkresa me nr. 2139 Pot., me objekt Njoftim për lidhje kontrate me OE “V. M.” Shpk. AK ka nënshkruar minikontratat dhe vazhdon shërbimi i mirëmbajtjes edhe për vitin 2023 ku ka akoma fond për mbylljen e këtij viti me shërbimet e kërkuara sipas specifikimeve teknike.

2.6.2. Mbi auditimin e procedurave të listuara më poshtë:

Nr.	Procedura e Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik	Data e lidhjes së kontratës
1	“Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe ambienteve të jashtme në SUT për nevoja emergjente”	2,126,606	2,125,175	S.AL	01.12.2021
2	“Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe ambienteve të jashtme në SUT për nevoja emergjente”	8,305,959	8,303,800	S.-AL	07.01.2022

3	“Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe ambienteve të jashtme në SUT për nevoja emergjente”	10,629,338	10,578,610	S.-AL	29.04.2022
4	“Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe ambienteve të jashtme në SUT për nevoja emergjente”	17,394,993	17,382,961	S.-AL	01.08.2022
5	“Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe ambienteve të jashtme në SUT” ABP	137,991,275	113,365,021	D.P.	25.10.2022

1. Aduditimi i procedurës “Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe ambienteve të jashtme në SUT për nevoja emergjente - Dhjetor 2021

Përshkrimi i procedurës

Shërbimi i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe ambienteve të jashtme të SUT është realizuar sipas një kontrate me “S.-AL” shpk, me afat tre vjet dhe me nr. 218 Prot., datë 03.12.2018. Shërbimi i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme në SUT, është dërguar për prokurim të përqendruar në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara. Për arsye të ankesave nga O.E. përkundrejt ABP0-së dhe pamundësisë së zhvillimit në kohë të procedurës në fjalë u krye procedura e prokurimit “Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe ambienteve të jashtme në SUT për nevoja emergjente” deri në momentin e zgjidhjes së ngërcit pranë ABP-së.

Fondi Limit

Fondi limit në vlerën: **2,126,606 leke (pa TVSH).**

Përmbledhja e procedurës në tabelë sipas Aneksit 2.6, pika 1

Procedura e prokurimit e mësipërme është zhvilluar bazuar në tabelën e mëposhtme ku janë cilësuar përshkrimi i shërbimeve dhe çmimet përkatëse të ofruara nga O.E. fitues:

2. Auditimi i Procedurës “Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe ambienteve të jashtme në SUT për nevoja emergjente” Janar 2022

Përshkrimi i procedurës

Shërbimi i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe ambienteve të jashtme të SUT është realizuar sipas një kontrate me “S.-AL” shpk, me afat tre vjet dhe me nr. 218 Prot., datë 03.12.2018. Shërbimi i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme në SUT, është dërguar për prokurim të përqendruar në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara. Për arsye të ankesave nga O.E. përkundrejt ABP0-së dhe pamundësisë së zhvillimit në kohë të procedurës në fjalë u krye procedura e prokurimit “Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe ambienteve të jashtme në SUT për nevoja emergjente” deri në momentin e zgjidhjes së ngërcit pranë ABP-së.

(ilustruar në Aneksin 2.6, pika 2)

Fondi Limit

Fondi limit në vlerën: **8,305,959 leke (pa TVSH).**

Përmbledhja e procedurës në tabelë sipas Aneksit 2.6, pika 3

Procedura e prokurimit e mësipërme është zhvilluar bazuar në tabelën (sipas Aneksit 2.6, pika 4) ku janë cilësuar përshkrimi i shërbimeve dhe çmimet përkatëse të ofruara nga O.E. fitues.

3. Auditimi i procedurës “Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe ambienteve të jashtme në SUT për nevoja emergjente” Prill 2022

Përshkrimi i procedurës

Shërbimi i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe ambienteve të jashtme të SUT është realizuar sipas një kontrate me “S.-AL” shpk, me afat tre vjet dhe me nr. 218 Prot., datë 03.12.2018. Shërbimi i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme në SUT, është dërguar për prokurim të përqendruar në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara. Për arsye të ankesave nga O.E. përkundrejt ABP0-së dhe pamundësisë së zhvillimit në kohë të procedurës në fjalë u krye procedura e prokurimit “Shërbim i

pastrimit të ambienteve të brendshme dhe ambienteve të jashtme në SUT për nevoja emergjente” deri në momentin e zgjidhjes së ngërcit pranë ABP-së.

Fondi Limit

Fondi limit në vlerën: **10,629,338 leke (pa TVSH).**

Përmbledhja e procedurës në tabelë sipas Aneksit 2.6, pika 5.

Me anë të shkresës nr. 27/6 Prot., datë 28.04.2022 njoftohet fituesi i procedurës së prokurimit O.E. “P.S.” i cili me anë të shkresës nr. 27/7 Prot., datë 28.04.2022 tërhiqet nga pjesëmarrja duke dhënë arsyetimin përkatës.

Procedura e prokurimit e mësipërme është zhvilluar bazuar në tabelën (sipas Aneksit 2.6, pika 6) ku janë cilësuar përshkrimi i shërbimeve dhe çmimet përkatëse të ofruara nga O.E. fitues.

4. Aduditimi i procedurës “Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe ambienteve të jashtme në SUT për nevoja emergjente” Gusht 2022

Përshkrimi i procedurës

Shërbimi i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe ambienteve të jashtme të SUT është realizuar sipas një kontrate me “S.-AL” shpk, me afat tre vjet dhe me nr. 218 Prot., datë 03.12.2018. Shërbimi i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme në SUT, është dërguar për prokurim të përqendruar në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara. Për arsye të ankesave nga O.E. përkundrejt ABP0-së dhe pamundësisë së zhvillimit në kohë të procedurës në fjalë u krye procedura e prokurimit “Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe ambienteve të jashtme në SUT për nevoja emergjente” deri në momentin e zgjidhjes së ngërcit pranë ABP-së.

Fondi Limit

Fondi limit në vlerën: **17,394,993 leke (pa TVSH).**

Përmbledhja e procedurës në tabelë sipas Aneksit 2.6, pika 7.

Procedura e prokurimit e mësipërme është zhvilluar bazuar në tabelën (sipas Aneksit 2.6, pika 8) ku janë cilësuar përshkrimi i shërbimeve dhe çmimet përkatëse të ofruara nga O.E. fitues

Duke u bazuar në praktikat dhe statistikat ndërkombëtare më të mira vihet re që çmimet për m2 të pastrimit të spitaleve rezultojnë si më poshtë:

- \$0.07 - \$0.17 për m2 për pastrim dhe dezinfektim
- \$0.12 - \$0.23 për m2 për pastrim të thellë
- \$0.08 - \$0.16 për m2 për dezinfektim të thellë

si dhe duke u nisur nga kontrata e lidhur me O.E. “R.” shpk si më poshtë:

Sipërfaqe totale per tu pastruar	REJ	SORI-AL	Diferenca
Pastrim i brendshëm me shërbim 8-orësh Administratë	2	3.6	1.6
Pastrim i brendshëm me shërbim 8-orësh Pacient	2	3.66	1.66
Pastrim i brendshëm me shërbim 16-orësh Receptions	2	4.8	2.8
Pastrim i brendshëm me shërbim 16-orësh Blloku operator	2	7.2	5.2
Pastrim i brendshëm me shërbim 24-orësh Urgjenca	2	4.18	2.18
Pastrim i brendshëm me shërbim 24- orësh	2.3	2.76	0.46
Sipërfaqet e jashtme pastrim	0.8	0.341	0.459
Sipërfaqet e jashtme larje	0.9	0.255	0.645
Cmimi neto pa TVSH			

TVSH (%)			
TOTAL			

Grupit

të Auditimit i lindin dyshime mbi fryrjen e fondit limit për 3 kontratat lidhur me O.E. “Sori-AI” për nevojat emergjente.

Vlera e mëposhtme, për tre kontrata e lidhura me O.E. “S.-AI” duke marrë si referencë çmimet e ofruara nga O.E. “R.” shpk, të cilat janë sa ½ e çmimeve të ofruara nga O.E. “S.-AI”, duke u konsideruar si një vlerë dhe diferencë e konsiderueshme, si më poshtë:

Sipërfaqe totale per tu pastruar	M2*10 muaj	Diferenca	
Pastrim i brendshëm me shërbim 8-orësh Administratë	613950	1.6	982,320
Pastrim i brendshëm me shërbim 8-orësh Pacient	616890	1.66	1,024,037
Pastrim i brendshëm me shërbim 16-orësh Reception	146580	2.8	410,424
Pastrim i brendshëm me shërbim 16-orësh Blloku operator	617250	5.2	3,209,700
Pastrim i brendshëm me shërbim 24-orësh Urgjenca	2027700	2.18	4,420,386
Pastrim i brendshëm me shërbim 24- orësh	5913540	0.46	2,720,228
TOTAL			12,767,096

Vlera prej **12,767,096 lekë pa TVSH**, nën gjykimin e grupit auditues përbën vlerë të përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet nga ana e SUT-së.

Titulli i gjetjes:	Përdorimi pa ekonomikitet i fondeve për pastrimin e ambienteve
Situata:	Për vitin 2021-2022, për kontratat lidhur me O.E. “S.-AI”, “Për shërbimin dhe pastrimin e ambienteve të SUT-së për nevojat emergjente” është paguar në total për 10 muaj shuma prej 38,390,546 lekë pa TVSH. Fondi limit është përlogaritur duke përdorur cmimet e kontratës së fundit, atë të vitit 2018, ku dhe kjo e fundit është bazuar në cmimet e kontratës 7 vjecarë që është nënshkruar në vitin 2010. Duke marrë për bazë testimin e tregut, statistikave ndërkombëtare si dhe cmimet e ofruara nga O.E. fitues i procedurës së fundit “R.” sh.p.k, të cilat janë sa ½ e çmimeve të ofruara nga O.E. “S.-AI”, duke u konsideruar si një vlerë dhe diferencë e konsiderueshme prej 12,767,096 lekë pa tvsh, shumë e cila përbën vlerë të përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet nga ana e SUT-së.
Kriteri:	Neni 9 “Llogaritja e vlerës së kontratës”, VKM Nr. 914, Datë 29.12.2014 Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik, I Ndryshuar Me Vendimin Nr. 823, Datë 21.10.2020.
Ndikimi/Efekti:	Përdorim i fondeve pa ekonomikitet
Shkaku:	Përdorimi i metodave jo të duhura për përlogaritjen e fondit limit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	SUT, të marrë në konsideratë parimin e ekonomikitetit gjatë përlogaritjes së fondit limit për procedurat e prokurimit që do të zhvillohen, duke përdorur metodat e duhura të përcaktuara në ligj.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi Njësia e Prokurimit, z. G. H., znj. M. P. dhe znj. R. J. dhe Titullari i Institucionit znj. E. B..

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.1375/8 prot, datë 04.07.2023 në lidhje me procedurat e prokurimit “Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme në SUT për nevoja emergjente” nga z. V. S., znj. M. P. dhe znj. R. J., ku janë shprehur kundërshtimet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Duke qënë se kontrata në fuqi për shërbimin e pastrimit përfundonte në Tetor-Nëntor 2021, AK ka përgatitur dokumentacionin dhe ka dërguar për prokurim të përqendruar në ABP kërkesën me nr. 1734 prot., datë 11.08.2021, për zhvillimin e procedurës me objekt: “Shërbimi i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme të SUT për një periudhë 36 mujore”.

Fondi limit për këtë procedurë u bazua në çmimin e kontratës së rivlerësimit me nr. 148 Prot., datë 20.01.2021. AK përllogaritur fondin limit duke u bazuar në çmimet e kontratës së fundit të vitit 2018 ndërkohë që dhe kontrata e vitit 2018 është e bazuar në çmimet e kontratës 7 vjeçare të nënshkruar në vitin 2010. Procedura e zhvilluar nga Organi Qendror Blerës me fond limit 96,103,933 (nëntëdhjetë e gjashtë milion e njëqind e tre mijë e nëntëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH me nr. Reference REF-05435-09-15-2021 është anuluar dhe më datë 19.11.2021 me nr.1951 Prot., Agjencia e Blerjeve të Përqendruara dërgon informacion mbi anulimin e procedurës, e cila ka ardhur si pasojë e vendimit të KPP.

Në këto kushte, pas qartësimit të specifikimeve dhe rillogaritjen e fondit limit në bazë të studimit të tregut, u ridërgua pranë ABP kërkesa për prokurim me nr. 135 Prot., datë 20.01.2022. Grupi i punës ka argumentuar teknikisht dhe ligjërish rillogaritjen e fondit limit duke u bazuar në arsyet e dështimit të procedurës.

Të gjendur në kushtet kur në testimin e tregut OE kanë ofertuar çmime shumë më të larta se çmimet e kontratave të mëparshme (kujtojmë që çmimet janë bazuar në ato të kontratave të vitit 2018 dhe çmimet e kontratës së vitit 2018 janë bazuar në kontratën e vitit 2010), Ak ka marrë për bazë çmimet mesatare të testimit të tregut sipas legjislacionit të sipërpërmendur. Me qëllim kryerjen e shërbimit dhe për të mos rrezikuar dështimin e procedurës së prokurimit, Ak ka zhvilluar negociimet duke u mbështetur në çmimet e reja sipas testimit të tregut dhe procedurës standarde që po zhvillohej nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara. Llogaritja e vlerës prej 12,767,096 lekë rezultuar nga diferencat e çmimeve të kontratave me negociim me operator Sori-Al shpk (në fuqi deri Tetor 2022) dhe çmimeve të operatorit Rej Shpk (në fuqi pas muajit Tetor 2022), nuk përbën vlerë të përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet, pasi fondi limit është argumentuar duke patur parasysh ndryshimet në kuadrin ligjor përsa i përket pagës minimale të punonjësve (e ndryshuar dy herë brenda vitit 2022 dhe e rritur me më shumë se 10%) dhe rritjes së ndjeshme të çmimeve përgjatë vitit 2022 ku rezulton se mesatarja e rritjes së çmimeve të publikuara nga INSTAT ka qënë 6.7%. Ak ka zhvilluar procedurat e negociimit në përputhje me LPP dhe këto procedura kanë qënë e vetmja alternativë ndërkohë që pritej të shpallej fituesi në procedurat e prokurimit të përqendruar.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Në lidhje me observacionin e bërë nga ana e përfaqësuesve të institucionit, grupi i auditimit mendon që në rastin kur A.K. ka gjykuar mbi rritjen e cmimit dhe pagës minimale, atëherë metoda më e saktë për përllogaritjen e fondit limit do të ishte përdorimi i metodës së testimit të tregut dhe INSTAT, të cilat do të kishin reflektuar dy arsyet e A.K. Nisur nga kjo, ishte testimi i tregut nga ABP, që përcaktoj çmimin më të ulët në vlerë të konsiderueshme krahasuar me kontratat e lidhura duke përdorur metodën e kontratës së mëparshme.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.

5. Auditimi i procedurës “Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe ambienteve të jashtme në SUT” ABP

Përshkrimi i procedurës

Realizimi i procedurës së prokurimit me objekt “Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe ambienteve të jashtme në SUT” është kryer pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara.

Fondi Limit

Fondi limit në vlerën: **137,991,275 leke (pa TVSH).**

Përmbledhja e procedurës në tabelë sipas Aneksit 2.6, pika 9.

Shërbimi i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme të SUT, është dërguar për prokurim të përqendruar në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara (ABP) me shkresën nr. 1734 Prot., datë 11.08.2021, e publikuar nga ana e ABP-së në sistemin e Prokurimit Elektronik në datën 15.09.2021 me nr. REF-05435-09-15-2021. Për arsye të ankesave nga O.E. përkundrejt ABP-së dhe pamundësisë së zhvillimit në kohë të procedurës në fjalë u kryen 3 procedura të prokurimit “Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe ambienteve të jashtme në SUT për nevoja emergjente” deri në momentin e zgjidhjes së ngërcit pranë ABP-së.

Nga grupi i auditimit u bë i mundur verifikimi në terren mbi zbatimin e kontratës nga ana e O.E. “R.” sh.p.k. si dhe komisionit mbi zbatimin dhe ndjekjen e kontratës.

Nga verifikimi i kryer rezultoi që :

Në ambientet e brendshme të spitalit u konstatuan:

Kati 1	1 Sanitare	1 Kosh	
Urgjenca	1 Sanitare	1 Kosh	
Blloku operator	1 Sanitare	1 Kosh	
Reanimacioni	1 Sanitare	1 Kosh	
Bllok Operator	3 Sanitare	3 Kosha	
Ortopedi	1 Sanitare	1 Kosh	
ORL	2 Sanitare	2 Kosha	
Kirurgji 1	1 Sanitare	1 Kosh	
Kirurgji 2	1 Sanitare	1 Kosh	
Fizioterapi	1 Sanitare	1 Kosh	
Reception	2 Sanitare	2 Kosha	2 Makineri Larëse
K. Plastike	1 Sanitare	1 Kosh	
Amb	1 Sanitare	1 Kosh	
Protezat	1 Sanitare	1 Kosh	

Gjithashtu për çdo dhomë pacienti, gjendej një kosh mbeturinash në hyrje te dera.

Në ambientet e jashtme – 2 Sanitare, 2 kosha, 1 makineri pastrimi

Nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit rezultuan që ambientet e brendshme dhe të jashtme ishin të pastra, duke u konstatuar vetëm dy problematika:

Pajisjet makineri pastrimi ishin të papërdorur më parë (ilustruar me foto) dhe gjatë qëndrimit të grupit auditues gjatë punës në terren pranë ambienteve të SUT nuk u konstatua përdorimi i tyre por përdorimi i vetëm i koshave të pastrimit. (ilustruar me foto sipas Aneksit 2.6, pika 10).

Ambienti i parkimit në të djathtë të godinës së SUT ishte i pa pastruar (ilustruar me foto sipas Aneksit 2.6, pika 11).

Ambientet e magazinimit të produkteve marrë me qera nga O.E. fitues, ishin jashtë standarteve dhe nuk plotësonin kushtet minimale higjienike (ilustruar me foto sipas Aneksit 2.6, pika 12)

Nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit mbi pastrimin e ambienteve të jashtme, që u përmend me sipër, përse i përket parkimit nga ana e djathtë të ndërtesës së SUT-së, duke u nisur nga specifikimet teknike ku si sipërfaqe përbën gati 1/3 të totalit të sipërfaqes së parkimit, pra 1,092 m², që për sa kohë nuk provohet as nga procesverbalet të mbajtur nga grupi i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës, vlera prej **278,460 lekë** ((1,092 m² x 5 x 30 x 0.8) + (1,092 m² x 5 x 30 x 0.9)) është përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet nga ana e SUT-së.

Titulli i gjetjes:	Mos përmbushja e kushteve të kontratës
Situata:	Gjatë auditimit të zbatimit të kontratës për procedurën “Shërbim i pastrimit të ambjentëve të brendshme dhe të jashtme në SUT” zhvilluar nga ABP, u konstatuar problematika në lidhje me zbatimin e kushteve të kontratës, si më poshtë: Pajisjet makineri pastrimi ishin të papërdorura, duke mos e kryer funksionin e tyre Ambienti i parkimit nga ana e djathtë e ndërtesës së SUT-së, e cila përbënte 1/3 të totalit të sipërfaqes së parkimit, ishte e papastruar dhe gjatë kohës proces auditimit në terren nuk u provua pastrimi i tyre. Shuma e përllogaritur për pastrimin e ambientit të parkimit deri në momentin e procesit të auditimit (faza në terren) përbën vlerën prej vlera prej 278,460 lekë ((1,092 m ² x 5 x 30 x 0.8) + (1,092 m ² x 5 x 30 x 0.9)). Ambientet e magazinimit të produkteve marrë me qera nga O.E. fitues, ishin jashtë standarteve dhe nuk plotësonin kushtet minimale higjienike
Kriteri:	Neni 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”, Neni 107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.
Ndikimi/Efekti:	Cënon cilësinë dhe vazhdimësinë e kryerjes së shërbimit
Shkaku:	Mos zbatim i kushteve të kontratës
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Grupi i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës, në lidhje me konstatimet e kryera nga ana e grupit të KLSH-së, të marrë masat për zbatimin e plotë të kushteve të kontratës si dhe garantimin e ambienteve për O.E. me kushtet e duhura higjienike.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi z. V. S., znj. M. P. dhe znj. R. J. në cilësinë e grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës në mospërputhje me Neni 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”, Neni 107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Sa më sipër është mbajtur Akt konstatimi nr.10 , datë 24.04.2023.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.1375/8 prot, datë 04.07.2023 në lidhje me procedurat e prokurimit “Shërbim i pastrimit të ambjentëve të brendshme dhe të jashtme në SUT” nga z. V. S., znj. M. P. dhe znj. R. J., ku janë shprehur kundërshtimet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Verifikimi i kryer nga grupi i auditimit, në prani të përfaqësuesve të SUT, ka gjetur pajisjet makineri pastrimi jo në gjendje pune, pasi njëra prej tyre është e planifikuar të përdoret në Godinën 3-katëshe të Sëmundjeve të Brendshme, e cila pas rikonstruksionit të saj është pothuajse gati për vënie në funksion të pacientëve. Pajisja tjetër përdoret në godinën qendrore të SUT, kryesisht në korridore në ditët e fundjavës, pasi funksioni i saj larës me shumë shkumë dhe ujë e bën të pamundur përdorimin e saj në ditët e punës, ku edhe fluksi i lëvizjeve është më i shtuar.

Përsa i përket konstatimit tuaj për vlerën prej 278,460 lekë përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet nga ana e SUT-së, sqarojmë se pastrimi dhe larja e parkingut të SUT bëhet herët në

mëngjes dhe hapësira që mund të zënë makinat e personelit mjekësor që punojnë turn i tretë është inapërfillshëm, krahasuar me sipërfaqen që ju keni llogaritur. Ju rikujtojmë që larja e ambienteve të jashtëme ka filluar në 16.03.2023, dhe përllogaritja e vlerës së sipërcituar duhet të fillojë nga kjo datë. Nga verifikimi grupit të punës në terren, rezulton se kjo sipërfaqe është pastruar sipas kushteve të kontratës dhe nuk ka patur ankesa nga asnjë punonjës i SUT. Autoriteti Kontraktor ka planifikuar rikonstruksionin e zyrave të administratës dhe atyre përreth, ku përfshihet dhe ambienti për të cilin ju bëni fjalë. Me përfundimin e rikonstruksionit, depoja e magazinimit do të jetë brenda të gjitha standardeve higjienike.

Oëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Në lidhje me observacionin e bërë nga ana e përfaqësuesve të institucionit, grupi i auditimit mendon që në rastin e makinerive që ishin të papërdorura, për makinerin që sipas A.K. është përdorur nuk qëndron pasi nuk janë përfshirë sipërfaqet e pastrimit për godinën e re të rikonstruktuar. Në lidhje me sipërfaqen e parkingut, vlera e mësipërme në lidhje me 3E mbahet në momentin e mbajtjes së Akt Verifikimit duke konstatuar sipërfaqet jo të menaxhuara si duhet.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet

Auditimi i zhvillimit të Procedurave të Prokurimit Publik në lidhje me shërbimin e gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit

Nr.	Procedura e Prokurimit	Fondi Limit	Vlera e kontratës	Operatori Ekonomik	Data e lidhjes së kontratës
1	“Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit për SUT, për nevoja emergjente”	10,183,671	10,124,752	S.-AI	15.10.2021
2	“Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit për SUT, për nevoja emergjente”	13,403,138	13,352,650	S.-AI	31.12.2021
3	“Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit për SUT, për nevoja emergjente”	11,000,000	10,985,480	S.-AI	29.04.2022
4	“Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Universitar të Traumës”	132,776,585	102,801,600	D. P.	13.06.2022

6.Auditimi i procedurës së prokurimit “Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit për SUT, për nevoja emergjente” Tetor 2021

Përshkrimi i procedurës

Shërbim i gatimi dhe shpërndarjes së ushqimit për SUT, ku përfshihen dietat e klasifikuara në bazë të nevojave shëndetësore për pacientët të cilët janë në regjim spitalor dhe nën kujdesin e mjekëve si dhe dietat për mjekët të cilët janë për kujdesin e pacientëve. Ky lloj shërbimi lind si i nevojshëm për shkak të mirë përcaktimit të specifikimeve se çfarë pacientët duhet të konsumojnë, cilësisë dhe orarit të marrjes së ushqimit. Për arsye të ankesave nga O.E. përkundrejt ABP-së dhe pamundësisë së zhvillimit në kohë të procedurës në fjalë u krye procedura e prokurimit “Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit për SUT, për nevoja emergjente” deri në momentin e zgjidhjes së ngërcit pranë ABP-së.

Fondi Limit

Fondi limit në vlerën: **10,183,671 leke (pa TVSH).**

Përmbledhja e procedurës në tabelë sipas Aneksit 2.6, pika 13.

Kërkesë për prokurim nr. 473 Prot., datë 07.10.2021 me fondet e MM nga znj. E. O.(përgjegjëse/sekt i planifikimit)

Urdhër nr. 77 Prot. Datë 11.10.2021 për krijimin e njësisë së prokurimit nga drejtori z. A.Z. për komisionin e mëposhtëm:

G.H. (përgj. Sektor i prokurimeve)

Znj. K. B. (Dietologe)

Znj. R. J. (specialiste prokurimi)

Njësia e prokurimit ka dërguar relacion më datë 11.10.2021 me nr. Prot. 77/1 drejtuar z. A. Z., drejtor i SUT, me përmbajtje si më poshtë:

Shërbimi i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit për SUT është dërguar për prokurim të përqendruar në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara në datën 27.07.2021 dhe akoma nuk është publikuar në ueb me arsyetimin që gjendet në fazën e përgatitjes së dokumenteve të tenderit nga ana e APP.

Në datën 07.10.2021 është bërë kërkesë nga zyra e planifikimit, pasi kontrata e shërbimit të gatimit përfundon me datë 14.10.2021 dhe SUT do mbesë pa shërbimin e sipërpërmendur dhe të gjendur në këto kushte është ngritur njësia e prokurimit me nr.77 Prot. Datë 13.10.2021 për zhvillimin e procedurës së prokurimit për nevojat emergjente.

Përgjegjësi për prokurimin ka regjistruar procedurën e prokurimit në regjistrin e parashikimeve SPE dhe është marrë aprovimi nga ana e APP-së e cila e ka publikuar në datën 13.10.2021.

Në përmbajtje të shkresës është cituar dhe fondi limit prej 10,183,671

Relacioni i sipërcituar mban datën 11.10.2021 dhe në përmbajtje të saj citohen shkresa të hartuara në 13.10.2021.

Përsa i përket përllogaritjes së fondit limit i cili mban datën 13.10.2021 me nr. 77/2 Prot. Citohet në përmbajtje të saj që çmimet janë rivlerësuar sipas kontratës nr. 2274 Prot., datë 18.11.2021, ku në të cilën sërish nuk ka një rakordancë midis datave të shkresave.

Në ofertë morri pjesë vetëm një Operator Ekonomik “S.-AL” shpk me ofertë 10,183,671 lekë pa tvsh, cili me anë të formulari i njoftimit të fituesit me nr.77/8 Prot., datë 14.10.2021 shpallet fitues.

7. Auditimi i procedurës se prokurimit “Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit për SUT, për nevoja emergjente” Dhjetor 2021

Përshkrimi i procedurës

Shërbim i gatimi dhe shpërndarjes së ushqimit për SUT, ku përfshihen dietat e klasifikuara në bazë të nevojave shëndetësore për pacientët të cilët janë në regjim spitalor dhe nën kujdesin e mjekëve si dhe dietat për mjekët të cilët janë për kujdesin e pacientëve. Ky lloj shërbimi lind si i nevojshëm për shkak të mirë përcaktimit të specifikimeve se çfarë pacientët duhet të konsumojnë, cilësisë dhe orarit të marrjes së ushqimit. Për arsye të ankesave nga O.E. përkundrejt ABP-së dhe pamundësisë së zhvillimit në kohë të procedurës në fjalë u krye procedura e prokurimit “*Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit për SUT, për nevoja emergjente*” deri në momentin e zgjidhjes së ngërcit pranë ABP-së.

Fondi Limit

Fondi limit në vlerën: **13,403,137 leke (pa TVSH).**

Përmbledhja e procedurës në tabelë sipas Aneksit 2.6, pika 14.

Procedura e mësipërme u zhvillua me anë të urdhrin të prokurimit nr. 104/3 prot., datë 29.12.2021, procedurë me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës si nevojë emergjente për përmbushjen e nevojave spitalore mbi përgatitjen dhe shpërndarjen e ushqimit te pacientët dhe te mjekët.

Procedura e prokurimit u vendos të zhvillohej me datë 30.12.2021, ku mori pjesë vetëm një O.E. “S.-AL” sh.p.k. me ofertë ekonomike 13,352,650 lekë pa TVSH, i cili rezultoi dhe fitues.

8. Auditimi i procedurës se prokurimit “Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit për SUT, për nevoja emergjente” Prill 2022

Përshkrimi i procedurës

Shërbim i gatimi dhe shpërndarjes së ushqimit për SUT, ku përfshihen dietat e klasifikuara në bazë të nevojave shëndetësore për pacientët të cilët janë në regjim spitalor dhe nën kujdesin e mjekëve si dhe dietat për mjekët të cilët janë për kujdesin e pacientëve. Ky lloj shërbimi lind si i nevojshëm për shkak të mirë përcaktimit të specifikimeve se çfarë pacientët duhet të konsumojnë, cilësisë dhe orarit të marrjes së ushqimit. Për arsye të ankesave nga O.E. përkundrejt ABP-së dhe pamundësisë së zhvillimit në kohë

të procedurës në fjalë u krye procedura e prokurimit “Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit për SUT, për nevoja emergjente” deri në momentin e zgjidhjes së ngërcit pranë ABP-së.

Fondi Limit

Fondi limit në vlerën: **10,993,750 leke (pa TVSH).**

Përmbledhja e procedurës në tabelë sipas Aneksit 2.6, pika 15.

Procedura e mësipërme u zhvillua me anë të urdhrit të prokurimit nr. 28/3 prot., datë 26.04.2022, procedurë me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës si nevojë emergjente për përmbushjen e nevojave spitalore mbi përgatitjen dhe shpërndarjen e ushqimit te pacientët dhe te mjekët.

Procedura e prokurimit u vendos të zhvillohej me datë 28.04.2022, ku mori pjesë vetëm një O.E. “S.-AL” sh.p.k. me ofertë ekonomike 10,985,479 lekë pa TVSH, i cili rezultoi dhe fitues.

Titulli i gjetjes:	Anomali në vendosjen e kriterëve dhe specifikimeve teknike
Situata:	Gjatë zhvillimit të procedurave “Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit të SUT”, për nevoja emergjente Në asnjë pikë të hartimit të kriterëve të veçanta dhe specifikimeve teknike nuk është përmendur minimumi i kriterëve që duhet të plotësojë një O.E., bazuar në praktikat më të mira, ku faktorët dietetikë-ushqimorë janë një shkak i parandalueshëm dhe i shërimit të sëmundjeve, prandaj spitalet pritet të shërbejnë ushqime me vlera ushqyese në mënyrë që të trajtojnë sëmundjet dhe promovojnë një dietë të shëndetshme dhe të ekuilibruar. Për më tepër, ushqimet që spitalet zgjedhin të blejnë dhe mënyra në të cilën ato prodhohen, përpunohen dhe transportohen mund të kenë një ndikim të thellë në shëndetin e njeriut, si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> - Dëshmi mbi vendin se ku do përpunohet dhe ambalazhohet ushqimi dhe mjetet për shpërndarjen e tyre, - Certifikatat dhe licencat mbi sigurinë, cilësinë dhe pastërtinë e ambienteve dhe ushqimeve që përdoren, - Dëshmi mbi eksperiencën disa vjeçare në industrinë e përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit, - Dëshmi mbi numrin e punonjësve të përfshirë dhe shefat e kuzhinës, (Eksperiencat) - Ambienti se ku do të pritet ushqimi, ambientet, punonjësit, - Menaxhimi i stafit dhe trajnimi i tyre - Cilësia e ushqimit, menuja e pasur, mënyra e ambalazhit, servirja.
Kriteri:	Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”
Ndikimi/Efekti:	Cënon cilësinë dhe vazhdimësinë e kryerjes së shërbimit
Shkaku:	Mos zbatimi i praktikave më të mira
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	SUT, grupi i hartimit të specifikimeve teknike, në zhvillimin e procedurave të prokurimit, gjatë hartimit të tyre, të marrë në konsideratë të gjitha praktikat më të mira që të orientojnë drejtë një produkti/shërbimi që përmbush 3E (eficiencë, ekonomicitet dhe efektivitet), duke u mbështetur dhe ne legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi z G.H., znj. K. B. dhe znj. R.J.

9. Auditimi i procedurës se prokurimit “Kryerja e Shërbimit të Gatimit dhe shpërndarjes të ushqimit për SUT” 2022

Fondi Limit

Fondi limit në vlerën: **10,993,750 leke (pa TVSH).**

Përmbledhja e procedurës në tabelë sipas Aneksit 2.6, pika 16.

Fillesat për lidhjen e kontratës së mësipërme nisin me anë të kërkesës për prokurim me nr.298/1 Prot. Datë 03.06.2021, me objektin e mësipërm nga ana e Përgjegjëses / Sektori i planifikimit znj. E.O. drejtuar Sektorit të Prokurimeve z. G. H.

Me anë të urdhrin nr. 52, datë 03.06.2021, ngrihet grupi i punës për përgatitjet e specifikimeve teknike brenda 30 ditëve me përbërje: znj. I. K., znj. N. M., znj. K.B.i, z. M.S. dhe znj. M.B.15,950,000

Me anë të shkresës 52/1 Prot., datë 29.06.2021 hartohen specifikimet teknike.

Në bazë të urdhrin nr 52/2 Prot., datë 02.07.2021 ngrihet grupi i punës për argumentimin e fondit limit me përbërje: z. G. H., z. B. V., znj. M.M.

Në bazë të informacionit sjellë nga komisioni i mëparshëm mbi zbatimin e kontratës në lidhje me sasinë e dietave që mund të konsumohen brenda një muaji, komisioni i mësipërm përllëgarit fondit limit duke u bazuar dhe në çmimet e kontratës nr. 2274 Prot. Datë 18.11.2020.

Me anë të shkresës nr. 1602 Prot. Datë 26.07.2021 përcillet shkresa për zhvillimin e procedurës në fjalë, drejtuar Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, Ministria e Punëve të Brendshme dhe me anë të shkresës nr. 52/5 dërgohet shkresa për përcaktimin e punonjësve të nevojshëm për procedurën të cilët nuk e kishin përmendur gjatë hartimit të kriterëve të veçanta.

Pranë Organit Qendror Blerës (ABP) është paraqitur kërkesa për prokurim nga Spitali Universitar i Traumës, me shkresat nr. 1602 prot., datë 26.07.2021, me objekt: *“Kërkesë për zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt: “Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit për SUT, për një periudhë 36 muaj”* si dhe me shkresën me nr. 2101 prot., datë 05.10.2021 mbi numrin e punonjësve të cilët nuk ishin cituar në hartimin e kriterëve të veçantë, me anë të cilës është finalizuar kërkesa me plotësimet e nevojshme.

Me date 10.01.2022 Organi Qendror Blerës ka publikuar procedurën e prokurimit me objekt: Loti 1 *“Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi”*, për Spitalin Universitar të Traumës, me fond të marrëveshjes kuadër: 132,776,585 (njëqind e tridhjetë e dy milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë) Lekë (pa TVSH), OSE 1,095,606.77 (një milion e nëntëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e gjashtë pike shtatëdhjetë e shtatë) Euro pa TVSH, me numër reference: REF-16943-01-07-2022. Për këtë procedure prokurimi nuk janë paraqitur ankesa për dokumentet e tenderit, procedura u zhvillua me date 09.02.2022.

U publikua Njoftimi i Fituesit paraprak me date 03.03.2022, janë paraqitur ankesa në lidhje me vlerësimin e ofertave, në përfundim të procesit të ankesave si dhe me zbardhjen e vendimit përfundimtar nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, Organi Qendror Blerës, ka publikuar njoftimin e fituesit për këtë procedure prokurimi me date 23.05.2022 në zbatim të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 381 prot., datë 26.04.2022, ku janë pasqyruar operatorët ekonomike pjesëmarrës, me vlerat përkatëse, dhe çdo informacion tjetër, në lidhje me OE pjesëmarrës.

Dokumentacioni i sipër cituar si dhe dokumente të tjerë në lidhje me procedurën e prokurimit janë paraqitur pranë SUT me shkresën nr. 97/27 prot., date 13.06.2022 me lende: *“Njoftim për lidhje kontrate”*, ku tregohet dhe numri i O.E. pjesëmarrës në garë si :

Dajti Park 2007 me ofertë 102,801,600 leke pa tvsh dhe S.-Al me ofertë 128,790,026 lekë pa tvsh.

Në zbatim të marrëveshjes kuadër nr. 97/26 Prot., datë 13.06.2022 për vitin 2022 janë lidhur 3 Mini kontrata respektivisht:

Mini kontrata nr.1 me nr. 52/11Prot. Datë 22.07.2022 për periudhën 23.07.2022 deri më 30.09.2022, në vlerën 5,213,850 pa tvsh.

Mini Kontrata nr. 2 me nr. 52/17 Prot., datë 29.09.2022 për periudhën 29.09.2022 deri me datë 31.12.2022, në vlerën 6,874,980 lekë pa tvsh

Mini Kontrata nr. 3 me nr. 52/21 Prot., datë 16.12.2022 për periudhën 17.12.2022 deri më 31.12.2022 (14 ditë) në vlerën 1,173,900 lekë pa tvsh.

Në lidhje me auditimin e procedurave të prokurimit të mësipërme u konstatua:

- Në ofertën sjellë nga O.E. D. P. 2007 vihet re çmimi i njëjtë i sjellë për çdo lloj Diete (prej 560 lekësh), e cila ka përmbajtje të ndryshme ingredientësh.
- Në momentin e ardhjes së ushqimit nga dera ballore e spitalit, në prani të shumë njerëzve, përbën risk mbi kontaminimin e ushqimit, ashtu siç është kërkuar dhe në specifikimet teknike.
- Gjatë verifikimit të procesit ndarjes dhe të shpërndarjes së ushqimit tek pacienti u vunë re problematika të theksuara mbi higjienën, cilësinë dhe kushtet e shpërndarjes të ushqimit të cilat janë të ilustruara me foto nga një verifikim i kryer nga grupi i auditimit pranë ambienteve të spitalit, në praninë e kryetares së ndjekjes dhe zbatimit të kontratës dhe njëkohësisht dietologia e spitalit znj. K. B. (ilustruar me foto sipas Aneksit 2.6, pika 17)
- Një nga arsyet e kontraktimit të shërbimeve është përmirësimi i tij në bazë të 3E (efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet), ku në gjykimin e grupit të auditimit nuk shihet ndonjë ndryshim me mënyrën e përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit në vitet paraardhëse, ku ky shërbim ofrohej nga punonjësit dhe mjediset e spitalit.

Titulli i gjetjes:	Kushte të papërshtatshme për shpërndarjen e ushqimit
Situata:	Gjatë zhvillimit të procedurave “Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit të SUT”, zhvilluar në ABP, me O.E. fitues “D. P.”, nga grupi i auditimit u konstatuan kushte dhe metoda të papërshtatshme për shpërndarjen e ushqimit. Zanafilla e problematikës së mësipërme është që në përcaktimin e specifikimeve teknike, ku citohet dhe mënyra për shpërndarjen e ushqimit. Duke marrë në konsideratë cmimet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në lidhje për sa më sipër, metodat e tanishme të shpërndarjes së ushqimit nuk kanë ndonjë ndryshim me metodat e para disa viteve, ku ky shërbim ofrohej nga punonjësit dhe mjediset e spitalit.
Kriteri:	Nenin 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”, Neni 107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.
Ndikimi/Efekti:	Cënon cilësinë dhe vazhdimësinë e kryerjes së shërbimit.
Shkaku:	Mos zbatimi i praktikave më të mira .
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	A.K., në këtë rast SUT, të rishikojë kushtet e kontratës dhe mënyrën e ambalazhimit dhe të shpërndarjes së ushqimit, si dhe të sigurojë ambiente dhe kushte të përshtatshme pranë spitalit duke u bazuar në praktikat më të mira si dhe të arrijë efektivitet të plotë të shërbimit nga O.E.

Titulli i gjetjes:	2 nga 8 punonjës për zbatimin e kontratës
Situata:	Gjatë zhvillimit të procedurave “Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit të SUT”, zhvilluar në ABP, me O.E. fitues “D. P.”, nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit, në lidhje me gatimin e ushqimit, shfaqej e njëjta menu në të gjithë fletët e forcës ditore, ku edhe pse kaloritë dhe ingredientët janë të përcaktuar, mënyra e gatimit të tyre duhet të ndryshohet.
Kriteri:	Marrëveshja kuadër nr. 97/26 Prot., datë 13.06.2022
Ndikimi/Efekti:	Cënon cilësinë dhe vazhdimësinë e kryerjes së shërbimit
Shkaku:	Mos zbatimi i kushteve të kontratës
Rëndësia:	E lartë

Rekomandimi:	Grupi i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës, gjatë kryerjes së detyrës, të bazohet në kushtet e kontratës, për plotësimin e plotë të tyre si dhe të marrë masat e duhura në mos plotësimi të kushteve të kontratës nga ana e O.E. dhe të kërkojë penalizimin e tyre.
---------------------	---

Titulli i gjetjes:	Menuja e njëjtë e gatimit të ushqimit
Situata:	Gjatë zhvillimit të procedurave “Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit të SUT”, zhvilluar në ABP, me O.E. fitues “D.P.”, nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit u konstatuan në ambientet e spitalit vetëm 2 punonjës për ambalazhimin dhe shpërndarjen e ushqimit nga 8 punonjës që duhej të ishin.
Kriteri:	Marrëveshja kuadër nr. 97/26 Prot., datë 13.06.2022
Ndikimi/Efekti:	Mosmarrja e sasisë së ingredientëve të duhur tek pacientët
Shkaku:	Mos zbatim i kushteve të kontratës
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Grupi i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës, gjatë kryerjes së detyrës, të bazohet në kushtet e kontratës, për plotësimin e plotë të tyre si dhe të marrë masat e duhura në mos plotësimi të kushteve të kontratës nga ana e O.E. dhe të kërkojë penalizimin e tyre.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi znj. Kozeta Bakiasi (Dietologe), znj. V. Xh. dhe znj. M. M., në cilësinë e grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës në mospërputhje me Nenin 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”, Neni 107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raporti Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.1375/8 prot, datë 04.07.2023 “në lidhje me procedurat e prokurimit “Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit” nga z. G. H., znj. K. B. dhe znj. V. Xh. dhe znj. M. M., ku janë shprehur kundërshtimet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. Në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet përsa I përket zbatimit të kontratave të shërbimit kemi dërguar observacionet tona për çdo pikë të akt konstatimeve të bëra nga grupi i auditimit të KLSH. Grupi i punës që ndjekin zbatimin e kontratës do të mbajnë parasysht rekomandimet tuaja me qëllim përmirësimin e dokumentacionit provues të shërbimit dhe të dokumentave të nevojshme përgjatë fazës së zbatimit të kontratës.

Përsa i përket gjetjeve në mangësitë e kontratës së shërbimit apo në specifikime teknike, ju bëjmë me dije se Ak nuk mund të ndryshojë kushtet e kontratës në këtë fazë pasi kjo do të përkthehet në procese të kushtueshme dhe të gjata gjyqësore pa arritur qëllimin e duhur për përmirësimin e shërbimit. Ak do të marrë masat që të përmirësojë specifikimet teknike dhe përmirësimin e shërbimit në procedurat në vazhdim ndërkohë që kontratat që po realizohen do të monitorohen dhe do të përmirësohet dokumentimi I procesit të shërbimit sipas kushteve të kontratës dhe rregullave të prokurimit publik.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Në lidhje me observacionin e bërë nga ana e përfaqësuesve të institucionit, grupi i auditimit thekson që ndryshimi i kushteve të kontratës që sipas mendimit të përfaqësuesve të A.K. do të kthehet në procese të kushtueshme nuk mund të krahasohet me pa sigurinë e pacientëve në lidhje me ushqimet e marra.

Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.

Auditimi i zhvillimit të Procedurës së Prokurimit Publik “Trajtimi i mbetjeve spitalore për SUT” , sipas Aneksit 2.6, pika 18

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Fondi i këtij i këtij investimi është akorduar nga Buxheti i Shtetit (sipas PBA) me vlerë 199,290,000 lekë për katër vite.

Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike të Spitalit Universitar të Traumës Tiranë.

Me kërkesën nr. 748 prot, datë 02.12.2019 drejtuar Zv/Drejtor ekonomik A.B. me detyrë nën/drejtoresh ekonomike dhe E. O. i me detyrë përgjegjëse e sektorit të planifikimit, grupi i punës i përbërë nga V. S., E. Xh., A. Rr., N. M., I. P.” ka njoftuar për përfundimin e kontratës së shërbimit të lavanderisë dhe marjen e masave për të lidhur kontratën tjetër.

-Me kërkesën nr. 82/ prot, datë 03.02.2020 drejtuar G. H. me detyrë përgjegjës i sektorit të prokurimeve, E. O. me detyrë përgjegjëse e sektorit të planifikimit, ka bërë kërkesë për prokurim me objekt: “Kryerjen e Shërbimit të lavanderisë dhe hotelerisë”, për nevojat e SUT, fond i cili është planifikuar me financim nga fondet e buxhetit të shtetit (Ministria e Mbrojtjes).

Me urdhër të Drejtorit të Spitalit nr. 7, datë 04.02.2020, është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike i përbërë nga: Valter Sulaj me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve, N. M. me detyrë përgjegjëse e receptionit, M.P. me detyrë specialiste planifikimi, E. Xh. me detyrë specialiste planifikimi dhe I.P. me detyrë Kryeinfermier.

Me protokoll nr. 7/1 datë 07.04.2020 grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike i përbër nga V. S., N. M., M. P., E. Xh. dhe I.P. kanë hartuar specifikimet teknike.

Në specifikimet teknike janë përcaktuar informacionet mbi gjendjen e shtretërve, tabelat e inventarit të butë me peshat përkatëse sipas studimeve (kontratave të mëparshme), tabela me sasi të përkatëse që do të blihen nga kontraktori përgjatë katër viteve, specifikimet e materialeve të buta dhe mënyra e kryerjes së shërbimit me punonjësit përkatës.

Me urdhër të Drejtorit të Spitalit nr. 7/2, datë 07.04.2020 është ngritur grupi i punës për argumentin e fondit limit i përbërë nga G. H. me detyrë Përgjegjës i sektorit të prokurimeve me profesion administrim publik, A. D. me detyrë specialiste finance me profesion ekonomiste, M. S. me detyrë specialist prokurimi me profesion jurist.

Me dokument të protokolluar nr. 7/5 datës 16.04.2020 grupi i përllogaritjes së fondit limit, i ngritur me urdhrin e drejtorit të spitalit 7/2, datë 07.04.2020 i përbërë nga G. H., A.D., M.S., është përcaktuar vlera 199,290,000 lekë pa TVSH dhe 239,148,000 lekë me TVSH, aq sa është dhe fondi i planifikuar nga Ministria e Mbrojtjes.

Pra, përllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në vlerën 199,290,000 lekë, sipas çmimit të marrë nga kontrata e fundit pasi testimi i tregut nuk është marrë parasysh sipas ofertës të ofruar nga operatorët “A.” shpk, “D.” shpk, “W-C.” shpk.

Vlera 199,290,000 lekë, është llogaritur si vlera më e ulët ndërmjet çmimit të tregut dhe kontratës së fundit.

Me urdhër të Drejtorit të Spitalit me nr. 7/6 Prot datë 16.04.2020, është ngritur njësi e prokurimit e përbërë nga G. H. Përgjegjës për prokurim me detyrë Përgjegjës i sektorit të prokurimeve, M. S. specialist prokurimi me detyrë jurist dhe M. P. Specialiste Planifikimi me detyrë ekonomiste.

Kërkesat për kualifikim janë miratuar me procesverbalin e datës 21.04.2020 të firmosura nga njësi e prokurimit e përbërë nga G.H., M. S. dhe M. P.

Me urdhër nr. 7/10, datë 28.04.2020 të Titullarit të SUT është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit, për arsye të ankesës së operatorit ekonomik “S.C.” me nr. protokoll nr. 824. Datë 28.04.2020, ankesës që ka të bëjë me dokumentet e tenderit dhe kriteret e kualifikimit.

Me urdhër nr. 7/9, datë 28.04.2020 të Titullarit të SUT është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesës, të operatorit ekonomik “S.C.” me nr. 824. Datë 28.04.2020, ankesë që ka të bëjë me përcaktimin e dokumentave të tenderit dhe kriteret e kualifikimit, i përbërë nga V.R., V.S.dhe B. V.

Me shkresën nr. 824/1 prot, datë 30.04.2020 komisioni i rekomandon Titullarit të SUT ndryshimin e dokumenteve të tenderit dhe kriterëve të kualifikimit sipas ankesës të “S. C.”, të cilat miratohen prej tij. Me urdhër nr. 7/12, datë 30.04.2020 të Titullarit të SUT, hiqet pezullimi i procedurës së prokurimit.

Me shkresën nr. 7/11 prot, datë 30.04.2020 , hartohet shtojca e me ndryshimet e dokumentave të tenderit, si dhe njoftohet me shkresën nr. 824/2 prot, datë 05.05.2020 operatori ekonomik “S. C.” shpk.

Në datë 04.05.2020 APP ka dërguar rekomandime mbi arsyetimin ose ndryshimin e kriterëve të kualifikimit.

Njësia e prokurimit e përbërë nga G.H., M. S.dhe M.P., ka rekomanduar ndryshimet e kriterëve të kualifikimit sipas rekomandimeve të APP-së dhe ka bërë arsyetimet e vendosjes së kriterëve.

Me shkresën nr. 7/14 datë 05.05.2020 është hartuar shtojca me ndryshimet e dokumenteve të tenderit dhe është bërë dhe ndryshimi i hapjes së datave të procedurës për vlerësim.

Me shkresën nr. 7/15 prot, datë 22.05.2020 Komisioni i vlerësimit të ofertave i drejtohet G.H. në cilësinë e përgjegjës të sektorit të prokurimeve për verifikim në sistemin e drejtësisë të subjekteve pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

Me shkresën nr. 7/116 prot, datë 22.05.2020, G. H. në cilësinë e përgjegjës të sektorit të prokurimeve i kthen përgjigje Komisionit të vlerësimit të ofertave i për rezultatin në regjistrin gjyqësorë të Ministrisë së Drejtësisë të subjekteve pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, duke bashkëlidhur dhe certifikata elektronike respektive për çdo subjekt të kërkuar.

Me shkresën nr. 977 Prot., datë 26.05.2020 është lëshuar një autorizim nga ana e Titullarit të SUT për verifikimin e subjekteve pjesëmarrës në tender të cilët kanë paraqitur ofertë si më poshtë:

1. “S.C.” Shpk
2. “D.” Shpk
3. B.OE “B. L.” Shpk & “K. I.” Shpk

Me proces-verbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të ofertave, në datë 29.05.2020 është bërë akt-konstatimi i subjekteve: 1. “S.C.” Shpk, 2. “D.” Shpk, 3. B.OE “B.L.” Shpk & “K. I.” Shpk

Me proces-verbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në datë 29.05.2020 është bërë vlerësimi i ofertave dhe dokumentacioni i verifikimit të subjekteve: 1. “S. C.” Shpk, 2. “D.” Shpk, 3. B.OE “B. L.” Shpk & “K. I.” Shpk.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët operatorë ekonomike.

Operatorët ekonomikë	Vlera e ofertuar	Refuzuar
S. C.	149,752,200	Jo
D.sh.p.k	159,432,100	Po
K.I.	164,556,600	Po
K.	0	Po
Ë. C.	0	Po

Pas vlerësimit të KVO u kualifikua dhe shpall fitues Shoqëria ” S. C.” shpk, me ofertë në vlerën 149,752,200 lekë, duke u skualifikuar operatorët e tjerë, të përmendur si më sipër.

Me ankesën nr. 1054 prot, datë 03.06.2020 ka kryer ankimim operatori ekonomik “D.” shpk drejtuar titullarit të autoriteti kontraktor për skualifikim të padrejtë.

Me ankesën nr. 1063 prot, datë 04.06.2020 ka kryer ankimim B.OE “B.L.” Shpk & “K. I.” Shpk drejtuar titullarit të autoriteti kontraktor për skualifikim të padrejtë.

Me urdhër nr. 29/18, datë 03.06.2020 të Titullarit të SUT është bërë pezullimi i procedurës së prokurimit, për arsye të ankesës së operatorit ekonomik operatori ekonomik “D.” shpk.

Me urdhër nr. 7/18, datë 03.06.2020 të Titullarit të SUT, është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesës operatori ekonomik “D.” shpk dhe me urdhër nr. 7/19, datë 04.06.2020 është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesës B.OE “B. L.” Shpk & “K. I.” Shpk i përbërë nga A. B. me detyrë Zv/Drejtor ekonomik, I.K. me detyrë Përgjegjëse e sektorit juridik dhe R. J.me detyrë specialiste prokurimi.

Me shkresën nr. 1054/2 prot, dhe nr. 1063 prot datë 10.06.2020 komisioni i shqyrtimit të ankesës i rekomandon Titullarit të autoritetit kontraktor për pranimin pjesërisht të ankesave dhe rekomandon rivlerësimin e procedurës.

Mbas aprovimit të rekomandimeve të KSHA nga Titullari i Ak, në dt. 10.06.2020, KVO dhe përgjegjësi për prokurim vazhduan me rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas arsyeve të skualifikimit nga komisioni i shqyrtimit të ankesave. Nga rivlerësimi i procedurës u vendos skualifikimi i të gjithë OE pjesëmarrës në tender:

Me shkresën nr. 1099 prot, datë 11.06.2020 OE “S. C.” Shpk kërkon informacion mbi procedurën e prokurimit..

Me ankesën nr. 1099/1 prot, datë 12.06.2020 i është kthyer përgjigje OE “S.C.” Shpk.

Me shkresën nr. 1126 prot., datë 17.06.2020 është bërë ankesë nga OE “S.C.” Shpk për skualifikim të padrejtë dhe rivlerësim të procedurës së prokurimit.

Me urdhër nr. 7/120, datë 17.06.2020 të Titullarit të SUT, është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik “S.C.” Shpk.

Me shkresën nr. 7/21 prot, datë 17.06.2020 komisioni i shqyrtimit të ankesës i rekomandon Titullarit të autoritetit kontraktor për pranimin e ankesës së OE “S. C.” Shpk dhe rekomandon rivlerësimin e procedurës.

Mbas aprovimit të rekomandimeve të KSHA nga Titullari i Ak, në dt. 17.06.2020, KVO dhe përgjegjësi për prokurim vazhduan me rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas arsyeve të shqyrtimit të ankesës nga komisioni i shqyrtimit të ankesave. Nga rivlerësimi i procedurës u vendos rikualifikimi i OE “S.C.” Shpk dhe është bërë vlerësimi final si më poshtë:

Me shkresën nr. 1126 prot., datë 18.06.2020 i është kthyer përgjigje OE “S. C.” mbi vendimin e marrë nga ana e Autoritetit kontraktor.

Me shkresën nr. 1177 prot., datë 22.06.2020 është bërë ankesë nga OE “D.” Shpk për rivlerësimin e procedurës së prokurimit.

Me shkresën nr. 1178 prot., datë 22.06.2020 është vënë në dijeni A.K. për ankesën e OE “D.” Shpk të drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik (KPP).

Me shkresën 1177/1 prot, datë 26.06.2020 i është kthyer përgjigje OE “D.” Shpk ku i refuzohet ankesa dhe nuk është marrë parasysh nga ana e Ak.

Komisionit i prokurimit publik me vendim nr. 218/1 prot, datë 25.06.2020 ka lejuar Ak për zhvillimin e mëtejshëm të procedurës dhe ka refuzuar ankesën e OE “D.” Shpk.

Me shkresën nr. 7/22 datë 06.07.2020 është bërë heqja e pezullimit të procedurës së prokurimit sipas vendimit të KPP.

Në datë 07.07.2020 është ribërë ankesë pranë KPP-së nga OE “D.” Shpk për dijeni dhe të SUT.

Me vendimin nr. 248/1 prot, datë 09.07.2020, Komisioni i prokurimit Publik ka refuzuar edhe njëherë ankesën e OE “D.” shpk.

Në datën 14.07.2020 është bërë njoftimi i fituesit dhe raporti përmbledhës i procedurës së prokurimit duke shpallur fitues OE “S.C.” Shpk.

Në datë 17.07.2020 është nënshkruar Marrëveshja kuadër mes SUT dhe OE “S. C.” Shpk me vlerën e fondit limit dhe me afat katër vjeçar.

Nga auditimi i procedurës së mësipërme dhe zbatimit të kontratës u konstatua:

- Procedura e mësipërme është audituar nga grupi i mëparshëm i auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ku janë konstatuar problematika ku për të cilat është hapur një proces gjygjësor dhe akoma nuk ka përfunduar.
- Për shkak se nga ana procedurale është audituar, grupi i auditimit është fokusuar në auditimin e zbatimit të kontratës. Grupi i auditimit kreu verifikimin mbi mënyrën e administrimit dhe kryerjes së shërbimit të lavanderisë.

Nga verifikimi u konstatua :

- Në sallën e grumbullimit dhe shpërndarjes së produkteve të lavanderisë gjendeshin 12 punonjës të shërbimit, me uniformat përkatëse.
- Depo qëndrore kishte gjendje rezervë të materiale të butë për shtrimin e shtretërve (ilustruar me foto sipas Aneksit 2.6, pika 19)
- Procesverbalet për pritjen e mallit ishin të hartuara dhe të firmosura dhe nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit kg e cituara në procesverbal korespondojnë me kg e produkteve të marra në atë ditë si dhe me kushtet e kontratës, si më poshtë:

Nr.	Emertimi	Sasia
10	Carcafë	10.8 kg
5	Carcafë të vegjël	5.5 kg
35	kllef jastëku	4.4 kg
10	Peshqir	2.4 kg
1	Jorgan	2.2 kg
9	Mbulesa	4.5 kg
2	Rrobdishan	05. kg
1	Jastëk	1 kg
1	Kostum mjeku	2.1 kg

Nga verifikimi i kryer i shtretërve të pacientëve në ambientet e spitalit, përgjithësisht ishin sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga A.K. në lidhje me carcafët, dyshekun, jastëkun (të ilustruara me foto sipas Aneksit 2.6, pika 20)

Në ambjentin, cilësuar si Ortopedia 1, në të gjithë katin kur numri total i shtretërve është 28, shtretërit u gjenden të pa rregulluar dhe dysheku i vendosur dukej teje i amortizuar. (ilustruar me foto sipas Aneksit 2.6, pika 21)

Titulli i gjetjes:	Dyshek jashtë kushteve të përshtatshme përdorimi
Situata:	Gjatë zhvillimit të procedurave “Kryerje e shërbimit të lavanderisë për një periudhë 48 mujore në SUT” , grupi i auditimit gjatë verifikimit të zbatimit të kontratës konstatoi që në ambjentin, cilësuar si Ortopedia 1, në të gjithë katin kur numri total i shtretërve është 28, shtretërit u gjenden të pa rregulluar dhe dysheku i vendosur dukej teje i amortizuar.
Kriteri:	Neni 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”, Neni107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në cilësinë e shërbimit

Shkaku:	Mos zbatimi i kushteve të kontratës
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Grupi i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës, gjatë kryerjes së detyrës, të bazohet në kushtet e kontratës, për plotësimin e plotë të tyre si dhe të marrë masat e duhura në mos plotësimi të kushteve të kontratës nga ana e O.E. dhe të kërkojë penalizimin e tyre.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi z. V. S., znj. M. P. z. I. P., z. A. Rr. dhe z. M. S. në cilësinë e grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës në mospërputhje me Neni 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”, Neni107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.1375/7 prot, datë 04.07.2023 në lidhje me procedurat e prokurimit “Kryerja e shërbimit të lavanderisë për një periudhë 48 mujore” nga z. V. S., znj. M. P., z. I. P., z. A. R., z. M. S., ku janë shprehur kundërshtimet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Sqarojmë se në lidhje me konstatimin tuaj për numrin e punonjësve të shërbimit, nga të cilët përgjat kontrollit u gjenden në shërbim 12 punonjës me uniformë shërbimi. Numri i punonjësve për turnin e parë sipas kushteve të kontratë është 12 punonjës, pasi pjesa tjetër e punonjësve janë më turne të II dhe turne të III. Bazuar në kushtet e kontratës OE nuk mund të shtrojë krevatët të cilat nuk kanë pacient pasi kjo shton kostot financiare të SUT, pasi ai shtrat mund të përdoret edhe nga familjarët e pacientëve dhe si rrjedhojë humbet sterilitetit. Ndodhur në këto kushte OE (sipërmarrësi) nuk mund të shtrojë çarçaf dhe dyshek pa marrë konfirmimin e kryeinfermierit të shërbimit mjekësor në SUT. Në lidhje me dyshekët e amortizuar, në momentin e kontrollit nga ana juaj, pasi nuk është ishte kryer procesi i seleksionimit si dhe në SUT nuk kemi mundësi për të magazinuar dysheket që do të zëvendësohen. Aktualisht SUT ndodhet në proces seleksionimi për të cilën është ngritur grupi i punës nga titullarja e SUT. Nga ana jone është marrë në konsideratë edhe zvendësimi i dyshekëve pas kryerjes së procesit të seleksionimit, pasi magazinimi i materialit të butë kërkon hapsira të cilat nuk i disponojmë si pasoje e rikonstruksioneve të cilave po i nënshtrohen godinat e SUT. Grupi i punës do të mbajë në konsideratë gjetjet tuaja, si dhe ka mar masat e nevojshme për plotësimin e të gjitha kushteve të kontratës së shërbimit menjëherë.

Oëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

*Në lidhje me observacionin e bërë nga ana e përfaqësuesve të institucionit, grupi i auditimit gjatë verifikimi të zbatimit të kontratës nuk mund të justifikohet mos shtrimi i krevatëve në një katë të tërë. Gjithashtu dysheqet mund të mblidhen dhe të seleksionohen edhe sikurse në disa dhoma, që të bëhet e mundur lirimi i hapësirave për pacientët që ju nevojitet shtrimi spitalor. **Për këto arsye, sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.***

Auditimi i zhvillimit të Procedurave të Prokurimit Publik sipas Aneksit 2.6, pika 22

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Fondi është akorduar nga Buxheti i Shtetit (sipas PBA) me vlerë: **91,135,200** (Nëntëdhjetë e një milionë e njëqind e tridhjetë e pesë mijë e dyqind) Lekë pa TVSH, për tre vite.

Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike të Spitalit Universitar të Traumës Tiranë.

Me nr. 132 Prot., date 19.01.2022 është protokolluar Kërkesa nga MSHMS për planifikimin e nevojave për trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore drejtuar SUT për një periudhë 24 mujore.

Me urdhër të Titullarit të Spitalit nr.4 Prot., datë 19.01.2022, është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike i përberë nga:

1. V. S. Pergjegjës i Sektorit shërb. Kryetar
2. G. P. Specialist Paisjesh Anëtar
3. P. S. Kryeinfermier Anëtar

Me protokoll nr. 4/1 Prot., datë 20.01.2022 grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike ka hartuar specifikimet teknike.

Me urdhër të Titullarit të Spitalit nr. 4/2 Prot., datë 20.01.2022 është ngritur grupi i punës për argumentin e fondit limit i përbërë nga:

1. G. H. Përgj. i Sek. të Prokurimeve (Përgj. Për prokurim)
2. M. M. Specialiste prokurimi (Anëtare)
3. R. J. Specialiste prokurimi (Anëtare)

Me dokument të protokolluar nr. 9/3 Prot., datë 21.01.2022 grupi i punës për argumentin e fondit limit, ka bere përlogaritjen e fondit limit dhe me shkresën 132/1 Prot., date 24.01.2022 ka bere kërkesën për prokurim te përqendruar drejtuar MSHMS për një periudhe 24 mujore.

Me nr 154 Prot., date 24.01.2022 është protokolluar Urdhri me nr 07/1 Prot., date 20.01.2022 nga MSHMS për ndryshimin e afatin e marrëveshjes kuadër nga 24 ne 48 Muaj.

Me nr 174 Prot., date 26.01.2022 grupi i punës për argumentin e fondit limit, ka bere përlogaritjen e fondit limit për 48 muaj dhe ka bere kërkesën për prokurim te përqendruar drejtuar MSHMS për një periudhe 48 mujore.

Me nr 451 Prot., date 24.02.2022 është protokolluar Kërkesa urgjente për prokurim te përqendruar pasi SUT i përfundon kontrata e shërbimit me objekt: **“Trajtimi i mbetjeve spitalore per SUT”**

Me nr. 1068 Prot., date 07.03.2022 është protokolluar Autorizimi nga MSHMS për zhvillimin nga SUT te procedurës për "Trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore ne SUT" ne cilësinë e Autoritetit Kontraktor.

Me nr. 17/1 Prot., date 08.03.2022 është protokolluar Relacioni drejtuar Titullarit mbi procedurën e trajtimit te mbetjeve spitalore. Fondi limit sipas sasive te pritshme për një periudhe 36 mujore ka rezultuar ne total: **91,135,200** (Nëntëdhjetë e një milionë e njëqind e tridhjetë e pesë mijë e dyqind) Leke pa TVSH dhe afati i marrëveshjes do te jete 3 vjeçar por me kushtin qe do te ndërpritet ne rast se MSMSH do te zhvilloje një procedure te përqendruar me te njëjtin objekt dhe do te nënshkruajë një marrëveshje te re për SUT.

Ne date 10.08.2022 në Spitalin Universitar të Traumës, anëtarët e njësisë së prokurimit të përcaktuar në Urdhrin e Prokurimit Nr. 17/2 Prot., datë 08.03.2022, kane hartuar dhe miratuar dokumentet e shpalljes së procedurës së prokurimit – Procedurë e hapur mbi kufirin e larte monetar - me objekt **“Trajtimi i mbetjeve spitalore per SUT”** – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik fitues, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 36 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër..

Kjo procedurë është e shpallur me Nr. **REF-21773-03-10-2022**

Me dokument të protokolluar nr. 17/4 Prot., datës 08.03.2022 është protokolluar Formulari i Njoftimit te Kontratës se Shpallur dhe ne date 11.04.2022 është zhvilluar procedura ne SPE.

Nëpërmjet emalit, APP ka dërguar rekomandimet për Procedurën e hapur mbi kufirin e larte monetar - me objekt "Trajtimi i mbetjeve spitalore per SUT".

Me dokument të protokolluar nr. 17/5 Prot., datës 18.03.2022 është administruar ne dosje miratimi nga titullari dhe Shtojca nr.1 te DST sipas udhëzimeve nga APP.

Në datë 11.04.2022 është administruar ne dosje Proces-verbal për marrjen ne dorëzim te mostrave nga OE. Ne date 12.04.2022 është administruar ne dosje Proces-Verbal Konstatimi ndaj subjektit “E. R.” SHPK. Ne date 14.04.2022 është administruar në dosje Kërkesa për Paraqitjen e sigurimit të kontratës dhe të dokumentacionit.

Me dokument të protokolluar nr. 779 Prot., datës 12.04.2022 është protokolluar Autorizimi për Kryerjen e Verifikimeve pranë subjektit “E. – R.” SHPK.

Me nr. 17/9 Prot., datë 15.04.2022, është protokolluar Marrëveshja Kuadër për objekt: “Trajtimi i mbetjeve spitalore per SUT” - Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik fitues, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhe 36 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër” mes SUT dhe OE “E. R.” SHPK me vlerën e fondit limit dhe me afat tre vjeçar dhe me kushtin qe do te ndërpritet ne rast se MSMSH do te zhvilloje një procedure te përqendruar me të njëjtin objekt dhe do te nënshkruajë një marrëveshje te re për SUT.

Me nr. 17/10 Prot., datë 19.04.2022, është protokolluar Urdhri i Titullarit për Ngritjen e Komisionit te Posaçëm për Monitorimin dhe Zbatimin e Marrëveshjes Kuadër i përbëre nga:

1. V. S. Pergjegjës i Sektorit shërb. Kryetar
2. P. S. Kryeinfermier Anëtar
3. G. P. Specialist Paisjesh Anëtar

Me dokument të protokolluar nr. 17/15 Prot., datës 19.04.2022 është protokolluar Plani i Zbatimit te Kontratës. Formulari Raportimi zbatim kontrate është hartuar ne date 01.02.2023.

Me dokument të protokolluar nr. 17/16 Prot., datës 19.04.2022 është protokolluar Njoftimi i Kontratës se nënshkruar.

Me dokument të protokolluar nr. 2394 Prot., datës 27.04.2022 është protokolluar Urdhër për Hetim Administrativ Pranë SUT nga Ministria e Drejtësisë.

Me dokument të protokolluar nr. 17/17 Prot., datës 27.04.2022 është protokolluar Proces-verbali për dorëzimin e kopjes se dokumentacionit Ministrisë se Drejtësisë.

Ne date 18.05.2022 është protokolluar Proces-verbal për kthimin mostrave OE "E.R." shpk.

Me dokument të protokolluar nr. 2246/2 Prot., datës 31.05.2022 është protokolluar Kërkesa për informacion mbi procesin e planifikimit te nevojave nga MSHMS për "Trajtimin dhe asgjесimin e mbetjeve spitalore ne SUT".

Me dokument të protokolluar nr. 37 Prot., datës 07.06.2022 është protokolluar: Urdhër për krijimin e grupit te punës për përgatitjen e dokumentacionit drejtuar MSMSH.

Me dokument të protokolluar nr. 1211/1 Prot., datës 07.06.2022 është protokolluar: Dërgim informacioni MSHMS-se për "Trajtimin dhe asgjесimin e mbetjeve spitalore ne SUT".

Me dokument të protokolluar nr. 3410 Prot., datës 15.06.2022 është protokolluar: Akt Konstatimi nga Ministria e Drejtësisë.

Me dokument të protokolluar nr. 1275/2 Prot., datës 17.06.2022 është protokolluar: “Dërgim observacione Akt Konstatimi” drejtuar Ministrisë se Drejtësisë.

Me dokument të protokolluar nr. 1508 Prot., datës 14.07.2022 është protokolluar: Raport përfundimtar nga Ministria e Drejtësisë.

Me dokument të protokolluar nr. 1851 Prot., datës 26.08.2022 është protokolluar: Kërkese për informacion drejtuar M. Turizmit AKM dhe Drejtorisë së kërkimit dhe dijes mjedisore.

Me dokument të protokolluar nr. 1508/3 Prot., datës 05.10.2022 është protokolluar: Informacioni drejtuar Komisionit te ecurisë Disiplinore.

Me dokument të protokolluar nr. 670 Prot., datës 18.10.2022 është protokolluar: Relacioni mbi Proceduren Disiplinore ne ngarkim te Njësisë së prokurimit.

Me dokument të protokolluar nr. 734 Prot., datës 17.11.2022 është protokolluar Kërkesa nga plani për lidhjen e minikontrates 2/2022.

Me dokument të protokolluar nr. 17/20 Prot., datës 17.11.2022 është protokolluar Minikontrata 2/2022.

Me dokument të protokolluar nr. 17/21 Prot., datës 18.11.2022 është protokolluar Plani i Zbatimit të Kontratës për minikontraten 2.

Nga auditimi i procedurës së mësipërme dhe zbatimit të kontratës u konstatua:

Procedura e mësipërme është audituar nga Drejtoria e Përgjithshme Antikorrupsion, Ministria e Drejtësisë dhe është mbajtur Akt Konstatim me nr. 1275 Prot., datë 13.06.2022 si dhe Raport Përfundimtar me nr. 1508 Prot., datë 14.07.2022 me objekt “Hetim Administrativ pranë Spitalit Universitar të Traumës”, ku dhe janë propozuar masa disiplinore për z. G.H., z. G. P. si dhe z. M.S.si dhe dy rekomandime:

Për përdorimin e marrëveshjes kuadër me një operator ekonomik dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike, AK duhet t’i referohet dhe të justifikojë përdorimin e saj sipas udhëzimeve të APP-së.

Në rastet e procedurave të vecanta, ku numri i Operatorëve ekonomik për realizimin e shërbimeve është i vogël, Njësia e Prokurimit duhet të marrë paraprakisht informacionin e nevojshëm nga institucionet e tjera shtetërore, me qëllim që kriteret e pranimit të nxisin pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe të rrisin konkurrencën.

Për shkak se nga ana procedurale është audituar dosja nga një institucion i rëndësishëm së vecantë, grupi i auditimit ka marrë të mirëqena gjetjet e tyre dhe është fokusuar në auditimin e zbatimit të kontratës. Grupi i auditimit kreu verifikimin mbi mënyrën e administrimit, grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve spitalore.

Nga verifikimi u konstatua :

-Që në katet respektive gjendeshin:

Kosha për Mbetje infektive prerese dhe shpuese me kapacitet rreth 1 L

Kosha për Mbetje infektive me kapacitet rreth – 40L

Mbetje farmaceutike me kapacitet rreth – 20L, të shoqëruara me sinjalistikë dhe tabela sinjalizuese të cilat tregojnë *prezencën e mbetjeve të rrezikshme në ambientin/ambientet përkatëse të Autoritetit kontraktor.* (ilustruar me foto sipas Aneksit 2.6, pika 23)

Është mbajtur procesverbali për çdo dorëzim mbetjesh spitalore tek operatori për asgjësim.

-Është kryer tërheqja e mbetjeve spitalore në varësi të fluksit të mbetjeve.

- Pranë ambienteve të spitalit ishte i vendosur vetëm një kontenier ku brenda tij ishte i instaluar një frigorifer. Sipas kushteve të kontratës Operatori ekonomik, duhet të instalojë të paktën dy frigorifere në ambientet e SUT të përshtatshëm për ruajtjen e mbetjeve të rrezikshme të buta dhe të ngurta, deri në momentin e transportimit për në impiantin e asgjësimit si dhe u konstatua që nuk ishte kryer dezinfektimi i mirë i frigorifereve dhe ambientit brenda dhe përreth vendit ku ruhen mbetjet.(ilustruar me foto sipas Aneksit 2.6, pika 24)

Titulli i gjetjes:	Mos plotësimi i kushteve të kontratës
Situata:	Nga auditimi i procedurës së prokurimit “ <i>Trajtimi i mbetjeve spitalore</i> ” u konstatuar që pranë ambienteve të spitalit ishte i vendosur vetëm një kontenier ku brenda tij ishte i instaluar një frigorifer. Sipas kushteve të kontratës Operatori ekonomik, duhet të instalojë të paktën dy frigorifere në ambientet e SUT të përshtatshëm për ruajtjen e mbetjeve të rrezikshme të buta dhe të ngurta, deri në momentin e transportimit për në impiantin e asgjësimit si dhe u konstatua që nuk ishte kryer dezinfektimi i mirë i frigorifereve dhe ambientit brenda dhe përreth vendit ku ruhen mbetjet.
Kriteri:	Neni 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”, Neni 107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në cilësinë e shërbimit

Shkaku:	Mos zbatimi i kushteve të kontratës
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Grupi i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës, gjatë kryerjes së detyrës, të bazohet në kushtet e kontratës, për plotësimin e plotë të tyre si dhe të marrë masat e duhura në mos plotësimi të kushteve të kontratës nga ana e O.E. dhe të kërkojë penalizimin e tyre.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi z. V. S., z. P. S. dhe z. G. P. në cilësinë e grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës në mospërputhje me Neni 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”, Neni 107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.1375/12 prot, datë 04.07.2023 në lidhje me procedurat e prokurimit “*Trajtimi i mbetjeve spitalore*” nga z. V. S., znj. M. P., z. I. P., z. A. R., z. M. S., ku janë shprehur kundërshtimet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Nga ana jonë janë marrë të gjitha masat e nevojshme lidhur me mangësitë e konstatuara nga KLSH të cilat janë korrigjuar menjëherë, shprehim gadishmërinë tonë në përmbushjen me përpikmëri të gjetjeve tuaja si dhe në ndjekjen e shërbimit sipas kushteve të kontratës së shërbimit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Në lidhje me observacionin e bërë nga ana e përfaqësuesve të institucionit, grupi i auditimit thekson se nuk mund të gjykojë nëse janë korrigjuar mangësitë, pasi auditimi në terren ka përfunduar. Kjo mbetet për tu parë në momentin e kryerjes së zbatimit të rekomandimeve, pranda observacioni për këtë pikë nuk do të merret në konsiderat.

Auditimi i zhvillimit të Procedurës së Prokurimit Publik “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme e ndarë në dy lote”

Përshkrimi i procedurës

Procedura e prokurimit e ndarë në dy lote:

Loti 1: Materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore

Loti 2: Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale për nevoja spitalore

Fondi Limit

Fondi limit në vlerën: **49,537,653 lekë (pa TVSH) / 415,828.53 Euro**

Përmbledhja e procedurës në tabelë sipas Aneksit 2.6, pika 25

Me anë të shkresës nr. 1279 Prot., datë 16.06.2022, Drejtoresha e SUT-së, i drejtohet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me lëndë “Kërkesë për prokurim materiale mjekësore” duke listuar dhe arsyet përkatëse. Dhe me anë të shkresës nr. 2631/1 Prot. datë 30.06.2022, konfirmohet kryerja e procedurës së mësipërme nga ana e MSHMS.

Hartimi i specifikimeve teknike dhe përlllogaritja e fondit limit të procedurës me nr. 45/1 Prot., datë 04.07.2022.

O.E. të kualifikuar janë:

Për Lotin 1 është “M.shpk dhe B.A.shpk si dhe

për Lotin 2 është BOE “E. shpk dhe O.E.S. D. shpk.

Arsyet e skualifikimit të O.E. “C. P.” sipas grupit të KVO, ishin se në momentin e dorëzimit të mallrave personi i dërguar ishte i pa autorizuar dhe pjesa më e madhe e mostrave të paraqitura ishin të pa etiketuara si dhe të hapura në qese transparente.

Nga auditimi rezulton se:

Data e lidhjes së kontratës është 23.08.2022 dhe në kushtet e listuara në DST dhe sipas Nenit 5 “Afati i lëvrimit” deklarohet që furnizuesi do të fillojë lëvrimin e mallit menjëherë pas nënshkrimit të kontratës në maës 1/3 e sasisë totale, por jo më vonë se 5 ditë pune sipas artikujve të kërkuara nga AK.

Nga verifikimi i urdhërshpenzimeve për kontratën 45/12 dt. 23.08.2022, brenda afatit 5 ditor për faturat e sjella gjendeshin:

Fatura nr. 1340/2022 datë 26.08.2022 në vlerën 5,188,710 lekë + TVSH,

Fatura nr. 1327/2022 datë 25.08.2022 në vlerën 1,337,382 lekë + TVSH,

që përbën 1/5 të sasisë totale dhe jo 1/3 që është kërkuar nga A.K.

Për Kontratën me nr. 45/11 dt. 23.08.2022,

Fatura nr. 926/2022 datë 25.08.2022 në vlerën 516,420 lekë + TVSH

Fatura nr. 931/2022 datë 26.08.2022 në vlerën 2,345,244 lekë + TVSH,

Fatura nr. 881/2022 dt. 26.08.2022 në vlerën 3,151,200 lekë që në total përbëjnë shumën 6,526,092 që përbën sasinë minimale që është kërkuar nga A.K.

Grupit të auditimit nuk iu vunë dispozicion urdhër shpenzimet për të parë nëse malli/shërbimi është dërguar sipas kushteve të kontratës për sa i përket afateve kohore.

Titulli i gjetjes:	Kalimi i afatave për dërgimin e mallit
Situata:	Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme e ndarë në dy lote” u konstatua nga verifikimi i urdhërshpenzimeve për kontratën 45/12 dt. 23.08.2022, brenda afatit 5 ditor për faturat e sjella gjendeshin: Fatura nr. 1340/2022 datë 26.08.2022 në vlerën 5,188,710 lekë + TVSH Fatura nr. 1327/2022 datë 25.08.2022 në vlerën 1,337,382 lekë + TVSH, që përbën 1/5 të sasisë totale dhe jo 1/3 që është kërkuar nga A.K. Nga A.K. nuk është kërkuar penalitet për O.E., pasi Fatura e 3 është Fatura nr. 1304/2022 dt. 31.08.2022 në vlerën 4,564,688 lekë e sjellë 3 ditë me vonesë. Duke qenë se materialet e mjekimit janë të një rëndësie të lartë dhe jetike, kalimi i afateve sado i vogël të jetë, sjell mospërmbushje të objektivave të spitalit.
Kriteri:	Nenin 107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”
Ndikimi/Efekti:	Ndikim në arritjen e objektivave të institucionit
Shkaku:	Mos zbatimi i kushteve të kontratës
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Grupi i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës, gjatë kryerjes së detyrës, të bazohet në kushtet e kontratës, për plotësimin e plotë të tyre si dhe të marrë masat e duhura në mos plotësimi të kushteve të kontratës nga ana e O.E. dhe të kryejë llogaritjen dhe kërkojë penalizimin e tyre.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi z. D. C., z. K. S. dhe z. I. P. në cilësinë e grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës në mospërputhje me Nenin 107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe znj. E.B., në cilësinë e Përgjegjëses së Financës (07.2022 e në vazhdim) në mospërputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

2.6.3. Mbi zbatimimin e kontratës së punimeve civile “Ndërtim i Depos së ujit të SUT”.

Kontrata “Ndërtim i Depos së ujit të SUT”, është nënshkruar me nr. 14/24 prot., datë 26.04.2021, ndërmjet SUT përfaqësuar nga z. A. Z. dhe BOE “A. K.” dhe “4 A-M” SHPK, me vlerë 49,387,274.06 Lekë me TVSH. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur Shoqëria “H. & S.” SHPK, me të cilën është nënshkruar kontrata nr. 33/11 prot., datë 26.04.2021. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 6 muaj, referuar datës së së lirit të sheshit të ndërtimit. Projekti i zbatimit është realizuar nga Shoqëria “C.C.” SHPK. Oponenca Teknik është bërë nga Universiteti Politeknik i Tiranës. Këshilli Kombëtar i Territorit ka marrë Vendimin për miratimin e lejes së ndërtimit me nr. 09, datë 15.04.2021.

Kontrata përfshin punime të cilat kanë të bëjnë me:

Ndërtim i depos së ujit me volum 300 m³.

Punime për linjën kryesore të shpërndarjes.

Rikonstrukcion i godinës së shrbimit të depos së ujit (salla e komandimit).

Prishja e rezervuarit tip kullë (kulla e barit) dhe struktura e bunkerit.

Procesverbali i fillimit të punimeve është mbajtur me nr. 14/29 prot., datë 08.11.2021. Mbikëqyrësi i punimeve dhe Kontraktori me shkresë nr. 206/5 prot., datë 05.04.2022, për arsye të vonesave të furnizimit të pompave (shkak Covi-19), kushteve të papërshtatshme të motit dhe vonesa të tjera, është kërkuar shtyrje e afatit të përfundimit të punimeve me 3 muaj. Referuar sa më sipër, është hartuar relacioni nr. 14/33 prot., datë 17.01.2022, sipas të cilit komisioni i monitorimit të zbatimit të kontratës (ngritur me Urdhër nr. 14/24 prot., datë 26.04.2021) i përbërë nga z. G.H., znj. D.Ll., z. S.k., z. G. P.dhe z. M. S., ka shqyrtuar pretendimet dhe rrethanat duke konsideruar si të argumentuar shtyrjen përkatëse. Amendamenti i kontratës është nënshkruar me nr. 14/35 prot., datë 06.05.2022, i cili ka të bëjë me shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve deri me datë 08.08.2022. Sipas këtij ndryshimi afati i kontratës nga 6 muaj është bërë 9 muaj.

Bazuar në ditarin e punimeve, punimet kanë filluar me datë 08.11.2021 dhe kanë përfunduar me datë 08.08.2022, brenda afatit të parashikuar duke marrë në konsideratë edhe shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve.

Gjatë zbatimit të punimeve është konstatuar vështirësi dhe rrezikshmëri në procesin e shembjes së depos së vjetër e cila është vendosur në lartësi 32 m dhe anash depos kishte banesa. Për realizimin pa pasoja të këtij procesi është propozuar shembja e depos duke përdorur sharrë betoni. Soletat, trarët dhe kolonat duhet të priteshin në pjesë të veçuara dhe ulja e tyre në tokë nëpërmjet një vinçi kullë. Për këtë proces, por dhe ndryshime të tjera të përcaktuara si të domosdoshme, nga ana e kontraktorit është bërë kërkesa sipas shkresës nr. 15/11 prot., datë 15.11.2021, duke paraqitur dhe një metodologji, me hapat që duheshin ndjekur në varësi të lartësisë, tipit të strukturës, afërsinë me pronat private, si dhe rregullat e sigurimit teknik.

Për ndryshimet e mësipërme, pas kërkesës së kontraktorit grupi i monitorimit të kontratës ka përgatitur relacionin nr. 14/33 prot., datë 17.01.2022, i miratuar nga Drejtori i SUT znj. E.B.

Në preventivin e ndryshuar, përfshihen edhe punime të cilat nuk janë pjesë e preventivit të tenderuar. Për këtë arsye, duke qenë se në manualin e çmimeve të punimeve të ndërtimit nuk ka referenca sipas zërave të rinj, është aplikuar studimi i tregut, si dhe është hartuar analiza e kostos për zërat përkatës të punimeve.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike rezulton se janë plotësuar procesverbalet e punimeve që bëhen të padukshme, janë mbajtur aktkontrolle, janë paraqitur certifikata të testimi të materialeve të ndërtimit, është plotësuar ditari i punimeve, libreza e masave etj.

Me datë 04.04.2023, me prezencën e mbikëqyrësit të punimeve, u verifikuan disa zëra të punimeve të realizuara në objekt. Nga verifikimi për zëra të punimeve të dukshme, u konstatua se:

- Në përgjithësi janë realizuar punime me cilësi të mirë.

- Soletat janë hidroizoluar. Sasitë janë realizuar konformë raportimit në librezën e masave dhe situacionin përfundimtar, duke marrë në konsideratë se në këtë sasi është përfshirë edhe hidroizolimi i themeleve.

- Janë realizuar suvatimet, shtresat, dyer dritare sipas përcaktimeve në specifikimet teknike.

Sa i takon depos së vjetër të ujit, punimet janë realizuar plotësisht dhe nuk ka asnjë element të dukshëm. U konstatua mangësi si më poshtë:

- Sipas zërit 1.1.10 “rrethim i përhershëm me kolona b/a dhe rrjetë teli”, është certifikuar sasia 153 m², ndërsa nga matjet në objekt rezulton se për këtë zë punimi nuk është vendosur sasia 10 ml, ose 16 m², si dhe disa kolona betoni kanë pësuar devijim.

- Sipas zërit 1.1.24 “Ullukë shkarkimi vertikalë me llamarinë xinkato Ø 100 mm”, nga verifikimi në objekt rezulton se ulluqet janë vendosur material PVC, me diametër 65 mm.

- Sipas zërit “3.3.3 “Dyer të blinduara importi me akses kontrolli”, është certifikuar dhe realizuar sasia 2.46 m², por nuk është vendosur akses i kontrollit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me:

- Specifikimet teknike të kontratës.

- Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 4.1, ku përcaktohet:

“Mbikëqyrësi i punimeve njofton sipërmarrësin për difektet e vëna re dhe kohën e korrigjimit të tyre. Punimet me difekte nuk pranohen dhe nuk financohen deri në korrigjimin e tyre”.

Ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve, Shoqëria “H.-S. 11” SHPK.

Situacioni përfundimtar është certifikuar me vlerë 49,143,795.02 lekë.

Për kolaudimin e punimeve është përzgjedhur Shoqëria “A. – Studio” SHPK, me të cilën është nënshkruar kontrata nr. 61/7 prot., datë 22.08.2022. Akti i kolauditimit është mbajtur me datë 10.11.2022. Certifikata e marrjes në dorëzim të përkohshëm të punimeve është përgatitur me nr. 14/47 prot., datë 07.12.2022. Garancia e defekteve është 12 muaj.

Titulli i gjetjes:	Defekte të konstatuara në zbatimin e punimeve.
Situata:	Nga verifikimi i punimeve në objekt janë konstatuar mëngësi që kanë lidhje me: - Sipas zërit 1.1.10 “rrethim i përhershëm me kolona b/a dhe rrjetë teli”, është certifikuar sasia 153 m ² , ndërsa nga matjet në objekt rezulton se për këtë zë punimi nuk është vendosur sasia 10 ml, ose 16 m ² , si dhe disa kolona betoni kanë pësuar devijim. - Sipas zërit 1.1.24 “Ullukë shkarkimi vertikalë me llamarinë xinkato Ø 100 mm”, nga verifikimi në objekt rezulton se ulluqet janë vendosur material PVC, me diametër 65 mm. - Sipas zërit “3.3.3 “Dyer të blinduara importi me akses kontrolli”, është certifikuar dhe realizuar sasia 2.46 m ² , por nuk është vendosur akses i kontrollit.
Kriteri:	- Specifikimet teknike të kontratës. - Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 4.1.
Ndikimi:	Defektet mund të riparohen gjatë periudhës së garancisë.
Shkaku	Neglizhencë në përfundimin e punimeve sipas specifikimeve.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Mbikëqyrësi i punimeve të kërkojë nga kontraktori riparimin e defekteve dhe realizimin e plotë të sasisë për zërat e punimeve të konstatuara me mangësi, përpara përfundimit të periudhës së garancisë së tyre. Të bëhet verifikim për çdo zë punimi të realizuar, për identifikimin e defekteve të tjera të mundshme, në

mënyrë që të merret në dorëzim të përhershëm një objekt me të gjitha punimet e realizuara sipas kontratës dhe kushteve teknike të zbatimit.

Ngarkohet me përgjegjësi Mbikëqyrësi i punimeve Shoqëria "H.K 11" SHPK.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit, nga subjekti i audituar (nëpërmjet SUT) BOE "A.K." SHPK dhe "4 A-M" SHPK, është paraqitur observacioni me shkresë nr. 206/12 prot., datë 04.07.2023, protokolluar në KLSH me nr. 1199/11, datë 05.07.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

- Në lidhje me rrethimin e Depos së Ujit, sasia e rretës së munguar është zhvendosur/hequr/dëmtuar nga palë të treta pa dijeninë e sipërmarrësit të punimeve. Sipërmarrësi ka marrë të gjitha masat për zëvendësimin e sasisë së munguar dhe riparimin e kolonave të cilat kanë pësuar devijim (bashkëngjitur observacionit foto të punimeve).

- Në lidhje me tubacionet e shkarkimit, janë paraqitur foto sipas të cilave tubacionet e shkarkimit (uulukë) të vendosura me material PVC janë zëvendësuar me tubacione me material llamarinë zinkato, sipas specifikimeve, ilustruar me foto.

- Në protën e hyrjes është montuar sistemi i aksesit i cili mungonte, ilustruar dhe me foto.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Kemi të bëjmë me reflektim për riparimin e defekteve të konstatuara, bazuar në deklarin dhe fotot bashkëngjitur rekomandimit. Pavarësisht ndërhyrjes për zbatimin e plotë të specifikimeve teknike, siç pretendohet, rekomandimi konsiderohet i realizuar, pas verifikimit në objekt të tyre, gjatë fazës së auditimit mbi zbatimin e rekomandimeve pranë SUT.

2.6.4. Procedura e prokurimit Furnizim me barna për nevojat e SUT, e ndarë në 19 lote

Nga auditimi i procedurës së prokurimit publik të vitit 2022 me objekt: "Furnizim me barna për nevojat e SUT, e ndarë në 19 lote", Marrëveshje Kuadër me disa Operatorë Ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara (Një OE për secilin lot), për një periudhë 24 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër me nr. REF-38683-08-15-2022, u konstatua se:

I. Procedura e prokurimit e nisur me urdhrin e prokurimit nr.35/6 datë 24.06.2022 me objekt "Furnizim me barna për nevojat e SUT, e ndarë në 19 lote" është anuluar nga AK.

Sipas raportit përmbledhës nr.35/11 Prot. datë 01.08.2022 të komisionit të vlerësimit të ofertave më datë 13.07.2022, në SEP kishin paraqitur ofertë ekonomike vetëm 2 OE, respektivisht:

1. OE V. SHPK për lotin 2., me ofertë ekonomike: 410,300 Lekë pa TVSH.

2. OE F. SHPK për lotin 19., me ofertë ekonomike: 22,750,000 Lekë pa TVSH.

KVO kishte skualifikuar OE V. sepse sipas tyre ky OE nuk kishte ofertuar medikamentin e kërkuar nga AK, ndërsa OE Florifarma e kishte skualifikuar pasi oferta e tij, sipas KVO kishte mospërputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga AK në DST për principit aktiv të medikamentit "Nadroparine Calcium".

*Për sa më lart, KVO ka propozuar anulimin e procedurës, të cilën titullari i institucionit e ka miratuar me anë të formularit të njoftimit të Anulimit nr.35/12 datë 01.08.2022. Fondi limit për këtë procedurë ishte përcaktuar në shumën **24,638,221 lekë**.*

II. AK SUT, pas anulimit e ka rishpallur përsëri procedurën e prokurimit me të njëjtin objekt "Furnizim me barna për nevojat e SUT, e ndarë në 19 lote", Marrëveshje Kuadër me disa Operatorë Ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara (një OE për secilin lot), për një periudhë 24 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër".

Në tabelën nr.1 jepen të dhëna mbi zhvillimin e procedurës së blerjes së barnave të ndarë në 19 lote, për vitin 2022

Tabela nr.1. Të dhëna të përgjithshme mbi procedurën e prokurimit

1.Urdhër Prokurimi Nr.62/5 Datë 15.08.2022	3.Njësia e prokurimit Urdhër Nr.62 dt. 10.08.2022 V.A. G.H. M.S.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 62/6 datë 15.08.2022 A. C. R.J. M. M.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur Mallra”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) 24,638,221 Lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 24,392,551 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 245,670 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 31/08/2022 ora 10:00	9.Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit (Ministria e Mbrojtjes)	10.Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender: 4 OE b)S’kualifikuar : Asnjë OE c) Kualifikuar: 4 OE
11.Ankimime	12. Përgjigje Ankesës nga AK	13.Përgjigje Ankesës nga KPP

Llogaritja e Fondit limit:

Njësia e Prokurimit të SUT, nëpërmjet shkresës nr. 62/2 Prot., datë 10.08.2022, ka kërkuar ofertë ekonomike nga OE “C. F.”, “I.” dhe “F.” për medikamentin me princip aktiv Nadroparine Calcium OE të sipërcituar nëpërmjet formularit të deklarimit të ofertës nr. 62/3 Prot., datë 11.08.2022 kanë paraqitur ofertat siç pasqyrohen në tabelën nr.2.

Tabela nr.2. OE ofertues për llogaritjen e Fondit limit për barin Nadroparine Calcium

Nr.	OE Ofertues	Principi aktiv	Forme doza	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi (Leke)
1	C. F.	Nadroparine Calcium	Shiringë e parapërgatitur	cope	1	478.8
2	I.					474.1
3	F.					455

Nga auditimi konstatohet se:

Njësia e prokurimit të AK., SUT për lotet 1-18 ka përlllogaritur vlerën e fondit limit mbi bazën e Listës të barnave për përdorim spitalor të miratuar nga MSHMS.

Titulli i gjetjes:	Mos respektimi i listës së barnave për përdorim spitalor të miratuar nga MSHMS.
Situata:	Njësia e Prokurimit e AK., SUT për barin me princip aktiv <i>Nadroparine Calcium</i> , ka vepruar ndryshe për llogaritjen e fondit limit për lotin 19 nga lotet e tjera të kësaj procedure duke e përlllogaritur Fondin Limit për lotin 19 nëpërmjetë testimit të tregut duke shmangur çmimin e përcaktuar nga MSHMS për barin me princip aktiv Nadroparine Calcium që rezulton të jetë dhe alternativ e vetme në bazë të regjistrit të barnave pranë AKBPM. - Njësia e Prokurimit e SUT e përbërë nga V. A., G.H. dhe M. S., nëpërmjet shkresës nr. 62/4 Prot. datë 11.08.2022, si rezultat i testimit të tregut kanë marrë oferta nga OE “C.F.”, “I.” dhe “F.”. Mbi bazën e të cilave kanë përlllogaritur çmimin mesatar për njësi për “Nadroparine Calcium 5700 IU Axa/06 ml” në shumën 469.3 lekë (një shiringë e parapërgatitur) dhe për sasinë e kërkuar prej 50,000 copë Fondi Limit është përlllogaritur në vlerën 23,465,000 lekë . Pra Fondi limit i përlllogaritur vetëm për lotin 19 përbën 95.2% të totalit të Fondit Limit të kësaj procedure.

Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në SEP për lotin 19 nga OE F.F. i kualifikuar dhe shpallur fitues, rezulton se:

- OE F. ka regjistruar Barin me princip aktiv “Nadroparine Calcium” me forme dozë “Solution for injection x 5700 IU Axa/0.6ml” dhe paketim “10 shiringa të parapërgatitura” sipas detyrimit ligjor pranë AKBPM.
- OE F. e ka rinovuar autorizimin e tregtimit të barit me emër tregtar FRAXIPARINE dhe princip aktiv Nadroparine Calcium me formë dozë 5700 IU Axa/0.6ml me urdhrin e ministrit të shëndetësisë nr.131/11.02.2019, ku prodhues është firma “Aspen notre dame de bondeville” – France.

OE F.F. i shpallur fitues për Lotin 19, ka paraqitur si mbajtës të autorizur për shitjen (MAH) kompaninë M. H. D.O.O. Kroaci, e cila ka paraqitur aprovimin e variacionit duke kaluar MAH për Fraxiparinën, 5700 IU Axa/0.6 ml nga kompania Franceze tek kompania Kroate M.H. D.O.O.

- Duke qënë se Fraxiparina është një bar i regjistruar dhe pjese e listës së barnave për përdorim spitalor, çmimi i këtij bari është përcaktuar nga KÇB¹ sipas përcaktimeve të nenit 38 të ligjit 105/2014 për barnat dhe shërbimin farmaceutik.
- Sasia dhe llojet e barnave që prokurohen nga MSHMS/Spitalet Publike planifikohen mbi bazën e listës së miratuar të barnave për përdorim spitalor që miratohen nga MSHMS për cdo vit.
- Për vitin 2022, MSHMS ka miratuar listën e barnave për përdorim spitalor, ndërsa një komision i posaçëm i kësaj ministrie ka përcaktuar çmimet e barnave për përdorim spitalor.
- Lista e barnave së bashku me çmimet nëpërmjet strukturave përgjegjëse pranë MSHMS, është përcjell për të gjitha spitalet publike në vend në formatin Excel, në mënyrë që strukturat spitalore të bëjnë planifikimin për sasi të barna dhe materiale mjekimi.
- Lista me brana dhe materiale mjekimi për përdorim spitalor për vitin 2022 është dërguar nga MSHMS me e-mail e datës 10.02.2022 në adresën e sektorit të planifikimit të SUT.
- Në përgjigje të kërkesës së grupit të auditimit të KLSH drejtuar strukturave përgjegjëse të SUT për listën e barnave për përdorim spitalor të miratuara nga MSH për vitet 2020-2022, SUT nëpërmjet e mail të datë 07.04.2023 përcolli listën në formatin Excel, *sic pasqyrohet në prnt.scr. nr.1 në aneksin 2.6.4.*

*****Njësia e prokurimit në SUT**, në cilësinë e hartuesit të specifikimeve teknike dhe përcaktimit të fondit limit duhej të përllogariste Fondin Limit për lotin 19 me çmimin e përcaktuar nga KCB pranë MSHMS dhe jo me çmimin për njësi **469.3 lekë** të përfituar nga studimi i tregut mbi bazën e ofertave të marra nga subjektet e sipërcituar.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit ka vepruar në mospërputhje me ligjin e barnave dhe akteve ligjore në fuqi për përllogaritjen e fondit limit për lotin 19.

¹ Komisioni Çmimit të Barit

Konkluzion:

Njësia e prokurimit gjate përlllogaritjes se Fondit limit për këtë procedurë, nuk është bazuar tek cimet e përcaktuara nga komisioni i çmimeve për barnat për listën e miratuara të barnave për përdorim spitalor. Si rezultat ka vepruar në mospërputhje me ligjin 105/2014 për barnat dhe shërbimin farmaceutik dhe LPP.

Hartimi i Specifikimeve teknike:

Njësia e prokurimit ka hartuar specifikimet teknike për 19 lotet mbi bazën e specifikimeve teknike të mëparshme të përcaktuara nga grupi i punës në procedurën e anuluar me të njëjtin objekt prokurimi, duke ndryshuar vetëm specifikimet teknike për lotin 19, të pasqyruara në shkresën nr. 62/4 Prot., datë 11.08.2022.

- Njësia e prokurimit në formularin e specifikimeve teknike për lotin 19 në dokumentat e tenderit për barin me princip aktiv Nadroparine Calcium ka bërë shënimin që ky bar “nuk është pjese e listës” së barna për përdorim spitalor të miratuar nga MSHMS, gjithashtu tek specifikimet teknike të këtij bari, AK nuk ka vendosur vetëm princip aktiv të Nadroparinës por edhe emrin tregtar Faxiparin, pra ka kërkuar nga ofertuesit pjesëmarrës në tender me emrin **Faxiparin**/Nadroparine Calcium, duke vepruar në mospërputhje me LPP dhe akteve nënligjore

Nga auditimi rezulton se:

- Në listën e barnave për përdorim spitalor të miratura nga MSHMS për vitin 2022, bari me princip aktiv Nadroparine Calcium me formë dozë 5700 IU Axa/0.6ml është bar i regjistruar dhe pjesë e kësaj liste.
- OE F.F. ka paraqitur ofertë për barin me principin aktiv Nadroparine Calcium me formë dozë 5700 IU Axa/0.6ml për njësi (një shiringë parapërgatitur) në shumën 455 lekë pa TVSH.
- Anëtarët e Njesisë së prokurimit të AK, SUT., kanë përcaktuar fondin limit për barin tregtar Fraxiparine, nga studimi i tregut, duke mos marrë parasysh çmimin e përcaktuar nga KCB në MSHMS si i vetmi komision ligjor për përcaktimin e çmimeve të barnave të listës së barnave për përdorim spitalor.
- OE Florifarma ka ofertuar për barin Faksiparine i cili ka për princip aktiv Nadroparine Calciumi çmimin për njësi 455 lekë (një shiringë e parapërgatitur), ndërkohë që ky çmim duhej të ishte 434,7 lekë dhe vlera totale e kontratës për 50000 copë duhej të ishte **21,738,745 leke**.
- Pasi ne referim të shkresës nr.1775/3 prot datë 29.06.2023 të MSHMS çmimi CIF për për barin Faksiparine me princip aktiv Nadroparine Calciumi është 3.5 euro per shiring.
- Ne datën 31.08.2023 që është zhvilluar procedura, kursi i këmbimit zyrtar për 1 euro ka qënë 117.19 leke.

	<p>- Ne zbatim te VKM nr.143 date 18.02.2015 “Për përcaktimin e marzheve të tregtimit dhe fabrikimit të barnave” për grupin “Gjaku dhe organet formuese te gjakut” në të cilën bënë pjesë dhe bari me princip aktiv Nadroparine Calciumi është përcaktuar nje marzh fitimi 6 %.</p> <p>vlera e kontratës duhej të ishte: $(3.5*117.19)*1.06=434.7$ leke (nje shiring) $434.7*50,000$ shiringa=<u>21,738,745 leke</u> AK., SUT pas shpalljes fitues nga KVO, ka lidhur kontratë me OE FloriFarma për sasin 50,000 copë (shiringa të parapërgatitura) në shumën <u>22,750,000 lekë.</u></p> <p>- Për sa më lart, shuma prej <u>1,011,255 lekë</u>, e cila përfaqëson përfaqëson diferencën e çmimit të ofertuar dhe të shpallur fitues me atë të përcaktuar nga KCB të MSHMS përbën dëm ekonomik shkatuar buxhetit të SUT.</p>
Kriteri:	Neni 38 të ligjit 105/2014 për barnat dhe shërbimin farmaceutik. Lista e miratuar e barnave për përdorim spitalor për vitin 2022 nga MSHMS. neni 4, pika 38/b dhe neni 36, pika 3/b të LPP, si dhe neni 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” VKM nr.143 date 18.02.2015 “Për përcaktimin e marzheve të tregtimit dhe fabrikimit të barnave” për grupin “Gjaku dhe organet formuese te gjakut”.
Ndikimi:	Rritje artificiale e Fondit Limit për lotin 19 të kësaj procedure. Paracaktim i emërit tregtar të barit të kërkuar nga autoriteti Kontraktor SUT duke deformuar konkurrencën në treg.
Shkaku	Mos respektim i përcaktimeve të ligjit të barnave dhe listës se miratuar nga MSHMS. Mos respektim LPP dhe akteve nënligjore të prokurimeve publike.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Drejtuesi i institucionit të Spitalit Universitar të Traumës, të analizoj veprimtarinë e njësisë së prokurimit për këtë procedurë dhe kryesisht të komisionit të përcaktimit të specifikimeve teknike dhe të përlllogaritjes së fondit limit për barin me princip aktiv Nadroparine Calciumi dhe të nxjerr përgjegjesitë për secilin prej anëtarëve të këtij komisioni, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e shumës prej <u>1,011,255 lekë</u> nga OE F.F.

Me veprimet apo mos veprimet ngarkohen me përgjegjësi, V. A., G. H., M. S. në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit dhe hartues të specifikimeve teknike për lotin 19.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.1375/3 prot, datë 04.07.2023 “Observacion për projekt raportin me nr.1199/10” nga Z. G. H., M. M., M. S. dhe R. J. ku janë shprehur kundërshtimet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Në mënyrë të përmbledhur observacioni konsiston në, e citoj:

1.Në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet përsa i përket specifikimeve teknike dhe argumentimit të fondit limit, grupet e punës në SUT do të kenë parasysh që të korrigjohet praktika e ndjekur e zhvillimit të procedurave të prokurimit në përputhje me listat e miratuara me specifikime teknike dhe çmime të përcaktuara nga MSHMS si organ qëndror. Të gjendur përpara faktit se specifikimet teknike dhe çmimet

e barnave janë të monitoruara dhe miratuara nga MSHMS, gjykojmë se nuk ka patur shkelje të konkurrencës në treg pasi është zhvilluar një procedurë e hapur konform rregullave të prokurimit publik. Në këtë procedurë prokurimi nuk ka patur asnjë ankesë nga OE të interesuar dhe në katër lote (nga 19 në total) janë shpallur të suksesshëm OE të ndryshëm të cilët operojnë në tregun shqiptar dhe kanë kontrata furnizimi të vazhdueshme me SUT dhe institucione të tjera spitalore në RSH.

Njësia e prokurimit kanë zhvilluar procedurat e prokurimit me qëllim furnizimin sa më parë me barna sipas kërkesave të Shërbimeve mjekësore dhe zyrës së planifikimit në SUT.

Të gjendur në kushtet kur këto procedura zhvillohen ndër vite nga MSHMS, njësia e prokurimit nuk ka patur informacionin e duhur në përcaktimin e specifikimeve teknike duke bërë një gabim njerëzor duke vendosur emrin tregtar Fraxiparinë por kjo nuk ka ndikuar në kufizimin e konkurrencës pasi asnjë OE nuk ka paraqitur ankesë dhe vetë APP nuk ka sjellë rekomandime në korigjimin e gabimeve në dokumentet e tenderit.

Për me tepër medikamenti me princip aktiv "Nadroparine Calcium me forme dozë Solution for injection x 5700 IU Axa/0.6ml" ekziston vetëm një në Republikën e Shqipërisë dhe ky është Fraxiparine.

Për shkak të këtij gabimi njerëzor nuk është e mundur të limitohet konkurrenca pasi nuk ekziston një medikament tjetër në RSH me këtë princip aktiv dhe rrjedhimisht nuk ka konkurrence në treg persa i përket këtij medikamenti.

Zhvillimi i testimit të tregut për Lotin nr. 19 (Nadroparinë Calcium) është bërë duke u mbështetur në legjislacionin e prokurimit publik pasi njësia e prokurimit nuk ka pasur informacion mbi çmimin e miratuar nga MSHMS, tregu i barnave është i rregulluar me ligj të veçantë dhe Operatorët ekonomikë nuk mund të ofertojnë një çmim me marzh fitimi më të lartë se ai i aprovuar pasi në të kundërt do të penalizohen sipas ligjit dhe qëllimi i vetëm ka qenë furnizimi në një kohë sa më të shkurtër me medikamentet e kërkuara.

Këto dy gjetje do të korigjohen në procedurat në vazhdim (në rast se do të zhvillohen nga vetë AK) duke patur parasysh rekomandimet e bëra nga ana juaj. Për sa më sipër, ju lutemi të rishikoni qëndrimin tuaj në raportin përfundimtar.

2.Në lidhje me gjetjet dhe masat për shpërbllim dëmi po ju informojmë se MSHMS ka ridërguar shkresë "Informacion" në lidhje me çmimin e miratuar të barit "Nadroparinë Calcium".

Sipas shkresës me nr. 1775/3 Prot., datë 29.06.2023 e dërguar nga MSHMS (bashkangjitur këtyre observacioneve), rezulton se çmimi për njësi i miratuar për barin "Nadroparinë Calcium" është 449.5530667 lekë. Për sa më sipër, ju lutemi të rishikoni qëndrimin tuaj në raportin përfundimtar.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Grupi i auditimit gjatë fazës së projekt Raportit për këtë çështje është shprehur që do të merrte në konsiderat rivlerësimin e çmimit për njësi për barin me princip aktiv nadroparine calcium, i cili është reflektuar në materialin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Megjithese në observacionin perkatës për këtë çështje, subjekti i audituar i referohet shkresës nr.1775/3 prot. Datë 29.06.2023 të MSHMS, duke pretenduar që është bashkëlidhur observacionit.

Meqëse kjo shkresë referohej por mungonte bashkëlidhur observacionit, grupi i auditimit ka informuar nëpërmjet e-mail te datës 10.07.2023 Titullarin e institucionit të SUT.

Ne përgjigje te e mail te sipërcituar zv.Drejtori ekonomik ka dërguar e mail me përmbajtjen, e citoj:

Në përgjigje të e-mailit të dërguar nga ana juaj, lidhur me mungesën e shkresës me objekt "Informacion" të MSHMS - nr.1775/3 datë 29.06.2023, ju njoftojmë se gabimisht është mbajtur nga Sektori i Sekretarisë në kopjen që administrohet në këtë sektor. Ndodhur në këto kushte, bashkëlidhur po ju dërgojmë të skanuar observacionin nr. 1375/3 Prot. datë 04.07.2023, së bashku me praktikën (përfshirë edhe shkresa nr. 1775/3 prot., datë 29.06.2023 e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale).

Pas marrjes se informacionit zyrtar nga MSHMS, Grupi i auditimit të KLSH, ka bërë rivlerësimin e çmimit për njësi për fraxiparinën duke e pasqyruar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

*****Lidhur me planifikimin e sasisë** të barit me princip aktiv Nadroparine Calcium me formë dozë 5700 IU Axa/0.6ml në sasine 50,000 shiringa të parapërgatitura, konstatohet se nga auditimi i evidencës dokumentare të planifikimit të barnave për vitin 2022, nuk evidentohet kërkesa nga shërbimet e SUT për këtë sasi.

Hartimi i dokumenteve të tenderit

DST janë hartuar nga Njësia e prokurimit më datë 15.08.2022 për procedurën e prokurimit – Procedurë e Hapur - me objekt " Furnizim me barna për nevojat e SUT, e ndarë në lote" Marrëveshje Kuadër me disa Operatore Ekonomike ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara (një OE për secilin lot), për një periudhë 24 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Kjo procedurë është shpallur me Nr. REF-38683-08-15-2022, nëpërmjet formularit të njoftimit të kontratës së shpallur nr. 62/7 Prot., datës 15.08.2022

Zhvillimi i procedurës

Anëtarët e KVO-së, më datë 31.08.2022 ora 10:00, kanë bërë hapjen e procedurës në sistem elektronik të prokurimeve, nga ku ka rezultuar se kishte 4 (katër) OE pjesëmarrës të paraqitur si më poshtë:

1. OE "V." SHPK për **lotin 2** me ofertë ekonomike: 410,300 Lekë pa TVSH.
2. OE "R. F." SHPK për **lotin 10** me oferte ekonomike: 187,285 Leke pa TVSH.
3. OE "F." SHPK për **lotin 16** me ofertë ekonomike: 320,000 Lekë pa TVSH.
4. OE "F." SHPK për **lotin 19** me ofertë ekonomike: 22,750,000 Lekë pa TVSH.

*****Referuar raportit përmbledhës të KVO nr. 62/14 Prot., datë 02.09.2022**, për 15 lotet e tjera përveç lotëve 2, 10, 16 dhe 19 në këtë procedurë nuk është paraqitur ofertë ekonomike.

Sipas këtij raporti KVO , ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE të mëposhtëm:

OE "V." SHPK për lotin 2 me ofertë ekonomike 410,300 Lekë pa TVSH;

OE "R.F." SHPK për lotin 10 me oferte ekonomike 187,285 Leke pa TVSH;

OE "F." SHPK për lotin 16 me ofertë ekonomike: 320,000 Lekë pa TVSH;

OE "F." SHPK për lotin 19 me ofertë ekonomike: 22,750,000 Lekë pa TVSH.

Njoftimi i fituesit për Lotin 16 është bërë me shkresën nr. 62/8 Prot., datës 02.09.2022, për Lotin 19 me shkresën nr. 62/9 Prot., datës 02.09.2022, për lotin 10 me shkresën nr. 62/10 Prot., datës 02.09.2022 dhe për lotin 2 është bërë me shkresën nr. 62/11 Prot., datës 02.09.2022

Formulari i Njoftimit të Anulimit për 15 (pesëmbëdhjetë) lotet është bërë me shkresën nr. 62/12 Prot., datë 02.09.2022.

Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në SEP për lotin 10, rezultoi që nuk kishte parregullesi në lidhje me kualifikimin dhe shpalljen fitues të OE "R.Farma".

Për tre lotët e tjera respektivisht 2, 16 dhe 19 zhvillimi i procedurës paraqitet si më poshtë:

Loti nr. 2.

Sipas Raporti Përmbledhës të KVO dhe formularit të njoftimit të fituesit, rezulton se:

Në Lotin nr. 2 për barin "Levofloxacin " ka marrë pjesë vetëm 1(një) operator ekonomik dhe është kualifikuar dhe shpallur fitues, OE V., sic paraqitet në tabelën e mëposhtëme:

Nr.	Subjekti	Oferta	Kualifikuar/Skualifikuar
1	V.	410,300	Kualifikuar dhe shpallur fitues

*****Lidhur me OE të shpallur fitues V.**, pavarësisht se është oferta e vetme ekonomike, rezulton se ky OE nuk i plotëson të gjitha kriteret e DST, duke u kualifikuar dhe shpallur fitues me pa të drejt nga ana e KVO-së dhe titullarit të AK dhe konkretisht:

AK në DST tek “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.2 “Kandidati/ofertuesi duhet të duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë prej 20% të vlerës së fondit limit/ vlerës së pritshme të kontratave, të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës të kësaj procedure prokurimi.

... Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Titulli i gjetjes:	OE Viniphara është kualifikuar dhe shpallur fitues në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të vendosura nga AK., në DST.
Situata:	<p>Nga auditimi i procedurës së prokurimit për lotin 2, rezultoi që dokumentacioni i ngarkuar në SEP, nga OE Vinipharma kishte mangësi dhe nuk plotësonte kriteret e vendosura nga AK., SUT, të cilat paraqiten si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. OE V. ka ngarkuar në SEP si eksperiencia të ngjashme fatura tatimore shitje me subjekte private. Në faturën tatimore të shitjes nr.2079/2021 për vlerën 373,774 lekë për palën blerëse subjektin C. P., gjendet bari Levofloxacin në vlerën 7,403 lekë, kjo shumë e këtij bari rezulton të jetë më e vogël se 20% i vlerës së fondit limit të kërkuar nga AK në DST në kriterin 2.3.2 tek kriteret e veçanta 2. Faturat e tjerat tatimore të shitjes që ka ngarkuar OE V. në SEP nuk kanë barin me principin aktiv Levofloxacin apo anti-infektivë të përgjithshëm të së njëjtës familje apo grup familje. 3. Autorizimi për tregtim nr.1785/1 Prot. datë 20.04.2018 lëshuar nga AKBPM për barin Lexacin me princip aktiv Levofloksacin hemihidrati nuk është i vlefshëm pasi ai ka përfunduar në muajin Prill të vitit 2019. 4. OE V. nuk e ka regjistruar këtë bar pranë AKBPM, kjo në mospërputhje me piken 4 të kriterit 2.3. të DST. <p>Në këto kushte OE Vinipharma nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi për këtë lot duhet të ishte anuluar. Titullari nuk duhet të kishte miratuar dhe shpallur fitues OE “V.”.</p> <p><u>Konkluzion:</u> Kualifikimi dhe shpallja fitues nga KVO, i shoqërisë “V.” është në kushtet e mos plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk ky OE nuk plotëson disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte anuluar procedurën për këtë lot dhe tenderi duhej të ishte rishpallur, si dhe vlera e kontraktuar prej 410,300 lekë do të konsiderohet si prokurim i fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet (3-E^{-të}).</p>
Kriteri:	Ligji 162, datë 23.12.2020, pika 3, neni 92 “Për prokurimin publik”
Ndikimi:	Rritje te shpenzimeve jo efektive
Shkaku	Mos respektim i LPP dhe akteve nenligjore te tij
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Drejtoria e Spitalit Universitar të Traumës të analizoj këtë procedurë dhe të marrë masa për anëtarët e KVO të cilët kanë vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor

në fushën e prokurimeve publike, duke rritur shpenzimet pa efektivitet të buxhetit të SUT në shumën **410,300 lekë**.

Për sa më lart, ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga, Z.A. C. në cilësinë e kryetarit të KVO, Znj. R. J. dhe Znj. M. M. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor Znj. E. B.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.1375/3 prot, datë 04.07.2023 “Observacion për projekt raportin e auditimit me nr. 1199/10” nga Z. G. H., M. M., M. S. dhe R. J. ku janë shprehur kundërshtimet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Në mënyrë të përmbledhur observacioni konsiston në, e citoj:

...KVO ka vepruar ne përputhje me legjislacionin e prokurimeve, pasi në klasën e antibiotikeve, OE ka paraqitur shitje për “Lexacin eye drop solution” me përbërës aktiv “Levofloxacin” dhe “ Erbenz gel tubex” me përbërës aktiv”Ertromicin”..

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Në lidhje me observacionin për këtë pikë, AK nuk ka paraqitur dokumentacion të panjohurë më parë nga grupi i auditimit, artikujt e faturës tatimore të shitur nga OE V. për një subjekt tjetër privat nuk janë pjesë e familjes së barit Levofloxacin, prandaj observacioni për këtë pikë nuk do të merret në konsideratë.

Loti nr.16.

Titulli i gjetjes:	OE F. është kualifikuar dhe shpallur fitues në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të vendosura nga AK., në DST.
Situata:	Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në SEP nga OE F. për Lotin 16 rezultoi se: OE F. nuk ka paraqitur autorizimin e regjistrimit pranë AKBPM për barin me princip aktiv Hydrocortizone 100 mg. Në këto kushte KVO, nuk duhej ta kualifikonte dhe shpallte fitues OE F., sepse ky OE nuk plotëson disa nga kriteret e DST. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte anuluar procedurën për këtë lot dhe tenderi duhej të ishte rishpallur. Vlera e kontraktuar nga AK., SUT në shumën 320,000 lekë do të konsiderohet nga grupi i auditimit të KLSH, si një prokurim i fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E ^{te}). KVO me kualifikimin dhe shpalljen fitues të OE F. ka vepruar në kundërshtim me ligjin 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”.
Kriteri:	Ligji 162, datë 23.12.2020, pika 3, neni 92 “Për prokurimin publik”
Ndikimi:	Rritje te shpenzimeve jo efektive
Shkaku	Mos respektim i LPP dhe akteve nenligjore te tij
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Drejtoria e Spitalit Universitar të Traumës të analizoj këtë procedurë dhe të marrë masa për anëtarët e KVO të cilët kanë vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, duke rritur shpenzimet pa efektivitet të buxhetit të SUT në shumën 320,000 lekë .

Për sa më lart, ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: Z. A. C. në cilësinë e kryetarit të KVO, Znj.R. J. dhe Znj. M. M. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor znj. E. B.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.1375/3 prot, datë 04.07.2023 “Observacion për projekt raportin e auditimit me nr. 1199/10” nga Z. G. H.,M. M., M. S. dhe R. J. ku janë shprehur kundërshtimet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Në mënyrë të përmbledhur observacioni konsiston në, e citoj:

KVO ka vepruar ne përputhje me legjislacionin e prokurimit publik, pasi ne dokumentete tenderit eshte kërkuar nje deklarat per barna e paregjistruara, deklarat e cila eshte paraqitur nga OE ne sistemin elektronik.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Nga auditimi i SEP rezultoi se OE F. nuk ka paraqitur autorizimin e regjistrimit pranë AKBPM për barin me princip aktiv Hydrocortizone 100 mg. Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë, KVO duhet të kishte anuluar procedurën për këtë lot dhe tenderi duhej të ishte rishpallur, prandaj observacioni për këtë pikë nuk do të merret në konsiderat.

Për sa më lart, ngarkon me përgjegjësi anëtarët e njësisë së prokurimit të përbërë nga V. A, G. H. M. S. dhe titullarin e institucionit znj. E. B. në cilësinë e titullarit miratues të procedurës.

Titulli i gjetjes:	Mos respektim i kushteve të marrëveshjes kuadër nga OE i shpallur fitues
Situata:	Për lotin nr. 16., OE F. i shpallur fitues dhe nënshkruer i MK nr. 62/15 Prot., datë 13.09.2022 nuk ka pranuar të jap ofertë mbi bazën e kërkesës së AK duke bërë që SUT të mos furnizohej me medikamentin e kërkuar në Lotin 16. Në DST është përcaktuar që OE duhet të paraqesin sigurimin e Ofertës në shumën 2% të ofertës së paraqitur. Mos nënshkrimi i kontratës së furnizimit nga ana e OE përbën mosrealizim të saj, në këto kushte AK i lind e drejta e mbajtjes së shumës së sigurimit të Ofertës. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se, AK nuk e ka njoftuar OE dhe kompaninë e sigurimeve për të transferuar në llogarinë e SUT shumën e siguruar si garanci pranë kësaj kompanie sigurimesh. Për sa më lart, shuma prej <u>6,600 lekë</u> do të konsiderohet dëm ekonomik i shkaktuar për buxhetin e Shtetit.
Kriteri:	MK nr. 62/15 Prot., datë 13.09.2022
Ndikimi:	Mos furnizimi me medikamentet e kërkuara
Shkaku	Mos respektim i detyrimeve kontraktuale nga kontraktuesi
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtoria e Spitalit Universitar të Traumës të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e shumës 6,600 lekë nga përgjegjësi i sektorit të prokurimeve.

Për sa më lart, ngarkon me përgjegjësi z. G. H. në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të prokurimeve dhe znj.E. B. në cilësinë e Titullarit të Institucionit.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.1375/3 prot, datë 04.07.2023 “Observacion për projekt raportin e

auditimit me nr. 1199/10” pika 3., nga Z. G. H., M. M., M. S. dhe R. J ku janë shprehur kundërshtimet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Në mënyrë të përmbledhur observacioni konsiston në, e citoj:

Në lidhje me anulimin e lotit nr. 16 “Hydrocortisone sodium succinate” të shpallur si fitues OE F. Shpk, kemi sqaruar faktin se ky lot është anuluar pasi AK me iniciativën e tij ka vendosur anulimin më qëllim mirëmenaxhimin e fondeve dhe përdorimin e këtyre fondeve për medikamente të tjera pasi për këtë medikament ka zëvendësues të tjerë që përdoren. AK nuk ka pritur që OE të regjistrojë barin dhe të nënshkruajë kontratën e furnizimit dhe për këtë arsye nuk është penalizuar operatori ekonomik duke i mbajtur sigurimin e ofertës.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Mos nënshkrimi i kontratës së furnizimit nga ana e OE përbën mosrealizim të saj, në këto kushte AK i lind e drejta e mbajtjes së shumës së sigurimit të Ofertës, por nga sa paraqitet ne observacion ne lidhje me kete çështje, grupi i auditimit e pranon ate dhe do ta reflektoj ne materialin e auditimit.

Monitorimi i marrëveshjes kuadër:

Me nr. 62/15 Prot., datë 13.09.2022, është protokolluar Marrëveshja Kuadër për objekt: “Furnizim me barna për nevojat e SUT, e ndarë në lote” Marrëveshje Kuadër Mallra ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 24 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër mes SUT dhe OE: “V.” SHPK për Lotin 2, “R. F.” SHPK për Lotin 10 dhe “F.” SHPK për Lotin 16 dhe 19. Komisioni i Posaçëm për Monitorimin dhe Zbatimin e Marrëveshjes Kuadër i ngritur me Urdhrin nr. 62/16 Prot., datë 13.09.2022, përbehej nga: A. C., V. A.j, S. Gj., M. P. dhe E.K.

Lidhja e minikontratave:

Përgjegjësi i sektorit të prokurimeve Znj.M. M.me shkresën nr. 588 Prot., datë 14.09.2022, drejtuar Përgjegjësit të sektorit të prokurimeve Z.G. H.j me objekt: Kërkesë për lidhje minikontratë nr.1/2022 për MK nr. 62/15 date 13.09.2022 për blerjen e barna mjekësore për një periudhë 24 mujore, bazuar në kërkesën e grupit të monitorimit të MK me shkresë nr. 587 Prot. datë 14.09.2022, ka kërkuar lidhjen e minikontratës nr.1 me vlerë 11,833,729.5 leke pa TVSh.

Brenda periudhe së auditimit për këtë MK janë lidhur kontrata për Lotin 19, 10 dhe 2 siç pasqyrohen në tabelën nr.3

Tabela nr.3. Kontratat e lidhura për periudhën në auditim

Minikontrata	Nr. Prot dhe date	Vlera pa TVSH
1 Loti 19	Nr. 62/19 Prot., Datë 14.09.2022	11,375,000
1 Loti 10	Nr. 62/23 Prot., Datë 28.09.2022	93,642.5
1 Loti 2	Nr. 62/27 Prot., Datë 12.10.2022	205,150
Totali leke pa TVSH		11,673,793

2.6.5. Procedura e prokurimit Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimet mjekësore Neurokirurgji, K. Vazale, K. Maksilofaciale, K. Retinale

Në zbatim të pikës 6 të programit të auditimit Nr. 1199/1 Prot. Date 13.01.2023 u shqyrtua dokumentacioni i procedurës së prokurimit publik të vitit 2022 me objekt: Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimet mjekësore Neurokirurgji, K. Vazale, K. Maksilofaciale, K. Retinale, e ndarë në katër lote, Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (një operator një lot) ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 24 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër -REF-82886-12-22-2020

1.Urdhër Prokurimi Nr.80 Datë 21.12.2020	3.Njësia e prokurimit V. H. G.H. R.J.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 70/1 datë 03.10.2022 V.R. M.Xh. I. H. L. B. M. S.
2. “Procedurë e hapur”		
5.Fondi Limit (pa tvsh) LOTI 1 - 140,550,903 lekë LOTI 2 - 3,200,347 lekë LOTI 3 - 25,964,587 lekë LOTI 4 - 6,316,200 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) LOTI 1 - 139,876,540 lekë LOTI 2 - 3,144,800 lekë LOTI 3 - 25,839,520 lekë LOTI 4 - anuluar	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) LOTI 1 – 674,363 lekë LOTI 2 – 55,547 lekë LOTI 3 – 125,067 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 15.01.2021 Ora:10:00	9.Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit (Ministria e Mbrojtjes)	10.Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender: 1 (një) OE b) Kualifikuar 1 (një) OE
11.Ankimime: Jo		

Hartimi i specifikime teknike:

Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike për Neurokirurgjinë, i ngritur me urdhrin nr.57 datë 18.09.2020, përbëhej nga, F. O., I. H. dhe A.S.Ndërsa grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike për Kirurgjisë Vazale i ngritur me urdhrin nr.58 datë 22.09.2020, përbëhej nga: M. Xh., B. P. dhe E. Sh. Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike për Kirurgjisë Maxilofaciale i ngritur me urdher nr.58/1 datë 22.09.2020, përbëhej nga, M. S., L. B. dhe A. T.

Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike për Kirurgjisë Vitreo Retinale i ngritur me urdhrin nr.48 datë 03.08.2020, përbëhej nga, E. V., B. K. dhe I. P.

Specifikimet teknike sipas shërbimeve të sipërcituara janë hartuar nga grupet respektive me shkresat: Nr. 57/1 Prot., datë 25.09.2020, nr. 58/2 Prot., datë 25.09.2020, nr. 58/3 Prot., datë 25.09.2020 dhe nr. 48/1 Prot., datë 10.08.2020 të cilët kanë përcaktuar dhe sasitë e nevojshme për një periudhë dy vjeçare për shërbimin e Neurokirurgjisë dhe Kirurgjisë Maxilofaciale ndërsa për Kirurgjisë Vitreo Retinale 12 muaj.

Llogaritja e Fondit limit:

Grupi për llogaritjen e fondit limit është ngritur me urdhrin nr. 57/2 Prot., datë 25.09.2020 për Shërbimin e Neurokirurgjisë.

Për Shërbimin e Kirurgjinë Maxilofaciale dhe Kirurgjisë Vazale grupi i përllogaritjes së FL është ngritur me urdhrin nr. 57/4 Prot., datë 25.09.2020 .

për Shërbimin e Kirurgjisë Vitreo Retinale grupi i përllogaritjes së FL është ngritur me urdhrin nr. 48/2 Prot., datë 10.08.2020 .

Grupi për llogaritjen e FL në të tre urdhrat e mësipërm përbëhej nga:

Zh. H., A.D., R. J.

Për llogaritjen e FL, grupi i punës sipas shërbimeve më datë 29.05.2020 për Neurokirurgjinë ka marrë oferta nga OE E., OE G. dhe OE O.E.S. D.

Për Kirurgjinë Maxilofaciale dhe Kirurgjinë Vazale ka marrë oferta nga OE E., OE G., OE G.F. dhe OE O.E.S. D.

Për Kirurgjinë Vitreo Retinale më datë 10.08.2020 ka marrë oferta nga OE F.-N., OE M. dhe OE G.-. F. Mbi bazën e ofertave të marra nga OE të sipërcituar, Fondi limit sipas sasive të pritshme për një periudhë 24 mujore është përllogaritur në vlerën 176,032,037 Lekë pa Tvsh dhe i ndarë sipas lotëve:

Loti I. “Blerje materiale mjekimi për Shërbimin e neurokirurgjisë në SUT”, me fond limit: 140,550,903 lekë pa Tvsh.

Loti II. “Blerje materiale mjekimi për shërbimin e kirurgjisë maxilofaciale në SUT”, me fond limit: 3,200,347 lekë pa Tvsh.

Loti III. “Blerje materiale mjekimi për shërbimin e kirurgjisë vazale në SUT”, me fond limit: 25,964,587 lekë pa TVSH.

Loti IV. “Blerje materiale kirurgjia vitreo-retinale në SUT”, me fond limit: 6,316,200 lekë pa Tvsh.

Nga administrimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konstatohet se:

Në përgjigje të kërkesës së SUT nr. 2060 Prot., datë 20.10.2020, për zhvillimin e procedurës me prokurim të përqendruar drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e cila me shkresën nr. 4754/1 Prot., datë 27.11.2020 ka autorizuar SUT për kryerjen e prokurimit për një periudhë 24 mujore.

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Anëtarët e njësisë së prokurimit më datë 22.12.2020, kanë hartuar dhe miratuar dokumentet e shpalljes së procedurës së prokurimit:

Procedure e hapur - me objekt “Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimet mjekësore (Neurokirurgji, K. Vazale, K. Maksilofaciale, K. Retinale) për SUT” e ndarë në katër lote”, Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (një operator një lot) ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 24 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Kjo procedurë është e shpallur me nr. reference: **REF-82886-12-22-2020**

Loti nr. 1 REF-82888-12-22-2020; Loti nr. 2 REF-82890-12-22-2020; Loti nr. 3 REF-82892-12-22-2020 dhe Loti nr. 4 REF-82894-12-22-2020

Formulari i Njoftimit të Kontratës së Shpallur nr. 80/2 Prot., datës 22.12.2020 .

Zhvillimi i procedurës:

Anëtarët e KVO-së më datë 15.01.2021 ora 10:00, kanë bërë hapjen e procedurës së prokurimit në sistemin elektronik të prokurimeve.

Sipas raportit përmbledhës së KVO konstatohet se, në këtë procedurë sipas lotëve respektive paraqitën ofertë ekonomike OE si më poshtë:

Për Lotin1: OE “O.E.S. D.” me oferte ekonomike 139,876,540 Lekë pa TVSH

Për lotin 2 : OE “O.E.S. D.” me ofertë ekonomike 3,144,800 Lekë pa TVSH

Për lotin 3: “O.E.S. D.” me ofertë ekonomike 25,839,520 Lekë pa TVSH.

Për Lotin 4: Nuk kishte paraqitur oferte asnjë OE

KVO pasi ka verifikuar dokumentacionin e ngarkuar në sistem ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues OE te mëposhtëm:

Loti 1. “O.E.S. D.” me oferte ekonomike **139,876,540** Lekë pa TVSH.

Loti 2. “O.E.S. D.” me oferte ekonomike: **3,144,800** Lekë pa TVSH.

Loti 3. “O.E.S. D.” me oferte ekonomike: **25,839,520** Lekë pa TVSH.

Formulari i njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm në marrëveshjen kuadër nr. 80/4 datë 28.01.2021 (loti 2 dhe 3) dhe 80/5 Prot. Date 09.02.2021 (loti 1) .

Me nr. 80/3 Prot., datë 28.01.2021, është protokolluar raporti përmbledhës për “Procedure e hapur - me objekt: “Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimet mjekësore (Neurokirurgji, K. Vazale, K. Maksilofaciale, K. Retinale) për SUT” e ndarë në katër lote”, Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (një operator një lot) ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 24 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër. Me nr. 80/6 Prot., datë 09.02.2021, është protokolluar Urdhri i Titullarit për Administrim Dokumentacioni dhe lidhje Kontrate.

Lidhja e marrëveshjes kuadër:

Me nr. 80/7 Prot., datë 15.02.2021, është protokolluar Marrëveshja Kuadër për objekt: “Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Neurokirurgjisë dhe Kirurgjisë Maxilofaciale në SUT”, Marrëveshje Kuadër me disa Operatorë Ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 24 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër midis SUT dhe OE “O.E.S. D.” me vlerën e fondit limit dhe me afat dy vjeçar.

Komisioni i monitorimit të marrëveshjes kuadër:

Komisioni i Posaçëm për Monitorimin dhe Zbatimin e Marrëveshjes Kuadër është ngritur me urdhrin nr. 80/8 Prot., datë 16.02.2021, dhe përbëhej nga:

Për Neurokirurgjinë Loti 1: F.O., I.H., A.S.

Për kirurgjinë maksilo-faciale loti 2: M. S., A. T., L. B.

Për kirurgjinë vazale loti 3: M. Xh., B. P., E.Sh.

Me nr. 80/18 Prot., datë 18.05.2021 dhe urdhrin nr. 80/8 Prot., datë 16.02.2021 është bërë ndryshimi i anëtarit të komisionit të monitorimit për lotin 2 ku znj. L. B. është zëvendësuar me Znj. M.P. dhe për lotin 3 Znj. E.Sh. është zëvendësuar me Z. E. N. duke vijuar me ndryshimet të lotit 3 nëpërmjet urdhrin 80/25 Prot. Date 13.08.2021 duke zëvendësuar Znj. B. P. me Z. K.C.

Lidhja e minikontratave

Për këtë procedurë janë lidhur në total 16 minikontrata (dhjetë për Lotin 1; tre për Lotin 2 dhe tre për Lotin 3) gjatë vitit 2021 dhe vitit 2022 sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Minikontrata	Vlerat e kontratave
1	Lidhja e kontratës Nr.1 (Loti 1) Nr.80/11 Prot., Datë 26.02.2021	19,620,936
2	Lidhja e kontratës Nr.1 (Loti 2) Nr.80/14 Prot., Datë 02.03.2021	1,752,080
3	Lidhja e kontratës Nr.1 (Loti 3) Nr.80/17 Prot., Datë 09.03.2021	7,230,220
4	Lidhja e kontratës Nr.2 (Loti 1) Nr.80/21 Prot., Datë 26.05.2021	20,095,470
5	Lidhja e kontratës Nr.3 (Loti 1) Nr.80/24 Prot., Datë 23.07.2021	9,961,510
6	Lidhja e kontratës Nr.4 (Loti 1) Nr.80/28 Prot., Datë 16.09.2021	9,923,870
7	Lidhja e kontratës Nr.5 (Loti 1) Nr.80/31 Prot., Datë 18.11.2021	9,976,170
8	Lidhja e kontratës Nr.6 (Loti 1) Nr.80/34 Prot., Datë 28.12.2021	6,467,470
9	Lidhja e kontratës Nr.2 (Loti 3) Nr.80/37 Prot., Datë 29.12.2021	3,254,816
10	Lidhja e kontratës Nr.7 (Loti 1) Nr.80/40 Prot., Datë 17.03.2022	9,980,850
11	Lidhja e kontratës Nr.2 (Loti 2) Nr.80/43 Prot., Datë 23.03.2022	1,042,800
12	Lidhja e kontratës Nr.8 (Loti 1) Nr.80/48 Prot., Datë 21.04.2022	10,080,040
13	Lidhja e kontratës Nr.9 (Loti 1) Nr.80/52 Prot., Datë 02.06.2022	20,009,110
14	Lidhja e kontratës Nr.3 (Loti 2) Nr.80/56 Prot., Datë 04.08.2022	455,400
15	Lidhja e kontratës Nr.10 (Loti 1) Nr.80/60 Prot., Datë 08.09.2022	27,858,286
16	Lidhja e kontratës Nr. 3 (Loti 3) Nr.80/63 Prot., Datë 21.10.2022	18,573,954
Totali:		176,282,982

Realizimi i kontratave

Grupi i auditimit zgjodhi në mënyrë rastësore praktikën e realizuar për kontratën e lidhur nr.80/56 datë 04.08.2022, Kontratën nr.80/11 date 26.02.2021 dhe kontratën nr.80/21 date 26.05.2021.

Në zbatim të kushteve të kontratës, malli i dorëzuar nga OE kontraktues është marrë në dorëzim nga komisioni i pritjes, brenda periudhës në auditim (31.01.2021-15.06.2022) me **urdhrin nr.103 Prot. Date 25.01.2018**. Përcaktimi i datës 15.06.2022 është pasi Titullari i institucionit ka nxjerr Urdhrin nr. 317 Prot., datë 15.06.2022, për krijimin e komisionit të pritjes dhe marrjes në dorëzim të vlerave materiale me të cilat do të furnizohet SUT për vitin 2021 e në vazhdim.

Titulli i gjetjes:	Mungesa e implementimit efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në SUT.
Situata:	<p>Nga auditimi konstatohet se:</p> <p>Komisioni i pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit, për kontratat e mësipërme dhe ato në vazhdim të kësaj Marrëveshje kuadër i referohet urdhrin nr.103 datë 25.01.2018 ndërkohë që furnizimi për këto kontrata është gjatë vitit 2021 dhe 2022.</p> <p>Për periudhën nga 01.01.2021–15.06.2022 drejtuesit respektiv të SUT nuk kanë ngritur komision të pritjes dhe marrjes në dorëzim për mallrat që ata kanë prokuruar.</p> <p>Në pikëpamjen formale urdhri nr.103 datë 25.01.2018 dhe nr. 317 Prot., datë 15.06.2022, nuk bazohen në akte ligjore në fuqi, pasi i referohen ligjit nr. 6942 date 15.12.1984 dhe VKM nr.70 datë 11.03.1985 të shfuqizuara.</p> <p>Për sa më lart, mungesa e identifikimit dhe zbatimit të akteve ligjore në fuqi, tregon që në SUT mungon kontrolli i brendshëm, duke e bërë jo efektiv zbatimin ligjit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin (MFK) nga strukturat përgjegjëse drejtuese në SUT.</p>
Kriteri:	Regullore e brendshme e SUT, Ligji mbi MFK
Ndikimi:	Mungese e kontrollit të brendshëm institucional
Shkaku	Mungesa e monitorimit dhe kontrollit gjatë fazës së hartimit dhe emetimit të dokumentacionit administrativ nga strukturat përgjegjëse pranë SUT.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Nga Drejtorja e SUT, të kërkohet që aktet administrative, të miratohen paraprakisht nga sektori juridik për të garantuar përputhshmërinë e bazës ligjore në fuqi mbi të cilën mbështeten aktet administrative të emetuara nga titullari i institucionit.

Me veprimet dhe mos veprimet, ngarkojnë me përgjegjësi Titullarin e Institucionit znj. E. B. në cilësinë e nëpunësit autorizues (15.10.2021-vazhdim), znj. E. R. në cilësinë e Nëpunësit zbatues (19.05.2022-vazhdim), A. B. (17.08.2013-05.05.2022) në cilësinë e Nëpunësit zbatues, Z.G. H. në cilësinë e shefit të sektorit të prokurimeve.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.1375/9 prot, datë 04.07.2023 nga Z. B. T.

Pretendimet e subjektit:

Në mënyrë të përmbledhur observacioni konsiston në, e citoj:

...Konkretisht, në shpjegimet e dërguara tregohet momenti i fillimit të detyrës së z. B. T. në raport me momentin ku referohet se nuk është ngritur komision i pritjes dhe marrjes në dorëzim për mallrat që janë prokuruar për periudhën nga 01.01.2021-15.06.2022. Sqaroj edhe njëherë se z. B. T. nuk ka qenë punonjës në SUT gjatë kësaj periudhe. Marrëdhëniet e punës me këtë subjekt kanë filluar në datën 26.07.2022 në detyrën e Përgjegjësit të Sektorit Juridik.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Grupi i auditimit të KLSH e solli në vëmendje të strukturave përgjegjëse dhe drejtuese të SUT, hartimin dhe miratimin e akteve administrative të cilat rezultojnë me pasaktësi në pikëpamjen formale duke ritheksuar edhe njëherë mungesën e implementimit efektiv të MFK dhe për dhënë rekomandim që raste

të tilla të mos përsëriten, prandaj observacioni pranohet pjesërisht vetëm duke e shkarkuar nga përgjegjësia z.B. T.

2.6.6. Procedura e prokurimit (“Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Neurokirurgjisë dhe Kirurgjisë Maxilofaciale”)

Në zbatim të pikës 6 të programit të auditimit Nr. 1199/1 Prot. Datë 13.01.2023 u shqyrtua dokumentacioni i procedurës së prokurimit publik të vitit 2022 me objekt: “Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Neurokirurgjisë dhe Kirurgjisë Maxilofaciale në SUT” - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 24 muaj - ndarë në 2 lote”. Viti 2022

1.Urdhër Prokurimi Nr.74 Datë 03.10.2022	3.Njësia e prokurimit Urdhër Nr.50/7 dt. 01.09.2022 A. C. G.H. M. S.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 70/1 datë 03.10.2022 V. A. L. B. I. H. M. M. R. J.
2. “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar mallra”		
5.Fondi Limit (pa TVSh) LOTI 1 - 154,356,040 lekë LOTI 2 - 21,105,600 lekë	6.Oferta fituese (pa TVSh) LOTI 1 - 153.996.740,00 lekë LOTI 2 - 21.086.300,00 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh) LOTI 1 – 359,300 lekë LOTI 2 – 19,300 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 14.11.2022 Ora:10:00	9.Burimi Financimit Buxheti i Shtetit (Ministria e Mbrojtjes)	10.Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 1(një) OE b)S’kualifikuar - OE, c) Kualifikuar 1 (një) OE
11.Ankimim: Ska		
b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
13.Lidhja e kontratës nr.1: Nr.74/11 Prot., Datë 15.12.2022	13.Vlera e kontratës nr.1.: 20,014,724 Leke me TVSH	

Grupi i monitorimit të Marrëveshjes Kuadër Nr. 80/7 date 15.02.2021, i përbërë nga F. O., I.H. dhe A. S., nëpërmjet kërkesës nr. 434 Prot., datë 04.07.2022., drejtuar Drejtoreshës së SUT znj.E. B., kanë informuar mbi përfundimin para afatit të parashikuar të saj dhe njëkohësisht kanë kërkuar vazhdimin e furnizimit të pandërprerë me materiale për shërbimin e Neurokirurgjisë.

Spektori i planifikimit të SUT me shkresën nr. 445-447 Prot., datë 07.07.2022 ka paraqitur kërkesën pranë sektorit të prokurimeve për fillimin e procedurës së prokurimit “Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Neurokirurgjisë dhe Kirurgjisë Maxilofaciale në SUT”, për një periudhë 24 mujore.

Hartimi i specifikimeve teknike:

Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike për shërbimin e kirurgjisë Maxilofaciale i ngritur me urdhrin nr.52 datë 18.07.2022, përbëhej nga: L. B., M. S., A.T.

Grupi i punës ka hartuar specifikimet teknike për shërbimin e Kirurgjisë Maxilofaciale, të cilat ia kanë përcjell Njesisë së Prokurimit me shkresën nr. 52/1 Prot., datë 08/08/2022.

Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike për shërbimin e Neurokirurgjisë i ngritur me urdhrin nr.53 datë 18.07.2022, përbëhej nga: F. O., I. H., A. S.

Grupi i punës ka hartuar specifikimet teknike për shërbimin e Neurokirurgjisë, të cilat ia ka përcjell Njesisë së Prokurimit me shkresën nr. 53/1 Prot., datë 08/08/2022 .

Grupet respektive të punës kanë përcaktuar specifikimet teknike për shërbimin e Neurokirurgjisë dhe Kirurgjisë Maxilofaciale si dhe sasitë e nevojshme për një periudhë dy vjeçare.

Llogaritja e Fondit Limit:

Grupi e punës për llogaritjen e fondit limit i ngritur me urdhrin nr. 52/2 Prot., datë 08.08.2022 përbëhej nga: G.H., E. P. dhe M. S.

Grupi i përllogaritjes së fondit limit, ka kërkuar oferta nga OE E. shpk, OE G.-A. F.shpk dhe OE O.E.S. D. shpk me qëllim testimin e tregut nëpërmjet ftesës për ofertë me nr. 52/3 Prot. Datë 08.08.2022 për materialet e mjekimit për shërbimin e kirurgjisë maxilofaciale dhe 53/3 Prot., date 08.08.2022 për shërbimin e Neuro Kirurgjisë.

OE te sipërcituar kanë paraqitur Ofertat e tyre, të cilat janë administruar nga SUT me nr. 52/4 dhe 53/4 Prot., datë 10.08.2022.

Mbi bazën e ofertave te OE dhe Fondit limit të marrëveshjes kuadër Nr. 9/14 date 17.05.2021, grupi i punës së përllogaritjes së fondit limit ka përcaktuar respektivisht sipas shërbimeve vlerën 154,356,040 leke pa TVSh për shërbimin e neurokirurgjisë ose 1,326,310.7 euro (Loti 1) dhe 21,105,600 leke pa TVSH për shërbimin e maxilofaciale ose 181,350.74 euro (Loti 2).

Fondi Limit i përllogaritur është pasqyruar në proces verbalin nr. 52/5 dhe 53/5 Prot., datë 22.08.2022.

Nga administrimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konstatohet se:

Në përgjigje të kërkesës së SUT nr. 1822 Prot., datë 23.08.2022, për zhvillimin e procedurës me prokurim të përqendruar, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e cila me shkresën nr. 3367/1 Prot., datë 31.08.2022 ka autorizuar SUT për kryerjen e prokurimit për një periudhe 24 mujore.

Njësia e prokurimit është ngritur urdhrin nr. 74 Prot., datë 03.10.2022, e cila përbëhej nga: A. C., G. H., M. S.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është ngritur me Urdhrin Nr. 70/1 datë 03.10.2022, i cili përbëhej nga: V. A., L. B., I. H., M.M. dhe R.J.

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Anëtarët e Njesisë së Prokurimit të SUT, më datë 07.09.2022, kane hartuar dhe miratuar dokumentet e shpalljes së procedurës së prokurimit – Procedure e hapur mbi kufirin e larte monetar- me objekt “Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Neurokirurgjisë dhe Kirurgjisë Maxilofaciale në SUT” - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomik (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 24 muaj - ndarë në 2 lote”.

Kjo procedurë është e shpallur me:

Loti 1. REF-44264-10-03-2022

Loti 2. REF-44268-10-03-2022

Formulari i Njoftimit të Kontratës së Shpallur është nr. 74/2 Prot., datës 03.10.2022.

Me dokument të protokolluar me nr. 74/3 Prot., te datës 01.11.2022 është pezulluar procedura ne SPE janë ndryshuar e dokumentet e tenderit, shtojca është administruar ne dosje me nr. 74/4 date 01.11.2022, dhe me dokument të protokolluar me nr. 74/5 Prot., te datës 01.11.2022 është hequr pezullimi i procedurës ne SPE.

******Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST**, konstatohet se pas hedhjes së DST në SEP janë bërë ndryshime, nëpërmjet Shtojcës nr. 1 datë 01.11.2022 për arsye të ndryshimit të pikës 3.1 “Sigurimi i ofertës”. Për këtë arsye Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave ndryshon nga data 03.11.2022 ora 10:00 në datën 14.11.2022 ora 11:00.

Në lidhje me kriteret e vendosura, AK nuk ka kërkuar që gjatë procesit të dorëzimit të mallit OE Kontraktues, duhej të shoqëronte mallin me certifikatën e origjinës dhe të regjistrimit të tij pranë AKBPM.

Zhvillimi i procedurës

Anëtarët e KVO-së më datë 14.11.2022 ora 10:00, kanë hapur procedurën në SEP, ku ka rezultuar se kishte paraqitur ofertë vetëm 1 (një) Operator Ekonomik për të dy lote, si më poshtë:

Për lotin nr. 1 Operatori Ekonomik “O.E.S. D.” me ofertën ekonomike 153,996,740 lekë pa TVSH. Për lotin nr. 2 Operatori Ekonomik “O.E.S. D.” me ofertë ekonomike: 21.086.300,00 lekë Pa TVSh.

KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “O.E.S. D.” për te dy lotët, si më poshtë.

Nr. loti	Operatori Ekonomik	Oferta Ekonomike në Lekë pa TVSH.
1.	“O.E.S. D.” Shpk	153.996.740 lekë pa Tvsh.
2.	“O.E.S. D.” Shpk	21.086.300 lekë pa TVSh

Formulari i njoftimit të operatorëve ekonomik të suksesshëm në marrëveshjen kuadër mbanë nr. 74/6 dhe 74/7 Prot., të datës 01.12.2022.

Raporti përmbledhës i KVO nr. 74/8 Prot., datë 12.12.2022, i miratuar nga Drejtori i SUT znj. E. B.ka paraqitur gjithë ecurinë e kësaj procedure, por në asnjë rresht nuk informon Titullarin e institucionit për administrimin e mostrave që duhej të paraqiteshin nga OE pjesëmarrës ditën dhe orën e hapjes së kësaj procedure.

****** lidhur me OE të shpallur fitues “O.E.S. D.” për Lotin 1 dhe Lotin 2 pavarësisht se është oferta e vetme ekonomike, rezulton se ky OE nuk plotëson të gjitha kriteret e DST duke u kualifikuar dhe shpallur fitues në mungesë të plotësimit të tyre nga KVO dhe konkretisht:**

1. Referuar kriterit 2.3. germa h tek kriteri i kapacitetit teknik, AK ka kërkuar në DST që :

Për te vërtetuar qe OE i përmbushin specifikimet teknike dhe janë ne gjendje te realizojnë me sukses kontratën, duhet qe te paraqesin mostra për te gjithë artikujt me shenjen (), sipas tabelës ne specifikimet teknike dhe sipas katalogëve përkatëse te prodhuesit.*

- Mostrat duhet te paraqiten në datën dhe orën e hapjes së tenderit.

- Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë SUT, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a. Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.

-Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të ofertës.

-Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës. Do te s’kualifikohen OE ne rast se nuk paraqiten dhe/ose mostrat e paraqitura nuk janë sipas specifikimeve teknike.

Nga auditimi i evidencës dokumentare të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH, konstatohet se:

Në lidhje me këtë kërkesë të DST, nga ana e KVO nuk dokumentohet dorëzimi i këtyre mostrave pasi nuk ekziston asnjë proces verbal apo dokument tjetër që të vërtetoj plotësimin e këtij kriteri nga ana e OE “O.E.S. D.”, gjithashtu edhe në raportin përmbledhës së datës 12.12.2022, KVO nuk e kanë përmendur këtë fakt.

Referuar kërkesave te kriterit 2.3 germa d) dhe f)., AK ka kërkuar në DST për Lotin 1 dhe 2, që:

Për piken d):

Ofertuesi duhet të paraqesë Certifikatë konformiteti sipas direktivës MDD 93/42 EEC (të përditësuar)/ ose FDA ose ekuivalent, për të gjithë artikujt e ofruar, të përkthyer dhe noterizuar.

Nga auditimi në SEP, konstatohet se, OE “O.E.S. D.”, nuk e ka plotësuar këtë kriter, pasi dokumentacioni i ngarkuar në sistemin elektronik është i pa përkthyer dhe i pa noterizuar.

Për pikën f):

Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave për lejimin e tregimit të artikujve të tij, të përkthyer dhe noterizuar. OE mund të paraqesin autorizim të lëshuar edhe nga distributori i autorizuar. Për të vërtetuar autorizimin e lëshuar nga distributori i autorizuar, OE duhet të vërtetohet me dokumentacion lidhjen ndërmjet Prodhuesit dhe distributorit të autorizuar.

Titulli i gjetjes:	OE “O.E.S. D.” është kualifikuar dhe shpallur fitues në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të vendosura nga AK., në DST.
Situata:	<p>Nga auditimi rezulton se:</p> <p>OE “O.E.S. D.”, nuk e ka plotësuar këtë kriter, pasi dokumentacioni i ngarkuar në sistemin elektronik është i pa përkthyer dhe i pa noterizuar.</p> <p>Për sa më lart, kualifikimi i shoqërisë “O.E.S. D.”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotëson disa nga kriteret e DST.</p> <p>Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë, KVO duhet të kishte anuluar procedurën për Loti 1 dhe Lotin 2 dhe tenderi duhej të ishte rishpallur, si dhe vlera e kontraktuar për LOTI 1 - 154,356,040 lekë dhe LOTI 2 - 21,105,600 lekë përbën prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E^{të}), në kundërshtim me ligjin nr. 162 /2020 “Për prokurimin publik”.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 162 /2020 “Për prokurimin publik”.
Ndikimi:	Rritje të shpenzimeve jo efektive.
Shkaku	Mos respektim i LPP dhe akteve nenligjore të tij.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Drejtoria e Spitalit Universitar të Traumës të analizojë këtë procedurë dhe të marrë masa për anëtarët e KVO të cilët kanë vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, duke rritur shpenzimet pa efektivitet për buxhetin e SUT në shumën 175,461,640 lekë .

Me veprimet apo mosveprimet, për sa më lart, ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e KVO të përbërë nga: Znj. V. A. në cilësinë e kryetarit të KVO dhe Znj. L. B., I. H., M. M., R. J. në cilësinë e anëtarëve të KVO, si dhe titullarin e autoritetit kontraktor znj. E. B.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Perfundimtarr të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë 1375/5 Prot. Date 04.07.2023 nga G. H., M. M., R.J. dhe M. S.

<p>Pretendimet e subjektit:</p> <p>Në mënyrë të përmbledhur observacioni konsiston në, e citoj:</p> <p>Grupi i sipërcituar që ka paraqitur observacionin pranon gjetjet e grupit të KLSH.</p> <p>Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:</p> <p>Mungesa e paraqitjes së dokumentacionit shtesë të panjohur gjatë fazës së terrenit dhe pranimi nga vete subjekti i gjetjeve të pasqyruara në projekt raport, tregon që nga na e KVO është vepruar në mospërputhje me kërkesat e DST, prandaj observacioni për këtë pikë nuk do të merret në konsideratë.</p>
--

Lidhja e marrëveshjes kuadër

Administrimi i dokumentacionit të shkruar nga KVO është bërë nëpërmjet urdhrin nr. 74/9 date 12.12.2022 me objekt “ Administrim dokumentacioni dhe lidhje kontratës”.

Mbi bazën e vlerësimit të KVO si të dokumentacionit të ngarkuar në SEP dhe atij të dorëzuar në formatin e shkruar, i pasqyruara gjerësisht në raportin përmbledhës së KVO, të miratuar nga titullari i institucionit, është lidhur Marrëveshjen Kuadër nr. 74/8 Prot., datë 12.12.2022, me objekt: “Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Neurokirurgjisë dhe Kirurgjisë Maxilofaciale në SUT”, Marrëveshje Kuadër me disa Operatorë Ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 24 mujore me OE “O.E.S. D.”, me vlerën e fondit limit dhe me afat dy vjeçar.

Ndjekja dhe monitorimi i Marrëveshjes Kuadër.

Komisioni i Posaçëm për Monitorimin dhe Zbatimin e Marrëveshjes Kuadër, si dhe të minikontratave që do të lidhen është ngritur me urdhrin e brendshëm të titullarit të institucionit nr.74/10 Prot. Datë 13.12.2022 për lotin 1, të përberë nga:

F. O., I.H. dhe A.S. dhe për lotin 2, komisioni përbehej nga: M. S., A.T. dhe M. P.

Titulli i gjetjes:	Mungesa e kontrollit të brendshëm në menaxhimin financiar dhe kontrollin.
Situata:	<p><i>Nga auditimi rezulton se:</i></p> <p>1. Në urdhrin e sipërcituar ka reference jo të saktë të numrit të protokollit për Marrëveshjes Kuadër, pasi urdhri i referohet marrëveshjes nr.78/8 prot. Datë 12.12.202., ndërkohë që numri i protokollit të marrëveshjes është i korigjuar dhe mbanë nr. 74/9 prot datë 12.12.2022, ndërkohë që ky numër protokollit është përdorur në urdhrin për administrimin e dokumentacionit të shkruar që duhet të dorëzonte OE i kualifikuar dhe shpallur fitues para lidhjes së marrëveshjes kuadër. Numri i protokollit 74/8 datë 12.12.2022 që i referohet Urdhrit për ngritjen e komisionit të posaçëm për monitorimin e marrëveshjes kuadër, si dhe të minikontratave që do të lidheshin, rezulton të jetë i nr. i protokollit edhe për raportit përmbledhës të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO). Referenca e gabuar e nr. protokollit të marrëveshjes kuadër reflektohet edhe në kontratën e lidhur me OE “O.E.S. D.” Nr.74/13 Prot Datë 15.12.2022.</p> <p>2. Referuar Urdhrit nr. 317 Prot., datë 15.06.2022, për krijimin e komisionit të pritjes dhe marrjes në dorëzim të vlerave materiale me të cilat do të furnizohet SUT për vitin 2021 e në vazhdim titullari i institucionit ka ngritur komisionin e pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit respektivisht, për neurokirurgjinë: I. H., N. B., A. S. dhe për kirurgjinë maksilofaciale: L. B., M. S., A. T.</p> <p>3. Referuar Proces verbalit të datës 16.12.2022 mbi marrjen në dorëzim të mallit të dorëzuar nga kontraktuesi sipas faturës tatimore elektronike nr.1987/2022 date 16.12.2022, rezulton se komisioni i marrjes në dorëzim është ai i përcaktuar në Urdhrin nr. 317 Prot., datë 15.06.2022 dhe jo ai i përcaktuar në urdhrin nr.74/10 Prot. Datë 13.12.2022 të titullarit të institucionit.</p> <p>4. Urdhri nr. 317 Prot., datë 15.06.2022 i referohet bazës ligjore të shfuqizuar duke ju referuar ligjit nr. 6942 date 15.12.1984 dhe VKM nr.70 date 11.03.1985.</p> <p>Për sa më lart, titullari i institucionit për të njëjtin objekt të veprimtarisë dhe për të njëjtën periudhë kohore ka nxjerr dy urdhra me komisione të ndryshme. Kjo tregon që në SUT nuk është hartuar gjurma e auditit siç e</p>

	përcakton baza ligjore dhe nënligjore ne fuqi dhe për rrjedhojë mungon kontrolli i brendshëm duke e klasifikuar jo efektiv menaxhimin financiar dhe kontrollin (MFK).
Kriteri:	Rregullore e brendshme e SUT, Udhëzimi, nr. 30 datë 27.12.2011 “për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
Ndikimi:	Në funksionimin efektiv të ligjit të menaxhit financiar dhe kontrollit.
Shkaku	Mungesa e hartimit të gjurmës së auditit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtoria e Spitalit Universitar të Traumës, të ngrejë grupe pune për hartimin e gjurmës së auditit për cdo proces dhe veprimtari që ushtrohet në SUT., për të përmirësuar sistemin e kontrollit të brendshëm me qëllim që të sigurohet përdorimi me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë i fondeve publike.

Me veprimet dhe mos veprimet, ngarkojnë me përgjegjësi Titullarin e Institucionit znj. E. B. në cilësinë e nëpunësit autorizues, znj. E.R. në cilësinë e Nëpunësit zbatues, Z.G. H. në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të prokurimeve dhe z. B. T. në cilësinë e përgjegjësit të sektorit juridik.

Lidhja e minikontratave:

Brenda periudhës së auditimit, sektori i planifikimit nëpërmjet shkresës nr. 825 Prot., datë 15.12.2022, ka paraqitur kërkesën pranë sektorit të prokurimeve për furnizim me materiale për neurokirurgjinë. Për këtë procedurë brenda periudhës së auditimit është lidhur minikontrata Nr.74/13 Prot datë 15.12.2022 me OE “O.E.S. DISTRIMED” për shumën 20,014,724 lekë.

2.6.7. Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2021

Në zbatim të pikës 6 të programit të auditimit Nr. 1199/1 Prot. Date 13.01.2023 u shqyrtua dokumentacioni i procedurës së prokurimit publik të vitit 2021 me objekt: “*Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT*”, *Marrëveshje Kuadër me disa Operatorë Ekonomikë ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 24 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.*

1.Urdhër Prokurimi Nr.9/6 Datë 24.03.2021	3.Njësia e prokurimit Urdhër Nr.9/6 dt. 24.03.2021 G. H. K. S. M.M.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 9/7 datë 24.03.2021 V. R. B.V. M. S.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur Mallra”		
5.Fondi Limit (pa TVSh) 199,444,516 lekë	6.Oferta fituese (pa TVSh) 198,048,450 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 1,396,066 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 26.04.2021 ora 10:00	9.Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit	10.Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender : 2 OE b)S’kualifikua: 0 OE, c) Kualifikuar: 2 OE
11.Ankimime: JO	12. Përgjigje Ankesës nga AK	13.Përgjigje Ankesës nga KPP

Grupi i ndjekjes së Marrëveshjes Kuadër të vitit 2019, i përbërë nga V. R., B. G.dhe A. C. nëpërmjet kërkesës nr.1. Prot., datë 06.01.2021, drejtuar Drejtorit Z.A. Z. ka kërkuar vazhdimin e furnizimit të pandërprerë me materiale ortopedike të konsumit dhe materiale të osteosintezës, interne dhe eksterne të traumatologjisë të sistemit lokomotor duke përcaktuar sasi të që duhen për një periudhë tjetër 2 vjeçare në vazhdim.

Sektori i planifikimit të SUT me shkresën nr.2 Prot., datë 06.01.2020, ka paraqitur kërkesën për fillimin e prokurimit me objekt "Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT", për një periudhë 24 mujore.

Hartimi i specifikimeve teknike:

Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike i ngritur me urdhrin nr.9 datë 12.01.2021, përbëhet nga: V. R.; B. G.dhe A.C. Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës janë pasqyruara në shkresën nr. 9/1 Prot., datë 08.02.2021.

Hartimi i fondit limit:

Grupi për llogaritjen e fondit limit është ngritur me urdhrin nr. 9/2 Prot., datë 08.02.2021 dhe përbëhet nga: A.F., M.M. dhe R. J.

Grupi i përlllogaritjes së fondit limit ka kërkuar oferta nga OE OE T.shpk, O. 360 shpk dhe L. shpk nëpërmjet shkresës nr. 9/3 Prot., datë 08.02.2021.

OE te sipërcituar kanë paraqitur Ofertat e tyre, të cilat janë administruar nga SUT me nr. 9/4 Prot., datë 15.02.2021.

Mbi bazën e ofertave të OE dhe Fondit limit të përcaktuar në Marrëveshjen Kuadër nr. 23/12 Prot., dt. 30.10.2019, grupi i përlllogaritjes së fondit limit ka përcaktuar vlerën **199,444,516.60** Lekë pa TVSH, për afatin kohor të furnizimit për dy vite. Përlllogaritja e këtij Fondi Limit është pasqyruar në proces verbalin nr. 9/5 Prot., datë 15.02.2021.

Nga administrimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konstatohet se:

Në përgjigje të kërkesës së SUT nr. 363. Prot., datë 16.02.2021 për zhvillimin e procedurës me prokurim të përqendruar, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e cila me shkresën nr. 939/1 Prot., datë 24.02.2021, ka autorizuar SUT të kryej procedurën e prokurimit të blerjes së pajisjeve mjekësore, për vitin 2021 për një periudhë 24 mujore.

Njësia e prokurimit është ngritur me urdhrin nr. 9/6 Prot., datë 24.03.2021, i cili përbëhet nga: G.H.; Dr. K. S. dhe M.M.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është ngritur me urdhrin nr. 9/7 Prot., datë 24.03.2021, i cili përbëhet nga: V. R.(Kryetar); M.S. dhe B.V.

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Anëtarët e Njesisë së Prokurimit të SUT, më datë 26.03.2021 kanë hartuar DST për procedurën "Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e ortopedisë në SUT" Marrëveshje Kuadër me disa Operatore Ekonomike ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 24 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.

Kjo procedurë është e shpallur me Nr. REF-90969-03-24-2021.

Formulari i Njoftimit të Kontratës së Shpallur është nr. 9/8 Prot., datës 24.03.2021.

****** Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST**, konstatohet se, pas hedhjes së DST në SEP janë bërë ndryshime të saj, nëpërmjet Shtojcës nr.1 me nr. 9/9 Prot., datë 29.03.2021 dhe Shtojcës nr.2 me nr. 9/10 Prot., datë 29.03.2021.

Ndryshimet në DST kishin të bënin me përcaktimin e numrit maksimal të OE me të cilët do të lidhej marrëveshja kuadër dhe ndryshimin e kriterit 2.2., 2.3 germa d, h tek shtojca nr.9.

Si rezultat i ndryshimeve të DST, afati kohor për dorëzimin e ofertave për pjesëmarrje ndryshoi nga data 19.04.2021 në datën 26.04.2021.

Titulli i gjetjes:	Kriteret e veçanta ne DST janë të pa plota dhe nuk garantojnë cilesin e mallit.
Situata:	<p>AK për plotësimin e kapacitetit teknik , tek kriteri 2.3 pika “e”, ka kërkuar që: <i>“OE duhet të paraqesë autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore, të lëshuar nga MSHMS sipas ligjit 89/2014 “Për Pajisjet Mjekësore”.</i> Vendosja e këtij kriteri është i pa plotë, pasi AK duhet të kërkoj certifikatën për regjistrimin e pajisjeve mjekësore në regjistrin kombëtar të AKBPM, kjo në referim të ligjit nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”, neni 13 (procesi i regjistrimit) pika 1, c dhe 2 ku parashikohet se:</p> <ol style="list-style-type: none"> <i>1. Të gjitha pajisjet mjekësore që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë duhet të regjistrohen në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore që mbahet nga Agjencia e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Aplikimi për regjistrimin e pajisjes mjekësore në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore paraqitet nga:</i> <ol style="list-style-type: none"> <i>c) tregtuesit me shumicë të pajisjeve mjekësore</i> <i>2. AKBPM-ja lëshon një certifikatë për regjistrimin e pajisjes mjekësore në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore brenda 30 ditëve nga data e marrjes së aplikimi.</i> <p>****Lidhur me dorëzimin e mostrave, konstatohet se: Nga ana e KVO, më datë 26.04.2021 janë administruar në dosje procesverbalet e inventarizimit të marrjes në dorëzim të mostrave të paraqitura nga OE pjesëmarrës në këtë procedurë. Dorëzimi i tyre nga OE pjesëmarrës është bërë në referim të kriterit 2.3 pika h në DST., ku parashikohet se: <i>Për të vërtetuar që OE i përmbushin specifikimet teknike dhe janë në gjendje të realizojnë me sukses kontratën, duhet që të paraqesin mostra për të gjithë artikujt “Proteza”, sipas tabelës në specifikimet teknike dhe sipas katalogëve përkatëse të prodhuesit. OE ofertues duhet të paraqesin nga një mostër për çdo artikull proteze. Mostrat duhet të paraqiten në datën dhe orën e hapjes së tenderit. <u>Do të s’kualifikohen OE në rast se nuk paraqiten dhe/ose mostrat e paraqitura nuk janë sipas specifikimeve teknike.</u></i></p> <p>Nga auditimi konstatohet se:</p> <ol style="list-style-type: none"> Referuar Proces verbalin të datës 26.04.2021 të KVO, mbi dorëzimin dhe paraqitjen e mostrave të OE Trimed. Lista e mostrave të paraqitura nga ky OE kanë mospërputhje me specifikimet teknike pasi ato nuk përmbajnë elementet e ofertuar sipas të dhënave të katalogëve të ngarkuar në SEP. Përshkrimi i këtyre artikujve për mostrat e dorëzuara nga ky OE dhe të marra në dorëzim nga KVO, nuk përputhet me specifikimet teknike të kërkuara nga AK në shtojcën 10 të DST, pasi mungon kodi (S/N/Loti apo Ref.) vendi i origjinës së mallit, emri i kompanisë prodhuese, siç kërkohen në kriterin 2.3 pika b e DST. Në referim të Proces verbalit të datës 27.08.2021 KVO., i ka kthyer mostrat e dorëzuara BOE T. & L.

	<i>Për sa më lart, anëtarët e KVO, kanë vepruar në mospërputhje me kriterin 2.3 pika h e DST, duke kualifikuar padrejtësisht OE T.. Në këto kushte AK, duhej të anulonte procedurën dhe ta përsëriste nga fillimi.</i>
Kriteri:	Ligji 89/2014 “Për Pajisjet Mjekësore, Kriteret e vendosura në DST.
Ndikimi:	Në cilësinë e mallrave të prokuruar dhe shtandartet e kërkuara të pajisjeve mjekësore.
Shkaku	Mos respektim i LPP dhe ligjit të pajisjeve mjekësore.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtoria e SUT para miratimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të hartuara nga grupet e punës, duhet të kërkojnë që në kriteret e veçanta të përfshijë kërkesa që parashikohen në ligjin për pajisjet mjekësore në mënyrë që të prokuroj mallra/shërbime me cilësi të lartë duke optimizuar shpenzimet për këto mallra.

Për veprimet apo mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, V. R. (Kryetar); M. S. dhe B. V. në cilësinë e anëtarëve të KVO.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Perfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.1375/6 Prot. Date 04.07.2023 nga G. H., M. S. dhe M. M.

Pretendimet e subjektit:

1. Grupet e punës në SUT kanë vepruar duke u mbështetur në rregullat e prokurimit publik duke zhvilluar në kohë procedurat me qëllim furnizimin sa më parë me materiale për shërbimet e Ortopedisë në SUT. Ak ka shpallur të suksesshëm OE të cilët kanë vite që operojnë në tregun shqiptar dhe ndër vite kanë furnizuar SUT me materialet e kërkuara.

2. Në lidhje me zhvillimin e minikonkurseve sipas kërkesave të Ak, kemi argumentuar se në këtë procedurë janë shpallur dy OE të suksesshëm dhe ofertat e të dy operatorëve kanë qenë të vlefshme. Me qëllim mirëmenaxhimit e fondeve publike, Ak ka vendosur si fond limit në minikonkurse, ofertën me çmimet për njësi më të ulëta (oferta në vendin e parë) por në asnjë rast nuk nënkupton që kjo ofertë ka qenë fituesja pasi kemi dy oferta të shpallura të suksesshme. Ritheksojmë faktin se oferta e shpallur fituese në minikonkurse ka qenë gjithmonë më e ulët se fondi limit i përcaktuar nga Ak dhe në asnjë rast çmimet për njësi nuk kanë qenë më të larta se ato të shpallura të suksesshme në fazën e parë të procedurës së prokurimit.

3. Grupet e punës që ndjekin zbatimin e kontratës janë me profesion mjek ortopedë dhe përveç punës së tyre të përditshme në ofrimin e shërbimit ndaj pacientëve, kanë monitoruar dhe kontratat e furnizimit. Ju kemi shpjeguar se për disa gjetje në mbajtjen e proces-verbaleve të pritjes së mallit apo të ndërrimit të materialeve (ndërrimit të përmasave sipas çdo produkti), grupet e punës do të mbajnë në konsideratë rekomandimet tuaja me qëllim përmirësimin dhe dokumentimin e procesit të realizimit të kontratave të furnizimit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

AK i pranon gjetjen e grupit të auditimit, por i konsideron si devijime të vogla, prandaj ky observacion nuk do të merret në konsideratë.

Zhvillimi i procedurës

Nga KVO, është mbajtur Raporti Përmbledhës me nr. 9/11 Prot. Datë 05.05.2021, i miratuar nga titullarit i AK, në të cilin është përshkruar e gjithë procedura e ndjekur deri në shpalljen e fituesit. Sipas këtij Raporti përmbledhës, rezulton se janë paraqitur 2 (dy) operatorë ekonomike, përkatësisht me ofertat ekonomike si më poshtë:

BOE "T." Shpk dhe "L.", me ofertë ekonomike 198,048,450 Lekë pa TVSH.

OE "O." me ofertë ekonomike 199,243,370 Lekë pa TVSH.

KVO, mbi bazën e verifikimit në SPE ka kualifikuar të dy OE pjesëmarrës, respektivisht BOE "T." & "L." SHPK dhe "O." SHPK

Pas kualifikimit të OE pjesëmarrës, KVO ka pranuar Ofertat ekonomike sipas klasifikimit të mëposhtëm.

Nr.	Operatori Ekonomik	Oferta Ekonomike në Lekë pa TVSH.
1	BOE "T." Shpk dhe "L." Shpk	198,048,450 Lekë pa TVSH.
2	O." Shpk	199,243,370 Lekë pa TVSH.

Formulari i njoftimit të Operatoreve Ekonomik të suksesshëm në marrëveshjen kuadër është bërë me shkresën nr.9/12 Prot. Date 06.05.2021.

Me shkresën nr. 9/13 Prot., datë 05.05.2021, është protokolluar Urdhri i Titullarit për Administrim Dokumentacioni dhe lidhjen e Kontratës.

Marrëveshja Kuadër nr. 9/14 Prot., datë 17.05.2021, me objekt: "Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT", Marrëveshje Kuadër me disa Operatorë Ekonomikë ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 24 mujore" është lidhur midis SUT dhe BOE "T." & "L." dhe OE "O.360" me fond limit 199,444,516.60 lekë dhe me afat dy vjeçar. Marrëveshje kuadër nuk është një kontrate më vete, por përcakton kushtet për kontratat që do të lidhen mbi bazën e saj.

Oferta ekonomike, sipas parimit të çmimit me te ulet e ofertuar nga BOE "T. dhe L.", në vlerën 198,048,450 leke pa TVSh, shërben si referencë për mini-konkurset që do të zhvilloj SUT, bazuar në çmimet/njësi të artikujve të kërkuar.

Monitorimi i marrëveshjes kuadër:

Komisioni i Posaçëm për Monitorimin dhe Zbatimin e Marrëveshjes Kuadër i ngritur me urdhrin nr. 9/15 Prot., datë 18.05.2021, përbëhet nga: V. R., B. G. dhe A. C.

Zhvillimi i minikonkurseve:

Komisionit për zhvillimin e minikonkurseve sipas Marrëveshjes Kuadër me Nr.9/14 Prot, datë 17.05.2021 është ngritur me urdhrin nr. 9/16 Prot., datë 27.05.2021, dhe përbëhet nga: G.H., M. S., dhe K. S. Komisioni ka pësuar një ndryshim duke zëvendësuar K. S. me B. V. nëpërmjet urdhrin 9/38 date 28.02.2022.

Nëpërmjet shkresës nr. 9/17 dhe 9/18 Prot., datë 27.05.202, janë dërguar ftesat për ofertë BOE "T." & "L." dhe OE "O." me FL 35,631,800 leke pa TVSH për minikonkursin e parë.

Autoriteti Kontraktor në ftesat e dërguara OE, njofton se ofertat do të paraqiten në ambientet e SUT (zyra e prokurimeve) më datë 02.11.2022 ora 14:00, krahas ofertës AK ka kërkuar paraqitjen e dokumentacionit të mposhtëm:

a. OE duhet të paraqesin ofertën e tyre brenda datës dhe orës së caktuar.

b. OE duhet të përgatisin ofertën në mënyrë që vlera e ofertës të mos jetë më e lartë se vlera e fondit limit të përcaktuar në ftesën për Ofertë. Ofertat me vlera më të larta do të s'kualifikohen.

c. OE duhet të paraqesin një vetë deklaram me shkrim se kanë gjendje të gjitha materialet e kërkuara dhe do të vënë në dispozicion të SUT, sa here që do të ketë nevojë, të gjitha përmasat dhe llojet e materialeve që do të kërkojnë në mënyrë që të mos ketë mangësi gjatë operacioneve që do të zhvillohen sipas urgjencave dhe nevojave të SUT.

d. Të gjitha materialet do të sillen me anë të kontratës së furnizimit në SUT mund të ndërrohen (mallrat/materialet do të qëndrojnë të magazinuara në farmacinë e SUT) sipas përmasave dhe llojeve të

kërkuara rast pas rasti. Çdo material që do të ndërohet, duhet të pasqyrohet me anë të një procesverbali të cilin e firmosin përfaqësuesit e OE dhe përfaqësuesit e SUT që do të marrin pjesë gjatë operacioneve kirurgjikale rast pas rasti. Vlera e materialeve nuk do të ndryshojë nga ajo e kontratës së furnizimit.
e. OE duhet të paraqesin një vetëdeklarim me shkrim se do të vënë në dispozicion të SUT një specialist të trajnuar sipas llojeve të materialeve të furnizuara (sipas prodhuesit duhet të paraqitet dhe specialistit përkatës i trajnuar).

*****Lidhur me zhvillimin e minikonkurseve** nga komisioni për vlerësimin e ofertave të paraqitura nga ana e OE të klasifikuar të suksesshëm me të cilët është lidhur marrëveshja kuadër, konstatohet se: OE, ofertat i kanë dorëzuar fizikisht në zyrën e prokurimeve të SUT dhe jo në atë të protokollit të institucionit.

Oferta ekonomike e paraqitur nga BOE T.&L. dhe OE O. është pasqyruar në Proces Verbalin nr. 9/19 Prot. datë 01.06.2021. KVO i përbërë nga G. H., K. S. dhe M. S., sipas kriterëve të vlerësimit (kërkuar në dokumentet e tenderit dhe kushteve të përgjithshme në DT dhe MK) të çmimit më të ulët, ka shpallur fitues në vendin e parë OE "O." me ofertën **35,628,900 leke** (pa TVSh)

Për sa më lart, konstatohet se ofertat ekonomike të OE gjate fazës se zhvillimit të mikrokonkurseve nuk administrohen nga AK nëpërmjet zyrës së protokollit, duke ngarkuar me përgjegjësi Znj.E. B. në cilësinë e titullarëve të SUT për mos nxjerrjen e urdhrave të brendshëm për administrimin e dokumentacionit nëpërmjet zyrës së protokollit.

Kontrata e furnizimit

Më pas është lidhur Kontrata e Furnizimit nr.1/2021 me nr.9/20 Prot. Date 01.06.2021 midis SUT dhe OE O.për furnizimin me materiale konsumi (implante ortopedike) për shërbimin e Ortopedisë me afat furnizimi për 4 (katër) muaj.

Në nenin 5 të kontratës nr.1/2021 (Afatet e Lëvrimin dhe kushtet e lëvrimin) është përcaktuar:

Të gjitha materialet do të sillen me anë të kontratës se furnizimit ne SUT mund të ndërrohen (mallrat/materialet do të qëndrojnë te magazinuara në farmacinë e SUT) sipas përmasave dhe llojeve të kërkuara rast pas rasti. Çdo material që do të ndërohet, duhet të pasqyrohet me anë të një procesverbali të cilin e firmosin përfaqësuesit e OE dhe përfaqësuesit e SUT që do të marrin pjesë gjatë operacioneve kirurgjikale rast pas rasti. Vlera e materialeve nuk do të ndryshojë nga ajo e kontratës së furnizimit.

Komisionin për pritjen dhe administrimin e materialeve mjekësore për kontratën Nr.9/20 Prot Datë 01.06.2021, i ngritur me urdhrin nr. 9/21 Prot., datë 02.06.2021, përbehej nga: z. E. Q.kryetar; z. I.H. anëtar dhe z. L.F. anëtar.

Në piken 5 te urdhrin të mësipërm është parashikuar se:

Në përfundim të çdo minikotratë komisioni duhet të dorëzojë Formularin e Realizimit të kontratës brenda 5 ditëve nga momenti i përfundimit te saj pranë sektorit te Prokurimeve.

Ne piken 6 dhe 7 te urdhrin është përcaktuar se për zbatimin e urdhrin mbanë përgjegjësi komisioni si dhe zv/drejtori ekonomik i SUT .

Titulli i gjetjes:	Vendosja e materialeve sinteza nuk mbahet ne nje regjistër të vecant
Situata:	<p>Nga auditimi konstatohet se:</p> <p>1. Komisioni për pritjen dhe administrimin e materialeve mjekësore, nuk ka dorëzuar formularin për realizimin e kontratës Nr.9/20 Prot Datë 01.06.2021, pranë Sektorit të Prokurimeve.</p> <p>2. Referuar Deklaratave OE pjesëmarrës në procedurën e prokurimit për marrëveshjen kuadër, të cilët kanë deklaruar se:</p>

a. OE T., do të vendosë në dispozicion për çdo operacion që do të kryhet, setet e montimit (minimumin një set montimi) dhe tre specialist të trajnuar për përdorimin e tyre. Specialistët e trajnuar nga kompania prodhuese e seteve dhe materialeve mjekësore janë: E.Gj., K. S. dhe Elvis L..

b. OE L. do të vendosë në dispozicion për çdo operacion që do të kryhet, setet e montimit (minimumin një set montimi) dhe 3(tre) specialist të trajnuar për përdorimin e tyre. Specialistët e trajnuar nga kompania prodhuese e seteve dhe materialeve mjekësore janë: F.S., I. Sh., D. Sh.dhe E. Gj.

c. OE O. do të vendosë në dispozicion për çdo operacion që do të kryhet, setet e montimit (minimumin një set montimi) dhe 1(një) specialist të trajnuar për përdorimin e tyre.

Specialisti i trajnuar nga kompania prodhuese e seteve dhe materialeve mjekësore është: M.K.

3. Nga auditimi i regjistrave të bllokut operator qendror, konstatohet se:

Në sallën e operacionit sipas detyrimit të nenit 5 të kontratës së furnizimit, si përfaqësueses të firmës kanë asistuar edhe z. I. K., z. A.M., R. Zi, R. G.², persona që nuk janë deklaruar nga OE fitues të kësaj procedure me të cilët është lidhur marrëveshje kuadër.

4.Shkëmbimi i materialeve ortopedike të grupit sinteza nuk është dokumentuar me proces verbal sipas përcaktimit të pikës 5 paragrafi i dytë i kontratës nr.1/2021 të furnizimit, por nga ana e mjekut kirurg operues është lëshuar recetë mjekësore për pacientin që do të operohet duke përshkruar materialet ortopedike që duhen për këtë operacion, sic pasqyrohet në faksimilen nr.5, 6 dhe 6/1 të Aneksit 2.8.1.

5.Pajisjet mjekësore të marra në dorëzim nga komisioni përkatës nuk janë të shoqëruar me etiketën në gjuhën shqipe, veprim në mospërputhje me nenin 20 (Etiketimi dhe instruksionet për përdorim) të ligjit 89/2014 “Për Paisjet Mjekësore”, ku parashikohet se:

a. Çdo pajisje mjekësore, që vendoset në treg dhe vihet në shërbim, duhet të përmbajë etiketën në gjuhën shqipe, e cila duhet të paraqitet në një formë të dukshme dhe të lexueshme.

b. Instruksione për përdorim nuk do të kërkohen për pajisjet e klasave I dhe II.

c. Rregullat për etiketimin dhe instruksionet për përdorimin e pajisjeve mjekësore miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kriteri:	Marrëveshjes Kuadër me Nr.9/14 Prot, datë 17.05.2021; Kontrata e Furnizimit nr.1/2021 me nr.9/20 Prot. Date 01.06.2021; Pika 5 e urdhrit nr. 9/21 Prot., datë 02.06.2021.
Ndikimi:	Në administrimin dhe qarkullimin e materialeve ortopedike.
Shkaku	Mos respektim i kushteve të MK dhe kontratave të furnizimit.
Rëndësia:	E lartë

² Date 04.10.2021 me nr. karteles A007206., etj.

Rekomandimi:	Titullari i institucionit të ngrëjë grupe pune për të analizuar gjithë procesin e administrimit të materialeve ortopedike duke filluar nga planifikimi dhe qarkullimi i tyre deri tek shërbimi i ortopedisë, gjithashtu për rastet e gjenerimit të recetave mjekësore për materialet sinteza të bëjë një analizë të hollësishme të këtij fenomeni dhe të nxjerr akte administrative mbi dokumentimin e tyre, të ngjashëm me rastin e administrimit të protezave me anë të proces verbaleve duke i identifikuar këto materiale me të dhënat që ato janë bërë hyrje në farmaci.
---------------------	---

Për sa më lart, për veprimet apo mos veprimet ngarkohet me përgjegjësi V. R., B. G. dhe A. C. në cilësinë e anëtarëve të komisionit të monitorimit të marrëveshjes Kuadër nr. 9/14 Prot., datë 17.05.2021, znj. E. R. (19.05.2022 e në vazhdim), A. B. (17.08.2013 deri 05.05.2022) në cilësinë e zv.Drejtorit ekonomik; E. Q., I. H., L. F. në cilësinë e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të materialeve mjekësore; Znj.E. B. në cilësinë e Titullarit të Institucionit.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.1375/14.

<p>Pretendimet e subjektit: Në mënyrë të përmbledhur observacioni konsiston, e citoj. ...për materialet e sintezës ju sqarojmë se mjeku nuk lëshon recete. Flete kërkesa vjene nga salla në të cilën është kryer operacioni kirurgjikal, ku janë pasqyruar materialet të cilat janë përdorur.</p> <p>Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së: Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt raportit të Auditimit referuar dhe observacionit të paraqitur nga AK SUT, rezulton se për materialet sinteza nuk ka rregjister të administrimit të këtyre materialeve sic veprohet për materialet e grupit të protezave. Për sa observoni se për këto materiale (sintezë) mjeku nuk lëshon recete për pacientet, dokumentimin e gjeni në aneksin e këtij materiali auditimi, prandaj observacioni për këto pike nuk do të merret në konsideratë.</p>
--

Zbatimi i kontratës:
Për këtë procedurë janë zhvilluar dhjetë minikonkurse dhe janë lidhur dhjetë minikontrata deri në ezaurimin e fondit të Marrëveshjes Kuadër sipas tabelës së mëposhtme:

Minikontrata	Nr. Prot dhe date	Vlera pa TVSh	Kontraktuesi	Afati
1	Nr.9/20 Prot Datë 01.06.2021	35,628,900	O.	4 muaj
2	Nr.9/25 Prot Datë 27.07.2021	19,800,000	T.&L.	4 muaj
3	Nr.9/29 Prot Datë 04.10.2021	19,845,600	T.&L.	4 muaj
4	Nr.9/33 Prot Datë 23.11.2021	19,842,500	T.&L.	23.11.2021-31.12.2021
5	Nr.9/37 Prot Datë 28.12.2021	16,682,000	T.&L.	28.12.2021-31.12.2021
6	Nr.9/42 Prot Datë 04.03.2022	23,451,350	O.	3 muaj
7	Nr.9/47 Prot Datë 29.04.2022	6,585,000	T.&L.	3 muaj
8	Nr.9/52 Prot Datë 25.05.2022	29,832,990	T.&L.	4 muaj
9	Nr.9/57 Prot Datë 29.07.2022	21,500,175	T.&L.	3 muaj
10	Nr.9/63 Prot Datë 31.08.2022	6,132,000	O.	1 muaj
Totali leke pa TVSh		199,300,515		

Pas lidhjes së marrëveshjes kuadër, OE të shpallur të suksesshëm janë ftuar për të paraqitur ofertat ekonomike në minikonkurset që ka zhvilluar SUT.

Çmimet për njësi të materialeve ortopedike të marrëveshjes kuadër shërbejnë si reference për ofertat që do të paraqesin OE në minikonkurset që do të zhvillohen.

*** **Lidhur** me zhvillimin e minikonkursit me fond limit 35,631,800 leke pa TVSh, grupi i posaçëm për zhvillimin e tij ka shpallur fitues OE O. me ofertën 35,628, 900 leke pa TVSh me të cilin AK ka lidhur kontratën Nr.9/20 Prot Datë 01.06.2021 me vlerën totale 35,628, 900 lekë me TVSh.

Titulli i gjetjes:	Mos plotësim i kushteve të MK
Situata:	<p>Nga auditimi konstatohet se: Komisioni për zhvillimin e minikonkurseve, ka shpallur fitues OE Orthonet i cili nuk plotësonte kushtet e marrëveshjes kuadër pasi, për materialet e renditura në <u>tabelën nr.1 aneksi 2.6.6</u> çmimi i ofruar nga OE O. në minikonkursin rezultoi që të jetë më i lartë se çmimi referent. Vlera totale prej <u>498,250 lekë</u> do të konsiderohet dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit. Kjo shumë përfaqëson diferencën midis çmimit të ofertuar dhe të shpallur fitues në minikonkursin e parë dhe çmimit referent të marrëveshjes kuadër për sasinë e furnizuar me faturën tatimore nr. 10011/2021 datë 07.06.2021 të mallrave të dorëzuar nga OE O. pranë farmacisë qendrore të SUT. Në këto kushte komisioni i posaçëm i ngritur për organizimin e minikonkurseve ka vepruar në kundërshtim me LPP dhe akteve ligjore në fuqi duke shpallur fitues OE O., i cili ka ofertuar materialet e paraqitura në tabelën nr.1. me çmimin për njësi më të lartë se ai referent.</p> <p>Për të njëjtat arsye të sipërcituara, Komisioni për zhvillimin e minikonkurseve, ka shpallur fitues OE O. i cili nuk plotësonte kushtet e marrëveshjes kuadër pasi, për materialet e renditura në <u>tabelën nr.2 aneksi 2.6.6.</u> çmimi i ofruar për materialet respektive ortopedike nga OE O. në ofertën e shpallur fitues nga ky komision rezultoi që të jetë më i lartë se çmimi referent i përcaktuar në marrëveshjen kuadër. Vlera totale prej <u>229,650 lekë</u> do të konsiderohet dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit. Kjo shumë përfaqëson diferencën midis çmimit të ofertuar dhe të shpallur fitues në minikonkursin ku është lidhur kontrata Nr.9/42 Prot Datë 04.03.2022 dhe çmimit referent të marrëveshjes kuadër për sasinë e furnizuar me faturën tatimore nr. 71/2022 date 07.03.2022 të mallrave të dorëzuar nga OE O. pranë farmacisë qendrore të SUT. Në këto kushte komisioni i posaçëm i ngritur për organizimin e minikonkurseve ka vepruar në kundërshtim me LPP dhe akteve ligjore në fuqi duke shpallur fitues OE O. i cili ka ofertuar materialet e paraqitura në tabelën nr.2 me çmimin për njësi më të lartë se ai referent. <i>Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi z.G. H., M. S., B.V. në cilësinë e anëtarëve të komisionit për zhvillimin e minikonkursit nga ku është shpallur fitues OE O. mbi bazën e të cilës është lidhur kontrata Nr.9/42 Prot Datë 04.03.2022 në shumën 23,451,350.</i></p>

Kriteri:	LPP dhe akteve ligjore në fuq, Marrëveshjes Kuadër me Nr.9/14 Prot, datë 17.05.2021
Ndikimi:	Në administrimin dhe qarkullimin e materialeve ortopedike.
Shkaku	Mos respektim i kushteve të MK dhe kontratave të furnizimit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtuesi i institucionit të Spitalit Universitar të Traumës, të analizoj veprimtarinë e Komisionit për zhvillimin e minikonkurseve për këtë procedurë dhe të nxjerr përgjegjësitë për secilin prej anëtarëve të këtij komisioni, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e shumës prej 727,900 lekë nga OE O.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi z.G. H., M. S., K. S. dhe B. V. në cilësinë e anëtarëve të komisionit për zhvillimin e minikonkursit.

Pagesa e kontraktuesve

Për 10 (dhjetë) kontratat e lidhura me kontraktuesit sipas të dhënave të tabelës së mësipërme. Në praktikën e pagesës se tyre nga sektori i financës gjenden bashkëlidhur faturat tatimore elektronike, urdhër shpenzimi dhe proces verbali i marrjes në dorëzim nga komisioni përkatës, si dhe Flete hyrja ne farmacinë qendrore. Në total mbi bazën e minikontratave të lidhura rezulton se janë shpenzuar 199,300,515 lekë pa Tvsh.

2.6.8. Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2022

Në zbatim të pikës 6 të programit të auditimit Nr. 1199/1 Prot. Date 13.01.2023 u shqyrtua dokumentacioni i procedurës së prokurimit publik të vitit 2022 me objekt: *“Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e ortopedisë në SUT” - Marrëveshje Kuadër me disa Operatorë Ekonomikë ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 24 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër*

1.Urdhër Prokurimi Nr.50/7 Datë 01.09.2022	3.Njësia e prokurimit V. R.	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 50/8 datë 06.09.2022
2. Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar mallra”	G.H. R.. J.	A. C. M.S. M.P.
5.Fondi Limit (pa tvsh) 356,206,933.33 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 353,521,600 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 2,685,333.33 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 07.10.2022 Ora:14:00	9.Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit (Ministria e Mbrojtjes)	10.Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës: 3(tre) OE b)S’kualifikuar: 1 (një) OE c) Kualifikuar: 2 (dy) OE
11.Ankimim: Jo		
Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
12.Lidhja e kontratës nr.1 Nr.50/22 Prot., Datë 04.11.2022	Vlera e kontratës 31,721,650 Leke (me TVSH)	
13.Lidhja e kontratës nr.2 Nr.50/27 Prot., Datë 16.12.2022	Vlera e kontratës 29,622,250 Leke (me TVSH)	

Përfundimi i marrëveshjes kuadër i vitit 2021

Grupi i monitorimit të Marrëveshjes Kuadër të vitit 2021, i përberë nga V. R., B. G. dhe A.C.nëpërmjet kërkesës nr. 432 Prot., datë 04.07.2022, drejtuar Drejtoreshës së SUT Znj. E.B. ka informuar përfundimin para afatit të marrëveshjes kuadër të vitit 2021 dhe njëkohësisht kanë kërkuar vazhdimin e furnizimit të pandërprerë me materiale ortopedike të konsumit dhe materiale të osteosintezës, interne

dhe eksterne të traumatologjisë të sistemit lokomotor duke përcaktuar sasi të që duhen për një periudhë tjetër 2 vjeçare.

Spektori i planifikimit të SUT me shkresën nr. 446 Prot., datë 07.07.2022, ka paraqitur kërkesën për fillimin e prokurimit me objekt "Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT", për një periudhë 24 mujore.

Hartimi i specifikimeve teknike:

Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike i ngritur me urdhrin nr.50 datë 18.07.2022, përbehej nga: V. R.; B. G. dhe A. C. Specifikimet teknike të hartuara nga grupi i punës janë pasqyruara në shkresën nr. 50/1 Prot., datë 05/08/2022.

Hartimi i fondit limit:

Grupi për llogaritjen e fondit limit është ngritur me urdhrin nr. 50/2 Prot., datë 08.08.2022 dhe përbehej nga: G. H., E.P. dhe M.S.

Grupi i përllogaritjes së fondit limit ka kërkuar oferta nga OE .shpk, OE T. shpk dhe L. shpk nëpërmjet shkresës nr. 50/3 Prot., datë 08.08.2022.

OE të sipërcituar kanë paraqitur ofertat e tyre, të cilat janë administruar nga SUT me nr. 50/4 Prot., datë 10.08.2022.

Mbi bazën e ofertave të OE dhe fondit limit të përcaktuar në Marrëveshjen Kuadër Nr.9/14 Prot, datë 17.05.2021, grupi i përllogaritjes së fondit limit, ka përcaktuar vlerën **356,206,933.33 lekë** pa TVSH, për afatin kohor të furnizimit për dy vite.

Përllogaritja e këtij Fondi Limit është pasqyruar në proces verbalin nr. 50/5 Prot., datë 22.08.2022.

Nga administrimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, konstatohet se:

Në përgjigje të kërkesës së SUT nr.1822 Prot., datë 23.08.2022, për zhvillimin e procedurës me prokurim të përqendruar drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e cila me shkresën nr. 3367/1 Prot., datë 31.08.2022 ka autorizuar AK., SUT për kryerjen e prokurimit për një periudhë 24 mujore.

Njësia e prokurimit është ngritur me urdhrin nr. 50/7 Prot., datë 01.09.2022, e cila përbehej nga: V. R., G. H. dhe R. J.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është ngritur me urdhrin nr. 50/8 Prot., datë 06.09.2022, i cili përbehej nga: A.C., M. S. dhe M.P.

Hartimi i dokumenteve të tenderit

Anëtarët e Njesisë së Prokurimit të SUT, më datë 07.09.2022 kanë hartuar DST për procedurën e hapur mbi kufirin e lartë monetar, me objekt "Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT" - Marrëveshje Kuadër me disa Operatorë Ekonomikë ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 24 mujore nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër. Kjo procedurë është e shpallur me Nr. REF-40729-09-06-2022.

Njoftimi i Kontratës së Shpallur është bërë me formularin nr. 50/9 Prot., datës 06.09.2022

******Lidhur me kriteret e vendosura nga NJHDT në DST**, konstatohet se pas hedhjes së DST në SEP janë bërë ndryshime të saj, nëpërmjet Shtojcës nr. 50/11 Prot., datë 14.09.2022 për arsye të modifikimit të specifikimeve teknike nga vet Autoriteti Kontraktor, bazuar në LPP 162 Datë 23.12.2020, Neni 75., pika 2.

I. AK për plotësimin e kapacitetit teknik, tek kriteri 2.3 pika "e", ka kërkuar që:

“OE duhet të paraqesë autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore, të lëshuar nga MSHMS sipas ligjit 89/2014 “Për Pajisjet Mjekësore”.

Nga auditimi konstatohet se:

Vendosja e këtij kriteri është i pa plotë, pasi AK duhet të kërkoj certifikatën për regjistrimin e pajisjeve mjekësore në regjistrin kombëtar të AKBPM, kjo në referim të ligjit nr. 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”, neni 13 (procesi i regjistrimit) pika 1, c dhe 2 ku parashikohet se:

- | |
|--|
| <p>1. Të gjitha pajisjet mjekësore që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë duhet të regjistrohen në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore që mbahet nga Agjencia e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Aplikimi për regjistrimin e pajisjes mjekësore në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore paraqitet nga:</p> <p>c) tregtuesit me shumicë të pajisjeve mjekësore</p> <p>2. AKBPM-ja lëshon një certifikatë për regjistrimin e pajisjes mjekësore në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore brenda 30 ditëve nga data e marrjes së aplikimit.</p> |
|--|

II. Kërkesa për deklaratë për plotësimin e kriterit 2.3 pika “j”, konkretisht të paraqitjes së certifikatës së regjistrimit të mallit pranë AKBPM në fazën e dorëzimit të mallit, është një kriter që duhet të vendoset si detyrim kualifikues që gjatë fazës së vlerësimit të ofertave dhe jo gjatë dorëzimit të mallit.

*****Lidhur me dorëzimin e mostrave, konstatohet se:**

Nga ana e KVO, më datë 07.10.2022 janë administruar në dosje procesverbalet e inventarizimit të marrjes në dorëzim të mostrave të paraqitura nga OE pjesëmarrës në këtë procedurë. Dorëzimi i tyre nga OE pjesëmarrës është bërë në referim të kriterit 2.3 pika h në DST., ku parashikohet se:

Për të vërtetuar që OE i permbushin specifikimet teknike dhe janë në gjendje të realizojnë me sukses kontratën, duhet që të paraqesin mostra për të gjithë artikujt, sipas tabelës në specifikimet teknike dhe sipas katalogjeve përkatëse të prodhuesit.

- OE ofertues duhet të paraqesin nga një moster për cdo artikull.
- Mostrat duhet të paraqiten në datën dhe oren e hapjes së tenderit.
- Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë SUT, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a. Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.
- Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënojë Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të ofertës.
- Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës. Do të skualifikohen OE në rast se nuk paraqiten dhe/ose mostrat e paraqitura nuk janë sipas specifikimeve teknike.

Do të s’kualifikohen OE në rast se nuk paraqiten dhe/ose mostrat e paraqitura nuk janë sipas specifikimeve teknike.

Titulli i gjetjes:	Dorëzimi i mostrave nga OE nuk plotëson kriteret e kërkuara në DT
Situata:	<p>Kerkesa e AK për paraqitjen e mostrave nga OE, i shërben AK., SUT për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve të kërkuara për objektin e prokurimit, me qëllim që cilësia e materialeve ortopedike të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara.</p> <p>Nga auditimi rezulton se:</p> <p>1.Proces verbali të datës 07.10.2022 i mbajtur nga KVO, mbi dorëzimin dhe paraqitjen e mostrave të OE L. shpk ka mospërputhje me specifikimet</p>

teknike pasi ato nuk përmbajnë elementet e ofertuar sipas të dhënave të katalogëve të ngarkuar në SEP.

Përshkrimi i këtyre artikujve për mostrat e dorëzuara nga ky OE dhe të marra në dorëzim nga KVO, nuk përputhet me specifikimet teknike të kërkuara nga AK në shtojcën 10 të DST, pasi mungon kodi (S/N/Loti apo Ref.) vendi i origjinës së mallit, emri i kompanisë prodhuese, siç kërkohen në kriterin 2.3 pika b e DST.

Për sa më lart, anëtarët e KVO, kanë vepruar në mospërputhje me kriterin 2.3 pika h e DST, duke kualifikuar padrejtësisht OE L. shpk. Në këto kushte KVO, duhej të s'kualifikonte OE L. shpk.

2.OE CFO P.sipas proces verbalit të KVO, nuk ka paraqitur mostra për të gjithë artikujt e kërkuar sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, për këtë arsye KVO e ka skualifikuar këtë OE.

Zhvillimi i procedurës:

KVO, për këtë procedurë ka hartuar Raportin Përmbledhës me nr. 50/14 Prot. Date 25.10.2022, i cili është miratuar nga titullarit i AK.

Në këtë raport KVO ka përshkruar gjithë procedurën e ndjekur deri në shpalljen e OE fituesit.

Sipas këtij Raporti Përmbledhës, rezulton se janë paraqitur 3 (tre) operatorë ekonomike, përkatësisht me ofertë ekonomike si më poshtë:

1. Operatori Ekonomik "C. P." Shpk me ofertë ekonomike: 349.999.999,99 Lekë pa TVSH
2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "T." & "L." me ofertë: 353.521.600 Lekë pa TVSH.
3. Operatori Ekonomik "O." Shpk me ofertë ekonomike: 354.398.600 Lekë pa TVSH.

VO ka skualifikuar OE "C. P." pasi:

1. Në ofertën Ekonomike të paraqitur nga OE, rezultonte që të kishte gabime në lidhje me përlogaritjen e vlerës totale pa TVSH,.

KVO pas përlogaritjes së marrzhit të gabimit të ofertës ekonomike, e cila rezultoi më e madhe se 2 % sic parashikohet në LPP, e skualifikuar OE C.P. si ofertë e pavlefshme.

2. Gjithashtu OE "C. P." nuk ka paraqitur mostra për të gjithë artikujt e kërkuar sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor në DST.

Referuar raportit përmbledhës nr. 50/14 Prot. Date 25.10.2022 të KVO, janë ka kualifikuar dy OE, respektivisht:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik "T." & "L." me ofertë: 353.521.600 Lekë pa TVSH.

2. Operatori Ekonomik "O." Shpk me ofertë ekonomike: 354.398.600 Lekë pa TVSH.

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion grupi të auditimit të KLSH, rezulton se:

Referuar Proces verbalit të datës 07.10.2022 i mbajtur nga KVO, mbi dorëzimin dhe paraqitjen e mostrave të OE L. shpk kishte mospërputhje

të specifikimet teknike pasi ato nuk përmbanin elementet e ofertuar sipas të dhënave të katalogëve të ngarkuar në SEP.

Përshkrimi i këtyre artikujve për mostrat e dorëzuara nga ky OE L. pjese BOE "T.&L." dhe të marra në dorëzim nga KVO, nuk kishin përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST nga AK në shtojcën 10, pasi mungonte kodi (S/N/Loti apo Ref.) vendi i origjinës së mallit, emri i kompanisë prodhuese, siç AK i parashikonte në kriterin 2.3 pika b të DST. Kualifikimi i BOE "T.&L." nga KVO bie ndesh me kërkesat dhe kriteret e vendosura dhe të miratuara nga titullari i autoritetit Kontraktor.

Për sa më lart, anëtarët e KVO, kanë vepruar në mospërputhje me kriterin 2.3 pika h e DST, duke kualifikuar padrejtësisht OE L. shpk. Në këto kushte KVO, duhej të s'kualifikonte OE L. shpk

Konkluzion:

- KVO ka kualifikuar OE L. pjese BOE "T.&L." në kushtet kur ky OE, nuk i plotësonte kërkesat e AK në lidhje me listën e paraqitjes së mostrave, duke vepruar në mospërputhje me kriterin 2.3 pika h në DST.

- OE L. si pjese e BOE nuk përmbush kriteret për kualifikim, në këto kushte AK duhej të skualifikonte BOE.

-Pasi KVO ka skualifikuar me të drejtë OE C. P. për mosparaqitjen e plotë të mostrave.

-Në kushte kur OE L., pjese e BOE nuk përmbush kriteret për kualifikim, KVO duhej të **KISHTE** skualifikuar BOE, dhe duke qene se oferta e OE "O." Shpk e kualifikuar por ekonomikisht me pak e leverdiseshme për AK SUT, duhej të anulonte këtë procedurë.

Për sa më lart, KVO ka vepruar duke favorizuar BOE edhe pse në kushtet e skualifikimit.

Grupi i auditimit të KLSH **vlerën 353.521.600 Lekë** të kontratës së lidhur me BOE "T.&L." e konsideron perdorim pa efektivitet të buxhetit të SUT.

*****KVO, ka kualifikuar dy OE pjesëmarrës, respektivisht BOE "T." & "L." SHPK dhe "O." SHPK**

Pas kualifikimit të OE pjesëmarrës, KVO ka pranuar Ofertat ekonomike sipas klasifikimit të mëposhtëm.

1. BOE "T." Shpk dhe "L." Shpk me ofertën ekonomike 353.521.600 Lekë pa TVSH.

2. "O." Shpk me ofertën ekonomike 354.398.600 Lekë pa TVSH.

Formulari i njoftimit të Operatoreve Ekonomik të suksesshëm në marrëveshjen kuadër është bërë me shkresën nr. 50/13 Prot., të datës 11.10.2022 .

Pas verifikimit edhe të dokumentacionit të shkruar nga OE të cilat sipas KVO përputheshin me ato të ngarkuara në SEP, është nënshkruar Marrëveshja Kuadër nr. 50/16 Prot., datë 25.10.2022, me objekt: "Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT" midis SUT dhe B.OE "T." & "L." SHPK dhe "O." SHPK me vlerën

	e fondit limit për një afat kohor dy vjeçar. Marrëveshje kuadër nuk është një kontratë më vete, por përcakton kushtet për kontratat që do të lidhen mbi bazën e saj. <i>Oferta ekonomike, sipas parimit të çmimit më të ulët e ofertuar nga BOE “T. dhe L.”, në vlerën 353.521.600 leke pa TVSh, shërben si fond limit për minikonkurset që do të zhvillohen.</i>
Kriteri:	Kriteri 2.3 pika h e DST, Marrëveshja Kuadër nr. 50/16 Prot., datë 25.10.2022.
Ndikimi:	Në cilësinë e materialeve ortopedike.
Shkaku	Mos respektim të kriterereve të veçanta të përcaktuarnë DST.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Titullari i AK t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit dhe procesit të shqyrtimit e vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve nga komisionet e vlerësimit të ofertave.

Për veprimet apo mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: A. C., M. S. dhe M. P. në cilësinë e anëtarëve të KVO dhe znj.E.B. në cilësinë e miratueses së raportit përmbledhës nr. 50/14 Prot. Date 25.10.2022 te KVO.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.1375/4 prot, datë 04.07.2023 nga G. H., M. S. dhe M. P.

Pretendimet e subjektit:

Në mënyrë të përmbledhur observacioni konsiston në pjesën deklarative dhe nuk është shoqëruar apo kundërshtuar me dokumentacion që nuk është njohur me pare nga grupi i auditimit të KLSH, për më tepër nuk ka objekt gjetjet e grupit të auditimit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

Ne mungese të dokumentacionit vërtetues për sa janë pasqyruar në këtë pjesë të raportit përfundimtar të Auditimit, observacioni nuk do të merret parasysh.

Monitorimi i marrëveshjes kuadër:

Komisioni i Posaçëm për Monitorimin dhe Zbatimin e Marrëveshjes Kuadër i ngritur me urdhrin nr. 50/17 Prot., datë 25.10.2022, përbëhet nga: A. C., V. R. dhe M.P.

Zhvillimi i minikonkurseve:

Komisionit për zhvillimin e minikonkurseve sipas Marrëveshjes Kuadër nr. 50/16 Prot., datë 25.10.2022 është ngritur me urdhrin nr. 50/18 Prot., datë 26.10.2022, dhe përbëhet nga: G.H., M. S., dhe R.J.

Nëpërmjet shkresës nr. 50/19 dhe 50/20 Prot., datë 31.10.2022, janë dërguar ftesat për ofertë BOE “T.” & “L.” dhe OE “O.” me FL 31,915,150 leke pa TVSH për minikonkursin e parë.

Autoriteti Kontraktor në ftesat e dërguara OE, njofton se ofertat do të paraqiten në ambientet e SUT (zyra e prokurimeve) më datë 01.06.2021 ora 14:00, krahas ofertës AK ka kërkuar paraqitjen e dokumentacionit të mposhtëm:

a. OE duhet të paraqesin ofertën e tyre brenda datës dhe orës së caktuar.

b. OE duhet të përgatisin ofertën në mënyrë që vlera e ofertës të mos jetë më e lartë se vlera e fondit limit të përcaktuar në ftesën për Ofertë. Ofertat me vlera më të larta do të s’kualifikohen.

c. OE duhet të paraqesin një vetë deklaram me shkrim se kanë gjendje të gjitha materialet e kërkuara dhe do te vene në dispozicion te SUT, sa here që do të ketë nevojë, të gjitha përmasat dhe llojet e materialeve që do te kërkohe në mënyrë që të mos ketë mangësi gjatë operacioneve që do të zhvillohen sipas urgjencave dhe nevojave të SUT.

d. Të gjitha materialet do të sillen me anë të kontratës se furnizimit ne SUT mund të ndërrohen (mallrat/materialet do të qëndrojnë te magazinuar në farmacinë e SUT) sipas përmasave dhe llojeve të kërkuara rast pas rasti. *Çdo material që do të ndërrohet, duhet të pasqyrohet me anë të një procesverbali të cilin e firmosin përfaqësuesit e OE dhe përfaqësuesit e SUT që do të marrin pjesë gjatë operacioneve kirurgjikale rast pas rasti. Vlera e materialeve nuk do të ndryshojë nga ajo e kontratës së furnizimit.*

e. OE duhet të paraqesin një vetëdeklaram me shkrim se do te vene ne dispozicion të SUT një specialist të trajnuar sipas llojeve të materialeve të furnizuara (sipas prodhuesit duhet të paraqitet dhe specialistit përkatës i trajnuar).

*** **Vlerësimi i ofertave** të paraqitura nga ana e OE të klasifikuar të suksesshëm me të cilët është lidhur marrëveshja kuadër është bërë nga komisioni për zhvillimin e minikonkurseve të SUT.

Nga administrimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion të grupit të auditimit të KLSH, konstatohet se OE:

Ofertat OE pjesëmarrës i kanë dorëzuar fizikisht ne zyrën e prokurimeve të SUT.

Oferta ekonomike e paraqitur nga BOE T. &L. dhe OE O. është pasqyruar në Proces Verbalin nr. 50/21 Prot. Date 02.11.2022., të Komisionit për zhvillimin e minikonkurseve i përbërë nga G. H., M. S., dhe R. J. Sipas këtij proces verbali OE Orthonet 360 ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën 31,729,200 leke pa TVSH dhe BOE T. &L. paraqiti ofertën **31,721,650 leke (pa TVSh).**

Komisionit për zhvillimin e minikonkurseve sipas Marrëveshjes Kuadër nr. 50/16 Prot., datë 25.10.2022 ka shpallur fitues në vendin e parë BOE T. &L. me ofertën **31,721,650 leke (pa TVSh).**

Për këtë procedurë janë zhvilluar 2 minikonkurse dhe janë lidhur 2 minikontrata, siç pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Minikontrata	Nr Prot dhe date	Vlera pa Tvsh	Kontraktuesi	Afati
1	Nr.50/22 Prot Datë 04.11.2022	31,721,650	T.&L.	04.11.2022-31.12.2022
2	Nr.50/27 Prot Datë 16.12.2022	29,622,250	O.	16.12.2022-31.12.2022
Totali lekë pa tvsh		61,343,900		

Komisionit të pritjes, kontrollit dhe marrjes ne dorëzim

Komisioni i pritjes, kontrollit dhe marrjes në dorëzim i ngritur me urdhrin nr. 317 Prot., datë 15.06.2022, për vitin 2022 e në vazhdim, përbëhej nga: E. Q., I. H. dhe L. F.

Titulli i gjetjes:	Marrja në dorëzim e mallrave ne mungese te certifikatës se origjinës së mallit dhe te regjistrimit pranë AKBPM
Situata:	Nga auditimi konstatohet se: 1. BOE T.&L. dhe OE O.në cilësinë e kontraktuesit, gjatë dorëzimit të mallit sipas kontratave respektive nuk kanë shoqëruar mallin me certifikatën e regjistrimit pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Në këto kushte komisioni i pritjes dhe kolaudimit të mallit ka vepruar në mospërputhje me pikën j) të kriterit 2.3 paragrafi i dytë ku është përcaktuar se:

	<p>OE duhet të paraqesin një deklaratë ku të shprehet se do të vendosi në dispozicion të AK, certifikatat e origjinës së mallit (implanteve) <u>dhe certifikatat e regjistrimit të mallit pranë Institucioneve përkatëse në RSH.</u> Certifikatat duhet të shoqërojnë mallin sipas kontratave të furnizimit që do të nënshkruhen përgjatë periudhës 24 mujore</p> <p>2.Në Kontratën nr. Nr.50/22 Prot. datë 04.11.2022 dhe Nr.50/27 Prot., datë 16.12.2022 nuk kanë reflektuar kërkesat e parashikuara në DST të procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e ortopedisë në SUT” duke mos përfshirë në to, kërkesat e kriterit 2.3 pika “j”, konkretisht të paraqitjes së certifikatës së regjistrimit të mallit pranë AKBPM dhe certifikatës së cilësisë se mallit në fazën e dorëzimit të mallit.</p> <p><i>Për sa më lart, hartuesit e kontratës për këtë procedurë kanë vepruar në mospërputhje me kërkesat e parashikuara dhe të miratuara nga titullari i AK.</i></p>
Kriteri:	Kriteret e vendosura në DST
Ndikimi:	Në cilësinë e materialeve ortopedike të marra në dorëzim.
Shkaku	Mos respektim të kuadrit ligjor në fuqi për prokurimet publike.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Titullari i institucioni të marrë masa që komisioni i pranimit dhe drejtuesi i shërbimit të farmacisë qendrore, gjatë procesit të marrjes në dorëzim të mallrave, të kërkojnë që mallrat të shoqërohen me dokumentacionin e kërkuar nga AK, në rastin konkret të certifikatave të origjinës së mallit dhe të certifikatës së regjistrimit pranë AKBPM.

Për veprimet apo mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

E. Q., I. H.dhe L.F. në cilësinë e anëtarëve të pritjes së mallit dhe E. K.në cilësinë e shefes së shërbimit të farmacisë, si dhe B. T. në cilësinë e përgjegjësit të sektorit juridik dhe z. G. H. në cilësinë e përgjegjësit të sektorit të prokurimeve publike.

2.7. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qera të aktiveve afatgjata materiale

1. Shoqëria “U.-A.” (A. H.) sh.a.

Vendimi Nr.729, datë 18.10.2006, vendosi dhënien me qera pa konkurim shoqërisë “U.-A.” Shpk të disa mjediseve me sipërfaqe trualli gjithsej 15,638 m² në Spitalin Ushtarak Qëndror Universitar Tiranë, institucion në varësi administrative të Ministrisë së Mbrojtjes, për ngritjen e një qendre spitalore. Afati i kontratës së qerasë do të jetë 20 (njëzet) vjet.

Në datë 28.12.2006 është lidhur Kontrata e Qerasë me Nr.10817 Rep. 9783 Kol me palë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (Qeradhënës) dhe shoqëria “U.-A.” Shpk, përfaqësuar nga Drejtori i shoqërisë Z.K. A. (Qeramarrës). Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qera e disa objekteve në Spitalin Ushtarak Qëndror Universitar me sipërfaqe gjithsej 15,449 m² nga të cilat nën objekt 809 m². Afati i Kontratës së qerasë është 20 (njëzet) vjet. Qeramarrësi do të paguaj Qeradhënësit një qera mujore prej 755,100 lekë.

Në datë 13.01.2007 është lidhur Aneks Kontratë Nr.1 ku në Nenin 1 pika 1.1 është bërë një ndryshim dhe shtohet prej 500 m² e gjitha nën objekt. Sipërfaqe e përgjithshme bëhet 15,949 m² prej nga 1,307 sipërfaqe ndërtese. Neni 6, Pika 1.1 riformulohet dhe qeramarrësi detyrohet të paguajë qeradhënësit detyrimin mujor në vlerën 855,100 lekë.

Në datë 30.08.2013 është lidhur Kontrata e Qerajsë me Nr.677 Rep. 158 Kol. me palë Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës (Qeradhënës) dhe shoqëria “U.-A.” Shpk, përfaqësuar nga Drejtori i shoqërisë Z.K.Al. (Qeramarrës). Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qera e pasurisë “Ambiente në Katin e dytë të Spitalit Universitar të Traumës, Tiranë”, me sipërfaqe të përgjithshme 496 m² e gjitha sipërfaqe në ndërtesë. Objekti i kësaj Kontrate është kryerja e shërbimeve spitalore kryesisht në Kardiologji dhe Kardiokirurgji. Afati i Kontratës së Qerasë është 10 vjet. Qeramarrësi do të paguaj Qeradhënësit një qera mujore prej 104,000 lekë. Pas investimeve të bëra ndër vite nga ana e Qeramarrësit kuota mujore e qerasë është ulur. Kjo gjë është cituar dhe në Kontratën e Qerasë me Nr.10817 Rep. 9783, datë 28.12.2006.

Në vijim të auditimit të kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në vitin 2015, ku është konstatuar përdorimi i sipërfaqeve shtesë pa kontratë nga ana e Shoqërisë “A. H.” sha, si dhe ndërtime pa leje mbi territorin dhe godinat e SUT, nga ana e kësaj të fundit (SUT) është filluar ndjekja e rrugës ligjore për rivendosjen e të drejtave të cënuara.

Në këtë drejtim, nga ana e SUT është iniciuar procesi gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke u depozituar Kërkesë Padi me Nr. 2697 prot., datë 13.12.2018. Kjo kërkesë padi është protokolluar pranë sekretarisë së Gjykatës në datën 24.12.2018 dhe ka palë e objekt si më poshtë:

Paditës:	Spitali Universitar i Traumës. Adresa: Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.
I Paditur:	Shoqëria “A. H.” sha. Adresa: Rr. “S. G.”, Tiranë
Personi i Tretë:	1. Ministria e Financave dhe Ekonomisë 2. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Objekti:	1- Detyrimin e Shoqërisë “A. H.” sha për t’i paguar SUT-së vlerën e detyrimit për sipërfaqet e rezultuara shtesë që përdoren pa kontratë qiraje; Detyrimin për t’i paguar SUT-së detyrimin që rrjedh nga përdorimi i i sipërfaqeve të ndërtuara pa leje në territorin e SUT dhe mbi godinat e SUT; Detyrimin për ti paguar SUT-së detyrimet që rrjedhin nga përdorimi i ambjenteve të SUT pa kontratë qiraje për periudhën 2011 – 2013 periudhë kjo deri në rilidhjen e kontratës së qirasë. Këto detyrime të paguhen deri në momentin e lirimit të ambjenteve ose lidhjes së kontratës nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për këto shtesa. 2- Gjithashtu kërkojmë kamatëvonesat e detyrimeve të mësipërme. 3- Shenzimet gjyqësore në ngarkim të të paditurit. 4- Saktësimin e sipërfaqeve të ndërtuara pa leje brënda truallit të dhënë me qira të paditurit sipas VKM 729 date 18.10.2006 dhe përcaktimin e detyrimit për to duke përfshirë dhe kamatëvonesat deri në momentin e lirimit të ambjenteve ose lidhjes së kontratës nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për këto shtesa.

Shënim: Ky proces po zhvillohet gjithashtu edhe me pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit si palë.

2. Kontrata e qirasë me O.E. “S.C.” Shpk

Në datë 17.07.2020 është lidhur Marrëveshja Kuadër Nr.7/26 me palë Spitali Universitar i Traumës i referuar si Autoriteti Kontraktor dhe shoqëria “S.C.” Shpk i referuar si Sipërmarrës. Objekti i marrëveshjes kuadër është të përcaktojë kushtet, përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat për dorëzimin e mallrave/shërbimeve/punëvë në vijim. Kryerjen e Shërbimit të lavanderisë për një periudhë 48 mujore në SUT. Fondi limit në total për katër vite është 199,290,000 lekë pa TVSH. Kohëzgjatja e marrëveshje kuadër do të jetë nga 17.07.2020 deri më 17.07.2024 (48 muaj).

Në datë 09.02.2021 është lidhur Kontrata e Qerasë Nr.7/41 Prot., me palë “Spitali Universitar i Traumës (Qerradhënës): dhe Shoqëria “S. C.” Shpk (Qeramarrës)”. Objekti i kësaj Kontrate është dhënia me qera mini-ambientet dhe hapsirë me sipërfaqe totale 67.2 m² si dhe çmim/ njësi 300 lekë për 1m² për çdo muaj. Qëllimi i dhënies me qera është për të bërë te mundur realizimin me sukses të Marrëveshjes Kuadër me Nr.7/26 Prot., datë 17.07.2020 me objekt “Kryerjen e shërbimit të lavanderisë për një periudhë 48 mujore në SUT”. Afati i kësaj Kontrate do të përfundojë me Marrëveshjen Kuadër. Tarifa mujore do të jetë 20,160 Lekë/Muaj. Për periudhën nga data 20.07.2020 – 20.01.2021 vlera e detyrimit është 120,960 lekë. Kjo pagesë do të bëhet nga Qeramarrësi brënda 5 ditëve nga nënshkrimi i Kontratës, në rast të kundërt ky detyrim do ti zbritet nga Fatura Mujore e Shërbimit të Lavanderisë.

3. Kontratat e Qirasë me O.E. “S.-A.” Shpk

Në datë 03.12.2018 është lidhur Kontratë për “Kryerja e shërbimit të pastrimit të ambienteve të brëndshme dhe pastrimi i ambjenteve të jashtme në SUT” me Nr.218 Prot., me palë Spitali Universitar i Traumës (Autoriteti Kontraktor) dhe OE S.A. Shpk (Sipërmarrësi). Objekti i kësaj kontrate është “Kryerja e shërbimit të pastrimit të ambienteve të brëndshme dhe pastrimi i ambjenteve të jashtme në SUT”. Afati i kësaj kontrate do të jetë 3 (tre) vjet.

Në datë 31.03.2021 është lidhur Kontrata e Qerasë Nr. 686 Prot., me palë Spitali Universitar i Traumës përfaqësuar nga Drejtori z. A.Z. në cilësinë e “Qeradhënësit” dhe Shoqëria “S.-A.” Shpk përfaqësuar nga administratori znj. A. T. në cilësinë e “Qeramarrësit”. Objekt i kësaj kontrate është dhënia me qera e ambienteve Zyra & Garderobë në hyrje të SUT-së prej 28.04 m², Depo me sipërfaqe 5.74 m² dhe Bodrumit ambient i përbashkët për të gjithë sanitaret prej 15.37 m², të ndodhura në ambientet e SUT-së. Kohëzgjatja e kësaj kontrate është nga momenti i nënshkrimit deri në përfundim të Kontratës së Shërbimit Nr.218 Prot., datë 03.12.2018. Kuota e qerasë do të jetë 300 lekë/m². Pagesa totale mujore do të jetë 14,745 lekë/muaj.

Në datë 22.12.2021 është lidhur Kontrata e Qerasë Nr. 2806 Prot., me palë Spitali Universitar i Traumës përfaqësuar nga Drejtori znj. E. B. në cilësinë e “Qeradhënësit” dhe Shoqëria “S.-A.” Shpk përfaqësuar nga administratori znj. A. T. në cilësinë e “Qeramarrësit”. Objekt i kësaj kontrate është dhënia me qera e ambienteve Zyra & Garderobë prej 30 m², Depo me sipërfaqe 5.74 m² dhe Bodrumit ambient i përbashkët për të gjithë sanitaret prej 15.37 m², të ndodhura në ambientet e SUT-së. Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia me gëzim të përkohshëm të ambienteve për kryerjen e shërbimit të pastrimit sipas Kontratës së Shërbimit Nr.84/11 Prot., datë 01.12.2021. Afati është 1 muaj (01.12.2021-31.12.2021).

Në datë 07.01.2022 është lidhur Kontratë Shërbimi për “Shërbimi i pastrimit të ambienteve të brëndshme dhe të jashtme në SUT për nevoja emergjente” me Nr.105/11 Prot., me palë Spitali Universitar i Traumës (Autoriteti Kontraktor) dhe OE S.-A. Shpk (Sipërmarrësi). Objekti i kësaj kontrate është “Shërbimi i pastrimit të ambienteve të brëndshme dhe të jashtme në SUT për nevoja emergjente”. Afati i kësaj kontrate do të jetë 4 (katër) muaj.

Në datë 28.02.2022 është lidhur Kontratë Qeraje Nr. 321/1 Prot., me palë Spitali Universitar i Traumës përfaqësuar nga Drejtori znj. E. B. në cilësinë e “Qeradhënësit” dhe Shoqëria “S.-A.” Shpk përfaqësuar nga administratori znj. A.T.në cilësinë e “Qeramarrësit”. Objekt i kësaj kontrate është dhënia me qera e ambienteve Zyra & Garderobë prej 30 m², Depo me sipërfaqe 5.74 m² dhe Bodrumit ambient i përbashkët për të gjithë sanitaret prej 15.37 m² të ndodhura në ambientet e SUT-së. Afati i kësaj Kontrate do të jetë sipas afatit të Kontratës së Shërbimit Nr. 105/11 Prot., datë 07.01.2022. Kohëzgjatja e kësaj kontrate qeraje do të jetë 4 muaj nga data 01.01.2022 – 30.04.2022. Kuota e qerasë do të jetë 300 lekë/m² dhe pagesa totale 15,333 lekë/muaj.

Titulli i gjetjes:	Mungesa e lidhjes së kontratave të furnizimit me energji dhe ujë të pijshëm për kontraktuesin S.-Al.
Situata:	<p>Në datë 01.08.2022 është lidhur Kontratë Shërbimi për “Shërbimi i pastrimit të ambienteve të brëndshme dhe të jashtme në SUT për nevoja emergjente” me Nr.57/11 Prot., me palë Spitali Universitar i Traumës (Autoriteti Kontraktor) dhe OE S.-A. Shpk (Sipërmarrësi). Objekti i kësaj kontrate është “Shërbimi i pastrimit të ambienteve të brëndshme dhe të jashtme në SUT për nevoja emergjente”. Afati i kësaj kontrate do të jetë 4 (katër) muaj.</p> <p>Në datë 02.08.2022 është lidhur Kontratë Qeraje Nr. 57/16 Prot., me palë Spitali Universitar i Traumës përfaqësuar nga Drejtori znj. E. B. në cilësinë e “Qeradhënësit” dhe Shoqëria “S.-Al” Shpk përfaqësuar nga administratori znj. A. T. në cilësinë e “Qeramarrësit”. Objekt i kësaj kontrate është dhënia me qera e ambienteve Zyra & Garderobë prej 30 m², Depo me sipërfaqe 5.74 m² dhe Bodrumit ambient i përbashkët për të gjithë sanitaret prej 15.37 m² të ndodhura në ambientet e SUT-së. Afati i kësaj Kontrate do të jetë sipas afatit të Kontratës së Shërbimit Nr. 57/11 Prot., datë 01.08.2022. Kohëzgjatja e kësaj kontrate qeraje do të jetë 4 muaj nga data 01.08.2022 – 31.12.2022. Kuota e qerasë do të jetë 300 lekë/m² dhe pagesa totale 15,333 lekë/muaj.</p> <p>Nga auditimi i dokumentacionit të mësipërm u konstatua:</p> <p>Në përmbajtje të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, si dhe pas verifikimit të pagesave, nuk u konstatua asnjë kontratë furnizimi me energji dhe ujë të pijshëm për ambjentet marrë me qira nga O.E. i sipërcituar, në mospërputhje me Nenin 6 “Detyrimet e palëve” Pika 6.2 “Të drejtat dhe detyrimet e qeramarrësit”.</p> <p>Në përmbajtje të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, si dhe pas verifikimit të pagesave, nuk u konstatua asnjë kontratë furnizimi me energji dhe ujë të pijshëm për ambjentet marrë me qira nga O.E. i sipërcituar</p>
Kriteri:	Nenin 6 “Detyrimet e palëve” Pika 6.2 “Të drejtat dhe detyrimet e qeramarrësit”.
Ndikimi/Efekti:	Rritja e kostove operacionale të SUT-së
Shkaku:	Moszbatimi i kushteve të kontratës
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtoria e SUT, të marrë masa të hartojë dhe të finalizojë kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm me operatorët ekonomik, kontraktues të ambienteve dhënë me qira nga ana e A.K.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi znj. E. R., z. V. S., z. B. V., znj. D. Ll., znj. M. M. dhe znj. A. D., në cilësinë e grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës.

4. Kontrata Qirasë me P.F. Luan Karuli.

Në datë 18.11.2020 është lidhur Kontratë Qeraje Nr. 2265 Prot., me palë Spitali Universitar i Traumës, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm z. Arben Zenelaj (Qeradhënësi) dhe Person Fizik L. K., përfaqësuar nga administratori z. L. K. (Qeramarrësi). Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qera e disa ambienteve të SUT Tiranë, me sipërfaqe totale 11.52 m². Ky ambient do të përdoret me destinacion për instalimin e 16 distributorëve automatike (8 express dhe 8 frigo) në SUT. Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia me gëzim të përkohshëm të sipërfaqes për ushtrimin e shërbimit kafe-frigorifer, nëpërmjet makinave të distribucionit me monedha. Afati i kësaj Kontrate do të jetë 1 vit nga data e nënshkrimit të saj. Pagesa është përcaktuar në vlerën 350 lekë/m². Për 11.52 m² pagesa totale mujore do të jetë 4,032 lekë/muaj. Kësaj vlere do ti shtohet dhe konsumi i energjisë i cili sipas matjeve të bëra nga specialistët

e sektorit të menaxhimit të teknologjisë së SUT është llogaritur në vlerën 3,677 lekë/muaj me TVSH. Vlera totale mujore e kontratës së qerasë është 7,709 Lekë.

Në datë 05.04.2022 është lidhur Kontratë Qeraje Nr. 736 Prot., me palë Spitali Universitar i Traumës, përfaqësuar nga Drejtorie znj. E. B. (Qiradhënës) dhe Person Fizik L. K., përfaqësuar nga administratori z. L.K. (Qiramarrës).

Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qera e disa ambienteve të SUT Tiranë, me sipërfaqe totale 9.1 m². Ky ambient do të përdoret me destinacion për instalimin e 16 distributorëve automatike (8 express dhe 8 frigo) në SUT.

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia me gëzim të përkohshëm të sipërfaqes për ushtrimin e shërbimit kafe-frigorifer, nëpërmjet makinave të distribucionit me monedha.

Afati i kësaj Kontrate do të jetë 1 vit nga data e nënshkrimit të saj. Pagesa është përcaktuar në vlerën 350 lekë/m². Për 9.1 m² pagesa totale mujore do të jetë 3,185 lekë/muaj. Kësaj vlere do ti shtohet dhe konsumi i energjisë i cili sipas matjeve të bëra nga specialistët e sektorit të menaxhimit të teknologjisë së SUT është llogaritur në vlerën 3,677 lekë/muaj me TVSH. Vlera totale mujore e kontratës së qerasë është 6,682 lekë.

5. Kontrata e Qirasë me O.E. “D.P. 2007” shpk

Në datë 22.07.2022 është lidhur Kontratë Qeraje Nr. 52/13 Prot., me palë “Spitali Universitar i Traumës” përfaqësuar nga Drejtorie znj. E.B., në cilësinë e “Qeradhënësi” dhe OE “D. P. 2” Shpk me administrator z. L. Q., në cilësinë e “Qeramarrësi”. Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qera mini ambientet dhe hapsirë totale 74.3 m² si dhe çmim/njësi 301 lekë për 1m²/muaj. Qëllimi i kësaj kontrate është realizimi me sukses i Marrëveshjes Kuadër me Nr. 97/26 Prot., datë 13.06.2022 me objekt “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi për Spitalin Universitar të Traumës” në funksion të interesit publik duke garantuar përkujdesin ndaj pacientëve të SUT-së. Afati i lidhjes së kësaj kontrate është 36 muaj (3 vjet). Pagesa totale për 74.3 m² është 22,364.3 lekë/muaj.

Bashkëlidhur me këtë Kontratë Qeraje janë edhe Planimetritë.

Nga auditimi i dokumentacionit të mësipërm u konstatua:

Në përmbajtje të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, si dhe pas verifikimit të pagesave, Z. D.L. (Inxhinier elektrik) mban procesverbal për konsumin e energjisë si dhe cmimi i energjisë caktohet nga zyra e financës dhe i bashkangjitet faturës së qirasë mujore por nuk u konstatua asnjë kontratë furnizimi me energji dhe ujë të pijshëm për ambjentet marrë me qira nga O.E. i sipërcituar, në mospërputhje me *Nenin “Detyrimet e palëve” Pika 6.2 “Të drejtat dhe detyrimet e qeramarrësit”*.

Titulli i gjetjes:	Mungesa e Kontratave të furnizimit me energji dhe ujë të pijshëm
Situata:	Në përmbajtje të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, si dhe pas verifikimit të pagesave, Z. D. L. (Inxhinier elektrik) mban procesverbal për konsumin e energjisë si dhe cmimi i energjisë caktohet nga zyra e financës dhe i bashkangjitet faturës së qirasë mujore por nuk u konstatua asnjë kontratë furnizimi me energji dhe ujë të pijshëm për ambjentet marrë me qira nga O.E. i sipërcituar.
Kriteri:	<i>Nenin 6 “Detyrimet e palëve” Pika 6.2 “Të drejtat dhe detyrimet e qeramarrësit”.</i>
Ndikimi/Efekti:	Rritja e kostove operacionale të SUT-së.
Shkaku:	Moszbatimi i kushteve të kontratës.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	SUT, të marrë masat të hartojë dhe të finalizojë kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm me operatorët ekonomik, kontraktues të ambienteve dhënë me qira nga ana e A.K.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi znj. E. R., z. V. S., z. B. V., znj. D. Ll., znj. M. M. dhe znj. A. D., në cilësinë e grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës.

6. Kontrata e qirasë me O.E. “R.” Shpk

Në datë 04.11.2022 është lidhur Kontratë Qeraje Nr.83/16 Prot., me palë “Spitali Universitar i Traumës” përfaqësuar nga Drejtore znj. E. B., në cilësinë e “Qeradhënësi” dhe OE “R.” Shpk përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor i pajisur me prokurë të posaçme Nr.2454 Rep, Nr.1230 Kol, datë 07.10.2022 znj. M. K., në cilësinë e “Qeramarrësi”.

Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qera e ambienteve zyra & garderobë prej 30 m², depo me sipërfaqe 5.74 m², bodrum ambient i përbashkët për të gjithë sanitaret prej 15.37 m², kosha me përmasa (55 cm x 110 cm) prej 7.26 m² dhe kosha pastrimi (60 cm x 80 cm) prej 4.8 m², në total 63.17 m² të ndodhura në ambientet e Spitalit Universitar të Traumës.

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia me gëzim të përkohshëm të ambienteve për përdorimin e tyre si garderobë, magazinimin e mjeteve/pajsjeve dhe materialeve të nevojshme për kryerjen e shërbimit të pastrimit sipas Marrëveshjes Kuadër Nr.109/13 Prot., datë 25.10.2022.

Kohëzgjatja e kësaj kontrate do të jetë 3 vjet. Kuota e përcaktuar e qerasë do të jetë në vlerën 300 lekë/m² dhe në total 18,951 lekë/muaj.

Pastrimi i jashtëm bëhet me botet e tyre dhe nuk përdorin ujë.

Titulli i gjetjes:	Mungesa e Kontratave të furnizimit me energji dhe ujë të pijshëm
Situata:	Në përmbajtje të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, si dhe verifikimi të ambienteve fizike ekzistojnë makineri për të cilat nevojitet rrymë elektrike si dhe pajisje të tjera të cilat u nevojitet shërbimi i ujit, për të cilat duhej të ishin cituar në specifikimet teknike dhe në hartimin e kontratave ku të përfshihej pajisja me kontrata furnizimi të energjisë elektrike dhe ujit.
Kriteri:	Nenin 6 “Detyrimet e palëve” Pika 6.2 “Të drejtat dhe detyrimet e qeramarrësit”.
Ndikimi/Efekti:	Rritja e kostove operacionale të SUT-së.
Shkaku:	Moszbatimi i kushteve të kontratës
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	SUT, të marrë masat të hartojë dhe të finalizojë kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm me operatorët ekonomik, kontraktues të ambienteve dhënë me qira nga ana e A.K.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi znj. E. R., z. V. S., z. B. V., znj. D. Ll., znj. M. M. dhe znj. A. D., në cilësinë e grupit të ndjekjes dhe zbatimit të kontratës.

2.8. Të ndryshme, që do të dalin gjatë auditimit

2.8.1. Evidenca dokumentare e qarkullimit të materialeve ortopedike.

Grupi i auditimit të KLSH, në zbatim të pikës 8 (tetë) të programit të auditimit, konsideroi të nevojshëm dhe të rëndësishëm auditimin e gjithë zinxhirit të qarkullimit të materialeve ortopedike në SUT për shërbimin e Ortopedisë.

Duke vendosur si objektiv, auditimin e evidencës dokumentare mbi përdorimin e materialeve ortopedike duke filluar që nga planifikimi i kërkesave nga shërbimi i ortopedisë (blloku operator qendror) nëpërmjet fletë kërkesave drejtuar farmacisë qendrore për materialet e nevojshme ortopedike, fletë daljet nga Farmacia Qendrore për bllokun operator qendror, plotësimi i kartelës së pacientit nga mjeku kirurg

ortoped për materialet ortopedike të implantuara/vendosura, plotësimi i katelës elektronike të pacientit që ka kryer ndërhyrje kirurgjikale pranë shërbimit të ortopedisë, si dhe monitorimi dhe kontrolli i këtyre materialeve ortopedike nga strukturat përgjegjëse në SUT.

Për realizimin e këtij objekti u administrua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Regjistri i protezave me komponentët përbërës të implantuara tek pacientët dhe atyre të shkëmbyera me firmën kontraktuese për periudhën 13.01.2021-31.12.2021; 05.01.2022-22.08.2022 dhe 23.08.2022 deri 24.02.2023.
- Fletë kërkesat për materiale ortopedike të bllokut operator qendror për periudhën objekt auditimi për farmacinë qendrore.
- Faturat e daljeve të materialeve ortopedike nga Farmacia Qendrore për Bllokun Operator Qendror
- Recetat e lëshuara nga mjekët kirurg ortoped për pacientët e shtruar që do të nënshtrohen ndërhyrjeve kirurgjikale ortopedike për vendosjen e pllakave, shtizave (materiale sinteza) etj., për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 dhe 01.01.2022-31.12.2022,.
- Kartela mjekësore të pacienteve që kanë kryer ndërhyrje kirurgjikale (Proteza, Sinteza)
- Inventari i gjendjes së materialeve ortopedike (Proteza, Sinteza) në ambientet e shërbimit të Ortopedisë - bllokun operator qendror
- Inventari i gjendjes së materialeve ortopedike në Farmacinë Qendrore
- Raportet e emetuara nga sistemi SIIS, kryesisht për komponentët:
 - *Cementin kockor*
 - *Koka bipolare*
 - *Koka femorale*
 - *Komponenti femoral*
- Raportet e gjeneruara nga SIIS (Pentaho) për pacientët e shtruar (operuara) për vitin 2021 dhe 2022

Furnizimi i SUT-së me materiale ortopedike për vitin 2021 dhe 2022.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik të realizuara nga AK., SUT të pasqyruara edhe në Akt konstatimet respektive të mbajtura nga grupi i auditimit të KLSH, kryesisht ato të marrëveshjeve kuadër, rezultojnë se:

AK., SUT ka blerë nëpërmjet procedurave të prokurimit publik për vitin 2021 për nevojat e shërbimit të ortopedisë, e përlllogaritur kjo vetëm për materiale ortopedike (proteza+sintezat) në shumën **209,394,917 lekë** dhe për vitin 2022 në shumën **365,269,600 lekë**.

*Pra, SUT për periudhën objekt auditimi është furnizuar me materiale ortopedike për nevojat e shërbimit të ortopedisë nëpërmjet procedurave të prokurimit në shumën totale **574,664,517 lekë** ose **5,130,933 Euro**³, ku më hollësisht paraqitet në tabelën nr.1 aneksi 2.8.1.*

Kosto e materialeve ortopedike për pacient për vitin 2021 dhe 2022.

Drejtori i Spitalit Universitar të Traumës, në zbatim të kontratës S/2021, nëpërmjet shkresës nr.133 Prot. datë 20.01.2022 ka përcjell pranë FSDKSH të dhënat mbi kostot totale të ndarë sipas shërbimeve për vitin 2021, siç pasqyrohet në tabelën nr. 2., aneksi 2.8.1.

Referuar të dhënave të sektorit të kostos pranë SUT për vitin 2021, rezultojnë se:

Në vitin 2021 pranë shërbimit të ortopedisë janë hapur 4,028 kartela⁴ për pacientë (duke përfshirë edhe kartelat ditore), nga këta vetëm **2,234 pacientë** kanë kryer ndërhyrje kirurgjikale pranë shërbimit të ortopedisë në vitin 2021.

³ Referua kursit zyrtar të këmbimit valuator të datës 24.04.2023: 1 euro =112 lekë

⁴ Sipas të dhënave të pasqyruara në shkresën nr.133 Prot. datë 20.01.2022

Shpenzimet e përlllogaritura nga sektori i kostos i SUT për zërin “Materiale“, ku përfshihen edhe shpenzimet për materialet ortopedike (proteza, pllaka, vida, shtiza, etj.) për vitin 2021 janë në shumën **139,597,381 lekë**.

Nëse vlerën totale të këtyre shpenzimeve për vitin 2021, do ta konsideronim vetëm si shpenzim për materiale ortopedike, por në fakt ato janë më të vogla se kjo shumë, pasi në zërin “Materiale” bëjnë pjesë edhe materiale të tjera mjekimi që nuk futen tek grupi i materialeve ortopedike. Nëse do të kishim të dhëna të sakta për shpenzimet për materiale ortopedike, atëherë kosto për pacient do të dilte më e vogël se ajo e përlllogaritur me hipotezën që gjithë shpenzimet për materiale shkojnë vetëm për materiale ortopedi, gjë që do të përforconte më shumë konkluzionet e arritura nga grupi i auditimit të KLSH.

Në referim të të dhënave të sektorit të kostos të SUT, grupi i auditimit të KLSH ka përlllogaritur koston mesatare për një pacient të operuar, i cili ka përdorur materialet ortopedike në vitin 2021., rezulton që ajo të jetë afërsisht $(139,597,381/2,234) = \mathbf{62,488 \text{ lekë}}$.

Nëse i referohemi shpenzimeve të realizuara nga SUT nëpërmjet procedurave të prokurimit publik për vitin 2021, konstatohet se janë blerë **209,394,917 lekë** materiale ortopedike (proteza, pllaka, vida, shtiza, etj.)

Për sa më lart, shpenzimet e realizuara nga SUT nëpërmjet procedurave të prokurimit vetëm për materialet ortopedike për vitin 2021 kanë një shpërndarje (mbulim) mesatare për një pacientë që ka kryer ndërhyrje kirurgjikale në shërbimin e ortopedisë në shumën **93,731 lekë** $[(209,394,917/2,234)=93,731]$ Pra, shpenzimet e SUT, për materialet ortopedike (proteza, pllaka, vida, shtiza, etj.) për vitin 2021, mbulon me **150 %** $(93,731/62,488)$ koston mesatare të një pacienti për materiale ortopedike

Referuar të dhënave të sektorit të kostos pranë SUT për vitin 2022 rezulton se:

Në zbatim të Kontratës S/2022⁵, me shkresën nr. 251 Prot datë 27.01.2023 të miratuar nga titullari i institucionit, SUT ka përcjell për FSDKSH tabelën përmbledhëse progresive të kostove sipas shërbimeve për vitin 2022, **sic pasqyrohet në tabelën nr.3 aneksi 2.8.1**

Në vitin 2022 pranë shërbimit të ortopedisë janë hapur **4,242 kartela** për pacientë (duke përfshirë edhe kartelat ditore). Në totalin e tyre, vetëm **2,542 pacientë** janë operuar në vitin 2022 sipas të dhënave të sistemit të menaxhimit spitalor SIIS.

Shpenzimet e përlllogaritura për “Materiale“ ku përfshihen edhe shpenzimet ortopedike (proteza, pllaka, vida, shtiza) janë në shumën **173,447,199 lekë**.

Duke e konsideruar këtë shumë si shpenzim vetëm për materiale ortopedike, por në fakt shpenzimet për materialet ortopedike janë më të vogla se kjo shumë, pasi në këtë zërin “Materiale” bëjnë pjesë dhe materiale të tjera mjekimi, rezulton se:

Kosto mesatare e përlllogaritur për një pacient për materialet ortopedike për vitin 2022 është afërsisht $(173,447,199/2,542) = \mathbf{68,233 \text{ lekë}}$.

Nga auditimi rezulton se:

- Shpenzimet për materiale ortopedike (proteza, pllaka, vida, shtiza, etj.) për vitin 2022, janë në shumën **365,269,600 lekë**.

- Materialet ortopedike të prokuruar nga SUT për vitin 2022, kanë një mbulim për pacientin në shumën $(365,269,600/2,542) = \mathbf{143,694 \text{ lekë}}$.

Për sa më lart, vlera e materialeve ortopedike (proteza, Pllaka, vida, shtiza, etj.) të prokuruar në vitin 2022, mbulon **210%** $(143,694/68,233)$ koston mesatare të një pacienti për materiale ortopedike.

⁵ Kontrata s/2022 me nr. 172/3 Prot. Datë 26.01.2022

Nga auditimi mbi mbajtjen e dokumentacionit për evidentimin e vendosjes/implantimit të materialeve ortopedike tek pacienti rezulton se:

1. Materialet ortopedike të grupit të “Protezave” që implantohen tek pacientët (të planifikuar/ardhur nga urgjenca) mbahen nga blloku operator qendror në një regjistër të veçantë, ku janë bashkëlidhur proces verbalet e nënshkruar nga kryeinfermieri, mjeku kirurg operues dhe përfaqësuesi i firmës kontraktuese të materialeve ortopedike.
2. Materialet ortopedike të grupit “Sinteza” si pllaka, shifte dhe aksesori të tyre, që vendosen tek pacientët (të planifikuar/ardhur nga urgjenca) nuk mbahen në regjistër të veçantë, duke mos identifikuar markën dhe numrat serial të këtyre materialeve (sinteza) që vendosen tek pacienti. Për materialet ortopedike pllaka, shifte, shtiza, etj., të grupit të Sintezës, mjeku kirurg operues lëshon recetë për pacientin që do të operohet dhe që kanë nevojë për këto materiale ortopedike, të cilat ndryshe nga materialet e grupit të protezave nuk janë të sterilizuara, proces që realizohet nga vet shërbimi i ortopedisë.

Regjistri i protezave:

Për evidentimin e protezave me nr. serial të implantuara tek pacientët, grupi i auditimit administroi 3 (tre) regjistra të bllokut operator qendror për periudhën objekt auditimi.

Respektivisht, regjistrat për periudhën 13.01.2021 deri 31.12.2021; 05.01.2022 deri 22.08.2022 dhe 23.08.2022 deri 24.02.2023.

Grupi i auditimit të KLSH, në mënyrë rastësore nga këto regjistra përzgjodhi 14 pacientë (kartela mjekësore) të cilët kanë bërë ndërhyrje kirurgjikale pranë bllokut operator qendror, dhe iu është implantuar proteza me komponentët përbërës të saj.

Kartelat mjekësore të përzgjedhura nga grupi i auditimit të KLSH, janë:

A037230; A030079; A031784; A033077; A033743; A035545; A037425; A039759; A040763; A041691; A044813; A045238; A048676; A048529

Cdo faqe e regjistrat të protezave që mbahet për çdo pacient që ka kryer ndërhyrje kirurgjikale ka bashkëlidhur një proces verbalin me dy fletë që nënshkruhet nga mjeku kirurg operues, përfaqësuesi i firmës kontraktuese të materialeve ortopedike dhe kryeinfermieri i bllokut operator qendror.

Në faqen e parë të Proces Verbalit, jepen të dhëna për datën e operimit, emrin e pacienti, nr. e kartelës mjekësore, diagnoza dhe emri i mjekut kirurg operues si dhe materialet mjekësore ortopedike të vendosura tek pacienti, **siç pasqyrohet në faksimilen nr.1 aneksi 2.8.1.**

Pra, në këtë faqe të proces verbalit në përfundim të operacionit shënohen materialet ortopedike të implantura (grupi proteza) me nr.serial (Lotin) të tyre.

Në rastet e përzgjedhura sa më sipër, në faqen e parë të proces verbalit paraqiten materialet ortopedike komponentët femoral me cement, koka femorale, koka bipolare dhe cementi kockor, me nr. e tyre serial, ku në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën nr.4.

Materialet ortopedike të grupit Proteza, janë të sterilizuara të paketuara, të shoqëruara me etiketa adezive me kodbar dhe numër serial (lote, Reference).

Në tabelën nr.4. pasqyrohen të dhëna mbi materialet ortopedike sipas nr. serial të implantuar tek 14 pacientët, sipas kartelave mjekësore të përzgjedhur rastësisht nga grupi i auditimit. Këto të dhëna janë marrë nga faqe e parë e proces verbaleve respektive të pacientëve që kanë kryer ndërhyrje kirurgjikale

dhe janë pasqyruar në regjistrin e terapisë (Proteza) dhe administrohet nga personeli i bllokut operator qendror.

Tabela nr.4. Materialet e implantuara (të vendosura) tek pacienti sipas nr. të kartelës mjekesore

Nr.	Nr. kartelës	Data	Komp. Femoral me Cement	Koka femorale	Koke bipolare	Cement Kockor	Mjeku kirurg	Kryeinfermier	Përfaqësuesi I firmës
			Loti nr.	Loti nr.	Loti nr.	Loti nr.			
1	A037230	12.10.2022	4026	2282654 ⁶	4058	41293	J. R.	A. M.	I.K.
2	A030079	02.09.2022	4071	4271	4079	41329	V. M.	A.M.	I. K.
3	A031784	09.09.2022	4083	4271	4029	39687	S. B.	A.M	I.K.
4	A033077	21.09.2022	4003	4284	4057	41293	B.G.	A.M.	M. K.
5	A033743	03.10.2022	4062	4082	4269	37121	A. D.	A. M.	M.K.
6	A035545	05.10.2022	4006	4272	4089	42110	A. D.	A. M.	I.K.
7	A037425	19.10.2022	4083	4291	4052	41329	J.R.	A. M.	I.K.
8	A039759	28.10.2022	4074	4291	4068	39687	B. G.	A.M.	I.K.
9	A040763	02.11.2022	4074	4289	4048	41293	J. R.	A.M.	M.K.
10	A041691	10.11.2022	KAF239	22FT65119	R2208596	62061126	A. D.	A.M.	E. Gj.
11	A044813	24.11.2022	KAM135	22ET63357	R2142187	62061126	Z. D.	A.M.	E.Gj.
12	A045238	01.12.2022	7296058	3081796	564190	Y06AA0401	Z. D.	A. M.	A.M
13	A048676	22.12.202	4013	4141	4046	42110	S.M.	A.M.	I.K.
14	A048529	23.12.2022	4053	4289	4029	41293	S.M.	A.M.	I.K.

Burimi: SUT, përpunimi grupi i KLSH

Në faqen e dytë të Proces verbalit është shënuar, e citoj:

Pas zhvillimit të operacionit, bëhet tërheqja e materialit dhe shkëmbimi i tyre...

Në këtë faqe janë shënuar materialet ortopedike si:

Komponentët femoral me cement, koka femorale, koka bipolare dhe cementi kockor të cilat janë shkëmbyer me materialet e pasqyruara në faqen e parë të Proces Verbalit **sic pasqyrohet në faksimilen nr.2., aneksi 2.8.1.** ose për rastin tonë, me materialet e pasqyruara në tabelën nr.4.

Materialet ortopedike që janë shkëmbyer me materialet e sjella nga përfaqësuesit e firmës kontraktuese pasqyrohen në tabelën nr.5.

*****Psh.**, pacienti me nr. karteles nr. **A033743**, ka kryer ndërhyrje kirurgjikale më datë 03.10.2022. Sipas proces verbalit të mbajtur nga A. M. në cilësinë e kryeinfermieres, Mjeku kirurg A. D. dhe përfaqësuesi i firmës kontraktuese O.N. **M. K.**, pacientit janë implantuar “Komp. F. me Cement” me nr. serial **4062⁷** (lot).

Ky material është vënë në dispozicion nga M.K. i cili asiston në sallën e operacionit në cilësinë e përfaqësuesit të firmës O.

⁶ Komponenti “Koka femoral” me lot 2282654 nuk është bërë asnjëherë hyrje në farmacinë e SUT, dhe për rrjedhojë grupi i auditimit nuk i referohet dot çmimit të saj dhe as markës.

⁷ Shif tabelën nr.4

Procedura që ndiqet për shkëmbimin e materialeve ortopedike

1. Për materialin ortopedik “Komp. F. me Cement” me nr. serial **4062** (lot) që ju vendos pacientit, përfaqësuesit të firmës O.N., nga strukturat përgjegjëse të bllokut qendror operator i jepet në këmbim materiali ortopedik “Komp. Femoral me Cement” me nr.serial **4067**⁸(Lot).

Siç, shihet nr.serial të këtyre materialeve ortopedike janë të ndryshëm.

2.Për materialin ortopedik “Koka femorale” me nr serial **4082**⁹(Lot) që ju vendos pacientit, përfaqësuesit të firmës O.N. i jepet në këmbim të saj materiali ortopedik “Koka femorale” me nr. serial **4269**¹⁰.

Siç, shihet nr.serial të këtyre materialeve ortopedike janë të ndryshëm.

3. Për materialin ortopedik “Kokë bipolare” me nr.serial **4269** (Lot) që ju vendos pacientit, përfaqësuesit të firmës O.N. i jepet në këmbim materiali ortopedik “Koke bipolare” me nr.serial **4072** (Lot).

Siç, shihet nr.serial të këtyre materialeve ortopedike janë të ndryshëm.

4. Për materialin ortopedik “Cement Kockor” me nr.serial **37121** (Lot) që ju vendos pacientit, përfaqësuesit të firmës O.N. i jepet në këmbim materiali ortopedik “Cement Kockor” me nr.serial **41329** (Lot).

Siç, shihet nr.serial të këtyre materialeve ortopedike janë të ndryshëm.

Proces Verbalet e përshkruar më sipër, janë nënshkruar nga kryeinfiermieri, përfaqësuesi i OE (që ka fituar Marrëveshjen Kuadër), i cili është prezent në sallën e operimit dhe mjeku kirurg operues.

Materialet e mësipërme ortopedike të pasqyruara në tabelën nr.4, sipas Kryeinfiermierit të bllokut Operator Qendror A. M., sillen nga përfaqësuesit i firmës kontraktuese (T.& L. dhe O.), i cili asiston në sallë së bashku me mjekun kirurg operues duke e furnizuar me materialet e veta ortopedike mjekun kirurg gjatë kryerjes së ndërhyrjes kirurgjikale ndaj pacientit.

Materialet ortopedike të pasqyruar në tabelën nr.5 nëpërmjet kryeinfiermierit të bllokut operator qendror janë shkëmbyer me materialet e tabelës nr.4 me përfaqësuesit e firmës kontraktuese.

Materialet ortopedike të shkëmbyera nga kryeinfiermieri me përfaqësuesit e firmave kontraktuese janë materiale të tërhequra nga Farmacia e SUT-së dhe gjenden ne ambientet e zyrës se kryeinfiermierit.

Tabela nr.5 Materialet e SUT të shkëmbyera me firmën kontraktuese të Marrëveshjes Kuadër

Nr.	Nr. kartelës	Data	Komponenti Femoral me Cement	Koka femorale	Koke bipolare	Cement Kockor
			loti	loti	loti	loti
1	A037230	12.10.2022	4071	4044	4057	42110
2	A030079	02.09.2022	4067	4271	4072	39687
3	A031784	09.09.2022	4083	4284	4029	37121
4	A033077	21.09.2022	2099	4044	4057	41293
5	A033743	03.10.2022	4067	4269	4072	41329
6	A035545	05.10.2022	4026	4115	4072	42110
7	A037425	19.10.2022	4026	4141	4057	41329
8	A039759	28.10.2022	4042	4141	4018	41293
9	A040763	02.11.2022	4048	4129	4038	41293
10	A041691	10.11.2022	KA2340	22FT65120	P2214246	62061126

⁸ Shif tabelen nr.5

⁹ Shif tabelën nr.4

¹⁰ Shif tabela nr.5

11	A044813	24.11.2022	HBP625	22FT65119	P20149092	62061126
12	A045238	01.12.2022	7260480	2932724	498080	Y13AAC1505
13	A048676	22.12.202	4074	4092	4038	42091
14	A048529	23.12.2022	4073	4092	4038	42091

Burimi: SUT, përpunimi grupi i KLSH

Në faqen e regjistrit të operacioneve (proteza) ku janë bashkëlidhur 2 fletët e Proces verbalit, janë vendosur etiketat me kod bar të materialeve ortopedike të implantuara tek pacienti, **sic pasqyrohen në faksimilen nr. 3., aneksi 2.8.1**

Moduli i kostos së pacientit

Pas përfundimit të Operacionit, nga ana e bllokut qendror operator plotësohet përveç kartelës mjekësore (hard Copy) edhe kartela elektronike në sistemin e menaxhimit spitalor SIIS, tek moduli i kostos, **sic pasqyrohet në faksimile nr.4 aneksi 2.8.1.**

Nga auditimi në Sistemin e menaxhimit spitalor SIIS, rezulton se:

Materialet që janë pasqyruar në kartelën elektronike të 14 pacientëve, sic pasqyrohet në tabelën nr.6., kanë nr.serial të ndryshëm me materialet që janë implantuar tek këta pacient sic pasqyrohet në tabelën 4.

Tabela nr.6. Kartela elektronike e pacientit

Nr.	Nr. kartelës	Data	Komponenti Femoral me Cement	Koka femorale	Koke bipolare	Cement Kockor
			loti	loti	loti	loti
1	A037230	12.10.2022	4034	4129	4024	Y06AAA0401
2	A030079	02.09.2022	2099	4272	4072	37121
3	A031784	09.09.2022	4034	4080	4058	39687
4	A033077	21.09.2022	4074	4092	4088	41293
5	A033743	03.10.2022	IDH844	19LT30471	R2208596	Y06AAA0401
6	A035545	05.10.2022	JAË035	4075	4018	Y06AAA0401
7	A037425	19.10.2022	4034	4129	4057	19FTC0114
8	A039759	28.10.2022	KAA559	4,041	4042	97411051
9	A040763	02.11.2022	4044	4041	4048	41293
10	A041691	10.11.2022	IDH863	3062391	4072	41293
11	A044813	24.11.2022	KAZ341	2932724	891840	41293
12	A045238	01.12.2022	KAZ344	2932724	258700	41329
13	A048676	22.12.202	4034	4129	4057	Y26FAD0606
14	A048529	23.12.2022	4034	4067	4038	41329

Burimi: SUT, përpunimi grupi i KLSH

Nga auditimi i materialeve ortopedike të implanuar tek pacienti me nr.kartele A033743 rezulton se:

1. Sipas proces verbalit¹¹ të datës 03.10.2022, pacientit janë vendosur materialet ortopedike me nr.serial: 4062, 4082, 4269, 37121. Këto materiale janë sjellë nga përfaqësuesi i firmës O. z. M.K.

¹¹ Faqe e pare e proces verbalit

2. Sipas të njëjtit process verbal¹², materialet me nr. Serial (lotet) 4067, 4269, 4072, 41329 janë marrë nga përfaqësuesi i firmes O.N. z.M. K. si shkëmbim për materialet e sjella.
3. Sipas raportit të Sistemit Informatik SIIS, tek moduli I kostos në kartelën elektronike të këtij pacienti, pasqyrohen materialet ortopedike me nr. serial (lote): IDH844, 19LT30471, R2208596, Y06AAA0401.
4. Numrat serial të materialeve ortopedike të vendosura tek pacienti janë të ndryshme me ato të pasqyruara në kartelën e këtij pacienti, sic paraqiten në tabelën e mëposhtme

Materialet e implantuara tek pacienti me nr. kartele A033743 (sipas tabelës nr.4)

Nr.	Nr. kartelës	Data	Komp. Femoral me Cement	Koka femorale	Koke bipolare	Cement Kockor	Mjeku kirurg	Kryeinf. ermier.	Përfaqësuesi I firmës
			Loti nr.	Loti nr.	Loti nr.	Loti nr.			
5	A033743	03.10.2022	4062	4082	4269	37121	A.D.	A.M.	M.K.
Materialet e shkëmbyera me firmën kontraktuese të Marrëveshjes Kuadër (sipas tabelës nr.5)									
5	A033743	03.10.2022	4067	4269	4072	41329	A.D.	A.M.	M.K.
Kartela elektronike e pacientit me nr. A033743 (sipas tabelës nr.6)									
5	A033743	03.10.2022	IDH844	19LT30471	R2208596	Y06AAA0401			

Në mënyrë të përmbledhur, në tabelën nr.7 pasqyrohet mospërputhja e këtyre materialeve ortopedike për pacientin me kartelën mjekesore nr. A033743

Tabela nr.7. Materialet ortopedike për pacientin me nr. kartele A033743

Material Ortopedie	Sasia	Firma distributore	Sipas Flete Daljes	Sipas kartelës elektronike
		Loti	Loti	Loti
Komponenti Femoral me cement	1	4062	4067	IDH844
Koka femorale	1	4082	4269	19LT30471
Koka bipolare	1	4269	4072	R2208596
Cement kockor	1	37121	41329	Y06AAA0401
Komponentët		Të vendosur	Të kërkuar	Të shkarkuar

Grupi i auditimit të KLSH, mbi bazën e raporteve të gjeneruara nga SIIS, mbi lëvizjet e medikamenteve hyrje në farmaci dhe dalje në bllokun qendror operator për komponentët Femoral me cement, Koka femorale, Koka bipolare dhe cement Kockor analizoj gjendjen e këtyre materialeve ne farmaci ne kohen kur eshte realizuar operacioni për pacientet dhe janë përdorur keto materiale.

Nga auditimi konstatohet se:

1. Të gjitha materialet e pasqyruara në tabelën nr.4 kanë qënë gjendje në farmaci dhe në bllokun operator qendror në periudhën kur janë përdorur këto materiale për ndërhyrje kirurgjikale.

Pra nuk ka qënë e nevojshme shkëmbimi i këtyre materialeve ortopedike me OE kontraktues.

2. Referuar proces verbaleve të regjistrave të materialeve të përdorura gjatë ndërhyrjeve kirurgjikale për vitin 2021-2022, shkëmbimi i materialeve nuk është bërë në përputhje me kushtet e marrëveshjes kuadër apo të kontratave të furnizimit, pasi në asnjë rast nuk rezulton që materiale të ndryshme ortopedike të jene kthyer mbrapsht në farmaci dhe të jenë ndëruar me materiale të tjera, sic parashikohet ne kushtet e Marrëveshjes Kuadër apo në atë të kontratës së furnizimit.

¹² Faqe e dyte e proces verbalit

Të gjitha mallrat që do të sillen me anë të kontratës së furnizimit në SUT mund të ndërrohen (mallrat/materialet do të qëndrojnë të magazinuara në farmacinë e SUT) sipas përmasave dhe llojeve të kërkuara rast pas rasti.

Gjendja stok e materialeve në bllokun operator qendror:

SUT, brenda periudhës së auditimit, ka realizuar procedura prokurimi dhe ka lidhur marrëveshje kuadër për furnizimin me materiale ortopedike. Sasitë dhe llojet e materialeve ortopedike të kontraktuara janë trajtuar nga grupi i auditimit të KLSH në akt konstatimet 14, 15 të datës 24.04.2023.

Materialet ortopedike, bëhen hyrje në Farmacinë qendrore të SUT, të cilat merren në dorëzim nga komisione të veçanta duke i identifikuar materialet ortopedike nga nr.serial (lotin ose referencën).

Në bazë të kërkesave të bllokut operator qendror, në varësi të planifikimeve të operacioneve apo të urgjencave tërhiqen materialet ortopedike nga Farmacia, dhe mbahen në dhomën e kryeinfermierit të bllokut qendror operator.

*Nga verifikimi fizik i kryer në ambjentin e kryeinfermierit të bllokut qendror operator nga grupi i auditimit të KLSH, më datë 23.03.2023 rezultoj se në këtë ambient gjendeshin materialet ortopedike Proteza dhe të grupit të Sintezës në shumën **35,228,087 lekë ose 317,370 euro.***

Administrimi i materialeve ortopedike – Sintezë

Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për administrimin e pllakave dhe vidave dhe përbërësve të tyre, pjesë e grupit “sintezë” rezulton se:

*Për periudhën 2 vjeçare 2021 e 2022 mjekët e shërbimit të ortopedisë kanë gjeneruar **2,680 receta** për pacientët e shtruar në pavijonin e ortopedisë, receta të njëjta me ato që lëshohen në sistemin parësor (për pacientët jo të shtruar në spital) për materiale ortopedike që nevojiten për këta pacientë sipas diagnozës që gjendet në kartelat mjekësore të tyre.*

Disa prej recetave të lëshuara për pacientët e shtruar, pasqyrohen bashkëlidhur në faksimilen nr.5, 6 dhe 6/1 tek aneksi 2.8.1

*****Lidhur me dokumentimin e vendosjes së pllakave, vidave, etj., nga përzgjedhja rastësore e recetave të lëshuara nga mjekët kirurg të shërbimit të ortopedisë për vitin 2022, për materiale ortopedike si pllaka fibule, vida spongiotike, vida maleolare dhe vida kortikale nëpërmjet recetave mjekësore të lëshuara për pacientët e shtruar në SUT që do të nënshtrohen operacionit zgjedhëm recetën, sic pasqyrohet në faksimilen nr.6 në aneksin 2.8.1 të pacientit me nr. e kartelës A046687 si dhe fletën korresponduese të kartelës së pacientit të tërhequr nga arkivi i SUT, sic pasqyrohet bashkëlidhur në faksimilen nr.7 në aneksin 2.8.1**

Gjithashtu në faksimilen nr.6/1 aneksi 2.8.1 paraqiten një sasi kosiderueshme nga totali i recetave që janë lëshuar nga mjekët kirurg për materialet e grupit të sintezës.

*Për të ilustruar një material ortopedik në faksimilen nr.8 aneksi 2.8.1., paraqitet pllaka anatomike femuri proksimal me ATC-VK0174, nr. serial 19120038 me çmimin **58, 000 lekë***

Nga auditimi konstatohet se:

1. Referuar raportit “Lëvizje Medikamenti” në sistemin Pentaho për produktin Vida auto-filetante (Vida spongiotike auto-filetante 4.0mm me gjatësi nga 10mm – 70mm) me kod ATC-VK0185, konstatohet se kryeinfermierja A. M. ka tërhequr përgjatë vitit 2022 sasinë 850 copë nga të cilat janë përdorur 772 copë dhe në fund të vitit 2022 **kishte gjendje 78 cope.**

2. Referuar raportit “Lëvizje Medikamenti” në sistemin Pentaho për produktin Vida auto-filetante (Vida maleolare auto-filetante 4.5mm me gjatësi nga 20mm – 120mm) me kod ATC - VK0106_01,

konstatohet se kryeinfermierja Alma Mucaj ka tërhequr përgjatë vitit 2022 sasine 275 cope nga te cilat janë përdorur 128 cope dhe ne fund te vitit 2022 **kishte gjendje 147 copë.**

3. Referuar raportit “Lëvizje Medikamenti” ne sistemin Pentaho për produktin Vida auto-filetante (Materia - Vida kortikale auto-filetante 3.5mm me gjatësi nga 10 mm –120mm) me kod ATC-VK0104_02, konstatohet se kryeinfermierja A. M.ka tërhequr përgjatë vitit 2022 sasine 2925 cope nga te cilat janë përdorur 2392 cope dhe ne fund te vitit 2022 **kishte gjendje 533 cope.**

4. Referuar raportit “Lëvizje Medikamenti” në sistemin Pentaho për produktin Pllakë distale anatomike fibul - Pllake 1/3 Tubulare me gjatësi te ndryshme nga 70mm deri ne 140 mm me devijacion +/-5% me kod ATC-VK0098_01, konstatohet se ne datën 31.12.2021 blloku operator **kishte gjendje 91 copë.** Kryeinfermierja A. M.ka tërhequr përgjatë vitit 2022 sasine 105 cope, pra sasia totale e produktit VK0098_01 për vitin 2022 rezulton te jete 91 cope + 105 cope = 196 cope nga te cilat janë përdorur 186 cope dhe ne fund te vitit 2022 **kishte gjendje 10 cope.**

5. Për sa më lart, konstatohet se, nuk ka përputhje midis materialeve të kërkuara në recetën për pacientin me nr. karteles A046687 kundrejt përshkrimit të bërë në kartelën mjekësore (hard copy), siç pasqyrohet në faksimilen nr.7., aneksi 2.8.I., pasi në recetën e lëshuar nga mjeku kirurg operues është përcaktuar lloji i pllakës që do të përdoret gjatë operacionit dhe sasia e tyre, ndërkohë në kartelën mjekësore (hard copy) ka një përshkrim të përgjithshëm, e citoj,”**ORIF pllaka+vida**”. Pra, nuk evidentohet në kartelën mjekësore lloji i pllakës dhe nr. serial i saj.

6. Materialet e grupit të sintezës, kanë një veçanti në krahasim me ato të protezës, pasi materialet ortopedike të grupit të sintezës nuk janë të sterilizuara në momentin e furnizimit. Procesi i sterilizimit bëhet para kryerjes së ndërhyrjes kirurgjikale nga shërbimi i ortopedisë.

7. Materialet e sintezës zakonisht pas kohës së rikuperimit të gjendjes së pacientit i hiqen atij. Nga auditimi rezulton se në asnjë rast, nga ana e SUT nuk dokumentohet heqja e tyre, si dhe seleksionimi i këtyre materialeve për tu ripërdorur përsëri, pasi ato siç konstatuam dhe më sipër kanë nevojë vetëm për sterilizim.

Nga auditimi konstatohet se:

Viti 2021

- a. Referuar regjistrave të bllokut qendror operator të sipërpërmendur ku evidentohen vendosja e materialeve të grupit të protezës për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, janë mbajtur 273 proces verbale, çka nënkupton operacionet e realizuara në këtë periudhë.
- b. Referuar recetave të lëshuara nga mjeket për materialet ortopedike të grupit sinteza për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, janë lëshuar 1,294 receta mjekësore, çka nënkupton operacione të realizuar në këtë periudhë.
- c. Referuar të dhënave të marra nga sektori i kostos në SUT, përgjatë vitit 2021, janë realizuar në total në shërbimin e ortopedisë **2,234 operacione** (Protezë + Sintezë)

Viti 2022

- d. Referuar regjistrave, ku evidentohet vendosja e materialeve të grupit të protezës për periudhën 01.01.2022-31.12.2022. konstatohet se janë mbajtur 345 proces verbale, çka nënkupton 345 operacione të kryera. Nga datat 05.01.2022 – 22.08.2022 në regjistër gjenden 204 copë proces verbale dhe për periudhën 23.08.2022 - 31.12.2022 gjenden 141 copë proces verbale.
- e. Referuar recetave të lëshuara nga mjeket për materialet ortopedike të grupit sinteza për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 janë lëshuar 1,386 receta mjekësore, çka nënkupton operacione të kryera në këtë periudhë.
- f. Referuar të dhënave të marra nga sistemi i menaxhimit spitalor SIIS, përgjatë vitit 2022 janë realizuar në total në shërbimin e ortopedisë **2,542 operacione** (protezë+Sintezë)

Titulli i gjetjes:	Mungojnë procedurat të kontrollit dhe monitorimit për materialet ortopedike në SUT .
Situata:	<p><i>Në mënyrë të përmbledhur për sa është trajtuar më sipër rezulton se:</i></p> <p>1. Si rezultat i planifikimit nga strukturat përgjegjëse të SUT për sasi dhe llojet për materialeve ortopedike (proteza, pllaka, vida, shifte, shtiza, etj.) për nevojat e shërbimit të ortopedisë, janë blerë nëpërmjet procedurave të prokurimit publik materiale ortopedike, vlera totale e të cilave për periudhën objekt auditimi ka plotësuar nevojat e shërbimit të ortopedisë, duke patur një shpërndarje mesatare të këtyre shpenzimeve për një pacient më të lartë se kostoja mesatare për pacient e përlogaritur nga sektori i koston së SUT-së.</p> <p>Për vitin 2021, shpenzimet e SUT, për materialeve ortopedike (proteza, pllaka, vida, shtiza, etj.) mbulojnë me 150 % koston mesatare të një pacienti për materiale ortopedike dhe për vitin 2022 shpenzimet e SUT, për materialeve ortopedike (proteza, Pllaka, vida, shtiza, etj.) mbulojnë me 210% koston mesatare të një pacienti për materiale ortopedike.</p> <p>Nga auditimi, rezulton se:</p> <p>SUT për periudhën objekt auditimi, të trajtuara gjerësisht në Akt Konstatime të veçanta nga grupi i auditimit të KLSH, nëpërmjet specifikimeve teknike dhe planifikimit të sasive, ka prokuruar gjithë gamën e domosdoshme dhe të nevojshme për materialet ortopedike që nevojiten për pacientet që do të operohen. Hartimi i specifikimeve teknike dhe planifikimi i sasive për materialet ortopedike të nevojshme nga SUT ka bërë që SUT nëpërmjet realizimit të procedurave të prokurimit të ketë gjendje në bllokun operator qendror materiale ortopedike si, pllaka, vida, shifte, proteza, etj., për të gjitha përmasat dhe modelet, pasi SUT përveç procedurave të realizuara për blerjen e materialeve ortopedike nëpërmjet marrëveshjeve kuadër për çdo vit ka realizuar edhe procedura me negociim pa shpallje paraprake të kontratës duke shpenzuar vetëm për materiale ortopedike, brenda 2 viteve 2021 e 2022 në total <u>5,130,933 Euro</u>.</p> <p>2. Përsa më lart, të gjitha materialet ortopedike të tërhequra nga kryeinfiermjerja e bllokut operator qendror dhe që janë gjendje dhe inventar i shërbimit të ortopedisë për të 3 (tre) pavijonet e saj, qëndrojnë në ambientet e zyrës së kryeinfiermieres të ndara e të vendosura në rafte/dollap sipas furnitorëve (T., L. dhe O.)</p> <p>Në marrëveshjeve kuadër është përcaktuar që duhet të jetë prezent një specialist i këtyre firmave gjatë operacionit me setin e veglave që shërbejnë për montimin e implanteve.</p> <p>Në asnjë nen apo klauzolë në kontratën e furnizimit apo të marrëveshjes kuadër nuk është parashikuar që përfaqësuesi i firmës kontraktuese të ketë përveç setit të veglave që shërbejnë për montimin e protezave me komponentët e saj, të ketë me vete edhe materialet ortopedike të sjella jashtë SUT-së.</p> <p>Shkëmbimi i pretenduar i materialeve ortopedike, sipas strukturave përgjegjëse në SUT bëhet sepse këto materiale nuk janë gjendje sipas llojit dhe përmasave që kërkojnë mjekët kirurg operues gjatë realizimit të operacionit. Nga auditimi i sistemit të menaxhimit spitalor, rezulton se, te gjitha protezat dhe komponentët e tyre për 14 raste, ishin gjendje në bllokun operator qendror dhe në farmaci.</p>

Për më shumë që shkëmbimet, nëse do të ishin të nevojshme duhet të ishin bërë vetëm nëpërmjet farmacisë, sic përcaktohet në nenin 5 të kontratës së furnizimit (Afatet e Lëvrimin dhe kushtet e lëvrimin) , e citoj:

Të gjitha materialet do të sillen me anë të kontratës së furnizimit në SUT mund të ndërrohen (mallrat/materialet do të qëndrojnë në magazinuar në farmacinë e SUT) sipas përmasave dhe llojeve të kërkuara rast pas rasti. Çdo material që do të ndërrohet, duhet të pasqyrohet me anë të një procesverbali të cilin e firmosin përfaqësuesit e OE dhe përfaqësuesit e SUT që do të marrin pjesë gjatë operacioneve kirurgjikale rast pas rasti. Vlera e materialeve nuk do të ndryshojë nga ajo e kontratës së furnizimit.

3. Referuar të dhënave të tabelave të mësipërme të cilat janë nxjerr nga regjistrat e protezave të sipërcituar, rezulton se ka mospërputhje të numrave serial për 14 rastet (pacient) në lidhje me materialet që janë vendosur pacientit, numrat serial (Loti) të materialeve që janë kërkuar për pacientin dhe nr. serial në kartelën e elektronike të këtyre 14 pacientëve.

Kampioni i përzgjedhur prej 14 pacientë është përfaqësues për të gjitha të dhënat e materialeve ortopedike të implantuara tek këta pacientët, pasi të gjithë pacientët që janë të regjistruar në 3 (tre) regjistrat që përfshijnë periudhën 2021 dhe 2022, rezulton se nr.serial (Loti) i materialeve ortopedike nuk kanë përputhje midis materialeve të vendosura, atyre të kërkuara dhe atyre të shkarkuara në kartelën elektronike.

4.Për sa më lart, arrihet në konkluzionin se:

a. lëshimi i recetave kryesisht për materialet e sintezës nga ana e mjekut kirurg operues për pacientin bie në kundërshtim me legjislacionin në fushën e kujdesit shëndetësor dhe atij të shërbimit spitalor.

Lëshimi i recetave për pacientet e shtruar që marrin shërbim spitalor është në kundërshtim me ligjin për shërbimin spitalor Nr.9106, datë 17.7.2003, ligjin për kujdesin shëndetësor nr. 10107 datë 30.3.2009 dhe ligjin 10383 date 24.02.2011 për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në republikën e Shqipërisë, neni 10 pika 1/a ku parashikohet se:

1. Sigurimi i detyrueshëm financon paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, ku përfshihen:

a) vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor publik dhe në spitalet publike.

b.Për periudhe objekt auditimi, nga ana e mjekëve ortoped janë lëshuar **2,680 receta** për pacientët Nga auditimi i gjendjes kontabël të këtyre materialeve që janë përshkruar në këto receta, rezulton se në këtë periudhe pranë farmacisë qendrore dhe bllokut qendror operator ka pasur gjendje fizike të këtyre materialeve ortopedike (Sinteza), si në sasi dhe në lloje.

c.Materialet ortopedike të grupit të sintezës, pas heqjes së tyre nga pacientët që janë rikuperuar nuk administrohen nga strukturat përgjegjëse në SUT.

d.Titullari i Institucionit, nuk ka hartuar rregullore apo të ketë nxjerr urdhër administrativ për administrimin e këtij procesi. Pasi shumica e tyre pas heqjes nga pacientët janë në gjendje të mirë dhe mund të ripërdoren për të njëjtat funksione tek pacientë të ndryshëm, duke sjell uljen e kostove për blerjen e këtyre materialeve kur ato janë në gjendje të mirë fizike.

	<p>5.Për sa më lart, nga ana e bllokut operator qendror për vitin 2021, janë dokumentuar vetëm 1567 (1,294+273) operacione të kryera, duke mos pasqyruar të gjithë operacionet e kryera në regjistrat e mbajtura për vendosjen e materialeve ortopedike (proteza) me një diferencë prej 667 operacione.</p> <p>Mungesa e dokumentimit të materialeve ortopedike për 667 pacientë, përfaqëson diferencën midis numrit total (protez+sintez) të realizuar në vitin 2021 sipas të dhënave të sektorit të kostos (nr. i kartelave të pacientëve) me nr. e ndërhyrjeve në regjistrin e protezave dhe të nr. të recetave të lëshuara për materialet e sintezës (2234-1567).</p> <p>6. Për sa më lart, nga ana e bllokut operator qendror për vitin 2022 janë dokumentuar 1,731 (1,386+345) operacione kirurgjikale ortopedike, nga ku sipas SIIS për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 janë operuar 2,542 pacientë. Pra nga ana e bllokut operator qendror nuk janë pasqyruar të gjitha operacionet e kryera, pasi ka një diferencë me 811 operacione të pa dokumentuar në regjistrat e këtij shërbimi për vitin 2022. Mungesa e dokumentimit të vendosjes së materialeve ortopedike për 811 pacientë, përfaqëson diferencën midis numrit total (protez+sintez) të operacioneve të realizuar në vitin 2022 me nr. e operacioneve të dokumentuar me proces verbale në regjistrin e protezave të vitit 2022 dhe nr. të recetave të lëshuar në vitin 2022 për materialet e sintezës (2,196-1,731).</p>
Kriteri:	Ligji i menaxhimit financiar dhe kontrolli nr.10269, datë 15.10.2015, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kontratat e furnizimit me materiale ortopedike, marrëveshjet Kuader per furnizimin me materiale ortopedike, Ligji per materialet mjekesore.Kontrata Spitalore me FSDKSH, Rregullore e brendshme, ligji për shërbimin spitalor.
Ndikimi/Efekti:	Ne administrimin e materialeve ortopedike.
Shkaku:	Mungesa e kontrollit te brendshëm dhe mos funksionimi efektiv i ligjit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	<p>Drejtorja e financës, pranë SUT të krijoj dhe të llogarisë si zë më vete shpenzimet për materiale tek llogaria e shpenzimeve të materialeve të shërbimit të ortopedisë, për ti mundësuar sektorit të kostos që të llogarisë dhe të raportoj këto shpenzime të ndara nga njëra tjetra.</p> <p>Drejtorja e financës të filloj të përgatisë një model bilanci mujor/vjetor dhe progresiv në lidhje me hyrjet daljet dhe gjendjen e materialeve ortopedike të identifikuar sipas kodit ATC dhe nr.serial (lote) dhe të raportoj për çdo muaj pranë Drejtorisë së Spitalit Universitar të Traumës, për të mundësuar ndjekjen dhe monitorimin e qarkullimit të materialeve ortopedike .</p> <p>Drejtorja e SUT, në bashkëpunim me kryeinfermierin dhe shefin e shërbimit të bllokut operator qendror dhe sektorin juridik të fillojnë hartimin e modelit të Proces Verbalit mbi administrimin e materialeve ortopedike të grupit sinteza, dhe regjistrin e vecant për këto materiale, për të mundësuar gjurmën e auditit</p> <p>Titullari i institucionit të përcaktoj nëpërmjet akteve administrative procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me materialet e sintezës që nga momenti i fillimit të</p>

	<p>sterilizimit të tyre duke i identifikuar sipas hyrje daljeve dhe numrave identifikues për nevojat e bllokut qendror operator.</p> <p>Nga ana e titullarit të institucionit të përcaktohet qarte gjithë procedura dhe të nxirren udhëzues se si do të dokumentohet nderimi vetëm për rastet që në magazine e farmacisë apo të pavianit nuk gjendet materiali ortopedik që nevojitet gjate ndërhyrjes kirurgjikale .</p> <p>Nga ana e Titullarit të Institucionit të emetohen akte administrative në lidhje me sasi të nevojshme dhe të domosdoshme që duhet të mbahen në ambientet e bllokut operator qendror në lidhje me materialet ortopedike, ku të përshkruhen procedura dhe udhëzues sesi ato do të lëvizin nga farmacia tek blloku operator qendror.</p> <p>Nga ana e Titullarit të Institucionit nëpërmjet akteve (urdhër, udhëzim) të përcaktohen procedura të qarta që duhen të ndiqen mbi administrimin e materialeve ortopedike të sintezës pas heqjes nga pacienti, seleksionimin e tyre mbi mundësinë e ripërdorimit për ato materiale që janë në gjendje të mirë.</p> <p>Drejtorja e financës të realizoj inventar të gjendjes së materialeve ortopedike në ambientin e kryeinfermierit, të ballafaqoj me daljet e farmacisë dhe gjendjes fillestare të tyre gjate marrjes në dorëzim nga farmacia.</p> <p>Drejtorja e Spitalit Universitar të Traumës të marrë masa që materialet ortopedike që implantohen/vendosen tek pacienti të përputhen me materialet ortopedike sipas nr.serial (lotëve) që pasqyrohen në kartelën elektronike të pacientit tek moduli i kostos në sistemin e menaxhimit spitalor SIIS.</p> <p>Nga drejtorja e SUT, të analizohet dhe të nxirren përgjegjësi për mos dokumentimin në regjistrat e mbajtur në bllokun operator qendror të materialeve ortopedike të përdorura gjatë ndërhyrjeve kirurgjikale, pasi për vitin 2021 nga ana e bllokut operator qendror, nuk janë dokumentuar 667 operacione dhe 811 për vitin 2022.</p>
--	---

Për sa më lart, me veprimet dhe mos veprimet, ngarkohen me përgjegjësi Z. A. M., në cilësinë e kryeinfermieres, Z. K. K. në cilësinë e shefit të shërbimit të Ortopedisë, Z. A. C., Z.V. R. dhe M. P. në cilësinë e anëtarëve të komisionit të posaçëm për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes kuadër nr. 50/16 Prot., datë 25.10.2022, Znj. E. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të SUT, Znj.E. R. në cilësinë e Zv. Drejtorit të Përgjithshëm ekonomik të SUT duke vepruar në mospërputhje me :

Ligji i menaxhimit financiar dhe kontrolli nr.10269, datë 15.10.2015, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kontratat e furnizimit me materialet ortopedike, marrëveshjet Kuader për furnizimin me materialet ortopedike, Ligji për materialet mjekesore. Kontrata Spitalore me FSDKSH, Regulloren e brendshme dhe ligjin për shërbimin spitalor.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr.1375/14 date 04.07.2023, ku janë shprehur kundërshtimet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

1. Në lidhje me akt konstatimin tuaj informojmë se AK e ka të pamundur të përpunoj informacion të detajuar rreth kostos reale të cdo pacienti ne nje kohe te shkurtër. Cdo rast klinik i trajtuar ne SUT ne lidhje me kostot e materialeve ortopedike eshte i ndryshëm dhe i pa krahasueshëm me njeri tjetër in per arsyen se nje pacient është trajtuar me nje material, një tjetër me disa materiale apo raste të tjera me shumëllojshmëri materialesh ortopedike dhe jo vetëm (përmendim këtu rastet e politraumave për një pacient janë përdorur materiale sinteze, implante apo pllaka maksilofaciale dhe neurokirurgjie.

2. ... në tabelën nr.4 janë materiale implantura tek pacienti nga përfaqësuesit e OE. Lidhur me shënimin se komponenti “ Koka femurale” me lot 2282654 nuk është bërë asnjëherë hyrje në farmacie SUT, ju sqarojmë se nuk ka si të bëhet hyrje në farmaci komponenti në fjalë është në pronësi të OE. Shkëmbimi kryet me materialet që janë bërë hyrje në magazinë duke ia kthyer OE.

3. Lidhur me mospërputhjet per sa i përket lotëve te komponentëve te implantuara tek pacientet,... ju sqarojmë se:

Grupi i auditimit është sqaruar për faktin që komponenti i OE ka lot të ndryshëm nga ai i farmacisë.... theksojmë që nuk ka mundësi zgjedhje në sistem.

4. ...Lidhur me piken 2, për materialet e sintezës sqarojmë se mjeku nuk lëshon recetë. Flete kërkesa vjen nga salla në të cilën është kryer operacioni kirurgjikal, ku janë të pasqyrura materialet të cilat janë përdorur. Njëkohësisht shënohen dhe në bllokun e terapisë në sallë dhe në fletën e sistemit që futet në kartelë.

5. Në përgjithësi observacioni mbi gjetjet e pasqyruara në Akt konstatimin nr.18, datë 24.04.2023 të grupit të KLSH, më së shumti është deklarativ duke pranuar gjetjet dhe duke premtuar që do të reflektohet mbi to me masat që do të merren në zbatim të rekomandimeve që do të lërë grupi i auditimit të KLSH, por në asnjë rast nuk ka shoqëruar observacionin me evidencë dokumentare apo me akte administrative të nxjerra per zbatimin e kushteve të kontratës në lidhje me materialet ortopedike.

Në mënyrë të përmbledhur observacioni konsiston në, e citoj:

Ak do të marrë masa për të kryer një studim të detajuar në mënyrë që të verifikohen konstatimet tuaja. Theksojmë faktin se nuk është e mundur që të kthejmë përgjigje të detajuar pasi kërkon kohë më të gjatë dhe gjithëpërfshirjen e disa sektorëve si ai i planifikimit, i prokurimeve, statistikës, kostos, farmacia dhe Financa e SUT.

Nxjertja e të dhënave sipas rasteve të trajtura dhe ballafaqimi me dosjet faktike në arkivin e SUT është një punë që kërkohë disa muaj kohë dhe nuk mund të kthejmë një përgjigje të detajuar.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:

1.AK SUT ka paraqitur copy paste observacionin e paraqitur ne fazën e hartimit te projekt raportit, ku nder te tjera shprehni shqetësimin per kohen qe i duhej per te observuar gjetjet e grupit te KLSH.

Ju kujtojmë se periudha nga dorëzimi i Akteve deri ne hartimin e Projekt Raportit eshte nje periudhe e mjaftueshme per te observuar pretendimet tuaja.

2.Në lidhje me këtë observacion nga ana e AK nuk eshte sjelle asnjë kundërshti mbi baze te evidencave zyrtare të cilat të mbështeteshin ne aktet ligjore apo neligjore dhe administrative, grupi i auditimit i qëndron gjetjeve dhe konkuzionve të paraqitura në këtë pjesë të PRA duke mos i marrë në konsiderat observacionin për këtë pikë.

3.Observacioni i AK pohoj edhe njëherë mungesën e funksionimit të kontrollit të brendshëm si pjese integrale e funksionimit të ligjit të menaxhimit financir dhe kontrollit në lidhje me shkëmbimin e materialeve ortopedike. Sic pohojne vetë strukturat përgjegjëse në bllokun operator qendror është shkëmbyer një material që nuk është bërë asnjëherë hyrje në farmacinë e SUT, pra këto struktura nuk kanë dijeni për markën numrin serial dhe për pasoj çmimin, ku në kontratën e marrëveshjes kuadër është përcaktuar se do të shkëmbehen me artikuj me të njëjtin çmim nga farmacia e spitalit. Për më shumë ky observacion do të trajtohet në materialin e auditimi si një gjetje që ka ardhur nga vetë institucioni observues, prandaj ky observacion nuk do të merret në konsiderat.

4. Observimi për këtë pikë nga AK nuk ka sjell ndonjë gje të re për grupin e auditimit, pasqyrimi i numrave serial të materialeve të vendosura tek pacienti është një detyrim ligjor i juaji, i cili duhet të pasqyrohet tek kartela elektronike dhe ajo hard copy e pacienti. Por kjo ka ardhur si pasojë që shkarkimi i këtyre materialeve bëhet më vonë se data që është kryer ndërhyrja dhe në këto rast këto materiale nuk janë gjendje në sistem. Ky nuk është problem i sistemit por i organizimit dhe mungesës së procedurave të shkruara për të përcaktuar procedurat që duhen të ndiqen për pasqyrimin e materialeve që janë implantuar/vendosur tek pacienti në kartelën elektronike, prandaj ky observacion nuk do të merret në konsideratë.

5. Në lidhje me pretendimin që për materialet sinteza nuk lëshohen receta, kjo është vërtetuar nëpërmjet dosjes së materialeve të sintesës të përcjell nga kryeinfiermjerja e bllokut operator qendror, sic dhe paraqitet edhe në *faksimilen nr. 5, 6 dhe 6/1 aneksi 2.8.1.*

AK nuk e ka mbështetur observacionin e vetë me dokumentacion shtesë për të provuar kundërshtitë në lidhje me gjetjet e grupit të auditimit të KLSH për këtë pikë, prandaj observacioni nuk do të merret parasysh.

6. Strukturat përgjegjëse të SUT pranojnë vetë që nuk funksionon kontrolli i brendshëm dhe nuk kanë statistika apo bilance specifike për materialet ortopedike. Grupi i auditimit të KLSH, i është referuar vetëm dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga ana e SUT, si psh të dhënat për kostot janë marrë nga sektori i kostos të cilat janë miratuar nga titullari i institucionit, prandaj observacion për këtë pikë nuk do të merret konsideratë.

Si përfundim në lidhje me observacionin e përcjell nga AK., SUT nuk do të merren në konsideratë

2.8.2. Inventarizimi i pajisjeve mjekësore.

Inventarizimin e aktiveve, grupi i auditimit të KLSH e ka trajtuar në mënyrë të plotë në akt konstatimin nr.4. Por rëndësia që ka inventarizimi, mirëmbajtja dhe furnizimi me pajisje të reja diagnostikuese ngelen ndër sfidat më të rëndësishme në shërbimin shëndetësor spitalor.

Titulli i gjetjes:	SUT nuk ka bërë regjistrimin e plotë të pajisjeve mjekësore
Situata:	<p>Qendra Kombëtare e Inxhinierisë Bio-Mjekësore, nën varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, mbështet strukturat e sistemit shëndetësor publik, për riparimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore, si dhe ofrimin e kompetencës së lartë në fushën e Inxhinierisë Klinike.</p> <p>Inventarizimi në SUT për vitin 2021 është kryer sipas urdhrit nr. 151 Prot., datë 24.01.2022., dhe në përfundim grupet e inventarizimit kanë hartuar Raportin përmbledhës nr. 212 Prot., datë 15.03.2022 mbi inventarizimin e Hotelierisë dhe Pajisjeve Mjekësore në SUT për vitin 2021.</p> <p><i><u>Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion grupit të KLSH, konstatohet se:</u></i></p> <ol style="list-style-type: none"> Inventari i pajisjeve mjekësore dhe aparaturave mbahet në dy kartela inventari, njëra i përket Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe tjetra Ministrisë të Mbrojtjes (MM). Pajisjet mjekësore nga sektori i financës nuk mbahet në llogari të veçanta por ato mbahen në llogarinë “aparatura” ku gjenden edhe artikuj që nuk i përkasin kësaj llogarie. Një numër i konsiderueshëm i pajisjeve mjekësore nuk funksionon, megjithëse komisionet respektive të inventarizimit, kanë propozuar nxjerrjen jashtë përdorimit, e më pas asgjësimin e tyre sipas procedurave ligjore në fuqi. Këto pajisje mjekësore ende janë pjesë e inventarit të SUT,

	<p>duke rritur artificialisht vlerën e aktiveve gjendje kontabël në llogarinë “aparatura”.</p> <p>d. Të gjitha pajisjet mjekësore që janë në inventarin e SUT, nuk janë regjistruar nga struktura përgjegjëse të saj, sipas formularit tip të inventarizimit të standardizuar nga Qendra Kombëtare Teknike Biomjekësore (QKIB) në udhëzuesin e saj.</p> <p>Qendra Kombëtare Inxhinierisë Biomjekësore disponon sistemin e informacionit kompjuterik për pajisjet mjekësore CLINGO. Njësia e inxhinierisë klinike pranë SUT nuk ka regjistruar asnjë prej pajisjeve mjekësore të SUT-së në platformën Clingo. Sistemi i cili shërben për inventarizimin dhe monitorimin e pajisjeve mjekësore për sistemin shëndetësor publik.</p> <p>Në tabelën nr.1 aneksi 2.8.2. pasqyrohet pajisjet mjekësore të SUT, pjesë e inventarit të SUT që nuk funksionojnë.</p> <p><u>Për sa më lart, arrihet në konkluzionin se:</u></p> <p>a. Në SUT gjendet një sasi e konsiderueshme e pajisjeve mjekësore në vlerën 38,731,930 lekë që janë jashtë funksionit dhe të rrezikshme për shëndetin e pacienteve dhe personelit spitalor.</p> <p>b. Asnjë nga pajisjet mjekësore pjesë e inventarit të SUT nuk janë regjistruar në sistemin Clingo të Qendrës Kombëtare të Inxhinierisë Biomjekësore</p> <p>c. Titullarët e institucionit për periudhën objekt auditimi nuk kanë zbatuar dhe ndjekur politikën kombëtare për menaxhimin e pajisjeve mjekësore në Shqipëri, të cilat janë përcaktuar qartë në urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 3272, datë 11.09.2007 “Politika Kombëtare për Menaxhimin e Pajisjeve Mjekësore në Shqipëri, si më poshtë:</p> <p><i>Është përgjegjësi e Drejtorit të spitalit për zhvillimin e procedurës për mënyrën e raportimit të ngjarjeve të padëshirueshme dhe marrjen e sinjaleve të alarmit nga pajisjet mjekësore si dhe njohjen e personelit mjekësor me këto procedura.</i></p>
Kriteri:	Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë me nr. 3272, datë 11.09.2007 “Politika Kombëtare për Menaxhimin e Pajisjeve Mjekësore në Shqipëri”.
Ndikimi/Efekti:	Një sasi e konsiderueshme e pajisjeve mjekësore janë jashtë funksionit dhe të rrezikshme për shëndetin e pacienteve dhe personelit spitalor.
Shkaku:	Mos regjistrimi i pajisjeve mjekësore sipas standardit të kërkuar nga Qendra Kombëtare Teknike Biomjekësore (QKIB).
Rëndësia:	e Lartë
Rekomandim:	SUT në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Inxhinierisë Biomjekësore të bëjë vlerësimin mbi gjendjen aktuale të funksionimit të pajisjeve mjekësore dhe mundësisë së vënies së tyre në funksion për pajisjet mjekësore që nuk punojnë dhe njëkohësisht nga ana e SUT të ndiqen procedurat ligjore në fuqi për asgjësimin e pajisjeve mjekësore që janë jashtë përdorimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: Znj. E. B., në cilësinë Drejtorit të SUT

2.8.3. Mbi zbatimin e kontratës koncesionare të Sani Service

Në zbatim kontratës të SUT me FSDKSH, ish drejtori i SUT Z. A. Z.ka nxjerre urdhrin nr.381 datë 05.02.2019 mbi caktimin e grupit të monitorimit dhe rregullat e funksionimit për kontratën koncesionare

Nr. 1440/40 Prot., datë 24.12.2015, “Për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me materiale mjekësore sterile njëpërdorimshme në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”, të përbërë nga:

V. R.(kryetar), K.K., K. L., S.Gj., A. D., E.H. dhe E. T. (anëtarë).

Me urdhrin e brendshëm nr.327 date 31.05.2021 të titullarit të institucionit është bërë ndryshimi i anëtarëve të grupit të monitorimit i përcaktuar në urdhrin nr.381 date 05.02.2019., nga ku janë zëvendësuar A. D.e E.H. me F.B. dhe L.L.

Ne piken V të këtij urdhri përcaktohet se:

Grupi i monitorimit do t'i kërkojë dhe verifikojë çdo vit koncesionarit dokumentacionin që vërteton investimet e kryera (sipas Aneksit 3 “ Projekti Teknik” dhe planit të biznesit të koncesionarit) dhe do ti raportoj ato sipas kontratës.

Në pikën XXIV të urdhrin të sipërcituar parashikohet se:

Për ndërhyrjet ambulatorie të përdoren paketimet me instrumente dhe/ose materialet mjekësore ambulatorie të sterilizuara me autoklavë me avull ose paketimet me material të sterilizuar me cikël me temperaturë të ulët sipas buxhetit vjetor të miratuar.

Titulli i gjetjes:	Mungesa e monitorimit të zbatimit të kontratës koncesionare
Situata:	<p>Në zbatim të kontratës për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore ndërmjet drejtorisë së shërbimeve spitalore universitare të FSDKSH dhe spitalit të traumës për vitin 2021 dhe 2022 neni 5, pika 1 “Detyrime të spitalit në lidhje me kontratën koncesionare S.S.” parashikohet:</p> <p><i>Spitali është përgjegjës për kontrollin e zbatimit të rregullave të përcaktuara në Kontratën Koncesionare Nr. 1440/40 Prot., datë 24.12.2015, “Për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me materiale mjekësore sterile njëpërdorimshme në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale”, të lidhur midis Ministrisë së Shëndetësisë dhe Shoqërisë Koncesionare “S.S.” Sh.p.k.</i></p> <p><u>Nga auditimi rezulton se:</u></p> <p>a. Anëtarët e grupit të monitorimit nuk ka zbatuar pikën V të urdhrin nr.381 date 05.02.2019 të titullarit të institucionit, pasi nga ana e strukturave përgjegjëse të SUT mbi kërkesën e grupit të auditimit të KLSH për zbatimin e këtij detyrim nuk na u vendos asnjë evidence dokumentare nga ana e grupit të monitorimit në lidhje me investimet e kryera nga koncesionari dhe planin e biznesit të tij.</p> <p>b. Anëtarët e grupit të monitorimit të kontratës koncesionare nuk kanë zbatuar pikën XXIV të urdhrin të sipërcituar, pasi krahas shërbimit të sterilizimit të pajisjeve dhe seteve kirurgjikale të realizuara nga koncesionari S. S., në shërbimet Neurokirurgji, Salla e kirurgjisë plastike, Kabineti Maksilo Faciale dhe Reaminacion të SUT-së përdoren autoklava sterilizuese.</p> <p>Në inventarin e SUT gjenden 9 (nëntë) autoklava sterilizuese në vlerën totale 3,604,584 lekë.</p> <p>Përdorimi i tyre, nga shërbimet e sipërcituar të SUT krahas, atij të ofruar nga koncesionari si një detyrim koncesionar bie ndesh me kushtet e kontratës së lidhur midis MSHMS dhe Koncesionarit S.S.</p>

	<p>Referuar të dhënave të zyrës së kostos në SUT, për vitin 2021 koncesionari ka sterilizuar instrumente me avull në shumën 4,954,250 lekë dhe për vitin 2022 në shumën 6,044,850 lekë.</p> <p>c. Koncesionari Sani Service nuk ka dorëzuar pranë SUT dokumentacionin në lidhje me administrimin e mbetjeve të rrezikshme, e konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nuk ka dorëzuar Rregulloren e Brendshme për administrimin e mbetjeve spitalore brenda njësisë funksionuese, në kundërshtim me VKM nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, Kreu II, pika 7.1. - Nuk ka dorëzuar Planin për administrimin e mbetjeve spitalore, në kundërshtim me VKM nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore””, Kreu II, pika 7.2. - Nuk ka dorëzuar Regjistrin e veçantë për mbetjet spitalore, në kundërshtim me VKM nr. 798, datë 29.09.2010, Kreu III, pika 8.13 dhe Kreu VI, pika 12.2, germa ç. - Nuk ka dorëzuar Formularin e veçantë “Dokumentin transferimit të mbetjeve të rrezikshme”, në kundërshtim me VKM nr. 371, datë 11.06.2007.
Kriteri:	Ligji nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar. VKM nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, urdhrit nr.381 date 05.02.2019, kontratën koncesionare Nr. 1440/40 Prot., datë 24.12.2015
Ndikimi/Efekti:	Në cilësinë e shërbimit të ofruar nga koncesionari.
Shkaku:	Mungesa e monitorimit nga strukturat përgjegjëse pranë SUT për zbatimin e kushteve të përcaktuara në kontratën koncesionare.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	Titullari i institucionit të kërkojë nga grupi i monitorimit të kontratës koncesionare me objekt “Kontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale” informacion të plotë mbi ecurinë e saj, dhe të nxjerr përgjegjësi për mosrespektimin të kushteve kontraktore nga koncesionari.
Rekomandim:	Drejtori i Spitalit, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa për plotësimin nga Koncesionari S.S. SHPK të dokumentacionit të plotë mbi administrimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z.V. R. (kryetar), K.K., K. L., S. Gj., A. D., E. H., E. T., F. B. dhe L. Ll. i në cilësinë e anëtarëve të monitorimit të zbatimit të kontratës me koncesionarin S.S.

Aktiviteti i koncesionarit në periudhën objekt auditimi

Gjatë vitit 2021, SUT ka realizuar në total 7,782 ndërhyrje dhe ka realizuar 18,625 sterilizime të instrumenteve me avull duke faturuar për koncesionarin Sani service shumën 196,876,250 leke.

Për vitin 2022 janë realizuar 8,482 ndërhyrje nga SUT dhe 22,725 sete instrumentesh të sterilizuara me avull në vlerën 223,332,050 leke.

Në mënyrë më të detajuar dhe të ndara sipas nivelit të kompleksitetit numri i ndërhyrjeve dhe vlera financiare respektive sipas viteve paraqitet në tabelën nr.

Tabela nr.2. Nr. i ndërhyrjeve sipas kompleksitetit dhe vlera vjetore e shërbimit të koncesionarit

Shërbimi mjekësor	Viti	Ndërhyrje sipas kompleksitetit			Sterilizimi i instrumenteve me avull	Vlera totale ne Lekë
		i Larte	i Mesëm	i ulet		
Totali i Sallave	2021	2751	2176	2855	18625	196,876,250
	2022	3487	1952	3043	22725	223,332,050

Burimi: SUT, përpunimi nga Grupi i auditimit të KLSH

Në lidhje me shpenzimet për energji elektrike dhe ujë:

Prej datës 16.08.2017¹³ dhe në vazhdim koncesionari furnizohet me energji elektrike dhe ujë të siguruar nga SUT, dhe shpenzimet për to, mbulohen nga buxheti i SUT mbi bazën e nenit 19.5 të kontratës midis MSH dhe koncesionarit Sani Service, ku parashikohet:

Në qendrat e Back-up, përveç qendrës Back-up tek QSUT, autoriteti i siguron koncesionarit energji elektrike, uji, avull, vepra civile, impiante etj., me shpenzime në ngarkim të autoritetit.

Sipas të dhënave të sektorit teknik në SUT, koncesionari ka një konsum mesatar të energjisë elektrike për autoklavat me rreth 200 KËh dhe konsum të sasisë së ujit afërsisht 10 m³ ujë në ditë.

Nga auditimi rezulton se:

Nga ana e drejtuesve të SUT për periudhën në auditim, nuk është kërkuar që koncesionari të vendos matës të energjisë elektrike dhe të ujit.

Në mungesë të matësve, konsumi i përafërt i përlogaritur mbi bazën e të dhënave të SUT është:

Titulli i gjetjes:	Koncesionari S.S. përdor energjinë elektrike dhe ujin nga spitali, shpenzimet e te cilave mbulohen nga buxheti i SUT.
Situata:	<p><u><i>Për konsumin e energjisë elektrike</i></u> [200Khh*4 ore*22 dite*13.2 leke/kËh (me TVSh)] * 64 muaj= 14,868,480 lekë Pra në përlogaritjen e përafërt të konsumit të energjisë elektrike është supozuar që autoklavatë punojnë 4 orë mesatarisht në ditë dhe çmimi i energjisë elektrike për 1këh është 13.2 lekë (me TVSH) sipas faturës së energjisë elektrike që paguan SUT për periudhën 16.08.2017 deri 31.12.2022.</p> <p><u><i>Për konsumin e ujit:</i></u> Konsumi i përafërt i përlogaritur mbi bazën e të dhënave të SUT në mungesë të matësit të ujit, është: Konsumi i ujit: 10 m³/dite*22dite*64 muaj *156 leke/m³=2,196,480 lekë. Për sa më sipër, shpenzimet e energjisë elektrike dhe ujit të konsumuar nga koncesionari Sani Service SHPK, <u>në vlerën 17,064,960 lekë, përbëjnë efekt financiar negativ për Buxhetin e SUT.</u> <i>Përlogaritja e përafërtë e bërë nga grupi i auditimit mbi bazën e të dhënave të siguruara nga sektori i teknik i SUT, tregon që koncesionari krahas kostove të seteve kirurgjikale ka rritur kostot e shpenzimeve për energji elektrike dhe ujë nga buxheti i shtetit.</i></p>
Kriteri:	Ligji nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar; kontrata koncesionare; kontrata e Shërbimit Spitalor ndërmjet FDSKSH dhe SUT.

¹³ Data e fillimit të Sani service ne SUT

Ndikimi/Efekti:	Shpenzimet për energji elektrike dhe ujë kanë rënduar Buxhetin e SUT
Shkaku:	Mungesa e komunikimit dhe kërkesës së Drejtuesve të SUT për MSHMS në lidhje me rishikimin e disa termave të kontratës, kryesisht ato që e ngarkojnë Buxhetin e Spitalit në lidhje me konsumin e energjisë elektrike dhe të ujit.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandim:	SUT të marrë masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondeve buxhetore <u>në vlerën 17,064,960 lekë</u> , si dhe të kërkojë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rinegocimin e kontratës për pikën 19.5., ku shpenzimet e energjisë elektrike, ujë, avull, vepra civile, impiante etj., të jenë detyrime të Koncesionarit dhe jo buxhetit të spitalit.

Të ardhurat e munguara nga qeraja

Titulli i gjetjes:	Të ardhurat të munguara nga mungesa e lidhjes së kontratës së qeras me koncesionarin S.S.mbi shfrytëzimin e ambientit të SUT me sip. 288.6 m2.
Situata:	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se: Sipërfaqja totale në përdorim të koncesionarit është 288.6 m2 brenda ambienteve të SUT.</p> <p>Koncesionari e ka përdorur këtë ambient prej datës 16.08.2017 e në vazhdim, pa paguar qira.</p> <p>Në nenin 19.4, të kontratës koncesionare, ndër të tjera përcaktohet se: <i>“Autoriteti duhet të japë në përdorim, kur është e nevojshme për arsye logjike, hapësirat në zonat spitalore që mund të lejojnë operatorit koncesionar dhe operatorëve të saj akses dhe përdorim të të gjitha strukturave të ndërtuara si magazina ose aktivitete produktive të back-up, pa u kërkuar një qera dhe/ose rimbursim financiar”</i>.</p> <p>Për periudhën në auditim, për sipërfaqen 288.6 m2, mbi bazën e përcaktimeve të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.</p> <p>SUT nuk ka përfituar vlerën financiare nga qiraja e ambientit të përdorur nga koncesionari, e cila paraqitet sa me poshtë e llogaritur nga grupi i auditimit të KLSH:</p> <p>E ardhura e munguar për një muaj, ku çmimi për 1m2 është 300 leke, është: $(288.6 \text{ m}^2 * 300 \text{ leke/m}^2 = 86,580 \text{ leke/muaj})$.</p> <p>Koncesionari prej fillimit të aktivitetit deri me datë 31.12.2022 ka përdorur këtë ambient prej 64 muaj. Pra e ardhura e munguar nga mos përfitimi i qeras mujore për këtë ambient në total është:</p> <p>$86,580 \text{ leke/muaj} * 64 \text{ muaj} = 5,541,120 \text{ lekë}$</p> <p>Për sa më lart, shuma 5,541,120 lekë, përbën të ardhur të munguar për buxhetin e SUT.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar; kontrata koncesionare; kontrata e Shërbimit Spitalor.
Ndikimi/Efekti:	Përdorim i ambienteve të Spitalit të Traumës nga Koncesionari pa paguar detyrimin e qirasë.

Shkaku:	Mos zbatimi VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata te tjera të pasurisë shtetërore”.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	SUT të marrë masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondet buxhetore në vlerën 5,541,120 lekë si dhe të kërkojë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rinegocimin e kontratës për pikën 19.5.

2.8.3. Planifikimi dhe hartimi i listës së barnave, materialeve të mjekimit dhe pajisjeve mjekësore për vitin 2021 dhe 2022

SUT, në varësi të shërbimeve, referuar numrit të shtretërve dhe buxhetit të alokuar, planifikon për vitin pasardhës llojin dhe sasinë e barnave dhe materialeve të mjekimit, mbështetur në listën e barnave të miratuar nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë. Planifikimi i saktë i nevojave për barna dhe materiale mjekimi është hapi i parë dhe i rëndësishëm për optimizmin e burimeve financiare kundrejt një liste të konsoliduar barnash dhe materialeve mjekimi që plotësojnë realisht kërkesat e shërbimit spitalor, duke ndikuar ndjeshëm në cilësinë e shërbimit të ofruar ndaj pacientit dhe në përmirësimin e treguesve të performancës¹⁴ së tyre.

Planifikimi i nevojave për barnave dhe materialeve të mjekimit për përdorim spitalor bazohet:

- në listën e barnave të miratuar nga MSHMS;
- në konsumin e barnave të realizuar të paktën tre vitet e fundit;
- në nevojat për vitin pasardhës të paraqitur nga çdo shërbim pranë strukturave drejtuese të shërbimit spitalor, dhe
- në buxhetin e alokuar

Lista përfundimtare e kërkesave të SUT hartohet nga komisioni i veçantë i ngritur nga drejtuesi i institucionit të shërbimit spitalor.

Lista vjetore e kërkesave për barnave dhe materialeve të mjekimit duhet të sigurojë vazhdimësinë e aktivitetit normal të shërbimeve spitalore deri në realizimin e procedurave të blerjes për vitin pasardhës. Ajo duhet të jetë e saktë dhe realiste duke minimizuar sa më shumë të jetë e mundur krijimin e stokut të panevojshëm me barna të skaduar.

Planifikimi dhe hartimi i listës me kërkesat për barna dhe materiale mjekësore ndjek këto hapa:

Hapi i parë

- Gjatë hartimit të PBA-së, shefat e shërbimeve paraqesin kërkesat e tyre për vitin pasardhës për barna dhe materiale mjekimi të përgjithshme.
- Nevojat e tyre bazohen në listën e barnave dhe materialeve të mjekimit e miratuar nga MSHMS.
- SUT mund të propozojnë përfshirjen në listë edhe të barnave apo materialeve të reja të mjekimit, që nuk janë pasqyruar në listën e miratuar nga MSHMS.
- Shefat e shërbimeve planifikojnë vetëm sasinë e barnave dhe materialeve të mjekimit pa vlerën e tyre në lekë.

Hapi i dytë

- Sektori i planifikimit bën përmbledhjen e kërkesave të shërbimeve në rrugë elektronike (Excel) sipas formatit të kërkuar nga MSHMS.

¹⁴ Disa tregues të performancës janë: shkalla e shfrytëzimit të shtratit (%), ditë qëndrimi mesatar, xhiro shtrati, etj.

Hapi i tretë

- Me publikimin e çmimeve të barnave nga MSHMS bëhet një rivlerësim i listës së barnave në varësi të buxhetit që spitalet publike kanë në dispozicion.
- Drejtori i spitalit të SUT, përçjell listën e konsoliduar në MSHMS për vazhdimin e procedurave të prokurimit të përqendruar si i vetmi organ qendror blerës.
- Grupi i ngritur në MSHMS harton listën përfundimtare për të gjitha spitalet publike për fillimin e procedurave të prokurimit publik.

Hapi i katërt

- Procedurat e prokurimit¹⁵ realizohet nga MSHMS, si organ qendror blerës për blerjen e barnave dhe materialeve të mjekimit të përgjithshëm.
- Në rast të anulimit apo mos realizimit të një loti dy herë radhazi nga MSHMS, kjo procedurë i kalon spitalit publike për ta realizuar.

Hapi i pestë

- SUT nënshkruan kontratat me OE fitues të procedurës së prokuruar sipas lot-eve.
- Në përfundim komisioni i kolaudimit të barnave dhe materialeve të mjekimit i ngritur pranë SUT merr në dorëzim barnat dhe materialet e mjekimit sipas kushteve të përcaktuara në kontratë dhe DST.

Titulli i gjetjes:	Barnat dhe materialet e mjekimit të skaduara në farmaci dhe pavijone
Situata:	<p><i><u>Nga auditimi rezulton se:</u></i></p> <p>Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion dhe të dhënat e marra nga sistemi informarik SIIS, konstatohet se deri në fund të periudhës së auditimit në magazine e farmacisë së SUT, gjendet një stok i konsiderueshëm medikamente dhe materiale mjekimi të skaduara, të shkaktuara si pasoj e planifikimit dhe menaxhim jo eficient nga strukturat përgjegjëse të SUT dhe kërkesave të shefave të shërbimit.</p> <p>Nga të dhënat e marra nëpërmjet programit informatik të farmacisë SIIS, më datë 06.02.2023 në magazinën e farmacisë së SUT u gjendën barna te skaduara.</p> <p><i>Si pasoj e planifikimit dhe keqmenaxhimit përgjatë vitit 2021 dhe 2022 kanë skaduar dhe janë gjendje në farmacinë qendrore të SUT barna në vlerën totale 2,014,241 lekë.</i></p> <p>Përveç barnave te skaduar ne farmacinë qendrore një sasi e konsiderueshme e barnave te skaduar gjendet dhe ne shërbime qe kap vlerën 7,261,179 lekë.</p> <p><i>Në magazinën e farmacisë se SUT dhe ne pavijone deri në fund te periudhës se auditimit, gjendet një sasinë me medikamente te skaduara ne vlerën totale 9,275,420 lekë, e cila përbën një shpenzim jo eficient për SUT duke sjellë një efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit.</i></p> <p>Mungesa e koordinimit të grupit të punës, përgjegjësit të farmacisë dhe shefave të shërbimeve për hartimin e listës së barnave dhe materialeve të mjekimit, gjatë fazës së planifikimit të nevojave të tyre për barna dhe materiale mjekimi, ka ndikuar në mos reflektimin e kërkesave reale të shërbimeve dhe si rezultat të mos tërheqjes së tyre nga shërbimet përkatëse.</p> <p>Veprime këto në mospërputhje me Ligjin 9106 17.07.2013 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr.10296, datë 08/07/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Udhëzim nr. 30 datë 27.12.2011 “për</p>

¹⁵ Prej vitit 2018 aplikohet procedura e prokurimit marrëveshje kuadër

	menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe kontratat për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore ndërmjet FDSKSH dhe SUT për vitet 2021 dhe 2022. Për sa më lart, konstatohet se nga drejtuesit e institucionit, brenda periudhës së auditimit nuk janë marrë masat e nevojshme për mos krijimin e stokut të barna dhe materiale të skaduara, veprime në mospërputhje me rregulloren e spitalit dhe kontratën Spitalore me FDSKSH.
Kriteri:	Ligji 9106 date 17.07.2013 “Për shërbimin Spitalor ne Republikën e Shqipërisë”, Kontrata/S për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore për vitin 2021 dhe 2022 ndërmjet FDSKSH dhe SUT. Ligji Nr.10296, datë 08/07/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Udhëzim nr. 30 datë 27.12.2011 “për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.
Ndikimi/Efekti:	Krijimi i stokut të barnave dhe materialeve të mjekimit të skaduara.
Shkaku:	Planifikimi i gabuar nga shefat e shërbimeve dhe mungesa e kontrollit nga drejtuesit e spitalit për qarkullimin e barnave dhe sinjalizimi nga drejtuesi i farmacisë për barnat në prag të skadencës.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	Drejtorja e SUT të analizoj shkaqet e krijimit të stokut të barnave dhe materialeve të mjekimit të skaduar në vlerën 9,275,420 lekë , e cila përbën një shpenzim jo eficient për SUT duke sjellë një efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit dhe gjithashtu të marrë masa e duhura për mos krijimin e stokut të ri në të ardhmen.
Rekomandim:	SUT të filloj hartimin e rregullores së re për shërbimin farmaceutik, mbi bazën ligjore në fuqi duke përcaktuar qartë detyrimet dhe përgjegjësit e këtij shërbimi për gjithë fushën e veprimtarisë së vet sipas standardeve të miratuara për ruajtjen dhe qarkullimin e barnave.
Rekomandim:	Drejtori i SUT të përcaktoj të drejtat dhe përgjegjësit e shefit të shërbimit duke i sanksionuar në aktet administrative (kontratë, urdhër ose udhëzim), dhe në rastet e barnave të skaduara të cilat janë kërkuar prej tyre, të propozoj masa dhe penalitete në masën e dëmit të krijuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Znj. E. B., në cilësinë e drejtorit të SUT dhe E. K. në cilësinë e përgjegjëses së sektorit të farmacisë

Kushtet e ruajtjes së barnave dhe Pulla e kontrollit të barnave

Gjate verifikimit fizik që grupi i auditimit të KLSH kreu në Farmacinë qendrore mbi kushtet e ruajtjes së barnave dhe materialeve të mjekimit dhe zbatimin e bazës ligjore në fuqi, rezultoi se se i gjithë inventari në magazinën e farmacisë kishte pullë me “çmim të rrjetit të hapur” dhe jo me “çmim spitalor”.

Titulli i gjetjes:	Perdorimi i ambienteve të pa përshtatshe për ruajtjen e barnave dhe materialeve të mjekimit
Situata:	Nga verifikimi i realizuar në datën 13.01.2023 i pasqyruar në akt verifikimin nr. 1 u verifikua një sasi e madhe e medikamenteve ishin pa vulën e kuqe me mbishkrimin “për përdorim spitalor ndalohet shitja” Në Urdhrin nr.287 date 12.07.2022 i MSHMS, ku në piken 1 parashikohet se: <i>Barnat që qarkullojnë në sistemin shëndetësor publik përveç pullës së sigurisë duhet detyrimisht të jenë të vulosura edhe me vulën me mbishkrimin “Përdorim Spitalor-Ndalohet Shitja”</i> .

	<p>dhe ne dhe në piken 4 te këtij urdhri përcaktohet se: <i>Boja që përdoret për stampimin e vulës të jetë me ngjyrë të kuqe që nuk fshihet.</i> Gjithashtu barnat dhe materialet e mjekimit të verifikuar në akt verifikimin e datës 13.01.2023, ruheshin në magazinën e mallrave të SUT, ku krahas mallrave gjendeshin dhe pajisje mjekësore jashtë përdorimit e me rrezikshmëri për shëndetin e njërit. Magazina e mallrave të SUT nuk plotëson në asnjë drejtim kushtet e ruajtjes së barnave duke shtuar këtu se në këtë ambient gjenden dhe pajisje mjekësore jashtë përdorimit si radiografi etj., kjo në mospërputhje me urdhrin nr.660 datë 20.09. 2018 të MSHMS, për miratimin e rregullores mbi praktikat e ruajtjes dhe shpërndarjes së mirë të barnave, neni 5 pika 2 dhe nenet në vijim të këtij urdhri ku parashikohet se: <i>Zonat e magazinimit duhet të jenë të përshtatshme për të siguruar kushte të mira të ruajtjes. Në veçanti, ato duhet të jenë të pastra, brenda kufijve të temperaturës dhe lagështirës. Kushtet e ruajtjes duhet të sigurohen, kontrollohen, monitorohen sipas specifikimeve në etiketën e barit.</i> <i>Barnat nuk duhet të jenë në kontakt të drejtpërdrejtë me dyshtemenë dhe muret e të kenë hapësirë të përshtatshme për të lejuar pastrimin dhe inspektimin.</i></p>
Kriteri:	Urdhri nr.660 datë 20.09. 2018 të MSHMS, për miratimin e rregullores mbi praktikat e ruajtjes dhe shpërndarjes së mirë të barnave.
Ndikimi/Efekti:	Në sigurimin e cilësisë se barnave dhe materialeve te mjekimit.
Shkaku:	Mos respektim i kushteve te ruajtjes se barnave dhe materialeve te mjekimit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	Drejtori i Spitalit te SUT, në raste të pa mundësisë për të magazinuar barna apo materiale mjekimi në Farmacine qendrore duhet ti vendos ato ne ambiente te sigurta dhe me kushte te mira te ruajtjes dhe ne asnjë rast ne magazinën e mallrave e cila eshte e pa pershtateshme per ruajtjen e këtyre barnave apo materiale mjekimi.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi

Znj. E. B. në cilësinë e Drejtorit të SUT-së.

Znj. E. K. në cilësinë e shefit të shërbimit të farmacisë së SUT-së.

1.Të ndryshme.

Spitali Universitar i Traumës është një Institucion shëndetësor publik kombëtar mjekimi mësimdhënie dhe kërkimi shkencor në përmbushje të ofrimit të kujdesit shëndetësor.

Spitali Universitar i Traumës shërben si Qendër Kombëtare e Traumës me funksion mjekësor mësimor e kërkim shkencor, institucion i lartë diagnostikues, mjekues dhe shkencor dhe ka për mision, ofrimin e shërbimit mjekësor për trajtimin e traumave ne nivel terciar për të gjithë vendin.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet aktivitetit mjekësor për shërbimet e ofruara për pacientet e shtruar në SUT për periudhën 01.01.2021-31.12.2021

EMERTIMI	Nr shtrreteve	Gjithsej te hyre	Gjithsej te dale	Vdekur	Dite-paciente	Dite-qendrimi mesatar	Shfrytezim shtrati	Xhiro - shtrati
Semundje të Brendshme 1	30	66	123	0	1350	11	12	4
Semundje te Brendshme 2	28	207	106	3	923	9	9	4
Kirurgji e Pergjithsme 1	27	1034	1064	11	4427	4	45	39
Kirurgji e Pergjithsme 2	25	1109	1183	26	5747	5	63	47
Kirurgji Rikonstruktive	11	153	158	2	1038	7	26	14
Ortopedi 1	28	1240	1163	5	7340	6	72	42
Ortopedi 2	28	1094	1009	4	5270	5	52	36
Ortopedi 3	26	1110	854	5	4883	6	51	33
ORL-Okulistike-Maxsillofacial	11	628	890	0	3096	3	77	81
Neurokirurgji	22	953	791	34	6728	9	84	36
TOTALI	236	7594	7341	90	40802	6	47	31

Burimi: SUT, sektori i kostos.

Titulli i gjetjes:	Mungesa e ambienteve të morgut pranë SUT
Situata:	<p>Nga auditimi rezulton se SUT nuk ka ambient dhe nuk është i pajisur me frigorifer-morg, për të bërë administrimin e trupave të pacientëve që ndërrojnë jetë në SUT.</p> <p>Në vitin 2021 pranë këtij spitali kanë ndëruar jetë 90 pacient.</p> <p>SUT nuk ka krijuar ambiente të përshtatshme për të ushtruar veprimtarin e tyre ligjore strukturat përgjegjëse të parashikuara në legjislacionin në fuqi, duke vepruar në mospërputhje me parashikimet e Kreut IV -Kërkesat dhe klasifikimi i Spitaleve, nenit 31, shkronja g, të Ligjit nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë” dhe të Aneksit II, pika 8, të VKM-së nr. 237, datë 06.03.2009, ku parashikohet se:</p> <p><i>Ministri i Shëndetësisë njuh, hap, klasifikon dhe licencon spitalet publike dhe jopublike, në varësi të përmbushjes së kushteve, arritjes së standardeve, në bazë të teknologjisë spitalore dhe shkallës së plotësimit të kërkesave të domosdoshme për:</i></p> <p><i>g) logjistikën dhe pajisjet e duhura të repartit të morgut dhe të sallës së autopsisë;</i></p>
Kriteri:	Ligjit nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”
Ndikimi/Efekti:	Ne plotësimin e stadarteve te kërkuara per shërbimet terciare
Shkaku:	Mos respektim të bazës ligjore në fuqi për shërbimin spitalor
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	Titullari i Institucionit në bashkëpunim me MSHMS dhe Ministrinë e Drejtësisë, të marrë masa dhe të krijoj ambiente të përshtatshme sipas standardeve të kërkuara për të bërë administrimin e trupave të pacientëve që ndërrojnë jetë në SUT.

2.8.4 Mungesa e përcaktimit të mënyrës së planifikimit të barnave në kontratën e FSDKSH

Titulli i gjetjes:	Në kontratat me FSDKSH nuk është përcaktuar procedura e planifikimit të barnave dhe medikamenteve.
Situata:	<p>Nga auditimi u konstatua se:</p> <p>1.Në Kontratën për periudhën e auditimit të SUT me FSDKSH nuk është përcaktuar proceduara e planifikimit të barnave dhe medikamenteve, ndërkohë që në të gjitha kontratat Tip kjo gjë është e përcaktuar.</p> <p>Përsa i përket Kontratës me FSDKSH me nr. 3, datë 06.01.2021 (nr. 9060 prot., datë 30.12.2020 i FSDKSH) dhe kontratës me nr. 172/1 prot., datë 26.01.2022 (nr. 6920 prot., datë 31.12.2021 të FSDKSH), duhet të bëhet një shtesë në lidhje me planifikimin e barnave dhe medikamenteve të SUT.</p> <p>Këtë gjë nuk e parashikon asnjë nga kontratat e sipërcituara, ndërkohë që në të gjitha kontratat tip ajo përcaktohet.</p> <p>2.Në lidhje me Planifikimi i barnave dhe medikamenteve, nga auditimi rezulton se, për planifikimin e nevojave vjetore për barna dhe materiale mjekësore nga Shërbimet mjekësore në SUT, gjatë hartimit të projektbuxhetit dhe planit buxhetor (pas miratimit), nuk bëhet analizë mbi gjëndjen e ilaçeve, sasinë e konsumit të tyre vjetore, në mënyrë që të justifikojnë listën për nevojat e këtyre barnave. Gjithashtu është konstatuar se planifikimi nga shërbimet mjekësore është kryer pa marrë në konsideratë kërkesën dhe sasinë reale, sipas nevojës vjetore të secilit pavion. Për periudhën e auditimit nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2022, në tabelën nr. 1, aneksi 2.8.4 paraqiten disa nga medikamentet e skaduara që zënë peshën më të madhe të tyre.</p>
Kriteri	Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, UMF nr. 8 datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së buxhetit”, Ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.
Ndikimi/Efekti:	Kjo mund të ndikojë në uljen e performancës së Sektorit të Planifikimit duke mos i kushtuar rëndësinë e duhur këtij procesi kaq jetik për spitalet, pra planifikimit të barnave dhe medikamenteve.
Shkaku:	Mungesa e vëmendjes ndaj Sektorit të Planifikimit.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	Nga Organet Drejtuese të merren masa në mënyrë që të bëhet një shtesë në lidhje me planifikimin e barnave dhe medikamenteve të SUT në kontratat e lidhura me FSDKSH në përputhje me ligjin.
Rekomandimi:	Nga Strukturat drejtuese të merren masa në vazhdimësi për ngritjen e një grupi pune gjatë fazës së planifikimit dhe evidentimit të nevojave për medikamente dhe materiale mjekësore në mënyrë të tillë që ky planifikim të kryhet mbështetur në një analizë të konsumit dhe nevojës për barna.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi: Z. A. Z. në cilësinë e ish titullarit të institucionit dhe znj. E. B. në cilësinë e titullarit të institucionit, znj. E. O. në cilësinë e Përgjigjësës së Sektorit të Planifikimit, znj. M. P. (e komanduar) dhe znj. M. M. në cilësinë e Përgjigjësës së Sektorit të Planifikimit dhe znj. E. K. në cilësinë e Shefes së Shërbimit të Farmacisë.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresë nr. 1375/15 prot., datë 04.07.2023 në lidhje me planifikimin e barnave dhe medikamenteve, nga M. P., M. M. dhe E. K., nga ana e të cilave pretendohet se:

Pretendimi i subjektit:

“Lidhur me observacionin me nr. 1375/15 prot., datë 04.07.2023, dërguar nga përfaqësuesit e Spitalit Universitar të Traumës, u konstatua se nuk është paraqitur ndonjë gjë e re në observacion, pasi ky material është sjellë edhe në observacionin me nr. 1007/1 prot., datë 02.05.2023, i cili është reflektuar në Projekt Raport”.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH^{-së}:

Në lidhje me observacionin e dërguar me shkresën nr. 1375/15 prot., datë 04.07.2023, grupi i auditimit sqaron se materiali është dërguar edhe në observacionin me nr. 1007/1 prot. të datës 02.05.2023. *Për sa më sipër, observacioni juaj nuk pranohet.*

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar mbi Zbatimin e Rekomandimeve me nr. 520/56 Prot. datë 04.12.2020, rezultoi se janë trajtuar rekomandimet e lëna si më poshtë:

- Nga **29** masa organizative të rekomanduara gjithsej, **20** masa janë zbatuar plotësisht dhe **9** masa janë në proces auditimi.
- Nga **2** masa shpërblim dëmi të rekomanduara, **1** masë është zbatuar plotësisht dhe **1** masë tjetër është në proces zbatimi.
- Nga **21** masa disiplinore të rekomanduara gjithsej, **21** masa janë zbatuar plotësisht.

Rekomandimet e mbetura në proces zbatimi, paraqiten si më poshtë:

- Masa Organizative – **Rekomandimet nr. 3.1, 6.1, 19.1, 20.1, 21.1, 21.2, 22.1, 28.1, 29.1**
- Masa Shpërblim Dëmi – **Rekomandimet nr. 2.1**, në mospërputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa “j”.

1.1.Rekomandim: SUT, të marrë masa për përsheptimin e realizimit të rekomandimeve në proces zbatimi të lëna në auditimin e mëparshëm, me synim realizimin e objektivave dhe në përmbushjen e misionit të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Bordi i Spitalit Universitar të Traumës nuk ka funksionuar gjatë periudhës objekt auditimi dhe si rrjedhojë e kësaj nuk ka miratuar pasqyrat financiare vjetore (miratimi i raportit vjetor të veprimtarisë financiare), për vitin 2021. Për sa i takon periudhës objekt auditimi, Bordi i SUT është mbledhur për herë të parë në qershor të vitit 2022, referuar shkresës nr. 1195 Prot., datë 03.06.2022 “Kërkesë për mbledhjen e Bordit Drejtues të SUT, në mospërputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 66, datë 03.02.2017 “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare”, pika 10 c).

(Trajtuar më hollësisht në faqen nr.50-54....., pika 2.5 , të Raportit të Auditimit).

2.1.Rekomandim: Nga Bordi i Spitalit Universitar të Traumës të merren masa në vijimësi për miratimin çdo vit të pasqyrave financiare vjetore.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në Spitalin Universitar të Traumës nuk janë përgatitur pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara për vitin 2021, sipas udhëzimeve të MFE. Pasqyrat financiare janë përgatitur më

vete, ku njëra është hartuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe një pasqyrë për Ministrinë e Mbrojtjes në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, kapitulli IV, pika 98-111, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022.

3.1.Rekomandim: Nga sektori i financës të merren masa për të përgatitur pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara dhe paraqitja e tyre të jetë në përputhje me standardet kontabël kombëtare, duke pasqyruar gjendjen e tyre financiare në aneksin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit SUT.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Pasqyrat financiare vjetore edhe pse janë depozituar në Degën e Thesarit Tiranë, nuk provohet nga ana shpresore të jetë bërë konfirmimi nga kjo e fundit. Pasqyrat kanë vetëm numër protokollimi në Degën e Thesarit, në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme, kapitulli V, pika 117, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022.

4.1.Rekomandim: Nga sektori i financës në SUT të merren masa që pasqyrat financiare vjetore të dërgohen në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në Ministrinë e Mbrojtjes, pasi të jenë konfirmuar paraprakisht nga Dega e Thesarit të Rrethit Tiranë.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se shënimet shpjeguese nuk janë të plotësuara me detaje dhe informacione që duhet të pasqyrohen në të dy bilancet, si për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ashtu dhe për Ministrinë e Mbrojtjes. Plotësimi i tyre është realizuar pjesërisht dhe nuk janë përfshirë të gjitha informacionet shpjeguese që kërkohen, në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar, në të cilin jepen informacionet shpjeguese të nevojshme për të arritur paraqitjen e drejtë dhe të qartë të pasqyrave financiare, në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 3.7 “Rregullat për dhënien e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare individuale”, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022.

5.1.Rekomandim: Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, shënimet shpjeguese të plotësohen në mënyrë të saktë dhe të detajuar, në përputhje me SKK, duke dhënë informacionin e nevojshëm dhe të domosdoshëm për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në pasivin e bilancit kontabël të Spitalit Universitar të Traumës për Ministrinë e Mbrojtjes, nuk pasqyrohet në llogarinë 12 rezultat i mbartur nga viti i kaluar. Në këtë zë të pasqyrës së pasivit nuk është pasqyruar rezultat i mbartur për të bërë krahasimin ndërmjet gjendjes në çelje të tij, shtesën përgjatë vitit dhe përdorimin e tij në rezultat për të financuar shpenzimet korente apo kapitale, në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 date 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 3.7 “Rregullat për dhënien e shënimeve shpjeguese për pasqyrat financiare individuale”, të ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022.

6.1.Rekomandim: Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, pasqyrat financiare të përgatiten dhe paraqiten në përputhje me SKK duke pasqyruar në pasivin e bilancit rezultatin e mbartur nga viti i kaluar te “Llogaria 12”, për të bërë të mundur krahasimin ndërmjet gjendjes në çelje të tij, shtesën përgjatë vitit dhe përdorimin e tij në rezultat për të financuar shpenzimet korente apo kapitale.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Gjatë analizimit të inventarëve rezultoi se, për vitet objekt auditimi nuk është nxjerrë jashtë përdorimit asnjë aset (produkt), edhe pse duke u nisur nga vitet dhe nga norma e amortizimit, ekzistojnë asetete të cilat janë plotësisht të amortizuara. Gjithashtu te inventarët nuk janë përfshirë zërat (toka, ndërtesa, rikonstruksione), në mënyrë që të bëhet verifikimi i vlerës së aseteteve, amortizimit të duhur të tyre duke përfshirë edhe shtesat, si dhe të ardhurat e gjeneruara nga përdorimi i tyre, nëse ka. Në fletë hyrjen e magazinës dhe në dokumentacionin e marrjes në dorëzim të mallrave, nuk regjistrohen numrat serial/identifikimit përkatës të mallrave, duke e bërë të vështirë identifikimin e tyre, në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV “Sistemi i kontrollit periodik te aktiveve”, pika 73 – 120.

7.1.Rekomandim: Nga Sektori i Financës të merren masat që në vijimësi, asetet plotësisht të amortizuara të nxirren jashtë përdorimit. Gjithashtu duhet të përfshihen në inventar zërat si toka, ndërtesa, rikonstruksione dhe për secilin mall që merret në dorëzim nga institucioni, të përcaktohet dhe regjistrohet numri serial për të bërë te mundur identifikim e tyre.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Projekt-Buxhetet për periudhën e auditimit nuk janë të miratuara nga Bordi Drejtues i Spitalit Universitar të Traumës, pasi Bordi Drejtues i Spitalit Universitar të Traumës është mbledhur vetëm një herë përgjatë gjithë periudhës së auditimit 01.01.2020-31.12.2022, në të cilën ka miratuar Strukturën, Organikën, Statutin dhe Rregulloren e Spitalit Universitar të Traumës me Vendim nr.1, datë 15.06.2022. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me VKM nr. 66, datë 3.2.2017 “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen e organizimit e Shërbimeve dhe Strukturave Shëndetësore Universitare”, pika 10/a.

8.1 Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të merren masa që projekt-buxhetet të miratohen nga Bordi Drejtues, pasi kjo mund të sjelli keqmenaxhim të burimeve dhe mosrealizim të objektivave.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Duke iu referuar kërkesave buxhetore, u konstatua se Spitali Universitar i Traumës nuk ka kryer një planifikim të saktë të zërave në buxhet. Gjatë hartimit të Projekt Buxheteve nuk janë marrë në konsideratë kërkesat e kryera nga departamentet sipas strukturës organizative, pasi nuk ekziston asnjë shkresë e përgjegjësve të departamenteve dërguar Grupit për Menaxhimin Strategjik. Buxheti i planifikuar për vitin 2021 në MSHMS ka qenë 350,500,000 lekë, ndërsa faktiku është 413,395,000 lekë, duke tejkalluar planifikimin e buxhetit me 62,895,000 lekë. Buxheti i planifikuar i vitit 2021 në MM ka qenë 1,216,000,000 lekë, ndërsa faktiku është 1,305,350,000 lekë, duke tejkalluar planifikimin e buxhetit me 89,350,000 lekë. Buxheti i planifikuar i vitit 2022 në MSHMS ka qenë 430,500,000 lekë, ndërsa faktiku është 553,361,500 lekë, duke tejkalluar planifikimin e buxhetit me 122,861,500 lekë. Buxheti i planifikuar i vitit 2022 në MM ka qenë 1,135,076,000 lekë, ndërsa faktiku është 1,441,814,250 mijë lekë, duke tejkalluar planifikimin e buxhetit me 306,738,250 lekë. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 3, pika 29, dhe Kontrata “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore” për vitin 2019 dhe 2020, miratuar me VKA të FSDKSH nr. 20, datë 19.12.2018, dhe nr. 37, date 19.12.2019, neni 11, pika 14, neni 12, pika 14.

9.1 Rekomandimi: Nga ana e Spitalit Universitar të Traumës të merren masa që në raportet e monitorimit për zbatimin e buxhetit, të përmbajnë një informacion të plotë me shpjegimet përkatëse lidhur me ndryshimet e PBA, e buxhetit, nga plani fillestar deri në atë përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli, lidhur me ndryshimet e planifikuara të zërave në buxhet gjatë vitit ushtrimor, si në sasi dhe vlerë në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse në fuqi për zbatimin e buxhetit.

9.2 Rekomandimi: Nga ana e SUT të bëhet programimi i buxhetit duke pasur parasysh nevojat reale gjatë vitit të pritsëm buxhetor dhe të shmangen programimet duke rritur bazën në një përqindje të caktuar. Gjatë vitit të angazhohen vetëm ato shpenzime të cilat janë planifikuar sipas llojit dhe të mos ndryshohet destinacioni i përdorimit të këtyre fondeve Brenda artikujve buxhetorë.

9.3 Rekomandimi: Nga ana e SUT të merren masa që strukturat/struktura që do të merren me programimin dhe planifikimin buxhetor, të kryejnë analiza të hollësishme të gjithë treguesve të buxhetit referuar kuadrit rregullator ligjor përkatës, me qëllim eliminimin e ndryshimeve të konsiderueshme të buxhetit gjatë vitit ushtrimor.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Struktura, organika dhe statuti nuk janë të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Mbrojtjes. Referuar rregullores dhe akteve ligjore në fuqi, miratimi i tyre është detyrë funksionale e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Nga ana e Spitalit Universitar është kërkuar disa herë miratimi i tyre por nuk i është dhënë zgjidhje problemit. Struktura organike e re është e domosdoshme të miratohet sa më shpejt pasi rregullorja e re e protokolluar me nr. 1195/3 prot., datë 03.06.2022 përfshin pozicione të reja. Në këtë mënyrë nuk mund të implementohet ende rregullorja e re. Statuti i SUT vazhdon të jetë në fazë Projekt-Statuti. Në Vendimin nr. 1001, datë 2.12.2015 “Për integrimin e Spitalit Universitar të Traumës dhe Spitalit Ushtarak të Forcave të Armatosura në një strukturë të bashkuar”, ndër të tjera është përcaktuar edhe mënyra e hartimit të strukturës organike të Spitalit Universitar të Traumës, konkretisht pika 5 dhe 6. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje e Ligjin nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu III, Neni 23/pika 2; VKM nr. 66, datë 03.02.2017 “Për përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen e organizimin e shërbimeve dhe strukturave shëndetësore universitare” Pika 8 dhe 10; VKM Nr. 1001, datë 2.12.2015 “Për integrimin e Spitalit Universitar të Traumës dhe Spitalit Ushtarak të Forcave të Armatosura në një strukturë të bashkuar”, Pika 5 dhe 6; VKM Nr. 66, datë 3.2.2017 “Për Përcaktimin e kriterëve e të procedurave për ngritjen e organizimin e Shërbimeve dhe Strukturave Shëndetësore Universitare”, Pika 10/ a, b, c.

10.1 Rekomandimi: Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si institucione varësie, të marrin masa bazuar në aktet ligjore në fuqi të bëjnë miratimin e strukturës së re, organikës dhe statutit të Spitalit Universitar të Traumës.

Menjëherë dhe në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të personelit, u konstatua se në dosjet e punonjësve: A. M. dhe N. Q. me detyrë elektrikistë nuk u gjetën dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik. Referuar strukturës organizative të Spitalit Universitar të Traumës, të miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 30, datë 13.03.2017, shkresë e cila është protokolluar me nr. 371 prot., datë 16.03.2017, ku është miratuar që numri i punonjësve të SUT të jetë 630 punonjës, ndër të cilët 4 pozicione janë për elektrikistë, ku konkretisht dy prej të cilëve nuk kishin dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001, “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike” i ndryshuar, neni 9, pika 1, germa “a”.

11.1 Rekomandimi: Drejtori i Spitalit Universitar të Traumës në bashkëpunim me Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse të marrin masa për pajisjen me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik për punonjësit të cilët punojnë në pozicionin elektrikist, për të siguruar asetet e subjektit dhe jetën e punonjësve elektrikistë.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ka mospërputhje midis gradave dhe funksioneve organike në Forcat e Armatosura, pra gradës në Top dhe gradës në Fakt për personelin Oficer dhe Nënoficer të Njësisë Mjekësore Ushtarake, e cila konkretisht është në masën 13.3%.

Grada Top përcaktohet si grada për pranimin në pozicionin vakant. Kurse grada Fakt është grada që realisht punonjësi disponon. Mospërputhja gradë-funksion për Oficerët, ku konkretisht janë 5 Oficerë nga 40 në total të cilët kanë mospërputhje gradë funksion (pra kanë gradë më të lartë sesa grada top) në masën 12.5%. Ndërsa mospërputhja gradë-funksion për Nën Oficerët, ku konkretisht janë 5 nënoficerë nga 35 në total të cilët kanë mospërputhje gradë funksion (pra kanë gradë më të lartë sesa grada top) në masën 14%. E shprehur në përqindje mospërputhja gradë-funksion për Oficerët dhe Nën Oficerët është në masën 13.3%, siç e kemi paraqitur dhe në tabelat nr. 2, 3, 4 dhe 5, Aneksi 2.3. Mbi zbatimin e strukturës organizative dhe dispozitave ligjore në fuqi për dhënie e pagave dhe shpërblimeve. Kjo problematikë ka ardhur si pasojë e ndryshimeve gradë-funksion të oficerëve, të cilët janë rritur në gradë gjatë ushtrimit të detyrës, pasi ushtarakët sipas Ligjit nr.59/2014 “Për karrierën ushtarake në forcat e armatosura të Republikës së Shqipërisë” paguhen sipas gradës dhe jo sipas pozicionit ku aktualisht janë vendosur nga Ministria e Mbrojtjes. Referuar ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, Kreu III, Neni 32, pika 2: “Mospërputhja e gradave me funksionet organike në Forcat e Armatosura nuk duhet të kalojë masën 10 për qind të numrit të përgjithshëm të personelit ushtarak”.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me: ligjin nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, Kreu III, Neni 32, pika 2.

12.1 Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të NJMU, në bashkëpunim me Drejtorin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, të lihet detyrë që në të ardhmen të ndiqet vazhdimësia e kësaj problematike dhe të shikohet mundësia e përzgjedhjes së punonjësve oficerë dhe nënoficerë, grada fakt e të cilëve përputhet me gradën top.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i librit të arkës, për periudhën e auditimit, u konstatua se ka ndodhur tejkalim i limitit ditor të arkës së Spitalit Universitar të Traumës. Kjo gjë ka ndodhur, pasi shumat e arkëtuara në arkën qendrore tejkalojnë limitin ditor. Arkëtari i arkës qendrore çdo ditë ka mbledhur arkëtimet dhe ka bërë derdhjet për shumat e mbledhura. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, u konstatua se derdhjet në bankë nuk janë bërë çdo ditë, por një herë në 3-4 ditë.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me VKM nr. 290, date 14.06.1993 “Për limitin ditor të arkës për ndërmarrjet shtetërore”, pika nr. 3.

13.1 Rekomandimi: Nga Shefi i Financës dhe arkëtari të merren masa për respektimin e limitit ditor të arkës për të ulur riskun e mbajtjes së Cash-it në SUT.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i praktikave të bankës konstatohet se:

- Në të gjitha rastet për vitet 2021 dhe 2022, procesverbalet për marrjen në dorëzim të mallrave apo shërbimeve janë pa numër protokolli.

- Në disa raste u konstatua se referuar kontratave me operatorët ekonomikë, nga ana e Spitalit Universitar të Traumës ka vonesa në likuidimin e faturave me operatorët ekonomikë, duke mos respektuar afatet e parashikuara në detyrimet kontraktuale të kontratave dypalëshe respektive.

- Gjatë auditimit me zgjedhje të likuidimeve nëpërmjet bankës u konstatua se gjatë muajit shkurt dhe mars 2022 janë pranuar dhe likuiduar nga Komisioni i Pritjes së mallit “Blerje medikamente mjekësore”, të cilat e kanë pasur afatin e skadencës më të vogël se 1 vit. Kjo gjë është konstatuar në urdhër-shërbimin nr. 15, datë 15.02.2022 dhe në urdhër-shërbimin nr. 36, datë 10.03.2022.

Referuar urdhër shpenzimit nr. 15, datë 15.02.2022 “Blerje medikamente mjekësore” dhe urdhër shpenzimit nr. 36, datë 10.03.2022 “Furnizim medikamente mjekësore” u konstatua se janë marrë në dorëzim medikamente me afat skadence më të vogël se 1 (një) vit. Konkretisht, referuar urdhër shpenzimit të parë të cituar dhe procesverbalit për marrjen në dorëzim të medikamenteve të datës 17.01.2022, i cili nuk është i protokolluar, ku janë marrë në dorëzim medikamentet: Eptacog Alfa (Advanced) (1 mg/m i afterreconstitution; me nr. serial AG93) me skadencë 30.06.2022 në vlerën totale 4,818,000 lekë dhe Eptacog Alfa (Advanced) (1 mg/m i afterreconstitution; me nr. serial AX85) në vlerën 9,417,000 lekë. Ndërsa referuar urdhër shpenzimit të dytë të cituar dhe procesverbalit për marrjen në dorëzim të datës 8.02.2022, i cili nuk është i protokolluar, ku janë marrë në dorëzim medikamentet: Serum Antitetanik (SAT) Human Antitetanusimmunoglobuline; me nr. serial L02R0720 me skadencë 01.02.2023 në vlerën totale 601,983 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me DST të paraqitura në procedurën e prokurimit dhe në kontratën e nënshkruar mes palëve si dhe në dokumentet standarde të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe APP; Kontrata dypalëshe e lidhur midis SUT dhe OE “P. O.” nr. 79/15, datë 17.01.2022; dhe Kontrata dypalëshe e lidhur midis SUT dhe OE “Medicamenta” nr. 79/29, datë 10.02.2022 dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

14.1 Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të merren masa në të ardhmen, për plotësimin dhe sistemimin në mënyrë kronologjike të dokumentacionit justifikues, bashkëlidhur veprimeve të kryera me bankë në zbatim të përcaktimeve të dispozitave ligjore përkatëse.

14.2 Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të merren masa që në rastet e marrjes në dorëzim të medikamenteve, afatet e skadencës të jenë brenda normave të lejuara, në mënyrë që të sigurohet shërbimi i duhur për pacientët e Spitalit Universitar të Traumës.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, me përzgjedhje, u konstatua se:

-Në 5 raste Autorizimi për lëvizjen e mjetit nuk ndodhej në dosje.

-Nuk është bërë një planifikim mujor apo vjetor ku të ketë një plan shpërndarje për çdo sektor/degë/drejtori.

-Nga Organet Drejtuese nuk ka një udhëzim, manual dhe rregulla ku të jenë pjesë e rregullores së brendshme në të cilën të përcaktohet mënyra e funksionimit, monitorimit dhe organizimit të gjithë procesit të konsumit të karburantit për automjetet e SUT, në të cilën të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësitë respektive sipas drejtorive apo sektorëve.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 19, neni 22, dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 5, 10, 19 dhe 36.

15.1 Rekomandimi: Nga Titullari i SUT të merren masa për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshijë ata që kanë mjete në ngarkim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë gjendjen teknike të mjeteve dhe më pas të caktojë normativat mbi konsumin e karburantit, për mjetet që ushtrojnë aktivitetin në SUT pa normativa të miratuara.

15.2 Rekomandimi: Nga Titullari i SUT të merren masa për miratimin e një udhëzimi, manuali apo rregullave lidhur me mënyrën e funksionimit, monitorimit dhe organizimit të gjithë procesit të konsumit të karburantit për automjetet e SUT, ku të përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësitë respektive sipas drejtorive apo sektorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të qirasë, në përmbajtje të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, në lidhje me kontratat e qirasë me OE Sori-Al si dhe pas verifikimit të

pagesave, nuk u konstatua asnjë kontratë furnizimi me energji dhe ujë të pijshëm për ambientet marrë me qira nga O.E. i sipërcituar.

16.1.Rekomandim: Drejtoria e SUT, të marrë masa të hartojë dhe të finalizojë kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm me operatorët ekonomik, kontraktues të ambienteve dhënë me qira nga ana e A.K

Menjëherë dhe në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Në përmbajtje të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, si dhe verifikimit të ambienteve fizike ekzistojnë makineri për të cilat nevojitet rrymë elektrike si dhe pajisje të tjera të cilat u nevojitet shërbimi i ujit. duhej të ishin cituar në specifikimet teknike dhe në hartimin e kontratave ku të përfshihej pajisja me kontrata furnizimi të energjisë elektrike dhe ujit.

veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me VKM nr.54, datë 05/02/2014 “për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

17.1.Rekomandim: SUT, të marrë masat të hartojë dhe të finalizojë kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm me operatorët ekonomik, kontraktues të ambienteve dhënë me qira nga ana e A.K.

Menjëherë dhe në vijimësi

18. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i faqes Web për funksionimin dhe administrimin e saj, u konstatua që faqja web nuk funksiononte dhe në nën-menut dhe faqja kryesore ishin të paplotësuara dhe pa të dhëna.

18.1.Rekomandim: SUT, të marrë masat për ngritjen e një komisioni të dytë për zbatimin dhe mbikëqyrjen e kontratës, në lidhje me faqen web, për vënien e saj në përdorim sipas kushteve të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Në përmbajtje të dokumentacionit vënë në dispozicion grupit të auditimit, si dhe pas verifikimit të pagesave, z. D. L. (inxhinier elektrik) mban procesverbal për konsumin e energjisë si dhe çmimi i energjisë caktohet nga zyra e financës dhe i bashkëngjitet faturës së qirasë mujore por nuk u konstatua asnjë kontratë furnizimi me energji dhe ujë të pijshëm për ambientet marrë me qira nga O.E. i sipërcituar. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me VKM nr.54, datë 05/02/2014 “për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

19.1.Rekomandim: SUT, të marrë masat të hartojë dhe të finalizojë kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm me operatorët ekonomik, kontraktues të ambienteve dhënë me qira nga ana e A.K.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Gjatë verifikimi fizik të artikujve u has vështirësi pasi në inventarizimin e tyre, nuk regjistrohen me numrat serial/identifikimit përkatës të mallrave, duke bërë të vështirë identifikimin e tyre. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Neni 77 “Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”, Neni107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

20.1.Rekomandim: SUT, të marrë masat që në komisionet e pritjes së mallit ose marrjen në dorëzim të tij, magazinieri, që në momentin e pranimit të një malli/prodakti, të bëjnë regjistrimet përkatëse sipas natyrës, llojit dhe identifikimit të produktit/mallit.

Menjëherë dhe në vijimësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël rezultoi se në 2 (dy) raste kishim copëzim të fondeve apo kontratave gjatë përzgjedhjes së procedurave. SUT në llogaritjen e fondeve për procedurën e prokurimit në vlerë të vogël, nuk ka marrë parasysh grupin e mallrave apo shërbimeve të ngeshme, të cilat zakonisht duhet të prokurohen njëherësh dhe në asnjë rast, nuk duhet të ndahen gjatë përdorimit të kësaj procedure. Për këtë arsye, ato nuk përbëjnë shkak për ndërprerje të proceseve kryesore të shoqërisë, pra nuk janë objekt i avarive të cilat kërkojnë kryerjen e detyruar të procedurave të veçanta të prokurimit për çdo objekt.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje Pika 3 e Udhëzimit Nr.05, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” si dhe nenin 56, pika 2 dhe pika 11, e Vendimit Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave për Prokurimin publik”.

21.1.Rekomandim: SUT, të marrë të gjitha masat që në hartimin e regjistrit të prokurimeve të parashikohen të gjitha procedurat e blerjes së mallrave, punëve dhe shërbimeve, që do të prokurohen në vlerë të vogël, me qëllim që të shmangë përdorimin e paplanifikuar dhe të parregulluar të fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurave “Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit të SUT”, për nevoja emergjente në asnjë pikë të hartimit të kriterëve të veçanta dhe specifikimeve teknike nuk është përmendur minimumi i kriterëve që duhet të plotësojë një O.E., bazuar në praktikën më të mira, ku faktorët dietetikë-ushqimorë janë një shkak i parandalueshëm dhe i shërimit të sëmundjeve, pasi spitalet pritet të shërbejnë ushqime me vlera ushqyese në mënyrë që të trajtojnë sëmundjet dhe promovojnë një dietë të shëndetshme dhe të ekuilibruar. Për më tepër, ushqimet që spitalet zgjedhin të blejnë dhe mënyra në të cilën ato prodhohen, përpunohen dhe transportohen mund të kenë një ndikim të thellë në shëndetin e njeriut, si më poshtë:

- Dëshmi mbi vendin se ku do përpunohet dhe ambalazhohet ushqimi dhe mjetet për shpërndarjen e tyre.
- Certifikatat dhe licencat mbi sigurinë, cilësinë dhe pastërtinë e ambienteve dhe ushqimeve që përdoren.
- Dëshmi mbi eksperiencën disa vjeçare në industrinë e përgatitjes dhe shpërndarjes së ushqimit.
- Dëshmi mbi numrin e punonjësve të përfshirë dhe shefat e kuzhinës (Eksperiencat)
- Ambienti se ku do të pritet ushqimi, ambientet, punonjësit.
- Menaxhimi i stafit dhe trajnimi i tyre .

Cilësia e ushqimit, menuja e pasur, mënyra e ambalazhit, servirja, në mospërputhje me Nenin 36 “Specifikimet Teknike”, Ligji nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”.

22.1.Rekomandim: SUT, grupi i hartimit të specifikimeve teknike, në zhvillimin e procedurave të prokurimit, gjatë hartimit të tyre, të marrë në konsideratë të gjitha praktikën më të mira që të orientojnë drejtë një produkti/shërbimi që përmbush 3E (eficiencë, ekonomicitet dhe efektivitet), duke u mbështetur dhe në legjislacionin në fuqi.

Në vijimësi

23. Gjetje nga auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurave “Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit të SUT”, zhvilluar në ABP, me O.E. fitues “D.P.”, nga grupi i auditimit u konstatuan kushte dhe metoda të papërshtatshme për shpërndarjen e ushqimit. Zanafilla e problematikës së mësipërme është krijuar në përcaktimin e specifikimeve teknike, ku citohet dhe mënyra për shpërndarjen e ushqimit. Duke marrë në konsideratë çmimet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare në lidhje për sa më sipër, metodat e tanishme të shpërndarjes së ushqimit nuk kanë ndonjë ndryshim me metodat e para disa viteve, ku ky shërbim ofrohej nga punonjësit dhe mjediset e spitalit, në mospërputhje me Nenin 77 “Mbikëqyrja e

kontratës”, të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020”, Neni107 “Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës”, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

23.1.Rekomandim: A.K., në këtë rast SUT, të rishikojë kushtet e kontratës dhe mënyrën e ambalazhimit dhe të shpërndarjes së ushqimit, si dhe të sigurojë ambiente dhe kushte të përshtatshme pranë spitalit duke u bazuar në praktikat më të mira si dhe të arrijë efektivitet të plotë të shërbimit nga O.E.

Menjëherë

24. Gjetje nga auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurave “Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit të SUT”, zhvilluar në ABP, me O.E. fitues “D.P.”, nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit, në lidhje me gatimin e ushqimit, shfaqej e njëjta menu në të gjithë fletët e forcës ditore, ku edhe pse kaloritet dhe ingredientët janë të përcaktuar, mënyra e gatimit të tyre duhet të ndryshohet , në mospërputhje me Marrëveshjen kuadër nr. 97/26 Prot., datë 13.06.2022.

24.1.Rekomandim: Grupi i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës, gjatë kryerjes së detyrës, të bazohet në kushtet e kontratës, për plotësimin e plotë të tyre si dhe të marrë masat e duhura në mos plotësimi të kushteve të kontratës nga ana e O.E. dhe të kërkojë penalizimin e tyre.

Menjëherë

25. Gjetje nga auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurave “Shërbim i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit të SUT”, zhvilluar në ABP, me O.E. fitues “D.P.”, nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit u konstatuan në ambientet e spitalit vetëm 2 punonjës për ambalazhimin dhe shpërndarjen e ushqimit nga 8 punonjës që duhej të ishin, në mospërputhje me Marrëveshjen kuadër nr. 97/26 Prot., datë 13.06.2022.

25.1.Rekomandim: Grupi i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës, gjatë kryerjes së detyrës, të bazohet në kushtet e kontratës, për plotësimin e plotë të tyre si dhe të marrë masat e duhura në mos plotësimi të kushteve të kontratës nga ana e O.E. dhe të kërkojë penalizimin e tyre.

Menjëherë

26. Gjetje nga auditimi: Gjatë zhvillimit të procedurave “Kryerje e shërbimit të lavanderisë për një periudhë 48 mujore në SUT”, grupi i auditimit gjatë verifikimit të zbatimit të kontratës konstatoi që në ambientin, cilësuar si Ortopedia 1, në të gjithë katin kur numri total i shtretërve është 28, ku u konstatua që këto shtretër ishin të amortizuar dhe të pa rregulluar nga ana e O.E., në mospërputhje me Marrëveshjen kuadër nr. 97/26 Prot., datë 13.06.2022

26.1.Rekomandim: Grupi i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës, gjatë kryerjes së detyrës, të bazohet në kushtet e kontratës, për plotësimin e plotë të tyre si dhe të marrë masat e duhura në mos plotësimi të kushteve të kontratës nga ana e O.E. dhe të kërkojë penalizimin e tyre.

Menjëherë

27. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Trajtimi i mbetjeve spitalore” u konstatuar që pranë ambienteve të spitalit ishte i vendosur vetëm një kontejner ku brenda tij ishte i instaluar një frigorifer. Sipas kushteve të kontratës Operatori ekonomik, duhet te instalojë të paktën dy frigoriferë në ambientet e SUT të përshtatshëm për ruajtjen e mbetjeve të rrezikshme të buta dhe të ngurta, deri në momentin e transportimit për në impiantin e asgjësimit. Gjithashtu u konstatua se nuk ishte kryer dezinfektimi i mirë i frigoriferëve dhe ambientit brenda dhe përreth vendit ku ruhen mbetjet.

27.1.Rekomandim: Grupi i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës, gjatë kryerjes së detyrës, të bazohet në kushtet e kontratës, për plotësimin e plotë të tyre si dhe të marrë masat e duhura në mos plotësimi të kushteve të kontratës nga ana e O.E. dhe të kërkojë penalizimin e tyre.

Menjëherë

28. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për planifikimin e nevojave vjetore për barna dhe materiale mjekësore nga Shërbimet mjekësore në SUT, gjatë hartimit të projektbuxhetit dhe planit buxhetor (pas miratimit), nuk bëhet analizë mbi gjendjen e ilaçeve, sasinë e konsumit të tyre vjetore, në mënyrë që të justifikojnë listën për nevojat e këtyre barnave. U konstatua se planifikimi nga shërbimet mjekësore është kryer pa marrë në konsideratë kërkesën dhe sasinë reale, sipas nevojës vjetore të secilit pavijon. Në dosje u konstatua vetëm inventari i farmacisë i datës 31.12.2019.

Gjithashtu në kontratat me FSDKSH nuk është përcaktuar procedura e planifikimit të barnave dhe medikamenteve. Nga grupi i auditimit u konstatua se: në Kontratat me FSDKSH nuk është përcaktuar proceduara e planifikimit të barnave dhe medikamenteve, ndërkohë që në të gjitha kontratat Tip kjo gjë është e përcaktuar. Përsa i përket Kontratës me FSDKSH me nr. 3, datë 06.01.2021 (nr. 9060 prot., datë 30.12.2020 i FSDKSH) dhe kontratës me nr. 172/1 prot., datë 26.01.2022 (nr. 6920 prot., datë 31.12.2021 të FSDKSH), duhet të bëhet një shtesë në lidhje me planifikimin e barnave dhe medikamenteve të SUT. Këtë gjë nuk e parashikon asnjë nga kontratat e sipërcituara, ndërkohë që në të gjitha kontratat tip ajo përcaktohet.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, UMF nr. 8 datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së buxhetit” dhe Ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

28.1 Rekomandimi: Nga Strukturat drejtuese të merren masa në vazhdimësi për ngritjen e një grupi pune gjatë fazës së planifikimit dhe evidentimit të nevojave për medikamente dhe materiale mjekësore në mënyrë të tillë që ky planifikim të kryhet mbështetur në një analizë të konsumit dhe nevojës për barna.

28.2 Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të merren masa në mënyrë që të bëhet një shtesë në kontratën me FSDKSH, ku të përcaktohet qartë procedura e planifikimit të barnave dhe medikamenteve në përputhje me ligjin.

Në vijimësi

29. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i punimeve sipas Kontratës “Ndërtim i Depos së ujit të SUT” janë konstatuar mëngjesi të cilat kanë t bëjnë me:

- Sipas zërit 1.1.10 “Rrethim i përhershëm me kolona b/a dhe rrjetë teli”, është certifikuar sasia 153 m², ndërsa nga matjet në objekt rezulton se për këtë zë punimi nuk është vendosur sasia 10 ml, ose 16 m², si dhe disa kolona betoni kanë pësuar devijim.

- Sipas zërit 1.1.24 “Ullukë shkarkimi vertikale me llamarinë xinkato Ø 100 mm”, ulluqet vertikale janë vendosur material PVC, me diametër 65 mm dhe jo llamarinë xinkato.

- Sipas zërit “3.3.3 “Dyer të blinduara importi me akses kontrolli”, është certifikuar dhe realizuar sasia 2.46 m², por nuk është vendosur aksesi i kontrollit. Nga ana e subjektit është paraqitur material sipas të cilit të gjitha defektet e mësipërme janë riparuar, gjithsesi mbetet për t’u verifikuar në fazën e zbatimit të rekomandimeve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 4.1

29.1. Rekomandimi: Mbikëqyrësi i punimeve të kërkojë nga kontraktori riparimin e defekteve dhe realizimin e plotë të sasisë për zërat e punimeve të konstatuara me mangësi, përpara përfundimit të periudhës së garancisë së tyre. Të bëhet verifikim për çdo zë punimi të realizuar, për identifikimin e defekteve të tjera të mundshme, në mënyrë që të merret në dorëzime të përhershëm një objekt me të gjitha punimet e realizuara sipas kontratës dhe kushteve teknike të zbatimit.

Brenda periudhës së garancisë

30. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Procedura e prokurimit Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimet mjekësore Neurokirurgji, K. Vazale, K. Maksilofaciale, K. Retinale” rezulton se:

Komisioni i pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit, për kontratat e mësipërme dhe ato në vazhdim të kësaj Marrëveshje kuadër i referohet urdhrin nr.103 datë 25.01.2018 ndërkohë që furnizimi për këto kontrata është gjatë vitit 2021 dhe 2022.

Për periudhën nga 01.01.2021–15.06.2022 drejtuesit respektiv të SUT nuk kanë ngritur komision të pritjes dhe marrjes në dorëzim për mallrat që ata kanë prokuruar.

Në pikëpamjen formale urdhri nr.103 datë 25.01.2018 dhe nr. 317 Prot., datë 15.06.2022, nuk bazohen në akte ligjore në fuqi, pasi i referohen ligjit nr. 6942 date 15.12.1984 dhe VKM nr.70 datë 11.03.1985 të shfuqizuara.

Për sa më lart, mungesa e identifikimit dhe zbatimit të akteve ligjore në fuqi, tregon që në SUT mungon kontrolli i brendshëm, duke e bërë jo efektiv zbatimin ligjit mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin (MFK) nga strukturat përgjegjëse drejtuese në SUT.

30.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e SUT, të kërkohet që aktet administrative, të miratohen paraprakisht nga sektori juridik për të garantuar përputhshmërinë e bazës ligjore në fuqi mbi të cilën mbështeten aktet administrative të emetuara nga titullari i institucionit.

Në vijimësi

31. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Neurokirurgjisë dhe Kirurgjisë Maxilofaciale”, rezulton se:

Në urdhrin e sipërcituar ka reference jo të saktë të numrit të protokollit për Marrëveshjen Kuadër, pasi urdhri i referohet marrëveshjes nr.78/8 Prot. Datë 12.12.202., ndërkohë që numri i protokollit të marrëveshjes është i korigjuar dhe mbanë nr. 74/9 Prot datë 12.12.2022, ndërkohë që ky numër protokollit është përdorur në urdhrin për administrimin e dokumentacionit të shkruar që duhet të dorëzonte OE i kualifikuar dhe shpallur fitues para lidhjes së marrëveshjes kuadër.

Numri i protokollit 74/8 datë 12.12.2022 që i referohet Urdhrit për ngritjen e komisionit të posaçëm për monitorimin e marrëveshjes kuadër, si dhe të minikontratave që do të lidheshin, rezulton të jetë nr. i protokollit edhe për raportit përmbledhës të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO).

Referenca e gabuar e nr. të protokollit të marrëveshjes kuadër reflektohet edhe në kontratën e lidhur me OE “O.E.S. D.” Nr.74/13 Prot Datë 15.12.2022.

Referuar Urdhrit nr. 317 Prot., datë 15.06.2022, për krijimin e komisionit të pritjes dhe marrjes në dorëzim të vlerave materiale me të cilat do të furnizohet SUT për vitin 2021 e në vazhdim titullari i institucionit ka ngritur komisionin e pritjes dhe marrjes në dorëzim të mallit respektivisht, për neurokirurgjinë: I. H., N. B., A. S. dhe për kirurgjinë maksilofaciale: L. B., M. S., A. T.

Referuar Proces verbalit të datës 16.12.2022 mbi marrjen në dorëzim të mallit të dorëzuar nga kontraktuesi sipas faturës tatimore elektronike nr. 1987/2022 date 16.12.2022, rezulton se komisioni i marrjes në dorëzim është ai i përcaktuar në Urdhrin nr. 317 prot., datë 15.06.2022 dhe jo ai i përcaktuar në urdhrin nr. 74/10 Prot. Datë 13.12.2022 të titullarit të institucionit.

Urdhri nr. 317 Prot., datë 15.06.2022 i referohet bazës ligjore të shfuqizuar duke ju referuar ligjit nr. 6942 date 15.12.1984 dhe VKM nr.70 date 11.03.1985.

Për sa më lart, titullari i institucionit për të njëjtin objekt të veprimtarisë dhe për të njëjtën periudhë kohore ka nxjerr dy urdhra me komisione të ndryshme. Kjo tregon që në SUT nuk është hartuar gjurma e auditit siç e përcakton baza ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe për rrjedhojë mungon kontrolli i brendshëm duke e klasifikuar jo efektiv menaxhimin financiar dhe kontrollin (MFK).

31.1. Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Universitar të Traumës, të ngrëjë grupe pune për hartimin e gjurmës së auditit për çdo proces dhe veprimtari që ushtrohet në SUT., për të përmirësuar sistemin e kontrollit të brendshëm me qëllim që të sigurohet përdorimi me efektivitet, ekonomikitet dhe eficiencë i fondeve publike.

Në vijimësi

32. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT" viti-2021 rezulton se: AK për plotësimin e kapacitetit teknik, tek kriteri 2.3 pika "e", ka kërkuar që: "OE duhet të paraqesë autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore, të lëshuar nga MSHMS sipas ligjit 89/2014 "Për Pajisjet Mjekësore".

Vendosja e këtij kriteri është e pa plotë, pasi AK duhet të kërkoj certifikatën për regjistrimin e pajisjeve mjekësore në regjistrin kombëtar të AKBPM, kjo në referim të ligjit nr. 89/2014 "Për pajisjet mjekësore", neni 13 (procesi i regjistrimit) pika 1, c dhe 2 ku parashikohet se:

1. Të gjitha pajisjet mjekësore që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë duhet të regjistrohen në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore që mbahet nga Agjencia e Kontrollit të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Aplikimi për regjistrimin e pajisjes mjekësore në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore paraqitet nga:

c) tregtuesit me shumicë të pajisjeve mjekësore

2. AKBPM-ja lëshon një certifikatë për regjistrimin e pajisjes mjekësore në regjistrin kombëtar të pajisjeve mjekësore brenda 30 ditëve nga data e marrjes së aplikimi.

32.1. Rekomandimi: Drejtoria e SUT para miratimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të hartuara nga grupet e punës, duhet të kërkojnë që në kriteret e veçanta të përfshijë kërkesa që parashikohen në ligjin për pajisjet mjekësore në mënyrë që të prokurojë mallra/shërbime me cilësi të lartë duke optimizuar shpenzimet për këto mallra.

Në vijimësi

33. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT" viti-2021, rezulton se:

Komisioni për pritjen dhe administrimin e materialeve mjekësore, nuk ka dorëzuar formularin për realizimin e kontratës Nr.9/20 Prot Datë 01.06.2021, pranë Sektorit të Prokurimeve.

2. Referuar Deklaratave OE pjesëmarrës në procedurën e prokurimit për marrëveshjen kuadër, të cilët kanë deklaruar se:

a. OE T., do të vendosë në dispozicion për çdo operacion që do të kryhet, setet e montimit (minimumin një set montimi) dhe tre specialist të trajnuar për përdorimin e tyre. Specialistët e trajnuar nga kompania prodhuese e seteve dhe materialeve mjekësore janë: E.Gj., K. S. dhe E. L.

b. OE L. do të vendosë në dispozicion për çdo operacion që do të kryhet, setet e montimit (minimumin një set montimi) dhe 3(tre) specialist të trajnuar për përdorimin e tyre. Specialistët e trajnuar nga kompania prodhuese e seteve dhe materialeve mjekësore janë: F. S., I. Sh., D.Sh. dhe E. Gj.

c. OE O. do të vendosë në dispozicion për çdo operacion që do të kryhet, setet e montimit (minimumin një set montimi) dhe 1(një) specialist të trajnuar për përdorimin e tyre.

Specialisti i trajnuar nga kompania prodhuese e seteve dhe materialeve mjekësore është: M. K.

Nga auditimi i regjistrave të bllokut operator qendror, rezulton se:

-Në sallën e operacionit sipas detyrimit të nenit 5 të kontratës së furnizimit, si përfaqësueses të firmës kanë asistuar edhe z. I. K., z. A. M., R.Z., R. G., persona që nuk janë deklaruar nga OE fitues të kësaj procedure me të cilët është lidhur marrëveshje kuadër.

-Shkëmbimi i materialeve ortopedike të grupit sinteza nuk është dokumentuar me proces verbal sipas përcaktimit të pikës 5 paragrafi i dytë i kontratës nr.1/2021 të furnizimit, por nga ana e mjekut kirurg operues është lëshuar recetë mjekësore për pacientin që do të operohet duke përshkruar materialet ortopedike që duhen për këtë operacion, siç pasqyrohet në faksimilen nr.5, 6 dhe 6/1 të Aneksit 2.8.1.

-Pajisjet mjekësore të marra në dorëzim nga komisioni përkatës nuk janë të shoqëruar me etiketën në gjuhen shqipe, veprim në mospërputhje me nenin 20 (Etiketimi dhe instruksionet për përdorim) të ligjit 89/2014 "Për Pajisjet Mjekësore", ku parashikohet se:

a. Çdo pajisje mjekësore, që vendoset në treg dhe vihet në shërbim, duhet të përmbajë

etiketën në gjuhën shqipe, e cila duhet të paraqitet në një formë të dukshme dhe të lexueshme.

b. Instruksione për përdorim nuk do të kërkohen për pajisjet e klasave I dhe II.

c. Rregullat për etiketimin dhe instruksionet për përdorimin e pajisjeve mjekësore miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

33.1. Rekomandimi: Titullari i institucionit të ngrejë grupe pune për të analizuar gjithë procesin e administrimit të materialeve ortopedike duke filluar nga planifikimi dhe qarkullimi i tyre deri tek shërbimi i ortopedisë, gjithashtu për rastet e gjenerimit të recetave mjekësore për materialet sinteza të bëjë një analizë të hollësishme të këtij fenomeni dhe të nxjerr akte administrative mbi dokumentimin e tyre, të ngjashëm me rastin e administrimit të protezave me anë të proces verbaleve duke i identifikuar këto materiale me të dhënat që ato janë bërë hyrje në farmaci.

Në vijimësi

34. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-viti 2022” rezulton se:

BOE T.&L. dhe OE O. në cilësinë e kontraktuesit, gjatë dorëzimit të mallit sipas kontratave respektive nuk kanë shoqëruar mallin me certifikatën e regjistrimit pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Në këto kushte komisioni i pritjes dhe kolaudimit të mallit ka vepruar në mospërputhje me pikën j) të kriterit 2.3 paragrafi i dytë ku është përcaktuar se:

OE duhet të paraqesin një deklaratë ku të shprehet se do të vendosi në dispozicion të Ak, certifikatat e origjinës së mallit (implanteve) dhe certifikatat e regjistrimit të mallit pranë Institucioneve përkatëse në RSH. Certifikatat duhet të shoqërojnë mallin sipas kontratave të furnizimit që do të nënshkruhen përgjatë periudhës 24 mujore.

Në Kontratën nr. nr. 50/22 prot. datë 04.11.2022 dhe nr.50/27 prot., datë 16.12.2022 nuk kanë reflektuar kërkesat e parashikuara në DST të procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e ortopedisë në SUT” duke mos përfshirë në to, kërkesat e kriterit 2.3 pika “j”, konkretisht të paraqitjes së certifikatës së regjistrimit të mallit pranë AKBPM dhe certifikatës së cilësisë së mallit në fazën e dorëzimit të mallit.

Për sa më lart, hartuesit e kontratës për këtë procedurë kanë vepruar në mospërputhje me kërkesat e parashikuara dhe të miratuara nga titullari i AK.

34.1. Rekomandimi: Titullari i institucioni të marrë masa që komisioni i pranimit dhe drejtuesi i shërbimit të farmacisë qendrore, gjatë procesit të marrjes në dorëzim të mallrave, të kërkojnë që mallrat të shoqërohen me dokumentacionin e kërkuar nga AK, në rastin konkret të certifikatave të origjinës së mallit dhe të certifikatës së regjistrimit pranë AKBPM.

Në vijimësi

35.Gjetje nga auditimi: Në lidhje me auditimin e pikës 2.8.1. Evidenca dokumentare e qarkullimit të materialeve ortopedike, rezulton se:

Materialet ortopedike të tërhequra nga kryeinfermierja e bllokut operator qendror dhe që janë gjendje dhe inventar i shërbimit të ortopedisë për të 3 (tre) pavijonet e saj, qëndrojnë në ambientet e zyrës së kryeinfermieres të ndara e të vendosura në rafte/dollap sipas furnitorëve (T., L. dhe O.)

Në marrëveshjeve kuadër është përcaktuar që duhet të jetë prezent një specialist i këtyre firmave gjatë operacionit me setin e veglave që shërbejnë për montimin e implanteve.

Në asnjë nen apo klauzolë në kontratën e 2.8.1 apo të marrëveshjes kuadër nuk është parashikuar që përfaqësuesi i firmës kontraktuese përveç setit të veglave që shërbejnë për montimin e protezave me komponentët e saj, të ketë me vete edhe materialet ortopedike të sjella jashtë SUT-së.

Shkëmbimi i pretenduar i materialeve ortopedike, sipas strukturave përgjegjëse në SUT bëhet sepse këto materiale nuk janë gjendje sipas llojit dhe përmasave që kërkojnë mjekët kirurg operues gjatë realizimit

të operacionit. Nga auditimi i sistemit të menaxhimit spitalor, rezulton se, te gjitha protezat dhe komponentët e tyre për 14 raste, ishin gjendje në bllokun operator qendror dhe në farmaci.

Për më shumë që shkëmbimet, nëse do të ishin të nevojshme duhet të ishin bërë vetëm nëpërmjet farmacisë, siç përcaktohet në nenin 5 të kontratës së furnizimit (Afatet e Lëvrimit dhe kushtet e lëvrimit), ku parashikohet se:

Të gjitha materialet do të sillen me anë të kontratës së furnizimit në SUT mund të ndërrohen (mallrat/materialet do të qëndrojnë të magazinuara në farmacinë e SUT) sipas përmasave dhe llojeve të kërkuara rast pas rasti. Çdo material që do të nderohet, duhet të pasqyrohet me anë të një procesverbali të cilin e firmosin përfaqësuesit e OE dhe përfaqësuesit e SUT që do të marrin pjesë gjatë operacioneve kirurgjikale rast pas rasti. Vlera e materialeve nuk do të ndryshojë nga ajo e kontratës së furnizimit.

Referuar të dhënave të tabelave të mësipërme të cilat janë nxjerr nga regjistrat e protezave të sipërcituar, rezulton se ka mospërputhje të numrave serial për 14 rastet (pacient) në lidhje me materialet që janë vendosur pacientit, numrat serial (Loti) të materialeve që janë kërkuar për pacientin dhe nr. serial në kartelën e elektronike të këtyre 14 pacientëve.

Kampioni i përzgjedhur prej 14 pacientë është përfaqësues për të gjitha të dhënat e materialeve ortopedike të implantuara tek këta pacientët, pasi të gjithë pacientët që janë të regjistruar në 3 (tre) regjistrat që përfshijnë periudhën 2021 dhe 2022, rezulton se nr.serial (Loti) i materialeve ortopedike nuk kanë përputhje midis materialeve të vendosura, atyre të kërkuara dhe atyre të shkarkuara në kartelën elektronike për këta pacient në sistemin informatik të menaxhimit spitalor SIIS.

35.1.Rekomandimi: Drejtoria e financës, pranë SUT të krijojë dhe të llogarisë si zë më vete shpenzimet për materiale tek llogaria e shpenzimeve të materialeve të shërbimit të ortopedisë, për ti mundësuar sektorit të kostos që të llogarisë dhe të raportoj këto shpenzime të ndara nga njëra tjetra.

35.2.Rekomandimi: Drejtoria e financës të filloj të përgatisë një model bilanci mujor/vjetor dhe progresiv në lidhje me hyrjet daljet dhe gjendjen e materialeve ortopedike të identifikuar sipas kodit ATC dhe nr.serial (lote) dhe të raportoj për çdo muaj pranë Drejtorisë së Spitalit Universitar të Traumës, për të mundësuar ndjekjen dhe monitorimin e qarkullimit të materialeve ortopedike.

35.3.Rekomandimi: Drejtoria e SUT, në bashkëpunim me kryeinfermierin dhe shefin e shërbimit të bllokut operator qendror dhe sektorin juridik të fillojnë hartimin e modelit të Proces Verbalit mbi administrimin e materialeve ortopedike të grupit sinteza, dhe regjistrin e veçantë për këto materiale, për të mundësuar gjurmën e auditit.

35.4.Rekomandimi: Titullari i institucionit të përcaktojë nëpërmjet akteve administrative procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me materialet e sintezës që nga momenti i fillimit të sterilizimit të tyre duke i identifikuar sipas hyrje daljeve dhe numrave identifikues për nevojat e bllokut qendror operator.

Nga ana e titullarit të institucionit të përcaktohet qartë gjithë procedura dhe të nxirren udhëzues se si do të dokumentohet ndërimi **vetëm për rastet** që në magazinën e farmacisë apo të pavijonit nuk gjendet materiali ortopedik që nevojitet gjatë ndërhyrjes kirurgjikale.

35.5.Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të Institucionit të emetohen akte administrative në lidhje me sasi të nevojshme dhe të domosdoshme që duhet të mbahen në ambientet e bllokut operator qendror në lidhje me materialet ortopedike, ku të përshkruhen procedura dhe udhëzues sesi ato do të lëvizin nga farmacia tek blloku operator qendror.

35.6.Rekomandimi: Nga ana e Titullarit të Institucionit nëpërmjet akteve (urdhër, udhëzim) të përcaktohen procedura të qarta që duhen të ndiqen mbi administrimin e materialeve ortopedike të sintezës pas heqjes nga pacienti, seleksionimin e tyre mbi mundësinë e ripërdorimit për ato materiale që janë në gjendje të mirë.

35.7.Rekomandimi: Drejtoria e financës të realizojë inventar të gjendjes së materialeve ortopedike në ambientin e kryeinfermierit, të ballafaqoj me daljet e farmacisë dhe gjendjes fillestare të tyre gjatë marrjes në dorëzim nga farmacia.

35.8.Rekomandimi:Drejtoria e Spitalit Universitar të Traumës të marrë masa që materialet ortopedike që implantohen/vendosen tek pacienti të përputhen me materialet ortopedike sipas nr.serial (lotëve) që pasqyrohen në kartelën elektronike të pacientit tek moduli i kostos në sistemin e menaxhimit spitalor SIIS.

35.9.Rekomandimi:Nga drejtoria e SUT, të analizohet dhe të nxirren përgjegjësitë për mos dokumentimin në regjistrat e mbajtur në bllokun operator qendror të materialeve ortopedike të përdorura gjatë ndërhyrjeve kirurgjikale, pasi për vitin 2021 nga ana e bllokut operator qendror, nuk janë dokumentuar **667** operacione dhe **811** për vitin 2022.

Menjëherë dhe në vijimësi

36. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me piken 2.8.2. Inventarizimi i pajisjeve mjekësore, nga auditimi rezulton se në SUT gjendet një sasi e konsiderueshme e pajisjeve mjekësore në vlerën **38,731,930 lekë** që janë jashtë funksionit dhe të rrezikshme për shëndetin e pacienteve dhe personelit spitalor.

Asnjë nga pajisjet mjekësore pjesë e inventarit të SUT nuk janë regjistruar në sistemin Clingo të Qendrës Kombëtare të Inxhinierisë Biomjekësore.

Titullarët e institucionit për periudhën objekt auditimi nuk kanë zbatuar dhe ndjekur politikat kombëtare për menaxhimin e pajisjeve mjekësore në Shqipëri, të cilat janë përcaktuar qartë në urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 3272, datë 11.09.2007 “Politika Kombëtare për Menaxhimin e Pajisjeve Mjekësore në Shqipëri, si më poshtë:

Është përgjegjësi e Drejtorit të spitalit për zhvillimin e procedurës për mënyrën e raportimit të ngjarjeve të padëshirueshme dhe marrjen e sinjaleve të alarmit nga pajisjet mjekësore si dhe njohjen e personelit mjekësor me këto procedura.

36.1. Rekomandimi: SUT në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Inxhinierisë Biomjekësore të bëjë vlerësimin mbi gjendjen aktuale të funksionimit të pajisjeve mjekësore dhe mundësisë së vënies së tyre në funksion për pajisjet mjekësore që nuk punojnë dhe njëkohësisht nga ana e SUT të ndiqen procedurat ligjore në fuqi për asgjësimin e pajisjeve mjekësore që janë jashtë përdorimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

37. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi Mbi zbatimin e kontratës koncesionare të Sani Service, rezulton se: Koncesionari S.S. nuk ka dorëzuar pranë SUT dokumentacionin në lidhje me administrimin e mbetjeve të rrezikshme, e konkretisht:

- Nuk ka dorëzuar Rregulloren e Brendshme për administrimin e mbetjeve spitalore brenda njësisë funksionuese, në kundërshtim me VKM nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, Kreu II, pika 7.1.

- Nuk ka dorëzuar Planin për administrimin e mbetjeve spitalore, në kundërshtim me VKM nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore””, Kreu II, pika 7.2.

- Nuk ka dorëzuar Regjistrin e veçantë për mbetjet spitalore, në kundërshtim me VKM nr. 798, datë 29.09.2010, Kreu III, pika 8.13 dhe Kreu VI, pika 12.2, germa ç.

- Nuk ka dorëzuar Formularin e veçantë “Dokumentimi transferimit të mbetjeve të rrezikshme”, në kundërshtim me VKM nr. 371, datë 11.06.2007.

37.1. Rekomandimi: Titullari i institucionit të kërkojë nga grupi i monitorimit të kontratës koncesionare me objekt “Kontratë koncesioni për ofrimin e shërbimeve të integruara të furnizimit të setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale sterile, furnizimin me material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimin e mbetjeve me rrezik biologjik dhe dezinfektimin e sallave kirurgjikale” informacion të plotë mbi ecurinë e saj, dhe të nxjerr përgjegjësitë për mosrespektimin të kushteve kontraktuale nga koncesionari.

37.2. Rekomandimi: Drejtori i Spitalit, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të marrë masa për plotësimin nga Konkensionari SaniService SHPK të dokumentacionit të plotë mbi administrimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore.

Menjëherë dhe në vijimësi

38. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pikës 2.8.3. mbi kushtet e ruajtjes së barnave dhe materialeve të mjekimit, rezultoi se:

Në Farmacinë qendrore të SUT-së gjendej një sasi e madhe e medikamenteve që nuk kishin vulën e kuqe me mbishkrimin “për përdorim spitalor ndalohet shitja”, pasi bazuar në , në pikën 1 të Urdhrit nr. 287 datë 12.07.2022 të MSHMS parashikohet se:

Barnat që qarkullojnë në sistemin shëndetësor publik përveç pullës se sigurisë duhet detyrimisht të jene të vulosura edhe me vulën me mbishkrimin” Përdorim Spitalor-Ndalohet Shitja” dhe në pikën 4 të këtij urdhri përcaktohet se:

Boja që përdoret për stampimin e vulës të jetë me ngjyrë të kuqe që nuk fshihet.

Gjithashtu në magazinën e mallrave krahas tyre gjendeshin edhe barna, materiale të mjekimit dhe pajisje mjekësore jashtë përdorimit e me rrezikshmëri për shëndetin e njeriut.

Magazina e mallrave të SUT nuk plotëson në asnjë drejtim kushtet e ruajtjes së barnave duke shtuar këtu se në këtë ambient gjenden dhe pajisje mjekësore jashtë përdorimit si radiografi etj., kjo në mospërputhje me urdhrin nr. 660 datë 20.09. 2018 të MSHMS, për miratimin e rregullores mbi praktikën e ruajtjes dhe shpërndarjes së mirë të barnave, nëni 5 pika 2 dhe nënenet në vijim të këtij urdhri ku parashikohet se:

Zonat e magazinimit duhet të jenë të përshtatshme për të siguruar kushte të mira të ruajtjes. Në veçanti, ato duhet të jenë të pastra, brenda kufijve të temperaturës dhe lagështirës. Kushtet e ruajtjes duhet të sigurohen, kontrollohen, monitorohen sipas specifikimeve në etiketën e barit.

Barnat nuk duhet të jenë në kontakt të drejtpërdrejtë me dyshemenë dhe muret e të kenë hapësirë të përshtatshme për të lejuar pastrimin dhe inspektimin.

38.1. Rekomandimi: Drejtori i Spitalit të SUT, në raste të pa mundësisë për të magazinuar barna apo materiale mjekimi në Farmacinë qendrore duhet ti vendos ato në ambiente të sigurta dhe me kushte të mira të ruajtjes dhe në asnjë rast në magazinën e mallrave e cila është e pa përshtatshme për ruajtjen e këtyre barnave apo materiale mjekimi.

Në vijimësi

39. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pikës 2.8. të ndryshme rezulton se:

SUT nuk ka ambient dhe nuk është i pajisur me frigorifer-morg, për të bërë administrimin e trupave të pacientëve që ndërrojnë jetë në SUT.

Në vitin 2021 pranë këtij spitali kanë nderuar jetë 90 pacient.

SUT nuk ka krijuar ambiente të përshtatshme për të ushtruar veprimtarinë e tyre ligjore strukturat përgjegjëse të parashikuara në legjislacionin në fuqi, duke vepruar në mospërputhje me parashikimet e Kreut IV -Kërkesat dhe klasifikimi i Spitaleve, nëni 31, shkronja g, të Ligjit nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë” dhe të Aneksit II, pika 8, të VKM-së nr. 237, datë 06.03.2009.

39.1. Rekomandimi: Titullari i Institucionit në bashkëpunim me MSHMS dhe Ministrinë e Drejtësisë, të marrë masa dhe të krijoj ambiente të përshtatshme sipas standardeve të kërkuara për të bërë administrimin e trupave të pacientëve që ndërrojnë jetë në SUT.

Menjëherë

40. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të procedurës së prokurimit “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme e ndarë në dy lote” u konstatua nga verifikimi i urdhër shpenzimeve për kontratën 45/12 dt. 23.08.2022, brenda afatit 5 ditor për faturat e sjella gjendeshin:

Fatura nr. 1340/2022 datë 26.08.2022 në vlerën 5,188,710 lekë + TVSH
Fatura nr. 1327/2022 datë 25.08.2022 në vlerën 1,337,382 lekë + TVSH,
që përbën 1/5 të sasisë totale dhe jo 1/3 që është kërkuar nga A.K. Nga A.K. nuk është kërkuar penaltet për O.E., pasi Fatura e 3 është Fatura nr. 1304/2022 dt. 31.08.2022 në vlerën 4,564,688 lekë e sjellë 3 ditë me vonesë. Duke qenë se materialet e mjekimit janë të një rëndësie të lartë dhe jetike, kalimi i afateve sado i vogël të jetë, sjell mos përmbushje të objektivave të spitalit.

40.1.Rekomandim: Grupi i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës, gjatë kryerjes së detyrës, të bazohet në kushtet e kontratës, për plotësimin e plotë të tyre si dhe të marrë masat e duhura në mos plotësimi të kushteve të kontratës nga ana e O.E. dhe të kryejë llogaritjen dhe kërkojë penalizimin e tyre.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për automjetin 619 013 janë regjistruar dy urdhër shpenzime, ndërkohë që sipas fletë-udhëtimeve nuk ka informacion që ky automjet të ketë lëvizur përgjatë vitit 2021. Në Urdhër-shpenzimin nr. 122, datë 09.08.2021 janë likuiduar shërbim mirëmbajtje automjetesh sipas kontratës nr. 79/29, datë 23.04.2021 për automjetin me targë 619 013. Vlera e likuiduar në këtë urdhër shpenzim është **116,400 lekë**, e cila përbën dëm ekonomik. Ndërsa në Urdhër-shpenzimin nr. 239/1, datë 31.12.2021 janë likuiduar shërbim mirëmbajtje automjetesh sipas kontratës nr.3/15, datë 08.10.2021 për automjetin me targë 619 013. Vlera e likuiduar në këtë urdhër shpenzim është **21,600 lekë**, e cila përbën dëm ekonomik.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Kontratën S/2021 Neni 11 pika 2, Kontrata S/2022 Neni 13 pika 2; Kontrata S/2021 Neni 11 pika 2, Kontrata S/2022 Neni 13 pika 2; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar; si dhe Kontrata S/2021 Neni 11 pika 2, Kontrata S/2022 Neni 13 pika 2.

1.1 Rekomandimi: Nga ana e Drejtorit të Spitalit Universitar të Traumës të merren masa për arkëtimin e vlerës 138,000 lekë, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit, duke ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme administrative.

Deri më datë 31.12.2023

2. Gjetje nga Auditimi: Në lidhje me Procedurën e Prokurimit me objekt “Furnizim me barna për nevojat e SUT, e ndarë në 19 lote”, rezulton se, në listën e barnave për përdorim spitalor të miratuara nga MSHMS për vitin 2022, bari me princip aktiv Nadroparine Calcium me formë dozë 5700 IU Axa/0.6ml është bar i regjistruar dhe pjesë e kësaj liste.

OE F. ka paraqitur ofertë për barin me principin aktiv Nadroparine Calcium me formë dozë 5700 IU Axa/0.6ml për njësi (një shiringe parapërgatitur) në shumën 455 lekë pa TVSH.

Anëtarët e Njësisë së prokurimit të AK, SUT., kanë përcaktuar fondin limit për barin tregtar Fraxiparine, nga studimi i tregut, duke mos marrë parasysh çmimin e përcaktuar nga KCB në MSHMS si i vetmi komision ligjor për përcaktimin e çmimeve të barnave të listës së barnave për përdorim spitalor.

OE F. ka ofertuar për barin Faksiparine i cili ka për princip aktiv Nadroparine Calciumi çmimin për njësi 455 lekë (një shiringë e parapërgatitur), ndërkohë që ky çmim duhej të ishte 434,7 leke dhe vlera totale e kontratës për 50000 copë duhej të ishte **21,738,745 lekë**.

Në referim të shkresës nr.1775/3 prot datë 29.06.2023 të MSHMS çmimi CIF për barin Faksiparine me princip aktiv Nadroparine Calciumi është 3.5 euro për shiringë.

Në datën 31.08.2023 që është zhvilluar procedura, kursi i këmbimit zyrtar për 1 euro ka qenë 117.19 leke.

Në zbatim të VKM nr.143 datë 18.02.2015 "Për përcaktimin e marzheve të tregtimit dhe fabrikimit të barnave" për grupin " Gjaku dhe organet formuese te gjakut" në të cilën bënë pjesë dhe bari me princip aktiv Nadroparine Calciumi do te zbatohet një marzh fitimi 6 %.

Si rezultat do të kishim:

$(3.5*117.19)*1.06=434.7$ lekë (një shiringë)

$434.7*50,000$ shiringa=21,738,745 lekë duhej të ishte vlera e kontratës së lidhur me kontraktuesin.

AK., SUT pas shpalljes fitues nga KVO, ka lidhur kontratë me OE F. për sasinë 50,000 copë (shiringa të parapërgatitura) në shumën 22,750,000 lekë.

Për sa më lart, shuma prej **1,011,255 lekë**, e cila përfaqëson diferencën e çmimit të ofertuar dhe të shpallur fitues me atë të përcaktuar nga KCB të MSHMS duhej të ishte 434,7 lekë për njësi, përbën dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të SUT.

2.1. Rekomandimi: Drejtuesi i institucionit të Spitalit Universitar të Traumës, të analizoj veprimtarinë e njësisë së prokurimit për këtë procedurë dhe kryesisht të komisionit të përcaktimit të specifikimeve teknike dhe të përlllogaritjes së fondit limit për barin me princip aktiv Nadroparine Calciumi dhe të nxjerr përgjegjësitë për secilin prej anëtarëve të këtij komisioni, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e shumës prej **1,011,255 lekë** nga OE F.

Deri më datë 31.12.2023

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT" viti-2021, rezulton se:

Komisioni për zhvillimin e minikonkurseve, ka shpallur fitues OE O. i cili nuk plotësonte kushtet e marrëveshjes kuadër pasi, për materialet e renditura në tabelën nr.1 aneksi 2.6.6 çmimi i ofruar nga OE O. në minikonkursin rezulton që të jetë më i lartë se çmimi referent.

Vlera totale prej **498,250 lekë** do të konsiderohet dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit.

Kjo shumë përfaqëson diferencën midis çmimit të ofertuar dhe të shpallur fitues në minikonkursin e parë dhe çmimit referent të marrëveshjes kuadër për sasinë e furnizuar me faturën tatimore nr. 10011/2021 datë 07.06.2021 të mallrave të dorëzuar nga OE O. pranë farmacisë qendrore të SUT.

Në këto kushte komisioni i posaçëm i ngritur për organizimin e minikonkurseve ka vepruar në kundërshtim me LPP dhe akteve ligjore në fuqi duke shpallur fitues OE O., i cili ka ofertuar materialet e paraqitura në tabelën nr.1. me çmimin për njësi me të lart se ai referent.

Për të njëjtat arsye të sipërcituara, Komisioni për zhvillimin e minikonkurseve, ka shpallur fitues OE Orthonet i cili nuk plotësonte kushtet e marrëveshjes kuadër pasi, për materialet e renditura në **tabelën nr.2 aneksi 2.6.6.** çmimi i ofruar për materialet respektive ortopedike nga OE O. në ofertën e shpallur fitues nga ky komision rezulton që të jetë më i lartë se çmimi referent i përcaktuar ne marrëveshjen kuadër.

Vlera totale prej **229,650 lekë** do të konsiderohet dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit.

Kjo shumë përfaqëson diferencën midis çmimit të ofertuar dhe të shpallur fitues në minikonkursin ku është lidhur kontrata Nr.9/42 Prot Datë 04.03.2022 dhe çmimit referent të marrëveshjes kuadër për sasinë e furnizuar me faturën tatimore nr. 71/2022 date 07.03.2022 të mallrave të dorëzuar nga OE O. pranë farmacisë qendrore të SUT.

Në këto kushte komisioni i posaçëm i ngritur për organizimin e minikonkurseve ka vepruar në kundërshtim me LPP dhe akteve ligjore në fuqi duke shpallur fitues OE O., i cili ka ofertuar materialet e paraqitura në tabelën nr.2 me çmimin për njësi më të lart se ai referent.

3.1. Rekomandimi: Drejtuesi i institucionit të Spitalit Universitar të Traumës, të analizoj veprimtarinë e Komisionit për zhvillimin e minikonkurseve për këtë procedurë dhe të nxjerr përgjegjësitë për secilin prej anëtarëve të këtij komisioni, si dhe të përdorë gjithë procedurat administrative për arkëtimin e shumës prej **727,900 lekë** nga OE O.

Deri më datë 31.12.2023

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2021-2022, për kontratat lidhur me O.E. "S.-Al", "Për shërbimin dhe pastrimin e ambienteve të SUT-së për nevojat emergjente" është paguar në total për 10 muaj shuma prej 38,390,546 lekë pa TVSH.

Fondi limit është përlogaritur duke përdorur çmimet e kontratës së fundit, atë të vitit 2018, ku dhe kjo e fundit është bazuar në çmimet e kontratës 7 vjeçare që është nënshkruar në vitin 2010.

Duke marrë për bazë testimin e tregut, statistikave ndërkombëtare si dhe çmimet e ofruara nga O.E. fitues i procedurës së fundit "R." sh.p.k, të cilat janë sa $\frac{1}{2}$ e çmimeve të ofruara nga O.E. "S.Al", duke u konsideruar si një vlerë dhe diferencë e konsiderueshme prej 12,767,096 lekë pa tvsh, shumë e cila përbën vlerë të përdorur pa efektivitet, eficiencë dhe ekonomikitet nga ana e SUT-së në mospërputhje me Nenin 9 "Llogaritja e vlerës së kontratës", VKM Nr. 914, Datë 29.12.2014 Për Miratimin E Rregullave Të Prokurimit Publik, I Ndryshuar Me Vendimin Nr. 823, Datë 21.10.2020

1.1.Rekomandim: SUT, gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, të marrë në konsideratë parimin e ekonomikitetit gjatë përlogaritjes së fondit limit për procedurat e prokurimit që do të zhvillohen, duke përdorur metodat e duhura të përcaktuara në ligj.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit të zbatimit të kontratës për procedurën "Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendshme dhe të jashtme në SUT" zhvilluar nga ABP, u konstatuan problematika në lidhje me zbatimin e kushteve të kontratës, si më poshtë:

Pajisjet makineri pastrimi ishin të papërdorura, duke mos e kryer funksionin e tyre.

Ambienti i parkimit nga ana e djathtë e ndërtesës së SUT-së, e cila përbënte $\frac{1}{3}$ të totalit të sipërfaqes së parkimit, ishte e papastruar dhe gjatë kohës së auditimit në terren nuk u provua pastrimi i tyre. Shuma e përlogaritur për pastrimin e ambientit të parkimit deri në momentin e procesit të auditimit (faza në terren) përbën vlerën prej **278,460 lekë** $((1,092 \text{ m}^2 \times 5 \times 30 \times 0.8) + (1,092 \text{ m}^2 \times 5 \times 30 \times 0.9))$.

Ambientet e magazinimit të produkteve marrë me qira nga O.E. fitues, ishin jashtë standardeve dhe nuk plotësonin kushtet minimale higjienike, në mospërputhje me Nenin 77 "Mbikëqyrja e kontratës", të VKM-së nr. 914 datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i Ndryshuar me Vendimin nr. 823, datë 21.10.2020", Neni 107 "Zbatimi dhe Mbikëqyrja e kontratës", të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

2.1.Rekomandim: Grupi i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës, në lidhje me konstatimet e kryera nga ana e grupit të KLSH-së, të marrë masat për zbatimin e plotë të kushteve të kontratës si dhe garantimin e ambienteve për O.E. me kushtet e duhura higjienike.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit "Furnizim me barna për nevojat e SUT, e ndarë në 19 lote" për lotin 2, rezulton që dokumentacioni i ngarkuar në SEP, nga OE V. kishte mangësi dhe nuk plotësonte kriteret e vendosura nga AK., SUT, të cilat paraqiten si më poshtë:

a. OE V. ka ngarkuar në SEP si eksperiencë të ngjashme fatura tatimore shitje me subjekte private.

Në faturën tatimore të shitjes nr.2079/2021 për vlerën 373,774 lekë për palën blerëse subjektin CFO P., gjendet bari Levofloxacin në vlerën 7,403 lekë, kjo shumë e këtij bari rezulton të jetë më e vogël se 20% i vlerës së fondit limit të kërkuar nga AK në DST në kriterin 2.3.2 tek kriteret e veçanta

b. Faturat e tjerat tatimore të shitjes që ka ngarkuar OE V. në SEP nuk kanë barin me principin aktiv Levofloxacin apo anti-infektivë të përgjithshëm të së njëjtës familje apo grup familje.

- c. Autorizimi për tregtim nr.1785/1 Prot. datë 20.04.2018 lëshuar nga AKBPM për barin Lexacin me princip aktiv Levofloksacin hemihidrati nuk është i vlefshëm pasi ai ka përfunduar në muajin Prill të vitit 2019.
- d. OE Vinipharma nuk e ka regjistruar këtë bar pranë AKBPM, kjo në mospërputhje me pikën 4 të kriterit 2.3. të DST.

Në këto kushte OE Vinipharma nuk duhet të ishte kualifikuar nga KVO dhe nuk duhet të ishte shpallur fitues, si dhe tenderi për këtë lot duhet të ishte anuluar. Titullari nuk duhet të kishte miratuar dhe shpallur fitues OE “V.”.

Konkluzion:

Kualifikimi dhe shpallja fitues nga KVO, i shoqërisë “V. është në kushtet e mos plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk ky OE nuk plotëson disa nga kriteret e DST.

Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte anuluar procedura për këtë lot dhe tenderi duhej të ishte rishpallur. Vlera e kontraktuar prej **410,300 lekë** do të konsiderohet si prokurim i fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet (3-E^{titë}).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Universitar të Traumës të analizoj këtë procedurë dhe të marrë masa për anëtarët e KVO të cilët kanë vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, duke rritur shpenzimet pa efektivitet të buxhetit të SUT në shumën **410,300 lekë**

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Furnizim me barna për nevojat e SUT, e ndarë në 19 lote” për lotin 16 në SEP, rezulton se:

OE F. nuk ka paraqitur autorizimin e regjistrimit pranë AKBPM për barin me princip aktiv Hydrocortizone 100 mg.

Në këto kushte KVO, nuk duhej ta kualifikonte dhe shpallte fitues OE F., sepse ky OE nuk plotëson disa nga kriteret e DST.

Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë KVO duhet të kishte anuluar procedurën për këtë lot dhe tenderi duhej të ishte rishpallur.

Vlera e kontraktuar nga AK., SUT në shumën **320,000 lekë** do të konsiderohet nga grupi i auditimit të KLSH, si një prokurim i fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet (3-E^{titë}). KVO me kualifikimin dhe shpalljen fitues të OE F. ka vepruar në kundërshtim me ligjin 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”. Neni pika

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Universitar të Traumës të analizojë këtë procedurë dhe të marrë masa për anëtarët e KVO të cilët kanë vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën e prokurimeve publike, duke rritur shpenzimet pa efektivitet të buxhetit të SUT në shumën **320,000 lekë**.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale mjekimi specifike për shërbimin e Neurokirurgjisë dhe Kirurgjisë Maxilofaciale”, rezulton se:

OE “O.E.S. D.”, nuk e ka plotësuar këtë kriter, pasi dokumentacioni i ngarkuar në sistemin elektronik është i pa përkthyer dhe i pa noterizuar.

Për sa më lart, kualifikimi i shoqërisë “O.E.S. D.”, nuk është në kushtet e plotësimit të dispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi nuk plotëson disa nga kriteret e DST.

Në kushtet kur në garë nuk ka operatorë të tjerë, KVO duhet të kishte anuluar procedurën për Loti 1 dhe Lotin 2 dhe tenderi duhej të ishte rishpallur, si dhe vlera e kontraktuar për LOTI 1 - **154,356,040 lekë** dhe LOTI 2 - **21,105,600 lekë** përbën prokurim të fondeve publike pa ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet (3-E^{titë}), në kundërshtim me ligjin nr. 162 /2020 “Për prokurimin publik.

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Spitalit Universitar të Traumës të analizoj këtë procedurë dhe të marrë masa për anëtarët e KVO të cilët kanë vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fushën e

prokurimeve publike, duke rritur shpenzimet pa efektivitet për buxhetin e SUT në shumën **175,461,640 lekë**.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me shpenzimet për energji elektrike dhe ujë te koncesionarit S. S., rezulton se:

Për konsumin e energjisë elektrike

[200Khh*4 ore*22 dite*13.2 leke/kWh (me TVSh)] * 64 muaj= **14,868,480 lekë**

Pra në përlogaritjen e përafërt të konsumit të energjisë elektrike është supozuar që autoklava të punojnë 4 orë mesatarisht në ditë dhe çmimi i energjisë elektrike për 1kWh është 13.2 lekë (me TVSH) sipas faturës së energjisë elektrike që paguan SUT për periudhën 16.08.2017 deri 31.12.2022.

Për konsumin e ujit:

Konsumi i përafërt i përlogaritur mbi bazën e të dhënave të SUT në mungesë të matësit të ujit, është: Konsumi i ujit: $10 \text{ m}^3/\text{dite} * 22 \text{ dite} * 64 \text{ muaj} * 156 \text{ leke}/\text{m}^3 = \mathbf{2,196,480 \text{ lekë}}$.

Për sa më sipër, shpenzimet e energjisë elektrike dhe ujit të konsumuar nga koncesionari S. S. SHPK, në vlerën 17,064,960 lekë, përbëjnë efekt financiar negativ për Buxhetin e SUT.

Përlogaritja e përafërt u bë nga grupi i auditimit mbi bazën e të dhënave të siguruar nga sektori i teknik i SUT, tregon që koncesionari krahas kostove të seteve kirurgjikale ka rritur kostot e shpenzimeve për energji elektrike dhe ujë nga buxheti i shtetit.

6.1. Rekomandimi: SUT të marrë masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondeve buxhetore **në vlerën 17,064,960 lekë**, si dhe të kërkojë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rinegociimin e kontratës për pikën 19.5., ku shpenzimet e energjisë elektrike, ujë, avull, vepra civile, impiante etj., të jenë detyrime të Koncesionarit dhe jo buxhetit të spitalit.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të koncesionarit S.S. në lidhje me përdorimin e ambienteve të SUT, konstatohet se:

Sipërfaqja totale në përdorim të koncesionarit është 288.6 m² brenda ambienteve të SUT. Koncesionari e ka përdorur këtë ambient prej datës 16.08.2017 e në vazhdim, pa paguar qira. Në nenin 19.4, të kontratës koncesionare, ndër të tjera përcaktohet se: “*Autoriteti duhet të japë në përdorim, kur është e nevojshme për arsye logjike, hapësirat në zonat spitalore që mund ti lejojnë operatorit koncesionar dhe operatorëve të saj akses dhe përdorim të të gjitha strukturave të ndërtuara si magazina ose aktivitete produktive të back-up, pa u kërkuar një qera dhe/ose rimbursim financiar*”.

Për periudhën në auditim, për sipërfaqen 288.6 m², mbi bazën e përcaktimeve të VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfi-teozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar.

SUT nuk ka përfituar vlerën financiare nga qiraja e ambientit të përdorur nga koncesionari, e cila paraqitet sa me poshtë e llogaritur nga grupi i auditimit të KLSH:

E ardhura e munguar për një muaj, ku çmimi për 1m² është 300 lekë, është:

(288.6 m²*300 leke/m²=86,580 leke/muaj).

Koncesionari prej fillimit të aktivitetit deri me datë 31.12.2022 ka përdorur këtë ambient prej 64 muaj.

Pra e ardhura e munguar nga mos përfitimi i qeras mujore për këtë ambient në total është:

86,580 leke/muaj*64 muaj= 5,541,120 lekë

Për sa më lart, shuma 5,541,120 lekë, përbën të ardhur të munguar për buxhetin e SUT.

7.1. Rekomandimi: SUT të marrë masa, të analizojë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me eficiencë, ekonomikitet dhe efektivitet të fondeve buxhetore **në vlerën 5,541,120 lekë** si

dhe të kërkojë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale rinegocimin e kontratës për pikën 19.5.

Në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me auditimin e pikës 2.8.3. mbi Planifikimin dhe hartimin e listës së barnave, materialeve të mjekimit dhe pajisjeve mjekësore për vitin 2021 dhe 2022, rezulton se:

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion dhe të dhënat e marra nga sistemi informarik SIIS, konstatohet se deri në fund të periudhës së auditimit në magazinën e farmacisë së SUT, gjendet një stok i konsiderueshëm medikamente dhe materiale mjekimi të skaduara, të shkaktuara si pasojë e planifikimit dhe menaxhimit jo eficient nga strukturat përgjegjëse të SUT dhe kërkesave të shefave të shërbimit.

Nga të dhënat e marra nëpërmjet programit informatik të farmacisë SIIS, më datë 06.02.2023 në magazinën e farmacisë së SUT u gjendën barna të skaduara.

Si pasojë e planifikimit dhe keqmenaxhimit përgjatë vitit 2021 dhe 2022 kanë skaduar dhe janë gjendje në farmacinë qendrore të SUT barna në vlerën totale 2,014,241 lekë.

Përveç barnave të skaduara në farmacinë qendrore një sasi e konsiderueshme e barnave të skaduara gjendet dhe në shërbime që kap vlerën 7,261,179 lekë.

*Në magazinën e farmacisë së SUT dhe në pavijone deri në fund të periudhës së auditimit, gjendet një sasi me medikamente të skaduara në vlerën totale **9,275,420 lekë**, e cila përbën një shpenzim jo eficient për SUT duke sjellë një efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit.*

Mungesa e koordinimit të grupit të punës, përgjegjësit të farmacisë dhe shefave të shërbimeve për hartimin e listës së barnave dhe materialeve të mjekimit, gjatë fazës së planifikimit të nevojave të tyre për barna dhe materiale mjekimi, ka ndikuar në mos reflektimin e kërkesave reale të shërbimeve dhe si rezultat të mos tërheqjes së tyre nga shërbimet përkatëse.

Sa më sipër është në mospërputhje me Ligjin 9106 17.07.2013 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit Nr.10296, datë 08/07/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Udhëzim nr. 30 datë 27.12.2011 “për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe kontratat për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore ndërmjet FDSKSH dhe SUT për vitet 2021 dhe 2022.

Për sa më lart, konstatohet se nga drejtuesit e institucionit, brenda periudhës së auditimit nuk janë marrë masat e nevojshme për mos krijimin e stokut të barna dhe materiale të skaduara, veprime në mospërputhje me rregulloren e spitalit dhe kontratën Spitalore me FSDKSH. (mungon neni pika)

8.1. Rekomandimi: Drejtoria e SUT të analizoj shkaqet e krijimit të stokut të barnave dhe materialeve të mjekimit të skaduar në vlerën **9,275,420 lekë**, e cila përbën një shpenzim jo eficient për SUT duke sjellë një efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit dhe gjithashtu të marrë masa e duhura për mos krijimin e stokut të ri në të ardhmen.

8.2. Rekomandimi: SUT të fillojë hartimin e rregullores së re për shërbimin farmaceutik, mbi bazën ligjore në fuqi duke përcaktuar qartë detyrimet dhe përgjegjësit e këtij shërbimi për gjithë fushën e veprimtarisë së vet sipas standardeve të miratuara për ruajtjen dhe qarkullimin e barnave.

8.3. Rekomandimi: Drejtori i SUT të përcaktoj të drejtat dhe përgjegjësit e shefit të shërbimit duke i sanksionuar në aktet administrative (kontratë, urdhër ose udhëzim), dhe në rastet e barnave të skaduara të cilat janë kërkuar prej tyre, të propozoj masa dhe penalitete në masën e dëmit të krijuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT” viti 2022, rezulton se:

Referuar Proces verbalit të datës 07.10.2022 i mbajtur nga KVO, mbi dorëzimin dhe paraqitjen e mostrave të OE L. shpk kishte mospërputhje të specifikimit teknike pasi ato nuk përmbanin elementet e ofertuar sipas të dhënave të katalogëve të ngarkuar në SEP.

Përshkrimi i këtyre artikujve për mostrat e dorëzuara nga ky OE L. pjese BOE "T.&L." dhe të marra në dorëzim nga KVO, nuk kishin përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në DST nga AK në shtojcën 10, pasi mungonte kodi (S/N/Loti apo Ref.) vendi i origjinës së mallit, emri i kompanisë prodhuese, siç AK i parashikonte në kriterin 2.3 pika b të DST.

Kualifikimi i BOE "T.&L." nga KVO bie ndesh me kërkesat dhe kriteret e vendosura dhe të miratuara nga titullari i autoritetit Kontraktor.

Për sa më lart, anëtarët e KVO, kanë vepruar në mospërputhje me kriterin 2.3 pika h e DST, duke kualifikuar padrejtësisht OE L. shpk. Në këto kushte KVO, duhej të s'kualifikonte OE L. shpk

Konkluzion:

- KVO ka kualifikuar OE L. pjese BOE "T.&L." në kushtet kur ky OE, nuk i plotësonte kërkesat e AK në lidhje me listën e paraqitjes së mostrave, duke vepruar në mospërputhje me kriterin 2.3 pika h në DST.

- OE L. si pjese e BOE nuk përmbush kriteret për kualifikim, në këto kushte AK duhej të skualifikonte BOE.

-Pasi KVO ka skualifikuar me të drejtë OE CFO Pharma për mosparaqitjen e plotë të mostrave.

-Në kushte kur OE L., pjese e BOE nuk përmbush kriteret për kualifikim, KVO duhej ta kishte skualifikuar BOE, dhe duke qene se oferta e OE "O." Shpk e kualifikuar por ekonomikisht me pak e leverdishme për AK SUT, duhej ta anulonte këtë procedurë.

Për sa më lart, KVO ka vepruar duke favorizuar BOE edhe pse në kushtet e skualifikimit.

Grupi i auditimit të KLSH vlerën 353.521.600 Lekë të kontratës së lidhur me BOE "T.&L." e konsideron përdorim pa efektivitet të buxhetit të SUT.

*****KVO, ka kualifikuar dy OE pjesëmarrës, respektivisht BOE "T." & "L." SHPK dhe "O." SHPK**

Pas kualifikimit të OE pjesëmarrës, KVO ka pranuar Ofertat ekonomike sipas klasifikimit të mëposhtëm. 1. BOE "T." Shpk dhe "L." Shpk me ofertën ekonomike 353.521.600 Lekë pa TVSH.

2. "O." Shpk me ofertën ekonomike 354.398.600 Lekë pa TVSH.

Formulari i njoftimit të Operatoreve Ekonomik të suksesshëm në marrëveshjen kuadër është bërë me shkresën nr. 50/13 Prot., të datës 11.10.2022

Pas verifikimit edhe të dokumentacionit të shkruar nga OE të cilat sipas KVO përputheshin me ato të ngarkuara në SEP, është nënshkruar Marrëveshja Kuadër nr. 50/16 Prot., datë 25.10.2022, me objekt: "Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT" midis SUT dhe B.OE "T." & "L." SHPK dhe "O." SHPK me vlerën e fondit limit për një afat kohor dy vjeçar. Marrëveshje kuadër nuk është një kontratë më vete, por përcakton kushtet për kontratat që do të lidhen mbi bazën e saj.

Oferta ekonomike, sipas parimit të çmimit më të ulët e ofertuar nga BOE "T. dhe L.", në vlerën 353.521.600 leke pa TVSh, shërben si fond limit për minikonkurset që do të zhvillohen.

9.1.Rekomandimi: Titullari i AK t'i kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të hartimit të kërkesave për kualifikim nga grupet e punës/njësia e prokurimit dhe procesit të shqyrtimit e vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve nga komisionet e vlerësimit të ofertave.

Në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

D1. Për punonjësit marrëdhëniet e punës të cilëve rregullohen me Kodin e Punës:

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar, kontratës individuale të punës dhe Rregullores së Brendshme të institucionit, i rekomandojmë, Ministrin të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të marrë masat për vendosjen e

masave disiplinore si më poshtë, pas shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, konkretisht:

“Ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës” për:

1.Znj.E. B., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i SUT-së:

1.Në cilësinë e Titullarit të institucionit dhe njëkohësisht të Nëpunësit Autorizues nuk ka hartuar dhe miratuar gjurmën e auditit për monitorimin dhe zbatimin e kontratave përgjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të Drejtorit të Përgjithshëm brenda periudhës së auditimit, duke mos siguruar kontrollin e brendshëm kryesisht për të gjitha proceset ekonomiko financiare kryesisht për shërbimet e prokuruar dhe blerjet e barnave , materialeve të mjekimit dhe kryesisht të materialeve ortopedike.

Duke vepruar në mospërputhje me përcaktimet e nenit 5 të ligjit Nr.10296, datë 8.7.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, kreun III, piken 2 të Rregullores së brendshme të SUT nr.1195/3 date 03.06.2022.

2.Në cilësinë e Titullarit të AK dhe miratuesit të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2022,. Në cilësinë e miratuesit të raportit përmbledhës nr. 50/14 Prot. Date 25.10.2022 të KVO, e cila ka kualifikuar OE L. pjesë e BOE “T.&L.” në kushtet kur nuk i plotësonte kërkesat e AK në lidhje me listën e paraqitjes së mostrave, duke vepruar në mospërputhje me kriterin 2.3 pika h në DST.

Në kushte kur OE L., pjesë e BOE “T.&L.” nuk përmbush kriteret për kualifikim, KVO duhej ta kishte Skualifikuar BOE, dhe duke qene se oferta tjetër e kualifikuar e OE “O.” Shpk ishte ekonomikisht me pak e leverdishme për AK SUT, AK duhej ta anulonte këtë procedurë.

Për sa më lart, KVO ka vepruar duke favorizuar BOE edhe pse në kushtet e skualifikimit.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.8. faqe 114-119.

3.Nga verifikimi fizik i kryer në zyrën e kryeinfermierit të bllokut operator qendror nga grupi i auditimit të KLSH, më datë 23.03.2023 rezultojë se në këtë ambient gjendej një sasi e konsiderueshme materialeve ortopedike të pajustificuara dhe të pa inventarizuara nga strukturat përgjegjëse të SUT.

Materialet ortopedike që gjendeshin në këtë ambient ishin materiale ortopedike të llojit Proteza dhe Sinteza, të cilat kishin vlerën ekonomike **35,228,087 lekë.**

Sasia edhe vlera e këtyre materialeve është pothuajse e barabartë me vlerën e materialeve ortopedike që prokurohen me Marrëveshje Kuadër nga SUT gjate një viti.

Këto materiale duhej të ishin në farmacinë e SUT dhe jo gjendje në zyrën e kryeinfermierit.

Gjenda stok e këtyre materialeve në zyrën e kryeinfermierit dhe mungesa e informacionit për sasine gjendjen dhe vlerën financiare të tyre ngarkon me përgjegjësi Drejtorin e Përgjithshëm, pasi ka vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe detyrat e përcaktuara në rregulloren e brendshme të SUT nr.1195/3 date 03.06.2022., kreu III pika 5.

4.Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për administrimin e pllakave dhe vidave dhe përbërësve të tyre, pjesë e grupi “sinteza” rezultoi se:

Për periudhën 2 vjeçare 2021 e 2022 mjekët e shërbimit të ortopedisë kanë gjeneruar **2,680 receta** për pacientët e shtruar në pavijonin e ortopedisë, receta të njëjta me ato që lëshohen në sistemin parësor (për pacientët jo të shtruar në spital) për materiale ortopedike që nevojiten për këta pacientë sipas diagnozës që gjendet në kartelat mjekësore të tyre.

5.Shkëmbimi i materialeve ortopedike të grupit sinteza nuk është dokumentuar me proces verbal sipas përcaktimit të pikës 5 paragrafi i dytë i kontratës nr.1/2021 të furnizimit, por nga ana e mjekut kirurg operues janë lëshuar receta mjekësore për pacientin që do të operohet.

6.Lëshimi i recetave për pacientet e shtruar që marrin shërbim spitalor është në kundërshtim të hapur me ligjin për shërbimin spitalor Nr.9106, datë 17.7.2003, ligjin për kujdesin shëndetësor nr. 10107 datë 30.3.2009, ligjin 10383 date 24.02.2011 për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në

republikën e Shqipërisë, neni 10 pika 1/a ku parashikohet se: 1. Sigurimi i detyrueshëm financon paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, ku përfshihen:

1/a Vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor publik dhe në spitalet publike.

7. Në bllokun operator qendror nuk janë pasqyruar **811 operacione** për vitin 2022 dhe **667 operacione** për vitin 2021 në regjistrat e këtij shërbimi.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8.1. faqe 137-153.

8. Si rezultat i planifikimit të gabuar të medikamenteve dhe materialeve të mjekimit nga shërbimet dhe mungesës së kontrollit nga strukturat përgjegjëse për qarkullimin e barnave dhe sinjalizimi për barnat në prag të skadencës, në SUT brenda periudhës së auditimit kanë skaduar barna dhe materiale mjekimi në shumën **9,275,420 lekë**.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8.3. faqe 160-164 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

9. Nga Titullari i institucionit nuk ka asnjë nisëm për krijimin e ambienteve për administrimin e trupave të pacientëve që ndërrojnë jetë në SUT.

SUT nuk ka krijuar ambiente të përshtatshme për të ushtruar veprimtarin e tyre ligjore strukturat përgjegjëse të parashikuara në legjisllacionin në fuqi, duke vepruar në mospërputhje me parashikimet e Kreut IV -Kërkesat dhe klasifikimi i Spitaleve, neni 31, shkronja g, të Ligjit nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin Spitalor në Republikën e Shqipërisë” dhe të Aneksit II, pika 8, të VKM-së nr. 237, datë 06.03.2009.

Më hollësisht trajtuar në pikën të ndryshme. faqe 164-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

10. Në cilësinë e titullarit dhe nëpunësit autorizues të Spitalit Universitar të Traumës ka lejuar që krahas shërbimit të sterilizimit nga koncesionari Sani Service, në shërbimet Neurokirurgji, Salla e kirurgjisë plastike, Kabineti Maksilo Faciale dhe Reaminacion të SUT-së të përdoren autoklava sterilizuese, të cilat në inventarin e SUT gjenden 9 (nëntë) autoklava sterilizuese në vlerën totale 3,604,584 lekë, duke vepruar në kundërshtim me kushtet e kontratës koncesionare Nr. 1440/40 Prot., datë 24.12.2015.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8.3. faqe 155-157 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

11. Nga titullari i institucionit nuk është zhvilluar procedura për mënyrën e raportimit të ngjarjeve të padëshirueshme dhe marrjen e sinjaleve të alarmit nga pajisjet mjekësore si dhe njohjen e personelit mjekësor me këto procedura. Nga ana e titullarit nuk janë marrë masa për asgjësimin e pajisjeve mjekësore që janë jashtë përdorimit por ato qëndrojnë në ambiente ku dëmtohet shëndeti i njeriut.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8.2. faqe 153-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

12. Në mungesë të efektivitetit të funksionimit të ligjit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në sallën e operacionit sipas detyrimit të neni 5 të marrëveshjes Kuadër nr. 9/14 Prot., datë 17.05.2021, kanë asistuar si përfaqësues të OE kontraktues z. I. K., z. A. M., R. Z., R. G., persona të paautorizuar që nuk janë deklaruar nga OE fitues në këtë procedurë me të cilët është lidhur marrëveshje kuadër me AK SUT.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.7., faqe 105-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2. Z. A. C., me detyrë Zv. Drejtor i Përgjithshëm Teknik i SUT-së.

1. Në cilësinë e kryetarit të KVO, për procedurën Furnizim me barna për nevojat e SUT, e ndarë në 19 lote. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.4. faqe 96-99).

2. Në cilësinë e anëtarëve të komisionit të monitorimit të marrëveshjes Kuadër nr. 9/14 Prot., datë 17.05.2021, për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2021”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.7. faqe 117-119.

3. Në cilësinë e anëtarëve të KVO për procedurën me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2022”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.8. faqe 124-126.

4.Në cilësinë e anëtarëve të KVO në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2022”.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.8. faqe 124-126.

5.Në cilësinë e anëtarëve të komisionit të posaçëm për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes kuadër nr. 50/16 Prot., datë 25.10.2022 dhe të Zv.Drejtorit Teknik në SUT.

6.Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për administrimin e pllakave dhe vidave dhe përbërësve të tyre, pjesë e grupi “sinteza” rezulton se:

Për periudhën 2 vjeçare 2021 e 2022 mjekët e shërbimit të ortopedisë kanë gjeneruar **2,680 receta** për pacientët e shtruar në pavijonin e ortopedisë, receta të njëjta me ato që lëshohen në sistemin parësor (për pacientët jo të shtruar në spital) për materiale ortopedike që nevojiten për këta pacientë sipas diagnozës që gjendet në kartelat mjekësore të tyre.

7.Shkëmbimi i materialeve ortopedike të grupit sinteza nuk është dokumentuar me proces verbal sipas përcaktimit të pikës 5 paragrafi i dytë i kontratës nr.1/2021 të furnizimit, por nga ana e mjekut kirurg operues janë lëshuar receta mjekësore për pacientin që do të operohet.

Lëshimi i recetave për pacientet e shtruar që marrin shërbim spitalor është në kundërshtim të hapur me ligjin për shërbimin spitalor Nr.9106, datë 17.7.2003, ligjin për kujdesin shëndetësor nr. 10107 datë 30.3.2009, ligjin 10383 date 24.02.2011 për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në republikën e Shqipërisë, neni 10 pika 1/a ku parashikohet se: 1.Sigurimi i detyrueshëm financon paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, ku përfshihen:

1/a Vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor publik dhe në spitalet publike.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8.1. faqe 137-153.

8. Në cilësinë e kryetarit të KVO në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale konsumi (implante ortopedike) për Shërbimin e Ortopedisë në SUT-2022, ka kualifikuar OE L. pjese BOE “T.&L.” në kushtet kur nuk i plotësonte kërkesat e AK në lidhje me listën e paraqitjes së mostrave, duke vepruar në mospërputhje me kriterin 2.3 pika h në DST.

Në kushte kur OE L., pjese e BOE “T.&L.” nuk përmbush kriteret për kualifikim, KVO duhej ta kishte Skualifikuar BOE, dhe duke qene se oferta tjetër e kualifikuar e OE “O.” Shpk ishte ekonomikisht me pak e leverdishme për AK SUT, AK duhej ta anulonte këtë procedurë.

Për sa më lart, KVO ka vepruar duke favorizuar BOE edhe pse në kushtet e skualifikimit.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.8. faqe 114-119.

9. Në cilësinë e anëtarëve të komisionit të monitorimit të marrëveshjes Kuadër nr. 9/14 Prot., datë 17.05.2021, në sallën e operacionit kanë asistuar si përfaqësues të OE kontraktues z. I.K., z. A. M., R. Z., R.G., persona të paautorizuar dhe që nuk janë deklaruar nga OE fitues në këtë procedure me të cilët është lidhur marrëveshje kuadër me AK SUT.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6.7., faqe 105-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

3. E. R., me detyre zv Drejtor i Përgjithshëm Ekonomik i SUT-së:

1.Në cilësinë zv.Drejtorit ekonomik dhe njëkohësisht nëpunësit zbatues nuk ka hartuar gjurmën e auditit për monitorimin dhe zbatimin e kontratave përgjatë periudhës së ushtrimit të funksionit të zv.Drejtorit të përgjithshëm ekonomik brenda periudhës së auditimit, duke mos siguruar kontrollin e brendshëm kryesisht për të gjitha proceset ekonomiko financiare kryesisht për shërbimet e prokuruar dhe blerjet e barnave , materialeve të mjekimit dhe kryesisht të materialeve ortopedike.

Duke vepruar në mospërputhje me përcaktimet e nenit 5 të ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, kreun III, piken 5 të Rregullores së brendshme të SUT nr.1195/3 date 03.06.2022., ku parashikohet se Zv. Drejtori i përgjithshëm ekonomik:

a. Organizon, drejton dhe kontrollon të gjithë aktivitetin ekonomik dhe financiar të SUT duke mbajtur përgjegjësi për funksionimin e kësaj veprimtarie sipas legjislacionit në fuqi.

- b. Pezullon çdo veprim që kryet në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe rregullat e caktuara në fushën ekonomiko-financiare, ndërhyjnë në organet përkatëse për marrjen e masave.
- c. Organizon, drejton e përgjigjet për sigurimin e bazës materiale të nevojshme për pacientet dhe sigurimin e shërbimit, për administrimin e shfrytëzimin racional të këtyre materialeve, plotëson nevojat e administratës së spitalit e shërbimeve me inventarin e pajisjet e nevojshme.
- d. Organizon punën dhe ndjek zbatimin e të gjitha detyrave për mënjanimin e krijimit të mallrave stoqe si medikamente, materiale mjekimi, konsumi etj.

2. Nga verifikimi fizik i kryer në zyrën e kryeinfermierit të bllokut operator qendror nga grupi i auditimit të KLSH, më datë 23.03.2023 rezultojë se në këtë ambient gjendej një sasi e konsiderueshme materialeve ortopedike e pajustifikuar dhe e pa inventarizuar nga strukturat përgjegjëse të SUT.

Materialet ortopedike që gjendeshin në këtë ambient ishin materiale ortopedike të llojit Proteza dhe Sinteza, të cilat kishin vlerën ekonomike **35,228,087 lekë**.

Sasia edhe vlera e këtyre materialeve është pothuajse e barabartë me vlerën e materialeve ortopedike që prokurohen me Marrëveshjes Kuadër nga SUT gjatë një viti. Këto materiale duhej të ishin në farmacinë e SUT dhe jo gjendje në zyrën e kryeinfermierit.

Gjenda stok e këtyre materialeve në zyrën e dhe mungesa e informacionit për gjendjen fizike dhe vlerën financiare të tyre ngarkon me përgjegjësi Zv. Drejtorin e përgjithshëm ekonomik duke vepruar në mospërputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe detyrat e përcaktuara në rregulloren e brendshme të SUT nr.1195/3 date 03.06.2022., kreu III pika 5.

3. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion për administrimin e pllakave dhe vidave dhe përbërësve të tyre, pjesë e grupi “sintezë” rezultoi se:

Për periudhën 2 vjeçare 2021 e 2022 mjekët e shërbimit të ortopedisë kanë gjeneruar **2,680 receta** për pacientët e shtruar në pavijonin e ortopedisë, receta të njëjta me ato që lëshohen në sistemin parësor (për pacientët jo të shtruar në spital) për materiale ortopedike që nevojiten për këta pacientë sipas diagnozës që gjendet në kartelat mjekësore të tyre.

Lëshimi i recetave për pacientet e shtruar që marrin shërbim spitalor është në kundërshtim të hapur me ligjin për shërbimin spitalor Nr.9106, datë 17.7.2003, ligjin për kujdesin shëndetësor nr. 10107 datë 30.3.2009, ligjin 10383 date 24.02.2011 për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në republikën e Shqipërisë, neni 10 pika 1/a ku parashikohet se: 1.Sigurimi i detyrueshëm financon paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, ku përfshihen:

1/a Vizitat, ekzaminimet dhe trajtimet mjekësore në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor publik dhe në spitalet publike.

4.Në bllokun operator qendror nuk janë pasqyruar **811 operacione** për vitin 2022 dhe **667 operacione** për vitin 2021 në regjistrat e këtij shërbimi.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8.1. faqe 137-153.

5.Në cilësinë e Përgjegjëses së financës për periudhën nën auditim, ka vepruar në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

6.Për periudhën objekt auditimi në SUT nuk është nxjerrë jashtë përdorimit asnjë aset i cili përmbushte kushtet për nxjerrjen jashtë përdorimi.

Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 54-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit

7.Për Kontratat e Qirasë me O.E. “S.-Al” Shpk dhe Kontrata e qirasë me O.E. “R.” Shpk, në cilësinë anëtarit të komisionit të ndjekjes së kontratës ka lejuar vazhdimin e kontratës megjithëse kontraktuesit nuk kishin kontaktor për matjen e harxhimit të energjisë elektrike dhe të ujit duke vepruar në mospërputhje me kushtet e kontratës *Nenin 6 “Detyrimet e palëve” Pika 6.2 “Të drejtat dhe detyrimet e qeramarrësit”*.

Trajtuar më hollësisht pikën 2.7 faqe 121-127.

